

Elaine Heffner

TË JESH NËNË

Elaine Heffner

TË JESH NËNË

Përktheu Marsela Tarelli

Redaktoi Petrit Bezhani



ALSAR
Tiranë. 2013

Elaine Heffner

TË JESH NËNË

Titulli i origjinalit:

MOTHERING

The Emotional Experience of Motherhood

after Freud and Feminism

Përktheu

Marsela Tarelli

Redaktoi

Petrit Bezhani

Faqosja dhe kopertina

Ludi Cami Serica

Botues

ALSAR - Shoqata "Alternativa e së Ardhmes"

Tiranë, 2013

Për Danielin, Andrean dhe

nënë e nënës së tyre

© Të gjitha të drejtat e ribotimit janë të rezervuara.

Asnjë riprodhim i pjesshëm ose i plotë nuk mund të bëhet

pa lejen e botuesit.

ELAINE HEFFNER
600 RIVERSIDE DRIVE
NEW YORK, NEW YORK 10024

February 1, 2011

Dear Marsela,

Here is a copy of my book that you requested. I hope it will be helpful to you in your work with the cultural association for women. I wish you success with that program.

I look forward to hearing more from you about this work.

Sincerely,



Elaine Heffner, Ed.D.

“Një ndërthurje e mirëpritur e logjikës së shëndoshë dhe entuziazmit për karrierën e një nëne me kohë të plotë, me të gjitha sfidat, vështirësitë dhe shpërblimet e saj. Një kundërhelm i plotë për marrëzinë e tridhjetë viteve të fundit të tolerancës së tejskajshme dhe refuzimit të mëmësisë.”

Margaret Mead, antropologe dhe mendimtare e njohur amerikane

“Mos e flakni edhe beben me ujin e govatës. Ky udhërrëfim i kësaj gruaje të mençur drejt mëmësisë së pastudiuar duhet të lexohet nga çdokush, që ka dyshime në të qenit njëkohësisht njeri dhe prind. Ky libër është një thirrje tronditëse – dhe pikërisht në kohën e duhur – për ruajtjen e një prej burimeve tona natyrale më të çmuara: aftësinë për të edukuar.”

Gail Sheehy, autori i “Pasazheve”

Me intuitë dhe mençuri Elaine Heffner diskuton përvojën emocionale të mëmësisë, ashtu siç i është dhënë formë nga dy fenomene të kohës tonë: ndikimi i teorisë psikoanalitike mbi edukimin e fëmijëve dhe lindja e lëvizjes së grave. Psikoanaliza, përfundon ajo, la mbi shpatullat e nënave përgjegjësinë për të rritur fëmijë të shëndetshëm emocionalisht, por nuk iu mësoi atyre se si ta arrinin këtë qëllim, duke i lënë të ndihen fajtores dhe të mbushura me ndjenja paafësie. Lëvizja e grave i është përgjigjur kësaj gjendje të vështirë, duke u përpjekur t'i çlirojë gratë nga roli i nënës, por nuk i ka ndihmuar aspak të jenë të suksesshme në të.

Nëna, më shumë se kushdo tjetër, është e aftë ta kuptojë fëmijën e saj, mendon znj. Heffner. Ajo paraqet një shembull të fortë për rolin e mëmësisë si një “zgjedhje profesionale, në të cilën gratë e meritojnë të përjetojnë vetëvlerësimin që do të përftonin prej çfarëdo kontributi tjetër profesional drejt rritjes njerëzore.”

Ky është një libër prekës, që të bën të të vërshojnë mendimet, që i ofron një dimension tërësisht të ri letërsisë kushtuar marrëdhënies nënë – fëmijë.

Parathënie

Ky libër flet për përvojën emocionale të mëmësisë, ashtu siç i është dhënë formë prej dy fenomeneve të kohës tonë: ndikimi i teorisë psikoanalitike mbi edukimin e fëmijëve dhe lindja e lëvizjes së grave, feminizmi.

Përgjatë përvojës time si nënë, si psikoterapiste, dhe edukatore prindërisht, kam mësuar se nënat kanë vuajtur turp dhe faj në rolin e tyre të të qenit nënë. Mendimi psikoanalitik iu imponoi nënave përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve të shëndetshëm emocionalisht, por nuk iu mësoi atyre se si ta kryenin këtë mision. Pasojat për nënat ka qenë faj i tejskajshëm dhe ndjenjat e të qenit të paafta. Lëvizja e grave i është përgjigjur kësaj gjendje të vështirë me përpjekjen për t'i "çliruar" gratë nga roli mëmësor, në vend që t'i ndihmonte ato të bëheshin të suksesshme në të. Si rrjedhim, nënat jo vetëm që ndihen të papërshtatshme, por ato ndihen sikur nuk kanë të bëjnë fare me këtë çështje. Ndjenja, se mëmësia është një rol i pashpërblyer vjen, mendoj unë, edhe nga një pranim pa dëshirë i vlerës së ulët që i vishet mëmësisë, nga të njëjtat forca negative, që iu japin formë edhe pikëpamjeve të tjera kundrejt grave, si edhe nga fakti se *janë* kaq shumë aspekte të dhimbshme në edukimin e fëmijës, sa që ka pothuajse një dëshirë të përgjithshme për t'u fshirë nga skena. Dhe nënat janë detyruar të besojnë se kjo dhimbje vjen si pasojë e papërshtatshmërisë dhe neurozave të tyre.

“Momentet universale” të edukimit të fëmijës, gjithsesi, janë në fakt, asgjë më pak se një përballje me problemet më kryesore të jetesës në shoqëri: një ballafaqim, nëpërmjet fëmijëve, të të gjithë konflikteve të trashëguara në marrëdhëniet njerëzore, një sqarim i çështjeve që kanë mbetur të pazgjidhura gjatë vetë rritjes së tyre.

Përvoja e edukimit të fëmijëve, jo vetëm që mund ta forcojë njeriun si individ, por ajo shfaq edhe mundësinë për t’iu dhënë formë marrëdhënieve njerëzore të së ardhmes. Fushat e zbulimit të vetvetes, që përfshihen në të qenit nënë, janë klasike dhe mund ta ngrenë eksploruesen nënë në një pozicion që nuk ka lidhje fare me të varurën, të pafuqishmen, nënën e fëmijës, ashtu siç është quajtur dhe është përshkruar nga shumë revista grash dhe libra që flasin mbi përkujdesjen e fëmijëve.

Atëherë kur nënat e përjetojnë këtë lloj vetëçlirimi, jo vetëm që arrijnë rritje personale, por, ato gjithashtu ndihen të lira të përdorin kapacitetin unik që gratë kanë për të kuptuar dhe për të zgjidhur problemet në marrëdhëniet njerëzore. Është procesi i të qenit nënë, që mund të humanizojë në mënyrën më të shkëlqyer. Megjithatë, pikërisht në pikën kur ne jemi më të përqenduar në nevojën për të zhvilluar të gjithë potencialin njerëzor, dukemi të gjithë të prirur në fshirjen e burimit kryesor të realizmit të tij.

Fakti që nënat zënë vendin kryesor në faqet që pasojnë, nuk tregon nënvlerësim të rolit që luajnë baballarët, dhe as mungesë admirimi për ata çifte të rinjsh, që zgjedhin me të vërtetë të ndajnë përgjegjësinë e edukimit. Por, ai pasqyron interesin tim në nxjerrjen në pah të një lloji të veçantë përvoja që gratë kanë patur si nëna. Kur gratë i përkushtohen tërësisht kujdesit ndaj fëmijëve, kjo është një zgjidhje profesionale po aq e rëndësishme sa çfarëdo lloj zgjidhje tjetër dhe, duhet të respektohet si e tillë. Ato e vuajnë pjesën më të madhe të stresit që sjell edukimi i fëmijëve dhe kanë të drejtë të shpresojnë, si mbështjettjen praktike, po ashtu edhe atë emocionale, e cila do t’iu mundësojë këtë lloj profesioni që mund t’iu japë

vetëvlerësimin që meritojnë. Ndiurma dhe mbështjettja e baballarëve është pjesë e kësaj mbështjette dhe, e tepërt ta themi, është po aq e rëndësishme për fëmijët sa edhe për nënat. Por, në të vërtetë, nëna që qëndron në shtëpi për të edukuar fëmijët, bëhet eksperti kryesor për zhvillimin e tyre dhe, ta mohosh këtë është si të mohosh se tek ajo, gjenden aftësi të veçanta për edukimin e fëmijëve. Është pikërisht ky lloj mohimi, që e ka nënvlerësuar në të kaluarën rolin e të qenit nënë.

Njohja e mëmësisë si një rol i çmueshëm, në asnjë mënyrë nuk zvogëlon arritjet e rëndësishme të bëra nga lëvizja e grave në hapjen e të tjera mundësive për to. Është pikërisht prirja për t’i parë këto dy interesa si pashmangshmërisht të kundërta, ajo që e ka bërë mëmësinë të duket si rrezik për liberalizmin dhe i ka lënë nënat të sulmuara nga beteja për të drejtat e grave. Sigurisht, ky nuk ishte qëllimi i gjithçkaje në lëvizjen e grave. Megjithatë, dendësia e pozicioneve teorike të parashtruara, krijoi një klimë shkatërruese për nënat.

Nënat që përmenden në këtë libër, janë nëna që i kam njohur gjatë shumë viteve që kam punuar me prindërit e fëmijëve të vegjël, në klinika dhe shkolla, në grupe, apo në mënyrë individuale. Këta prindër shpesh përballeshin me probleme të jashtëzakonshme në zhvillimin e fëmijëve të tyre. Gjithsesi, ajo që është për t’u vënë në dukje janë shqetësimet e tyre të fshehura. Dhimbja e tyre e veçantë, ka shërbyer për të hedhur dritë mbi pikëpyetjet, çoroditjen, dhe trazirën e brendshme të provuar nga të gjitha ne që kemi rritur fëmijë. Nëse unë iu kam mësuar diçka atyre, është pikërisht ajo, që ato më kanë mësuar mua.

Citimet në kapitullin e parë janë marrë nga intervista me nëna të reja, të cilat u treguan aq zemërgjera sa të më kushtonin pak nga çastet e tyre të lira, për të folur mbi ndjenjat e tyre në këtë erë të liberalizmit të grave. Do të doja t’i falënderoja të gjitha për kohën që më kushtuan dhe ndihmën që më kanë dhënë.

Mirënjohje

Mezi e pres mundësinë për t'iu shprehur mirënjohjen time të gjitha atyre shoqeve dhe kolegeve, të cilat, me dashje, apo pa dashje ndikuan në shkrimin e këtij libri.

Dashamirësia dhe mirënjohja ime e veçantë ndaj:

Sally Arteseros, aftësia për edukim e së cilës mundësoi dorëshkrimet.

Gloria Wagner, për mjeshtërinë dhe përkushtimin e saj dhe duart e saj të arta.

Doris Pfeffer, leximi plot njohuri i dorëshkrimeve të së cilës u bë për mua burim intuitash të reja, ashtu siç ka qenë edhe shoqëria e saj një burim ndihme.

Elisabeth Balliett, një shoqe e dashur dhe bashkëpunëtore prej kohësh, që me të kuptuarit e veçantë të fëmijëve, e ka pasuruar përvojën time profesionale.

Yonata Feldman, që më mësoi të dëgjoja nënat.

Hyman Spotnitz, që më mësoi të dëgjoja veten.

I fundit dhe përjetë, dashurinë dhe vlerësimin tim për bashkëshortin tim, Richard Heffner, i cili patjetër është babai i këtij libri.

Një fjalë të veçantë për dy djemtë e mi: Për durimin tuaj kur mësoja dhe për gatimin e drekës kur shkruaja – dashurinë dhe falënderimet e mia.

Përmbajtja

1. *Mistika e liberalizmit* 15
 2. *Mistifikim dhe faj* 34
 3. *Arti i mëmësisë* 47
 4. *Ju nuk duhet të...* 58
 5. *Rrezik i dyfishtë* 67
 6. *I inatosuri nuk është i keq* 86
 7. *Dialogu nënë – fëmijë* 98
 8. *Mediumi dhe mesazhi: sjellja dhe kuptimi i saj* 112
 9. *Nëna është mësuese* 123
 10. *Qëndro në krye të detyrës!* 136
 11. *Qëllimi i munguar* 145
- Bibliografia* 177

KAPITULLI 1

Mistika e liberalizmit

“Zotërinj, nëna është një shushkë.”

Philip Wylie, *Gjenerata e gjarpërinjve*

Kur teknologjia do të bëjë të mundur krijimin e jetës njerëzore jashtë trupit të femrës, një ditë, që pa dyshim do të vijë, anatomia e gruas, kapaciteti dhe dëshira e saj për të mbajtur dhe rritur fëmijë do të mbeten një burim konflikti për të, po ashtu edhe për ata që kërkojnë të imponojnë mbi të damkën e tyre për fatin e saj të vërtetë.

Problemi që shtrohet këtu është mëmësia. Por, konflikti që ngre ajo nuk është përcaktuar si diçka që ndodhet brenda vetë grave. Përkundrazi, këtij konflikti i është dhënë formë dhe është paraqitur vetëm si një makth i imponuar nga shoqëria. Është thënë se, aftësia e gruas për rritjen e fëmijëve e ka lënë atë të prekur ndaj shtrembërimit të qëllimshëm të natyrës së saj të vërtetë, me qëllim që ajo të mund të detyrohej t’iu shërbente atyre që do ta shfrytëzonin. E thënë shkurt, gratë janë viktimizuar nga mistika famëkeqe e feminitetit, që predikonte ungjillin e vetëplotësimit femëror dhe, shpallte se shprehja më e lartë e këtij vetërealizimi është mëmësia. Ashtu siç na ka shpjeguar Betty Friedan, “Mistika e feminizmit thotë se vlera më e lartë dhe përkushtimi i vetëm për gratë është plotësimi i feminitetit të tyre” dhe se, “gratë vetëm duke qenë gra dhe duke sjellë në jetë fëmijë, do të fitojnë të njëjtin respekt që u takon burrave për arritjet e tyre krijuese.”

Ashtu siç pritej, kjo teori mistike e vetëplotësimit femëror, në realitet, çoi, në po të njëjtin fat të lashtë – zonjë shtëpie, apo nënë. Por, ishte gabim të gjeje në mistikën e feminizmit diç më tepër se një shqetësim të dorës së dytë me vetëplotësimin personal të grave. Tipa si, Ferdinand Lundberg dhe Marynia Fernham, shkrimet e të cilëve stisën mistikën, ishin të motivuar, jo vetëm nga një shqetësim për përqindjen e ulët të lindjeve në atë kohë, po çështje më e rëndësishme, nga një shqetësim i ri që kishte të bënte me neurozën, që barazohej nga disa me mungesën e lumturisë, apo dëshpërimin njerëzor.

Libri “*Gruaja Moderne: Seksi i humbur*” shkruar nga Lundberg dhe Fernham dhe botuar më 1947, që luajti rol kryesor në përhapjen e kësaj mistike, ka si tezën e tij kryesore përfundimin se dëshpërimi në shoqëri ishte në rritje, se shprehja më e qartë e këtij dëshpërimi ishte neuroza, se shkaku për këtë dëshpërim qëndronte në shtëpinë e fëmijërisë, dhe se gratë ishin instrumenti kryesor i krijimit të tij. Pikërisht gratë ishin shkaku i dëshpërimit në botë, sepse dështimi i shoqërisë industriale për të mbajtur familjen, si njësi ekonomike i kishte penguar ato nga një vetëpërmbushje thelbësore. Të paafta për të mbajtur dhe rritur fëmijë në kushte të favorshme, ato ishin bërë neurotike dhe si pasojë po i bënë edhe fëmijët e tyre neurotikë. Shqetësimi i nënkuptuar atëherë, nuk kishte të bënte me vetëplotësimin e grave, por me neurozën, ekuivalentin me emrin e ri të depresionit në kohën tonë. Nëna ishte shkaku i menjëhershëm i neurozës dhe prandaj duhej të bëhej diçka me të.

Mëdyshja ishte se, ndërsa shoqëria kishte zhdukur disa nga funksionet e saj tradicionale, duke e lënë atë kështu, me një rol jo dhe aq të kënaqshëm, shoqëria kishte nevojë për një nënë të lumtur, me qëllim që të siguronte ndopak lumturi edhe për ata që kishte rrotull saj. Zgjidhja ishte t’ua mbushnin mendjen grave se, mëmësia jo vetëm që nuk ishte detyrimi i tyre shoqëror, por gjithashtu edhe burimi i lumturisë së tyre. Kështu, mistika e feminizmit që iu shtua

iluzionit të vetëplotësimit personal, si një shtresë ëmbëlsire për ta bërë ilaçon e hidhur të përgjegjësisë shoqërore më të lehtë për t’u gëlltitur. **Mëmësia është roli i gruas sepse ajo është femër. Për arsye se është femër, ajo ka karakteristika femërore. Dhe, për arsye se ka karakteristika femërore, mëmësia është vetëplotësimi i saj i vërtetë.**

Tash do të dukej e arsyeshme të arrinim në përfundimin se, lirimi i grave nga ky formulim burgosës, do të duhej të realizohej thjesht duke korrigjuar dy nga këto tri pjesë. Feminiteti është diçka më shumë se sa vetëpërmbushje nëpërmjet mëmësisë. Të jesh femër, është më tepër se sa një mandat për mëmësinë. Por, në vend që të zgjidhte më tepër, liberalizimi i grave, zgjodhi më pak. Lëvizja e grave, nuk flaku thjesht një përkufizim shumë ngushtues të feminitetit, që iu linte atyre mbi shpatulla një rol të mirëpërcaktuar shoqëror. Përkundrazi, ashtu si fëmijët, të cilët e vendosin identitetin e tyre duke thënë “jo”, shumë gra i thanë “jo” jo vetëm mëmësisë, por edhe gjithçkaje të trashëguar femërore, që mund të lidhej me një rol të tillë. Me sa duket, lirimi nga ideja se, mëmësia ishte vetëpërmbushja e **vetme** e vërtetë për gratë, kërkonte pranim të idesë se, ajo nuk përmbush **asnjë** nga nevojat e tyre. Lirimi nga një feminitet shtrëngues dukej se kërkonte një mohim të vetë feminitetit. Nën shfrimin retorik dhe teorik të skajshëm, të sajuar për të vërtetuar mungesën tërësore të karakteristikave femërore, shumë gra i thanë “jo” instiktit mëmësor, “jo” aftësive edukative, “jo” intuitës, dhe “jo” ndryshimeve gjinore.

Qëllimi i këtyre zërave të liberalizmit ishte të provonin se të gjitha karakteristikat e personalitetit, që ishin të lidhura me feminizmin nuk kanë asnjë bazë në biologji, po, përkundrazi, janë rezultat i traditës kulturore. Frojdi dhe pasuesit e tij, u sulmuan sepse besuan në cilësitë biologjike dhe instiktive femërore, që e përkufizonin natyrën e gruas dhe kështu të çonin pashmangshmërisht drejt rolit të saj të mirëpërcaktuar. Ideja se, biologjia, jo vetëm që përcaktonte kapacitetin e gruas për të mbartur dhe lindur fëmijë, por, gjithashtu

udhëhiqte tiparet e tjera gjinore, që e pajisnin atë për këtë rol dhe e grishnin për ta përmbushur një rol të tillë, u bë një anatemë. Ndaj u bë detyrë urgjente për të provuar se koncepti i karakteristikave femërore dhe sjellja e shoqëruar me to, imponoheshin jo nga biologjia, por nga kultura (tradita). Tiparet tradicionale femërore thjesht pasqyronin një përgjigje të përshtatur ndaj rolit dhe funksioneve të kërkuara prej grave nga shoqëria. Nëse gratë kishin rënë në kurth nga teoritë e sjelljes së përcaktuar biologjikisht, tani, do të liroheshin nga teoritë e përcaktuara nga kultura. Nuk mjaftonte për të thënë se gratë dëshironin, apo kishin nevojë për një vetëpërmbushje përveç mëmësisë. Ishte e domosdoshme të vërtetohej se nuk kishte kurrë asnjë arsye që ato të ishin nëna në radhë të parë. Ngjashëm, nuk mjaftonte të demonstrohej se, për sjelljen ka përcaktues më shumë se sa biologjikë. Ishte e nevojshme të pohohej se, sjellja përcaktohet vetëm në sajë të faktorëve kulturorë.

Kjo prirje për të polarizuar është karakteristikë e konfliktit. Prezenca e ideve, apo ndjenjave të kundërta është një burim shqetësimi, sepse ato na i kundërvenë pohimet e kundërta dhe na vendosin përballë zgjidhjesh në dukje të pazezistueshme. Një zgjidhje e provuar është të stërthem një rast me shpresën se njëra anë e mosmarrëveshjes do të bëhet aq e fortë, sa ta mposhtë tjetrën. Por, qëndrimet e skajshme që janë zënë nga forcat e kundërta në betejën kundër mëmësisë, mbeten një masë e konfliktit që vazhdon të egërsohet brenda vetë grave.

Mosmarrëveshja që paraqet mëmësia ndaj grave, është si ai që u përshkrua nga Helen Deutsch si “konflikti i pashmangshëm midis interesave të individit dhe atyre të species.” Sipërfaqësisht, ky i referohet, sigurisht, mëdyshjes që mund të ngrihet midis nevojës së llojit për riprodhim dhe interesit të gruas, në diçka tjetër përveç të qenit nënë. Por, ai, gjithashtu i referohet një mëdyshje brenda vetë grave. Kapaciteti biologjik i gruas, për t’i shërbyer llojit nëpërmjet riprodhimit ka plotësuesin e tij psikologjik, instiktin, apo impulsin

për të qenë nënë. Megjithatë, nevoja apo dëshira e saj për të qenë nënë, që rritet nga kapaciteti i saj biologjik për të vepruar kështu, një nevojë dhe dëshirë që është trupëzuar në natyrën e saj për të garantuar se ajo do të riprodhojë, mund të mos pajtohet me nevojat dhe dëshirat e tjera brenda saj. Helene Deutsch është sulmuar për këto teori për natyrën e feminitetit, të shprehura në librin e saj dyvëllimësh me titull “Psikologjia e Grave.” Megjithatë, edhe ajo vetë ishte e qartë se mëmësia nuk ishte e “gjithë historia” për gratë.

Nëse vetëm mëmësia si shprehje psikologjike e shërbimit të gruas ndaj species, do të mbushte jetën e saj psikike, ajo do t’i humbiste cilësitë e saj individuale, dhe do të zhytej në të si të thuash. [Por] dhembshuria e saj prej nëne dhe feminiteti nuk janë të vetmet burime të forcave të saj psikike.

Deutsch vë në dukje se, në shoqërinë tonë gratë nuk kanë pse të humbasin vetveten në detyrën e mëmësisë, sepse ka kaq shumë mundësi për të bërë marrëveshje dhe lëshime midis mëmësisë dhe nevojave, interesave dhe prirjeve të tjera.

Por, mundësia për të bërë kompromis, ofruar nga shoqëria jonë, nuk e eliminon frustrimin e trashëguar në këtë kompromis. Grave iu është dukur ky kompromis i papranueshëm, dhe kjo ka bërë që ato të kërkojnë një zgjidhje të re për konfliktin që i ndan ato në mes. Në përpjekje për ta fshirë njërin, ose tjetrën pjesë të personalitetit të tyre, ato kanë hedhur vështirimin nga një autoritet i jashtëm, drejt një tjetri. Së pari drejt profetëve të psikanalizës, e tash drejt teorive të liberalizmit. Ky përdorim i figurave autoritare është mjet i njohur për të zgjidhur konfliktin. Për shumë njerëz, idetë, apo sjelljet bëhen të pranueshme duke gjetur një autoritet që i shpall ato të vërteta, dhe sjelljen të pranueshme.

Përpjekja për të minuar themelin autoritar për nderimin e vetëplotësimit femëror në rolin e mëmësisë, rezultoi vetëm në

krijimin e një themeli të ri autoritar por, për një përkufizim të ri të vetëplotësimit. Ky përkufizim i ri varej nga fshirja e konceptit të feminitetit. Feminiteti nënkuptonte detyrim dhe dëshirë. Liberalizmi këmbëngulte se, jo vetëm që nuk ekziston asnjë dëshirë në natyrën e gruas për detyrën e mëmësisë, por, gjithashtu nuk ka asnjë bazë mbi të cilën shoqëria të kërkojë shërbimin e saj. Çfarëdo lloj pranimi për të qenë “femërore” do ta linte gruan të prekur ndaj shfrytëzimit. **Ndonëse një përkufizim i gjerë i konceptit të feminitetit, mund t’iu jepte grave shumë vend në të cilin të funksiononin, ato donin diçka më tepër se pak vend – ato donin liri të plotë.**

Siç duket, liri do të thotë se fëmijët nuk janë as shqetësim dhe as përgjegjësi e gruas. Me qëllim që të liroheshin nga roli i nënës, gratë u angazhuan të vërtetonin se ato nuk nevojiteshin fare për këtë. Për ta mbushur boshllëkun e lënë nga largimi i gruas nga rritja e fëmijëve, u duk një paradë e tërë zgjidhjesh. Më e qarta ishte se, gratë duhet të pushonin së linduri, një zgjidhje, e cila nën dritën e rrezikut të mbipopullimit dukej se paraqiste po aq shqetësim për specien, ashtu siç vepruan nxitjet e mëhershme ndaj gruas për të shtuar popullsinë. Na u tha se mbijetesa e njerëzimit tani varej, jo nga përqindja e lindjeve, por nga kufizimi i tyre. Jo vetëm që gratë nuk ishin më të detyruara të përmbushnin detyrimet e tyre riprodhuese, po, përkundrazi, ato do të kryenin një shërbim publik, nëse do të bënin të kundërtën.

Disa ishin më pak optimiste për recetën pa bebe që iu servirej. Ishte e qartë se, ca bebe duheshin dhe ca gra duhej t’i rrisnin ato. Po ky nuk ishte roli parësor i gruas. Edhe burrat, edhe mbarë

shoqëria, duhej të edukoheshin për ta marrë përsipër këtë përgjegjësi. Ideja ishte se, gratë nuk kanë asnjë detyrim për të edukuar fëmijët, por, shoqëria e ka për detyrë të ndërtojë çerdhe dhe kopshte, dhe burrat kanë për detyrë të bëhen, në mos zëvendësues të nënës, atëherë, prindër të barabartë.

Kujdesi komunal i fëmijës ishte zgjidhja e favorizuar nga

të tjerët. Ai u zhvillua, jo vetëm si një mënyrë për t’i liruar gratë nga përgjegjësia mëmësore, por në të vërtetë si një ambient më i mirë se ai i familjes për rritjen e fëmijëve. Hidhej argumenti se fëmijët zhvillojnë cilësitë e pavarësisë dhe të vetëmbështetjes më mirë në grupet e moshatarëve të tyre në çerdhe dhe kopshte, dhe se një përkujdesëse profesioniste mund të bënte një punë më të mirë se nëna. Vetë familja përshkruhej si një formë anakronike dhe patologjike e organizimit shoqëror, që përforcon identifikimin seksual të padëshirueshëm, dhe i detyron fëmijët të mbyllen në një botë të vogël të rriturish.

Të gjitha alternativat e sugjeruara ndaj kujdesit mëmësor të fëmijës, dolën nga kushtet e reja të tilla që sugjeronin që, jo vetëm që nuk është pjesë e natyrës së gruas rritja e fëmijëve, por kujdesi mëmësor nuk është as i nevojshëm as i dëshirueshëm. Tashmë jemi vite dritë larg nga artikulli i Revistës së Prindërve e vitit 1950, i cili shtronte pyetjen “A duhet të punojë një nënë?”

Një nënë duhet ta pyesë veten nëse puna e saj do të sjellë një fëmijë të lumtur, një burrë të kënaqur, një jetë të qetë në shtëpi, një komunitet më të mirë. Apo puna e saj do ta bëjë njomëzakun të ndihet i privuar nga një fëmijëri normale, burrin e saj të ndihet si një bashkëshort dhe furnizues i papërshatshëm? A do të bëhet shtëpia e saj një ambient në të cilin zbatohet orari? Për shkak të vendimit të saj për të punuar, a do të ketë të bëjë komuniteti me një shtëpi të shkatërruar dhe një fëmijë potencialisht të shthurur?

Çdo grua që ia bën vetes këto pyetje sot, do të zbulojë statusin e saj të “skllavit”. Ajo do të qëndrojë e ekspozuar si një viktimë e shpëlarjes së trurit nga ambienti përreth. Mistika e liberalizmit lejon vetëm një pyetje: “A po përmbush unë potencialin tim njerëzor për arritje krijuese në botën e vërtetë?”

Është një ironi finale se, në fund, zërat e liberalizmit i pranojnë

kushtet e vërteta të mistikës femërore, që u nisën t'i shkatërrojnë: Feminitet do të thotë vetëpërmushje nëpërmjet mëmësisë; kreativiteti femëror është i ndryshëm nga ai njerëzor, që në të kaluarën kishte qënë rezervuar vetëm për burrat. Prandaj, nëse grave do t'u duhet të lirohen të përmushshin potencialin e tyre njerëzor, ato duhet të njohin potencialin e tyre femëror. Paradoksi qëndron se, duke vazhduar të pranonin një përkufizim të cunguar të feminitetit, gratë iu bashkohen armiqve të tyre, duke mos iu përcaktuar asnjë fuqi apo vlerë përbërësve të veçantë femërore të personalitetit të gruas. Ato, po ashtu, bashkohen në një qëndrim përbuzës kundrejt mëmësisë, meqë bien dakord se gjithçka që është kuptimplotë dhe e vlefshme gjendet pikërisht në përpjekjet e meshkujve. Të paafta për ta trupëzuar feminitetin në humanitet, ato kanë rënë në grackë, në një pozicion ku, duhet të dorëzohen, ose, të paktën ta ndajnë veten prej atyre që nuk gjejnë asnjë vetërealizim në rolin mëmësor. Ne mbetemi me formulimin në vijim: Femërorja nuk është njerëzore; gratë janë njerëz, për këtë arsye, ato nuk janë femërore. Meqenëse femërore do të thotë nënë, nëna duhet të vazhdojë të përjashtohet nga komuniteti njerëzor.

Është e pamundur të mos habitesh se përse një lëvizje e cila shpallte shqetësim për fatin e të gjitha grave, ka vepruar kaq egërsisht, në mënyrë kaq shkatërrimtare, sa nuk i gjendet shoqja. A mund të ndodhë që ata të cilët organizojnë shoqërinë ta perceptojnë si kërcënimin më të madh, jo shovinizmin e burrave, apo qëndrimet shkatërruese të kulturës tonë, por impulsin për të qënë nënë brenda vetë grave? Sepse është nevoja, (biologjike, apo e induktuar nga kultura?) për të lindur dhe edukuar fëmijë, e cila ndërhyr me ndjekjen e shpenguar të arritjeve në fusha të tjera dhe plotësimin e aspekteve të tjera të qenies së gruas. Është ndjeshmëria e gruas ndaj plotësimit të nevojave të fëmijës, ajo që i bën ato të prirura për t'u shfrytëzuar dhe kërcënim se ato do të mbyllen brenda një roli të kufizuar.

Konflikti është i trashëguar në natyrën e njeriut, por paaftësia jonë për t'u përballur me të me sukses, na shtyn vazhdimisht për të kërkuar mënyra për të fshirë njërin apo tjetrin pjesë të skajeve të tij, me besimin se kjo do të sjellë lirim prej dhimbjeve. Përkundrazi, ne gjejmë vetëm një lloj të ri dhimbjeje, rrjedhimin e të jetuarit me mohim të nevojave dhe ndjenjave që janë pjesë e vetes tonë.

Grave, njëherë e një kohë, iu ishte thënë se mënyra e vetme për të qënë grua e vërtetë arrihej nëpërmjet mëmësisë. Me qëllim që të ishin të plota, ato duhej të sakrifikonin ato pjesë të vetvetes që mezi prisnin të shfaqeshin në mënyra të tjera. Tani, grave iu thuhet se, me qëllim që të vetëplotësohen duhet të sakrifikojnë impulsin për të qënë nëna. Me qëllim që të lirohen, ato duhet të prishin çargun e mëmësisë. Asnjëra prej këtyre pikëpamjeve nuk iu drejtohet në mënyrë të plotë ndjenjave të grave. Ashtu si mesazhi i parë u kuptua gabim nga shumë gra atëherë, edhe i dyti kuptohet gabim prej shumë prej tyre në ditët e sotme. Vetëm se pesha e autoritetit të jashtëm ka kaluar nga njëra anë e konfliktit në tjetrën. Natyra e konfliktit kërkon që ne të mësohemi të jetojmë me një tërësi ndjenjash kundërshtuese. Në vend që të ndihmohemi ta kryejmë këtë, përkundrazi, ne nxitemi të besojmë se vetëm duke mohuar një pjesë të vetvetes, do të lirohemi prej dhimbjes. Konflikti na bën të fragmentuara, të çara, dhe kështu ne besojmë se duhet të sakrifikojmë njërin apo tjetrin pjesë të vetvetes, me qëllim që të ndihemi të plota. Përkundrazi, duke mohuar një pjesë të vetvetes ne ndihemi gjithnjë e më të mangëta.

Zgjidhjet e ofruara nga lëvizja e grave ndaj konfliktit të shkaktuar nga mëmësia, nuk përputhen me realitetin ashtu siç e përjetojnë gratë. Përveç dashurisë që ndjejnë për fëmijët e tyre, dhe kënaqësisë që marrin nga rritja e tyre, gratë që bëhen nëna, shpejt e zbulojnë rëndësinë e rolit të tyre në zhvillimin e fëmijës. Ato ngurrojnë ta braktisin këtë rol, madje edhe kur përjetojnë dëshirën

për të shërbyer në mënyra të tjera. Si nëna, gratë bëhen gjithnjë e më të vetëdijshme për nevojat e fëmijëve të tyre, dhe zhvillojnë një pikëpamje se si mund të plotësohen ato. Ato nuk besojnë se, përbën ndonjë ndryshim se si plotësohen këto nevoja, apo nga kush.

Megjithatë, në të njëjtën kohë ato zbulojnë se mëmësia mund të jetë izoluese dhe shpesh ndihen të kapura në grackë. Ato e njohin shumë mirë dëshirën për t'u arratisur dhe për t'u bashkuar me botën e madhe. Një nënë e re, që po mendon të kthehet sërish në punë, shprehet në këtë mënyrë:

Ky është një konflikt i ri, dhe po filloj ta ndjej vërtet. Nuk mund ta shpjegoj, po ai i kthehet gjithë përvojës së lindjes dhe të qenit nënë. Është diçka kaq e mahnitshme! Rrënjët e saj janë kaq thellë brenda meje, saqë e kam shumë të vështirë të them se do të ndahem prej tij, dhe do të dal të punoj me orar të plotë dhe dikush tjetër do t'i bëjë këto gjëra, që po i bëj unë tani. Papritmas, kur kujtoj se do ta le djalin tim në duart e dikujt tjetër ta rrisë, ky mendim më bën nervoze dhe nuk jam e sigurt se do ta bëj këtë. E di se sa shumë formohet ai në këto vitet e para, dhe më duket kaq i çmuar sa ndihem e pasigurt t'ia le dikujt tjetër në dorë.

Sigurisht që, nuk është e re, apo e habitshme të dëgjosh gra që dëshirojnë të kujdesen për fëmijët e tyre. Ajo që është e habitshme, është numri atyre që alarmohen nga të tilla ndjenja. Në fakt, grave u është thënë se ato nuk kanë pse të ndihen në mëdyshje, sepse nuk ka asnjë konflikt në të vërtetë, se edhe ato ndjenja pozitive që mund të përjetojnë në lidhje me mëmësinë, nuk janë të vërteta, por thjesht një shprehje e qëndrimeve të imponuara nga shoqëria si pjesë e shfrytëzimit të grave. Meqenëse, këto ndjenja nuk janë të vërteta, ato në të vërtetë nuk mund të përjetojnë konflikt. Si rrjedhojë, gratë janë bërë të mendojnë se ndjenjat e tyre mëmësore janë të dyshimta, nuk janë të natyrshme dhe pasja e të tilla ndjenjave është shenjë

dobësie: aq sa, nëna i dorëzohet ose nevojës së fëmijës për të, ose nevojës së saj për fëmijën; në këtë shkallë ajo është një person i mangët. Faji që dikur ndjenin gratë për shkuarjen në punë, tani është shndërruar në një përfshirje në "përkujdesje ditore" (çerdhe, kopshte) për fëmijët e saj!

Nuk është nevoja e tyre për të qenë nënë, ajo që i habit disa gra; por, gjithashtu tronditja e zbulimit të kompleksitetit të sistemimeve të shumëllojshme të fëmijëve nëpër qendra të kujdesit ditor, të cilat janë bërë që të tingëllojnë kaq të thjeshta. Ata për të cilët zgjidhja e synuar është prindërim i barabartë, kanë zbuluar se disa prindër janë më të barabartë se të tjerët. Një nënë shprehet:

Në shumicën e familjeve që njoh ka një vetëdije të lartë për feminizmin, dhe sigurisht një vetëdije e lartë për ndarjen e gjërave – roleve që janë menduar tradicionalisht si mashkull dhe femër, madje edhe në ato familje radikale duket se ende nënat janë më tepër prezente në jetën e fëmijëve të tyre. S'ka si të ndodhë ndryshe, veç në qoftë se burrat do ta venë veten në rrezik për punën e tyre dhe të thonë: "Shiko, unë do të punoj me kohë të pjesshme, sepse duhet ta kaloj gjysmën e kohës në shtëpi." Por, ka vetëm pak vende pune ku ndokush mund ta bëjë këtë.

Një nënë tjetër shprehet se: Prindërimi i barabartë ishte ai që i bëri të mundur kthimin sërish në shkollë. Por, megjithatë, pasi filloi ajo, burrit të saj iu ofrua mundësia e parë për punë të mirë, për të cilën të dy menduan se ishte shumë e rëndësishme për të hequr dorë. Si pasojë, orari i punës së tij ndryshoi dhe deri tani kjo nënë nuk ka mundur të bëjë diçka për ta sistemuar fëmijën në çerdhe.

Fakti është se, si të burojë nga nevoja e brendshme, apo nga realiteti i jashtëm, kujdesi për fëmijën për pjesën më të madhe është detyrë e nënës. Megjithatë, ne jetojmë në mes një pretendimi të përgjithshëm masiv se ky nuk është problem shqetësues: Meqenëse

më shumë se gjysma e fëmijëve të moshës shkollare në vend, kanë nëna të cilat punojnë jashtë shtëpisë, ne pretendojmë se mëmësia nuk është më roli i gruas, se roli i saj i ri është arritur pas asnjë kosto për vetë gratë apo për fëmijët. Ne pretendojmë se për rritjen e fëmijës nuk kërkohet kohë, energji dhe përkushtim, dhe, që ta presim këtë nga gratë, do të ishte provë shfrytëzimi.

Ne mendojmë atëherë se problemi i rritjes së fëmijëve është zgjidhur. Meqenëse mëmësia është përshkruar si një punë poshtëruese që duhet ta heqim qafe, supozojmë se ajo po shket lehtë-lehtë në lavapjatë, bashkë me enët e darkës dhe nuk përbën asnjë detyrim për gratë. Një reklamë televizive tregon një burrë që admiron gruan e tij duke i thënë: “Nuk e kuptoj se si ia del, shtëpia, fëmijët, puna.” Gruaja ia kthen se nuk ka asgjë të vështirë. “Unë ha mirë, pushoj mirë dhe marr Geritol çdo ditë.” Ndërsa një nënë në jetën reale ka një përgjigje paksa ndryshe. “Unë mendoj se ne jemi goditur me idenë e supergruas, që mban një vend pune me pesëdhjetëmijë dollarë në vit dhe, në të njëjtën kohë, është një bashkëshorte dhe nënë e mrekullueshme. Unë nuk e kuptoj se si e ia del gjithë kësaj vetë.”

Shumica e grave e kuptojnë se duhet më shumë se të marrësh Geritol për të plotësuar kërkesat e të tjerëve, po ashtu edhe kërkesat që ato kanë vendosur për veten e tyre. Një nënë u shpreh me inat ndaj një spikeri, i cili raportonte se puna ishte kaq vetëplotësuese sa që u mundësonte grave të ishin më të duruara dhe t’iu përkushtoheshin më shumë fëmijëve të tyre:

Gratë që njoh unë punojnë si arkëtare në supermarket sepse janë të detyruara. Për këtë nuk ka asgjë që të bën të vetëplotësohesh. Ato kthehen në shtëpi kaq të lodhura, sa që as duan t’ua hedhin sytë fëmijëve.

Për qeverinë nuk ka asnjë përgjegjësi për të bërë të mundur

që këto gra të qëndrojnë në shtëpi me fëmijët e tyre. Përkundrazi, përgjegjësia qëndron mbi kopshtet dhe çerdhet, në mënyrë që sa më tepër gra të dalin për të punuar. Kushti bazë është se, liria e vetme që vlen, është liria për të punuar jashtë shtëpisë. Ndërsa liria për t’u kujdesur për fëmijët nuk është assesi liri, por skllavëri. Gratë e ndjejnë këtë për veten e tyre jo më pak se çë shfaqin të tjerët këtë qëndrim kundrejt tyre. Një nënë shprehet:

Unë kam qenë e lumtur duke qëndruar në shtëpi me fëmijët e mi, por, të qëndruarit brenda nuk e çmoj aq sa sa të dalësh jashtë. Dhe e di se shumica e shoqeve të mia ndihen kështu.

Një nënë tjetër që qëndron në shtëpi shprehet:

Edhe ndonëse unë besoj në atë që jam duke bërë, ende e gjej veten duke menduar se e kam gjithë këtë shkollim të mirë dhe gjithë ato talente që të gjithë m’i rikujtojnë; po vallë si po i përdor ato? Vetëm po rri në shtëpi duke qenë vetëm nënë dhe truri po më kthehet në tul. Gjithmonë ndihem nën presionin për të bërë diçka më tepër seç jam.

Jo vetëm që gratë udhëhiqen për të ndjerë se mëmësia nuk ia vlen kohën dhe mundin e tyre, por, ndërkohë, atyre u thuhet se kujdesi mëmësor nuk lidhet fare me zhvillimin e fëmijës. Ka një mohim të plotë të asaj që na është mësuar për kuptimin e marrëdhënies së parë të dashurisë (nënë- fëmijë) në zhvillimin e cilësive unike njerëzore, të kapacitetit për të formuar marrëdhënie, të aftësisë për t’u kujdesur për të tjerët. Një nënë thotë:

Kam lexuar në gazete shkrime që tregojnë se nuk ka rëndësi nëse fëmija rritet në kopshte e çerdhe apo, nga dikush tjetër përveç nënës. Nuk jam e sigurt plotësisht se çdo të thotë kjo – ndoshta i referohet zhvillimit intelektual të fëmijës. Mua më duket se çfarëdo që të bëni,

duhet të mendoni pasojat. Çfarë lloj fëmijësh po rrisni ju? Ju, madje, as që mund të jeni në gjendje të nxirrni ndonjë përfundim për këtë, por duhet të kuptoni faktin se do keni tashmë një fëmijë ndryshe, i cili varet nga mënyra e rritjes që i bëhet.

Pyetja nuk është tashmë ajo e vjetra: nëse dëmtohen apo jo fëmijët nga mosprania e nënës, por, duke marrë parasysh ndikimin e kujdesit të hershëm mbi karakterin dhe personalitetin e njeriut, a jemi gati të themi se nuk ka rëndësi se kush e ushtron atë ndikim? A jemi me të vërtetë gati për të qëndruar indiferentë për rrjedhojat e mundshme? Nuk mjafton vetëm të pyesim kush po na i rrit fëmijët. Por, për ne ka ardhur koha të mendojmë se ç'lloj njerëzish po rrisim.

Mund të imagjinohet se një lëvizje që është kaq e shqetësuar rreth përmbushjes së potencialit njerëzor, do të kishte pak respekt për ato që e rrisin burimin e tij. Por, politikat prodhojnë bashkëshortë të çuditshëm dhe, gratë e liberalizuara kanë zgjedhur që të jenë pjesë e një tradite të gjatë armiqësie ndaj nënave. Ato, në fakt, i janë bashkuar armikut të vjetër, mistikës femërore, në denoncimin e nënave si shkak i patologjisë tek fëmijët. Ndonëse libri *Gruaja Moderne: Seksi i Humbur* ishte një eulogji ndaj mëmësisë, vetë nënat në të përshkruheshin si agentë transmetues të neurozës. Nënat neurotike që rrisnin fëmijë neurotikë ndodheshin kudo: “nëna kundërshtuese, nëna mbimbrotëse, nëna zotëruese, nëna pasionante me fëmijët.” E bashkuar me imazhin e idealizuar të mëmësisë, që do ta flakte neurozën dhe do të sillte lumturi në botë, ishte piktura e zyrtë e vetë nënës – mbimbrotëse dhe zotëruese, një agjent transmetues për turbullime të personalitetit.

Kjo histori horrori tregohej dikur për gratë, të cilat nuk bëheshin dot me të vërtetë femra dhe nëna (ishin shterpa). Sot i njëjti paralajmërim tingëllon për gratë të cilat mbeten “të burgosura” në kujdesin ditor në kopshte e çerdhe dhe dështojnë në gjetjen e

“vetëpërmbushjes” për kreativitetin e tyre njerëzor. Të tilla nëna, na kanë thënë se i infantilizojnë fëmijët e tyre, (i lenë si foshnja). Ato kërkojnë t'i përdorin fëmijët si zëvendësues për vetëpërmbushjen e tyre dhe krijojnë marrëdhënie simbiotike, që i pengojnë fëmijët për të formuar identitetin e tyre. Në emër të liberalizmit, vetë nënat portretizohen në po të njëjtat përpjekje të errëta si qëmoti. Nëna kundërshtuese, mbimbrotëse, zotëruese, nëna pasionante për fëmijët, shkurtimisht, “nëna e keqe” është ende midis nesh.

Portreti skicofrenik i nënës së mirë dhe të keqe rezonon së bashku me pavetëdijen kolektive të përvojës njerëzore. Letërsia, arti dhe biografia janë të mbushura plot me imazhe të nënës, herë si martire e shenjtë dhe herë si grua e pandershme. Këto përfaqësime pasqyrojnë ndjenjat e fëmijërisë së hershme, kur nëna është një objekt i padiferencuar nga vetja ende joekzistente psikologjikisht. Si e tillë, ajo është burimi i plotfuqishëm i plotësimit të nevojave që japin jetë, por gjithashtu edhe instrumenti për frustrim të pashmangshëm. Zemërimi që ngjall ky frustrim tek fëmija është i rrezikshëm, meqenëse ai mbart në vetvete dëshirën për ta shkatërruar objektin nënë të dëshiruar. Zgjidhja për këtë dilemë psikologjike është të ndajmë burimin e kënaqësisë nga burimi i dhimbjes. Pra, nënën e mirë, nga nëna e keqe. Nëna e mirë është vetëm e mirë, nëna e keqe vetëm e keqe dhe asnjëherë nuk do të takohen të dyja. Nëse këto dy imazhe të ndara do të duhej të bashkoheshin, bëhet e domosdoshme ta shohim nënën si një person të veçantë me identitet të sajën. Asaj duhet t'i jepen përmasa njerëzore dhe t'i lejohet fakti i gabueshmërisë njerëzore. Me fjalë të tjera, fëmija duhet të rritet dhe të bëhet gati për të braktisur kërkimin për nënën e përsosur, që sakrifikon pa ndërprerë. Qartas, ne ende nuk kemi arritur në këtë pikë maturimi. Nëna është ende një objekt i padiferencuar dhe jo një person i vërtetë. Në ditët e lulëzimit të mistikës feministe, ajo idealizohej përtej njohjes. Por, roli i nënës, ashtu si vetë nëna, nuk ishte në lartësinë e duhur. **E pra, kishte ardhur koha për të shkatërruar nënën.** Nëse

gratë janë nëna, ne nuk mund t'i shohim ato si persona të vërtetë. Me qëllim që t'i bëjmë të vërteta, pjesa mëmësore e grave duhet të eliminohet. **Ky është vendimi i konfliktit të vjetër të fëmijërisë që u arrit me lëvizjen e grave.**

Një vendim i tillë, nga vetë natyra e tij, nuk mund t'i ofrojë asgjë një gruaje që e përkufizon veten si nënë, madje edhe pjesërisht, ose për momentin. Nëse vetë gratë zgjedhin të nënvizojnë besimin se, të qenit person dhe të qenit nënë, janë reciprokisht përjashtuese, nëna që mbetet bëhet edhe më shumë një qenie joekzistente. Ajo nuk mund të liberalizohet dhe të bëhet një person që mendon, ndjen dhe krijon, përveçse duke braktisur mëmësinë. Një nënë shpreh ndjenjat e shumë të tjerave kur ajo shprehet:

Mund të jetë një përvojë poshtëruese të ndodhesh pranë grave me karrierë, të cilat i shohin me përçmim njerëzit që rrisin fëmijë. Këto gra, që mendohet se kanë një vetëdije të lartë, nuk kanë absolutisht asnjë ndjeshmëri, apo interes që të kenë marrëdhënie me një grua e cila është nënë. Në një farë mënyre një grua e tillë vendoset në një klasë shoqërore më vete.

Tani është më e vërtetë se kurrë se, gratë të cilat i përkushtohen mëmësisë nuk e vlerësojnë lart atë që po bëjnë. Dhe është mjaft e qartë për to se asnjëri tjetër nuk e vlerëson këtë gjë po ashtu. Çështje më e keqja, ato besojnë se justifikohet armiqësia dhe përbuzja që përjetojnë ato vetë. Duke besuar në mitin e nënës së mirë, ato kanë marrë përsipër ta gjejnë atë në veten e tyre. Por, në vend të saj ato takojnë nënën e keqe dhe ajo është ato vetë. Mospërputhja midis fantazisë dhe realitetit – nëna që do të dëshironin të ishin, dhe ajo që janë në të vërtetë, sjellin një ndjenjë se ato kanë dështuar me fëmijët e tyre dhe me veten. Ndjenja të tilla për veten, të kombinuara me qëndrimet e të tjerëve, ua mbushin mendjen grave që janë nëna, se ato nuk kanë të drejtë të kenë vetëvlerësim apo vlerë. Pikërisht

nga qëndrime të tilla kundrejt vetes së tyre, vjen edhe konfirmimi i qëndrimeve të të tjerëve. Duke besuar se ato e meritojnë trajtimin që iu bëhet, ato vazhdojnë ta përjetojnë atë.

Është aspekti edukues i mëmësisë ai që e hap rrugën për shfrytëzim. Përgjigjja e thellë emocionale ndaj nevojave të tjetrit që lind tek nëna, fton idenë se nevojat e saj nuk kanë rëndësi. Kjo e bën atë të prirur ndaj abuzimit, nga ata që e rrethojnë, në lidhje me impulset e saj të edukimit. Ata besojnë se ajo është aty për t'iu shërbyer atyre, ndaj bëhet e lehtë për t'ia mbushur mendjen asaj për vërtetësinë e kësaj ideje. Është shfrytëzimi i kësaj aftësie për të edukuar që është njohur nga gratë, që i shtyn ato të refuzojnë profesionin e të qenit nënë. Ato besojnë se mënyra e vetme për të ndalur shfrytëzimin, është të ndalin edukimin. Ato nuk e kuptojnë çdo të thotë të jesh në rol edukues dhe në të njëjtën kohë të mos shfrytëzohesh. Prandaj, mëmësia është bërë gracka që duhet shmangur me çdo kusht.

Neve na duket se besojmë që përsosmëria është një gjendje e arritshme. Kur hasim ndonjë problem që mbin nga konfliktet e mënyrës së jetesës, ne imagjinojmë se problemi është rezultat i zgjidhjes që ekziston, më shumë se sa pjesë e vetë jetës. Ne tregohemi të ngutshëm për të arritur në përfundimin se një zgjidhje e kundërt do ta bënte jetën pa dhimbje. **Në këtë rast ne kemi zgjedhur ta hedhim jashtë edhe beben bashkë me ujin e govatës.** Pasi kemi zbuluar problemet e mëmësisë, ne e pranojmë si zgjidhje eliminimin e nënës. Janë ata që besojnë se mënyra e vetme për të zgjidhur përfundimisht armiqësinë kundrejt grave, që e ka zanafillën nga paqartësia e fëmijërisë kundrejt nënës, është të sigurohemi se gratë nuk janë më në një pozicion për të qenë shënjestra e kësaj armiqësie. Ideja duket të jetë se: ne s'kemi pse të gjejmë mënyra për t'i mësuar fëmijët tanë të përballen me frustrimet që vijnë nga jeta. Ne thjesht duhet të sigurohemi që gratë nuk janë më shënjestra për ndjenja negative të ngjallura nga frustrime të tilla. Ose gratë duhet të dalin nga zona e nxehtë, ose burrat të futen në të. Sikur të mjegullohej

dallimi midis burrave dhe grave, gratë nuk do të ishin më një shënjestër e dukshme. Kazani i shkrirjes, si zgjidhje për konfliktet që e kanë burimin nga ndryshimet, është provuar tashmë në shoqërinë tonë, po me sukses të dyshimtë. Ne kemi mësuar se ndryshimet janë një burim force, e pasurojnë jetën dhe se ato duhet të ushqehen më mirë se sa të zhduken fare. Por, ne nuk kemi kërkuar për burimin e forcës në faktorin femër. Është dukur më me leverdi të provojmë se nuk ekziston.

Gratë e kanë me të vërtetë forcën për të vazhduar të edukojnë pa e sakrifikuar vetveten në këtë proces. Ato e kanë forcën për t'i rezistuar modelit mëmësor që iu është imponuar. Ato janë aq të forta sa të bien në ujdi me natyrën e tyre të vërtetë njerëzore, në mënyrë që ato të mos vazhdojnë të ushqejnë dhe përforcojnë shpresa shkatërrimtare – të tyre apo të të tjerëve. Pasi të kenë mësuar ta bëjnë këtë vetë, ato do t'ua mësojnë edhe fëmijëve të tyre – djemve dhe vajzave – pa u shqetësuar për ndikimet gjinore në rritjen e fëmijëve. Çështja këtu nuk është për të përcaktuar rolet gjinore, por për t'i mësuar njerëzit si të jetojnë në harmoni me të gjithë ndjenjat e tyre – dashurinë, urrejtjen, inatin, agresivitetin, varësinë dhe si t'i zgjidhin konfliktet pa beteja të fuqishme shkatërrimtare. Kjo është sfida për mëmësinë. A duhet të besojmë se ata që angazhohen në të tilla gjëra, nuk po përmbushin potencialin e tyre njerëzor?

Gratë nuk kanë pse të sakrifikojnë të qenit njeri, nëse ato janë nëna. Ato nuk kanë pse të sakrifikojnë mëmësinë me qëllim që të jenë njerëz. Liberalizimi kishte për qëllim t'i hapte mundësitë e grave e jo t'i kufizonte ato. Vetëvlerësimi që është gjetur në fusha të tjera, mund të gjendet edhe në të qenit nënë. Por, suksesi nuk do të vijë nga intuita e nënës së mistikës së vjetër feministe. Suksesi kërkon punë të madhe, edukim, shkollim dhe zhvillim të aftësive që kanë të bëjnë me të kuptuarit dhe reagimin ndaj sjelljes së fëmijës. Suksesi kërkon gjithashtu gadishmëri për të studiuar vetveten dhe vullnet për të duruar dhimbjen që harmonizohet me

kënaqësinë e rritjes. Për më tepër, ai kërkon mbështetjen e ethshme, që u është ofruar grave në fusha të tjera të përpjekjeve njerëzore. Ashtu siç mësojmë ta çmojmë dhe ruajmë ajrin që thithim, ujin që pimë, energjinë që përdorim, ne duhet të mësojmë të vlerësojmë dhe të ruajmë aftësinë tonë për të edukuar. Ndryshe, në emër të potencialit njerëzor, ne do ta shkatërrojmë burimin e humanitetit tonë dalëngadalë, por, në mënyrë të sigurt.

KAPITULLI 2

Mistifikim dhe faj

Nuk është aspak e habitshme që gratë po braktisin rolin e tyre, mëmësor. Mëmësia sot është një profesion me rrezik të lartë. Përgjegjësitë për abuzim me detyrën nuk iu janë ngarkuar vetëm doktorëve dhe avokatëve. Nënata kanë pasur përvojë të dorës së parë me besimin e veçantë në kulturën tonë se, nëse diçka nuk shkon mirë, dikush e ka fajin. Ne nuk e vuajmë me dëshirë brishtësinë njerëzore, apo kufizimet e vetë jetës. Ne kemi nevojë për dikë që t'ia hedhim fajin për çfarëdo frustrim, apo mohim që kemi përjetuar në jetën tonë. Shumë shpesh ai dikush është nëna.

Ky formulim u bë legjitim nga ndikimi i teorisë së Frojdit mbi praktikën e edukimit të fëmijëve. Si rezultat i fokusit të ri mbi zhvillimin e personalitetit, qëllimi i edukimit të tyre u zhvendos nga ai i shoqërizimit të fëmijës, drejt shëndetit të tij mendor, nga të mësuarit e fëmijës për të jetuar në shoqëri, drejt shqetësimit për vetërealizimin e tij. Shëndeti mendor, si qëllim i edukimit të fëmijës, është provuar të jetë një qëllim i dyshimtë, mashtrues dhe i pasuksesshëm. Ndoshta kjo duhej të pritej në dritën e faktit që ne ishim në kërkim të diçkaje, që nuk mundnim, madje as ta përcaktonim. Në realitet, qëllimi i edukimit të fëmijës, u bë ai i parandalimit të shqetësimit emocional, më tepër se sa i nxitjes së mirëqenies emocionale. Neve na ishin mësuar vetëm shkaqet e sëmundjeve mendore, e jo burimet e shëndetit mendor. Thjesht u supozua se shmangia e asaj që është e keqe do të prodhonte diçka pozitive. Në praktikë, qëllimi i edukimit të fëmijëve u bë ai i

shmangies së çdo gjëje traumatike, apo shqetësuese në zhvillimin e fëmijës me besimin se kjo do të krijonte një fëmijë “të pjekur.” Ky mit në rritje i shëndetit mendor qëndronte në supozimin e pathënë se jeta pa frustrim, apo mohim të të drejtave, është e mundur. Nga kjo arrihet në përfundimin se, për dhimbjet dhe frustrimin dikush duhet ta ketë fajin. Suksesi i nënës në rolin e saj duhej të matej me anë të shëndetit mendor të fëmijës, një imazh i idealizuar i përsosmërisë që përfshinte mungesën e frustrimit, lirimin nga dhimbjet dhe, më në fund lumturinë. Dukej qartë se ajo po përgatitej për dështim. Ne përvijua një qasje për edukimin e fëmijës e cila përfshinte të gjitha fantazitë e fëmijërisë tonë për nënën si figura e plotfuqishme me fuqinë për të lejuar dhe për të ndaluar plotësimin e dëshirave. Ne krijuam një sistem që na jep leje të shprehim gjithë armiqësinë ndaj nënës e shoqëruar me këtë eksperiencë të fëmijërisë.

Keqinterpretimi i shëndetit mendor, i cili shpallte premtimin se jeta pa frustrim është e mundur, pati tërheqje të madhe. Më në fund u duk një shkak i prekshëm, konkret dhe një person për ta fajësuar për atë që është negative në jetën tonë. Frustrimi nuk ishte më në natyrën e vetë jetës, por ai vinte si shkak i faktit se nuk ishim hequr si duhet nga gjiri, apo se nuk ishim stërvitur si duhet në tualet. Dëshpërimi ynë e kishte burimin nga rruga e ashpër në të cilën ne ishim të detyruar të braktisnim prirjen tonë feminare për plotësimin e dëshirave. Qartas, për gjithçka faji ishte i nënës. Shëndeti mendor duhej të bëhej justifikimi për plotësimin total të dëshirave të fëmijëve. Fëmija, tek të gjithë ne, duhej të shpëtohej në kurriz të nënës. Dhe për ta shpëtuar atë erdhën një trupë gjithnjë e në rritje profesionistësh të shëndetit mendor.

Atëherë kur shëndeti mendor zëvendësoi mësimin e fëmijës për të jetuar si duhet në shoqëri, si objektiv i vetëm për edukimin e fëmijëve, profesionistët e shëndetit mendor zëvendësuan nënën si ekspertë në edukimin e fëmijëve. Së bashku me idenë se edukimi i fëmijëve duhej të mbështetej mbi baza “shkencore,” erdhi një

teknologji e re për edukimin, që në të vërtetë zëvendësoi të kuptuarit dhe kompetencat nga nëna tek ekspertët profesionistë. Në kohën kur, qëllimi i edukimit të fëmijës ishte shoqërimi i tij, roli i nënës ishte qartas t'i mësonte fëmijës sjelljen e miratuar nga shoqëria. Standartet e saj për sjelljen ishin të rrënjësura dhe të përforuara nga vlerat shoqërore. Por, tashmë u duk se u shfaq një tërësi standartesh të reja në lidhje me sjelljen. Në vend që fëmija të pritej të ndryshonte përgjigjet e tij, nëna ishte ajo që duhej të ndryshonte përgjigjet **e saj**. Në kohën kur sjellja e miratuar për fëmijët vinte nga konsensusi i shoqërisë, sjellja e re recetë për nënat duhet të vinte vetëm nga psikiatria. Pikërisht në kohën kur shumë forca në shoqëri ishin mobilizuar për të promovuar mëmësinë si një ideal për gratë, potenciali i tyre për sukses në atë rol po minohej. Nënata po përballeshin me një fushë misterioze njohurish, në të cilën iu tha se ato kishin në dorë çelësin për mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimi. Sfidat e rritjes së fëmijëve të pjekur mendërisht nuk duhej të merrej lehtë dhe nënat hodhën vështrimin të etura për udhëzim drejt ekspertëve të rinj. Pa qenë të vetëdijshme, ato hynë në një marrëdhënie që mbartte në vetvete farat e vetë shkatërrimit të tyre.

Marrëdhënia mes nënës dhe profesionistit nuk ka qenë një marrëdhënie në të cilën ata punojnë së bashku në të mirë të fëmijës, ku eksperti e ndihmon nënën të arrijë qëllimet që i ka vënë vetes për fëmijën. Përkundrazi, profesionistët shpesh sillen sikur vetëm ata janë avokatët e fëmijës; sikur ata janë mbrojtës të nevojave të fëmijës; sikur nëna po ta lenë vetëm me mendjen e saj sigurisht që do ta dëmtojë fëmijën dhe, vetëm profesionistët mund ta shpëtojnë atë. Marrëdhënia midis nënës dhe fëmijës perceptohet si një marrëdhënie armiqësie, në të cilën profesionisti lidhet me fëmijën dhe ndihet i thirrur për ta mbrojtur atë. Nëse nëna shihet si kundërshtar e nevojave të fëmijës, atëherë është e qartë se ajo duhet të shkatërrohet. Një fantazi luhet në skenë sikur nëna e vërtetë është nënë e keqe, dhe profesionisti është një nënë e mirë, që di si të kujdeset mirë

për fëmijën. Në një këmbim interesant rolesh, nëna gjithsesi bëhet fëmija i keq. Marrëdhënia që vendos profesionisti "ekspert" me nënën është një marrëdhënie autoritare prind – fëmijë në të cilën profesionisti, që luan rolin e një zëdhënësi për nevojat e vërteta të fëmijës, është autoriteti, apo figura prindërore. Tash nëna është në rolin e fëmijës dhe fëmija i përfaqësuar nga autoriteti i profesionistit është në rolin e prindit. Në ditët kur fëmijët priteshin të silleshin siç ishin porositur, ata që nuk vepronin kështu, konsideroheshin si të këqinj. Tani e ka radhën nëna të sillet në mënyrë të porositur. Por, nëse ajo nuk dështon, e gjen veten edhe si fëmijë i keq dhe si nënë e keqe: fëmijë i keq, i cili sillet keq dhe nënë e keqe, e cila dëmton fëmijën e saj duke mos i plotësuar nevojat e tij. Qoftë si fëmijë i keq, qoftë si nënë e keqe, ajo e meriton të ndëshkohet dhe ndëshkimi për nënat është faji.

"Ekspertiza" ndaj të cilës janë nënshtruar nënat nxit ndjeja faji. Faji është përfundimi i pashmangshëm i tre mesazheve kryesore që u janë transmetuar nënave për edukimin e fëmijëve. I pari është se, një nënë e mirë duhet të mendojë në rradhë të parë dhe përgjithmonë për nevojat e fëmijës. Informacioni për edukimin e fëmijës për nënat ka qenë gjithmonë i përqendruar tek fëmija. Kjo do të thotë se ai fokusohet në edukimin e nënave rreth nevojave të fëmijëve. Sidoqoftë, është e qartë në këtë pikë se vetëm nevojat e fëmijës janë ato që merren parasysh.

Mesazhi i dytë është se fëmijës mund t'i shkatohet dëm i madh, nëse nevojat e tij, apo të saj, nuk plotësohen si duhet dhe, për këtë arsye, nënat kanë në vetvete një potencial të madh për t'i dëmtuar fëmijët e tyre.

Dhe mesazhi i fundit është se, ekziston një mënyrë e drejtë dhe një mënyrë e gabuar për t'iu përgjigjur fëmijës dhe, nëse nëna bën një gabim dhe zgjedh mënyrën e gabuar, ajo do ta shkatërrojë fëmijën në mënyrë të pariparueshme. Këto mesazhe janë transmetuar në një fushë njohurish, e cila edhe e mistifikon edhe e thjeshtëson tej

mase edukimin e fëmijës. Në fund të fundit, nëse nënat janë thjesht të këqija, apo si fëmijë të paaftë për vete, do të ishte jorealiste t'iu ofroje të kuptuar të vërtetë emocional. Më mirë t'ia nisim me ABC-në e thjeshtë; me ushtrime të thjeshta dhe teknika për edukimin. Fatkeqësisht, lehtësia me të cilën problemet kuptohen dhe zgjidhen në letër, në libra dhe në artikuj revistash, kurrë nuk përshtatet me realitetin e përvojës së nënës. Zakonisht ka një mospërputhje të madhe, midis asaj që pritet prej nënës dhe arritjeve të saj. Sjellja e fëmijës së saj shpesh nuk e ndjek versionin e librit me përralla. Ndjenjat e saj nuk arrijnë të përputhen me mënyrën që i është treguar asaj se si duhet të ndihet. Të gjitha këto e lenë atë të shqetësuar, të paaftë dhe të papërshtatshme. Ka diçka që nuk shkon me fëmijën, ose me atë vetë, mendon ajo. Sido që të jetë, ajo e pranon akuzën dhe fajin.

Po pse gratë duhet të besojnë më të keqen për veten e tyre si nëna? Si ka qënë e mundur që ato janë bindur kaq lehtë për mënyrat me të cilat mund t'i dëmtojnë, i kanë dëmtuar, apo do t'i dëmtojnë të vegjlit e tyre? Përgjigjja është se gratë janë të prirura ndaj sulmeve të tilla, sepse të ndihesh në faj, është një ndjenjë normale e mëmësisë. Helen Deutch flet për “ndjenjën e fajit si faktorin më të rëndësishëm në të gjithë pikturën psikologjike të mëmësisë.” Roli i mëmësisë nxit reagime të forta emocionale, të cilat e çojnë pashmangshmërisht drejt ndjenjave të fajit. Fatkeqësisht, nënat e interpretojnë faktin se **ndihen** në faj për të kuptuar që **janë** në të vërtetë fajtorë. Profesionalistët thjesht e kanë vërtetuar këtë interpretim duke iu treguar nënave se **përse** ato janë fajtorë. Elementi shkatërrues ka qënë prirja për t'i parë këto ndjenja të ngjallura nga mëmësia si të këqija, ose patologjike, kur, është universaliteti i këtyre përvojave arsyeja pse nënat kanë nevojë për ndihmë që të kuptojnë, me qëllim që të përgatiten të përballen me këto reagime, kur ato lindin. Përkundrazi, qëndrimet kundrejt nënave janë tallur me këto ndjenja, aq shumë sa, ia kanë shtuar barrën e fajit.

Faji universal i mëmësisë buron nga tre eksperiencia emocionale kryesore: kërkesa e nënës për të qenë e plotfuqishme, ndjenjat e saj të inatit, dhe konfliktet e saj për varësinë. Nën këta tre faktorë ndodhet fakti i pafuqishmërisë së fëmijës dhe nevojës së tij të madhe për kujdes mëmësor. Varësia e fëmijës nxit mbi nënën një nevojë të madhe për të dhënë nga vetja. Marrëdhëniet mes tyre ngjallin konflikt për marrje dhe dhënie dhe e prezantojnë nënën me rrezikun e asaj që Deutch e quan “humbjes së egos në favor të fëmijës.”

Të pasurit e një fëmije është ndarja e madhe midis fëmijërisë dhe pjekurisë së njeriut. Përnjëherësh, dikush varet nga ju. Ju nuk jeni më fëmija e nënës tuaj, por nëna e fëmijës tuaj. Në vend që të kujdesen për ju, tashmë ju jeni përgjegjëse për t'u kujdesur për dikë tjetër. Natyra e pashtershme e nevojave të fëmijës mund të përjetohet si një sulm mbi veten. Foshnja që qan, i vogli që fut hundët kudo, fëmija i sëmurë gjithë natën, janë një prani që të rrethon gjithandej. Ju nuk mund të dilni, nuk mund ta lini këtë detyrë, as të bëni pak pushim, madje as të shkoni të qeta në tualet. Në bisedat e mia me nënat, të mos jesh në gjendje as të shkosh në tualet, duket se është shkalla e fundit për mungesën e lirisë, për pushtimin final të intimitetit të dikujt.

Mjaft nëna përjetojnë një frikë të madhe se do të jenë të paafta t'i plotësojnë këto lloj kërkesash të varësisë së plotë të fëmijës. Ato fillojnë të ndiejnë se në veten e tyre mungon diçka, dhe ato janë të paafta për të qenë nëna të përshtatshme. Faji rritet kur ato arrijnë të besojnë se mund të shkaktojnë dëm të madh mbi fëmijën si pasojë e papërshtatshmërisë së tyre. Në një situatë të tillë, vetë nëna dëshiron të varet tek dikush, të ketë dikë që t'ia marrë këtë përgjegjësi, apo ta kryejë atë më mirë. Ajo ka nevojë për dikë që do ta përkrahë për nevojat e saj të paplotësuar. Përkundrazi, asaj i jepet “siguri” në formën e shpjegimeve për natyrën normale të kërkesave të fëmijës.

Kjo ka pasojën e shtimit të fajit, sepse edhe një herë janë theksuar nevojat e fëmijës dhe ideja e përçarur është se, paaftësia e saj për t'i plotësuar ato është patologjike. Asnjë nuk i sugjeron se është e lejuar që ajo të respektojë veten, apo t'i tregojë se ajo është po kaq e rëndësishme sa edhe fëmija. Ndjenjat normale të varësisë së nënës trajtohen sikur ato të ishin një shenjë dobësie, diçka që nuk është e pranueshme të haset tek një nënë. Profesionistët shfrytëzojnë varësinë e nënës duke iu përgjigjur asaj sikur ajo të ishte në të vërtetë një fëmijë. Mesazhi që i jepet asaj është "bëje se them unë." Por, nëna nuk mund të bëjë siç i thotë eksperti, sepse problemi është se ajo nuk di çfarë të bëjë, por se ajo ndihet sikur nuk mund ta bëjë atë. Këshillat që merr ia shtojnë ndjenjat e saj të dështimit dhe fajit.

Sjellja dhe kërkesat e fëmijëve provokojnë inat të madh te nënat. Por, në kulturën tonë neve nuk na është dhënë leje të përjetojmë ndjenja negative. Inati, zemërimi, armiqësia, nuk janë të pranueshme në disa situata. Në edukimin e fëmijëve, mosaprovimi i ndjenjave negative ka kaluar nga mosaprovimi i këtyre ndjenjave tek fëmija, në zhdukjen e tyre tek nëna. Në të kaluarën, fëmijët nuk duhet të kishin ndjenja "të këqija" për prindërit e tyre. Shumica e fëmijëve nuk guxonin t'i shprehnin ndjenja e tyre negative, pasi ata që vepronin kështu ndëshkoheshin keq. Tani, teoria e Frojdit na ka paralajmëruar për rreziqet e këtyre qëndrimeve shtypëse dhe pasojat e rënda të varrosjes së këtyre ndjenjave. Ne kemi mësuar se fëmijët duhet të lejohen t'i shprehin ndjenjat e tyre. Megjithatë, në shqetësimin tonë të madh për shëndetin mendor të fëmijëve, ne e kemi anashkaluar shëndetin mendor të nënave. Ato janë bërë të besojnë se nevojat e fëmijëve të tyre nuk duhet të frustrohen, dhe kështu edhe të gjithë inatet normale të nënës, pavendosmëritë normale të jetës nuk janë të lejuara. Nëna që përjeton ndjenja "të këqija" kundrejt fëmijës, është nënë e keqe.

Nënat nuk janë të përgatitura për këto lloj ndjenjash negative që ato kanë kundrejt fëmijëve të tyre. Ato nuk ndihmohen të kuptojnë se

ndjenja të tilla janë të zakonshme dhe normale. Është tipike që inati të ngjallet nga stresi i kujdesit ndaj fëmijëve dhe sjelljes së tyre. Vitet e para të jetës së fëmijës janë fizikisht lodhës, me orë të gjata pune, gjumë të parehatshëm, të njëjtat detyra që përsëriten dhe privim nga kënaqësia e të rriturve dhe stimulimi mendor. Përkundër këtij sfondi vijjnë sjelljet tipike për fazat e zhvillimit të fëmijëve si: derdhja e tasit me ushqim, hedhja e lodrave jashtë krevatit, edhe një shishe ujë para gjumit, dhe lodrat që notojnë në tualetin e mbushur plot me ujë. Një shoqe, një herë vuri në dukje se është më e lehtë të pranosh faktin e qumështit të derdhur, kur dikush tjetër sapo e ka larë dyshtemenë e kuzhinës. Por, kur nëna është e raskapitur, një sjellje e tillë fillon të duket si provokim i qëllimshëm dhe ndjenja se fëmija po e "sfidon" nënën është shumë e zakonshme. Nëna fillon të ndihet si viktimë e impulseve të fëmijës dhe kur ajo ndihet kështu, shpesh hidhet në kundërsulm. Pastaj, kur fëmija qan, duket i dëshpëruar, i trishtuar dhe pashpresë, apo më vonë, kur ai fle si ëngjëll në shtratin e tij, nëna mbushet me ndjenja faji për sjelljen e saj ose për ndjenjat e saj, edhe kur ajo nuk i ka respektuar ndjenjat e saj. Ndjenja e humbjes së kontrollit ka rrjedhoja të frikshme mbi të, kur ajo është e inatosur. Një nga arsyet më të zakonshme që u është thënë nënave për të mos i goditur fëmijët, është frika se do t'i dëmtojnë ata. Një nënë tha: "Unë nuk e godas kurrë atë, por pastaj e godas shumë rëndë. Nuk e mendoj veten si një abuzuese fëmijësh, por, më shqetëson fakti se çfarë po bëj kur nervat nuk më mbajnë më nga gjithë ato që bën ai – kur jemi bashkë për shumë kohë."

Një pjesë e problemit është se, ne shpesh nuk e bëjmë dallimin midis të përjetuarit të një ndjenje dhe të shprehurit të saj; midis të shprehurit të kësaj ndjenje me fjalë dhe të shprehurit të saj me sjellje. Ne nuk e bëjmë dallimin mes këtyre gjërave të ndryshme dhe kështu, të ndërjetit e inatosur duket po aq e rrezikshme sa edhe goditja e dikujt. Ne nuk e njohim kapacitetin tonë për t'u ndier të inatosur, por pa e shprehur këtë me vepra sepse ne nuk kemi patur

praktikën e mjaftueshme. Vetëkontroll do të thotë të ndiesh diçka, por, pa e shprehur atë me vepër. Të mos e ndiesh fare është njëlloj si ta mohosh se ekziston. Kjo do të thotë t'ia vësh kapakun. Kjo do të thotë siç tha njëherë një fëmijë, të "shpërthesh." "Kjo do të thotë se ju nuk inatoseni edhe kur jeni të inatosur, kështu që kur inatoseni, inati i mbledhur të bën të "shpërthesh." Kur nënat shpërthejnë e ndëshkojnë veten me faj. Sulmet mbi to, si nëna të këqija, duken të justifikuar, kur atyre u kujtohen ato momente dhe impulset e fshehta armiqësore, që kanë përjetuar kundrejt fëmijëve të tyre.

Dashuria e nënës për fëmijën i mundëson asaj të japë atë kujdes për të cilin ka nevojë ai, dhe është ana e kundërt e inatit që provokojnë kërkesat e tij. Megjithatë, kjo dashuri bën që nëna të ketë kërkesa të mëdha ndaj vetes dhe ndaj mospërputhjes që ekziston midis fantazisë së saj në lidhje me atë si është, ose si duhet të jetë një nënë, dhe se si e përjeton ajo veten në realitet. Pritshmëria e nënës për veten është që ajo të jetë e plotfuqishme. Ajo dëshiron të pengojë të gjitha gjërat negative dhe të japë gjithçka pozitive për fëmijën. Ajo beson se është përgjegjëse për gjithçka që ndodh. Ashtu siç u shpreh një nënë: "Gjëja më e vështirë është të kesh në duart e tua përgjegjësinë e plotë për jetën e dikujt tjetër." Kjo kërkesë për plotfuqishmëri është ndoshta një mbetje nga fëmijëria, kur ajo i vishte prindërit e saj me fuqi të mahnitshme. Për ne, si fëmijë nëna ishte sjellësja e gjithçkaje që ishte e mirë dhe e dëshirueshme dhe në të njëjtin kujtim, privim apo frustrim ishte deri diku faji i saj. Ne po e përdorim të njëjtin njësi matëse ndaj vetes tonë kur bëhemi nëna. Kurdoherë që nëna përjeton ndonjë problem në zhvillimin e fëmijës së saj, menjëherë beson se ajo është përgjegjëse për të.

Prirja për ta matur suksesin mëmësor në lidhje me shëndetin mendor të fëmijës është tallur me nevojën e nënës për plotfuqishmëri. Ndërtimi emocional është interpretuar sikur të jetë baraz me përsosmërinë, si për nënën, ashtu edhe për fëmijën. Shëndet mendor, lumturi, mungesë frustrimi, lirim nga dhimbjet, të gjitha këto bëhen

bashkë në mendjen e nënës. Që të jetë e suksesshme ajo beson se duhet t'i shkrijë ndjenjat negative dhe të mos gjejë asnjë gjurmë dhimbjeje apo konflikti. Nënave nuk u është mësuar se problemet janë në natyrën e jetës. Jeta përfshin frustrim, dhimbje, konflikt dhe inat. Edukimi i fëmijëve do të thotë t'i ndihmosh ata t'i kontrollojnë dhe të përballen si duhet me këto ndjenja. Me qëllim që t'i vemë në kontroll ndenjat, ne duhet t'i ndjejmë ato. Po si mund ta ndihmojë një nënë fëmijën, nëse ajo është detyruar të besojë se suksesi i saj varet nga mosgjeteja e gjurmëve të ndjenjave apo sjelljeve të tilla? Në përkufizimin e nënës së mirë nënkuptohet shmangia e problemeve; shprehja e ndjenjave të fëmijës, më pas, shndërrohet në sulm mbi të, në qortim. Gjithçka që duket negative i ngjall ankth.

Një nënë që ishte shumë e kujdesshme për ta mbajtur fëmijën e saj të lumtur tha se: mendonte se ai do të mësonte dhe do të rritej, vetëm nëse do të ishte i lumtur. Ajo u habit kur mësoi se gjëja që kishte nevojë më shumë të mësonte fëmija i saj ishte se si të përballej me ndjenjat trishtuese, me ndjenjat e tensionit dhe ankthit. Nëna ndihej kaq e shpërqenduar për ndonjë shenjë të këtyre ndjenjave, sa që ajo ia kishte përçuar pa dashje fëmijës idenë se ndjenja të tilla janë të rrezikshme. Vetë fëmija kishte frikë nga ndjenjat e tij negative.

Siguria e vërtetë vjen vetëm nga përjetimi i këtyre ndjenjave dhe nga zbulimi se ato nuk janë asgjësuese. Është e mundur të mbijetosh me to. Nëse nëna i sheh shprehjet negative të tyre jo si pjesë e jetës, po si dështim të saj, ajo është mundur para se ta fillojë lojën. Sjellja që duket se reflekton diçka negative bëhet kërcënuese, sepse ajo ndjen se në një farë mënyre është faji i saj. Ndaj ajo dëshiron që sjellja që tregon shenja të paaftësisë së saj të zhduket.

Pikërisht, në këtë pikë ideja se, ka një mënyrë të drejtë dhe një mënyrë të gabuar për t'u përballur me gjithçka në zhvillimin e fëmijës, është tejet shkatërruese. Nënave filluan të kërkonin teknika që do të shmangnin gjithçka që dukej negative. Nëna kërkon një përgjigje të

sigurt sepse ajo ka nevojë të dijë, se ajo bën “atë që duhet” për fëmijën e saj. Ajo mendon se duhet të ketë një përgjigje, një mënyrë të drejtë për t’u përballur me çdo situatë. Ajo beson se mënyra e drejtë do të thotë që të bëjë atë që është më e mirë për fëmijën, ndërsa mënyra e gabuar do të thotë të bëjë atë që është e keqe për fëmijën. Ajo kërkon ta dijë që më përpara, se cila qasje është më e mira për fëmijën, cilat do të jenë pasojat nëse ajo ndjek një rrugë apo tjetrën. Asaj do t’i pëlqente që dikush t’ia tregonte se çfarë të bënte, në mënyrë që të shmangte gabimet. Është më e sigurt të bësh atë që thotë eksperti sepse ajo, nëna, nuk merr përgjegjësi për vendimin. Ajo beson se eksperti e di mënyrën që do t’i sjellë rezultatet e duhura. Nëse diçka shkon keq, të paktën nuk ka qenë ajo që e ka dëmtuar fëmijën. Nëse nëna beson se përgjigja e ekspertit është automatikisht e drejtë, një recetë që duhet të plotësohet, ajo ndihet e nxitur që ta realizojë. Ajo ndodhet nën presion të madh për të vepruar kështu, nëse nga kjo varet mirëqenia e fëmijës. Dhe ky është ekzaktësisht mesazhi që i është transmetuar asaj. Ajo është nxitur të mos i besojë gjykimit të saj. Motivet e saj janë bërë të dyshimta. Të qenit nënë e mirë është binjakëzuar me vënien në jetë të porosive të njerëzve të tjerë më tepër se sa të sajat.

Të besuarit se ka përgjigje përfundimtare dhe të pandryshueshme, dhe se eksperti profesionist i ka ato, atëherë këtë besim, nënat dhe profesionistët priren t’ia përforcojnë këtë njëri-tjetrit. Ata të dy kanë nevojë ta besojnë këtë. Ata duket se bien dakort, gjithashtu, se nëse receta nuk funksionon si duhet, kjo vjen për shkak të papërshtatshmërisë së nënës. Kur një nënë krijon këtë lloj marrëdhënie, duke e veshur ekspertin me këtë lloj fuqie dhe autoriteti, ajo e ve atë në rolin e prindit dhe veten në rolin e fëmijës. Të jesh nënë e mirë do të thotë të jesh vajzë e mirë, që e dëgjon “babin”. Por, nëna nuk mund të jetë nënë për fëmijën e saj, nëse ajo për vete trajtohet ende si fëmijë. Fëmijët nuk bëjnë për prindër të mirë.

Recetat janë kuptimplota vetëm nëse ndihmojnë individët për të cilët janë shkruar. Pyetja se çfarë është më e mira për fëmijën, në një kohë të dhënë, mbetet pa përgjigje abstrakte. Nënat dhe fëmijët janë gjithsecili individë krejt të ndryshëm nga tjetri. Ajo që mund të jetë e mirë për një fëmijë, mund të jetë e keqe për një tjetër. Një mënyrë e drejtë për njërin, mund të jetë e gabuar për tjetrin. Nëna të veçanta mund të kenë qëllime dhe objektiva të ndryshëm për fëmijët e tyre, në kohë të ndryshme, dhe fëmijë të veçantë mund të jenë të aftë, ose të paaftë t’i arrijnë ato pika në zhvillimin e tyre. Nëna duhet të ndihmohet t’i gjejë përgjigjet e saj, sepse është ajo që mund të përcaktojë më mirë nëse një ide e mirë në teori mund të shndërrohet në ide të keqe në praktikë.

Nëna mund të mos e dijë, por ajo ka një mori aftësish që e kualifikojnë atë si eksperti kryesor për fëmijën. Ajo e njeh fëmijën më mirë se kushdo tjetër, pasi e ka vëzhguar sjelljen e tij qysh nga lindja dhe ka mësuar ta interpretojë atë. Kjo do të thotë se ajo e di se si është sjellja e tij e vërtetë. Ajo kujdeset për fëmijën e saj, më shumë se kushdo tjetër, dhe është, gjithashtu, e përgatitur të bëjë më shumë për të. Asnjë ekspert, sado i interesuar qoftë, nuk e ka shqetësimin e duhur për një fëmijë të veçantë, që përputhet me atë të nënës. Fatkeqësisht kjo e vërtetë është kthyer në një akuzë: Nënat janë të mbingarkuara emocionalisht dhe, për këtë arsye, të paafta të jenë objektive. Sidoqoftë, objektiviteti nuk duhet ngatërruar me të vërtetën. Që të bëhen të vërteta “faktet” objektive, duhet të zbuten me përkushtim, shpresë, dhe përkujdesje. Këto mund t’i japë vetëm nëna. Së fundi, asnjë ekspert nuk është në pozicion të tillë që të bëjë për fëmijën atë që mund të bëjë nëna. Fizikisht, emocionalisht, legalisht, nëna ka përgjegjësi për fëmijën përtej asaj të ekspertit dhe kjo përgjegjësi sjell si të drejta, po ashtu edhe detyra.

Nëna ka të drejtë të veprojë në të mirë të fëmijës, ashtu siç e kupton ajo. Pikërisht kjo është vështirësia. Ne ia kemi minuar

Elaine Heffner

vetëbesimin asaj, duke i thënë se ajo nuk kupton. Të gjitha teoritë e parashtruara dikur për rolin e prindit janë nënvlerësuar nga specialistët. Specialistët e psikiatrisë, specialistët psikologë dhe ata të edukimit, të gjithë e kanë mistifikuar zhvillimin e fëmijës. Ne kemi zhvilluar idenë se të kuptuarit e fëmijëve dhe nxitja emocionale dhe intelektuale është shumë e ndërlikuar për nënat dhe kërkon ndërhyrjen e ekspertëve. Në kemi trajnuar specialistë që të marrin përsipër detyrën e nënës, në vend që të përgatisnim nënat, të cilat janë më të përgatitura nga gjithë të tjerët për ta kryer si duhet këtë mision.

Nuk gjenden përgjigje të drejta, në kuptimin e të vërtetave abstrakte, që kanë të bëjnë me çfarëdo lloj pyetje që i shqetëson nënat. Për më tepër, ajo që përfshihet është një proces vendimmarrje se cili është qëllimi i nënës në një moment të dhënë, një proces prove dhe gabimesh dhe vazhdimësi e vëzhgimit të rezultateve. Për shkak se nëna ndodhet në pozicionin më të mirë për ta bërë këtë lloj monitorimi, është thelbësore që ajo ta mendojë dhe ta ndjekë planin e saj. Ajo duhet t'i vlerësojë rezultatet e punës së saj përsa i përket qëllimeve, të cilat është nisur t'i arrijë. Kjo do të thotë se ajo duhet të marrë përgjegjësinë për të menduar dhe për të marrë vendime. Por, mbi të gjitha ajo duhet të jetë e aftë të durojë pasigurinë. Ajo duhet të ndihet e lirë të rrezikojë edhe ndonjë gabim, dhe të ndihet e sigurt se nuk do ta dëmtojë në mënyrë të pandreqshme fëmijën e saj. Pasiguria rreth pasojave në edukimin e fëmijëve, asaj, i është thënë dhe nuk është aspak shenjë e paaftësisë së saj. Ajo nuk duhet të shmangë dëshirën për të qenë e plotfuqishme, gjithëdhënëse, nëna e përsosur, që do të ndreqë të gjitha padrejtësitë dhe do të kompensojë me fëmijën e saj atë që iu mohua asaj kur ishte vetë ende fëmijë. Ajo është thjesht një qenie njerëzore e gabueshme me nevoja të sajat.

KAPITULLI 3

Arti i mëmësisë

Arti i të jetuarit do të thotë të jetosh në shoqëri pa t'u dhunuar nevojat e tua dhe pa dhunuar nevojat e të tjerëve. Arti i mëmësisë do të thotë t'u mësosh fëmijëve artin e të jetuarit. Mjaft prej nesh janë ende duke u përpjekur të mësojnë artin e të jetuarit. Ne jemi rritur sipas një modeli, në të cilin nevojat konfliktuese zgjidhen nëpërmjet betejash force, në të cilat dikush fiton e dikush humb. Ne jemi mësuar me një shprehje "ose – ose" në të cilën, ose unë heq dorë nga ajo që dua, ose ti heq dorë nga ajo që do për mua. Shpesh, duket sikur çmimi i të jetuarit me dikë tjetër është mohimi i vetvetes. Shumë dhimbje në marrëdhëniet njerëzore vjen nga paaftësia jonë për të plotësuar nevojat tona dhe ato të të tjerëve. Konflikti është i pashmangshëm, nëse do të na duhet të jetojmë të ndërvarur. Ne heqim dorë nga disa prej lirive individuale me qëllim që të përfitojmë dobitë e jetesës në grup. Me qëllim që të mbrohen të drejtat e gjithkujt, duhet të vihet një rregull shoqëror. Nëse grupi apo shoqëria, duhet të garantojë të drejtat e secilit kjo do të thotë se individit heq dorë nga e drejta e tij ndaj lirisë absolute të veprimit.

Konflikti nuk ka vetëm midis individit dhe grupit, ai gjithashtu gjendet edhe midis njerëzve brenda grupit. Meqenëse nuk gjen dy njerëz që të jenë njëlloj, ata janë të prirur që të kenë ide, dëshira dhe ndjenja të ndryshme, të cilat kërkojnë të shfaqen në çdo kohë. Veprimi që mbron interesin e njërit, mund të jetë i padëshirueshëm nga pikëpamja e tjetrit. Konflikti mund të jetë i thjeshtë si psh: Çfarë filmi do të shohim, apo aq i ndërlikuar sa: Unë kam nevojë për

ngrohtësi dhe dashuri, por ti je i ftohtë dhe mohues. Konflikti mund të jetë aq primitiv sa: Është vetëm një copë bukë, cili prej nesh do ta hajë, apo aq i ndërlikuar sa: Unë nuk jam dakord me zgjidhjen që i jep ti këtij problemi.

Konflikti është një kusht bazë i jetës së njeriut. Ai është pjesë e gjithë përvojës njerëzore e, megjithatë, ne dimë vetëm disa mënyra për të bashkëvepruar me të. Ne tiranizojmë, nënshtrohem, ose luftojmë. Ne përpiqemi ta zgjidhim atë, ose nëpërmjet forcës, ose nëpërmjet arsyesimit. Përpjekjet për t'i mbushur mendjen tjetrit pothuajse gjithmonë kanë si qëllim vendosjen e kritereve të së drejtës dhe të gabuarës, së mirës dhe së keqes. Ideja është të zgjidhim konfliktin me kushtin që njëri ka të drejtë, ndërsa tjetri jo, njëri ka mendim të mirë, tjetri të gabuar. Atij që e ka gabim, apo ka ide të gabuar, duhet t'i mbushet mendja nga tjetri për t'u dorëzuar në favor të idesë së mirë. Veç kësaj, nëse jemi të bindur se kemi të drejtë, ky kthehet në justifikim për të imponuar vullnetin tonë mbi dikë tjetër. Pak apo shumë, ne të gjithë përdorim modelin autoritar për të zgjidhur konfliktin. Pak rëndësi ka nëse përdorim autoritetin e së drejtës apo atë të forcës, ne përkrahim konceptin se nevojat apo pikëpamjet e një njeriu do të mbizotërojnë mbi të tjerët, sepse ai është ose më i drejtë, më i rëndësishëm, apo më i fuqishëm se të tjerët.

Problemi i nevojave dhe dëshirave të kundërta në marrëdhëniet njerëzore vendoset fillimisht në marrëdhënien nënë – fëmijë. Kjo marrëdhënie është prototipi, jo vetëm i konfliktit njerëzor, por gjithashtu i mënyrave që përdorim ne në përpjekjen për ta zgjidhur atë. Një foshnjë vjen në këtë botë me prirje dhe impulse primitive. Ai kërkon plotësim të plotë të nevojave të tij. Narcisizmi dhe egocentrizmi i tij nuk pajtohen me jetën në shoqëri. Meqë foshnja është i paaftë të plotësojë nevojat e tij, plotësimi i tyre, madje mbijetesa e tij, varen plotësisht nga dikush tjetër. Por, varësia totale e tij bie ndesh me shumë nevoja të nënës. Nëse ai zgjohet

për t'u ushqyer gjatë natës, nevoja e saj për gjumë çenohet. Nevoja e tij për vëmendje mund të pengojë nevojën e saj për të ndjekur interesa, apo përgjegjësi të tjera. Shqetësimi i tij mund të pengojë nevojën e saj për pushim, qetësi dhe paqe mendore. Nevojat dhe kërkesat shtrerruese të foshnjës mund ta bëjnë nënën të ndjejë se ajo po mbaron si person. Shkurtimisht, ajo mund të mos e ndejë këtë situatë si një konflikt, por më tepër, të ndihet e mbingarkuar nga prania e plotë e foshnjës. **Mbijetesa urgjente e foshnjës varet nga plotësimi i nevojave të tij. Ndërsa mbijetesa afatgjatë e tij varet nga zhvillimi i aftësive të nevojshme për t'u kujdesur për veten, për të vonuar plotësimin e nevojave dhe për t'i zbutur ato impulse që kërcënojnë mbijetesën fizike dhe psikologjike të të tjerëve. Po si do të arrihet zhvillimi nga njëri pozicion tek tjetri?**

Nëna është personi i parë me të cilin bie në konflikt fëmija. Pikërisht në këtë marrëdhënie, ai përjeton për herë të parë frustrim. Pak nga ky frustrim ndodh thjesht nga realiteti i të jetuarit në këtë botë e jo në mitër. Nëna nuk ka mundësi gjithmonë që ta ushqejë fëmijën sapo ai të ndjejë uri. Ajo mund të jetë e paaftë të deshifrojë drejt apo të lehtësojë shqetësimet e tij. Sidoqoftë, pak frustrim duhet të imponohet qëllimisht nga nëna, meqënëse ajo kërkon t'ia mësojë fëmijës kufijtë e sjelljes së kërkuar nga jeta në shoqëri. Në kryerjen e këtij veprimi, nëna ndikohet mjaft nga besimet dhe shabllonet e sjelljes së shoqërisë në të cilën ajo jeton. Por, ajo ndikohet gjithashtu edhe nga mënyra me të cilën i janë transmetuar këto qëndrime vetë asaj gjatë fëmijërisë.

Në konfliktin mes nevojave të fëmijës, dhe kërkesave të jetës në shoqëri, shembujt tradicionalë në rritjen e fëmijëve shprehin një pikëpamje të qartë. Sjellja primitive dhe e pasocializuar e fëmijërisë ishte e padëshirueshme dhe e papranueshme. Prindi ishte autoriteti dhe fëmija duhej të bindej, pak rëndësi ka nëse kjo do të binte ndesh me një dëshirë të tijën, apo jo. Në këtë qasje ndaj konfliktit, fjalët dhe dëshirat e prindit ishin të padiskutueshme. Ndikimi kryesor

i teorive psikoanalitike të zhvillimit të personalitetit ishte sepse ato e kthyen përmbys këtë marrëdhënie. Kështu, u prezantua një pikëpamje e re mbi nevojat e fëmijës. Ndërsa prindërit mësuan për traumat e heqjes nga gjiri dhe ato të trajnimit në tualet, ndërsa kofliktet e Edipit, ankthet e kastrimit dhe neurozat sillleshin vërdallë tyre, mesazhi që perceptuan ata ishte se frustrimi ishte i dëmshëm, se këmbëngulja për disa sjellje mund të dëmtonte fëmijën dhe se nëse kishte një konflikt mes dëshirave të tyre dhe nevojave të fëmijës, pikërisht ato të fëmijës ishin të një rëndësie më të madhe. Kjo zhvendosje në qëndrim simbolizohet ndoshta më mirë nga përmbysja e besimeve rreth ushqyerjes së foshnjave, një zhvendosje nga një orar i mirëpërcaktuar nga nëna drejt një ushqyerje të kërkuar nga vetë fëmija, në të cilën bebet ushqeheshin sa herë që qanin apo dukeshin të uritur. Duke prekur këtë pyetje, në botimin e vitit 1957 të librit të tij me titull: “Foshnja dhe kujdesi për fëmijën,” Dr. Benjamin Spock shkruante: “Unë vetëm shqetësohem se ajo (nëna) e ka kuptuar idenë se sa më shumë të sakrifikojë për fëmijën, aq më mirë është për të (për fëmijën), apo se ajo duhet ta provojë se është nënë e mirë duke lënë pas dore rehatin e saj.”

Dr. Spock kishte të drejtë të shqetësohej. Kjo është pikërisht ideja që mori ajo, të cilën e kanë ende shumë nëna në ditët e sotme. Ide të tilla janë rrjedhoja të pashmangshme të më tepër se tri dekadave këshillash mbi edukimin e fëmijës, të cilat kanë qenë të fokusuara tek fëmija. Kjo qasje e edukimit të fëmijës që iu është transmetuar nënave i drejtohet vetëm nevojave dhe ndjenjave të fëmijës dhe, në thelb, anashkalon nevojat dhe ndjenjat e nënës.

Ka një emërues të përbashkët të këtyre qasjeve në dukje të kundërta të edukimit të fëmijës. Të dyja modelet bazohen mbi një gjykim vlerash që vërtitet rreth nevojave dhe dëshirave. Në të dy shembujt, konflikti zgjidhet sipas një pikëpamje të paracaktuar, e cila përcakton se nevojat dhe dëshirat e kujt janë më të rëndësishme, dhe mbi sakrificën arbitrare të një personi mbi tjetrin. Në të parin

vullneti i nënës mbisundonte, ashtu siç paraqitej nga shoqëria. Ndërsa tek tjetri sundojnë nevojat e fëmijës. Metodatat e vjetra autoritare të edukimit të fëmijës u zbuluan se janë shkatërruese për zhvillimin individual të personalitetit të fëmijës. Metodatat e reja autoritare, të bazuara mbi autoritetin e nevojave të fëmijës, janë provuar të jenë njëllor shkatërruese për nënën dhe kanë shkaktuar një mori të tërë problemesh tek fëmija. Asnjëra qasje nuk ka qenë e suksesshme për të na dhënë mjetet e nevojshme për t'u përballur me konfliktin në jetën tonë dhe në shoqërinë më të gjerë.

Sfidat më të mëdha për mëmësinë dhe problemet e saj më të mëdha janë çështjet emocionale që e mbështjellin dhe burojnë nga konflikti i hapur në marrëdhënien nënë - fëmijë. Nënata e gjejnë veten në reagimin ndaj sjelljes së fëmijëve të tyre në mënyra që ato nuk i parashikojnë. Ato zbulojnë në vetvete një zemërim të paimagjinueshëm dhe faj të papërballueshëm. Këto ndjenja shfaqen në atë shkallë sa që, nevojat e fëmijës, siç shprehen në sjelljen e tij, përbëjnë një kërcënim ndaj vetë nevojave të nënës. Asaj i errësohen sytë nga sjellja e fëmijës, kur kjo sjellje bie ndesh me ndjenjat e saj. Në të shumtën e rasteve, ajo nuk e ka përjetuar mundësinë që këto nevoja, dëshira dhe ndjenja të kundërta, mund të bashkëjetojnë. Ajo sheh vetëm dy mundësi: ose fëmija duhet t'i dorëzohet asaj, ose ajo t'i dorëzohet pa kushte fëmijës. Sidoqoftë, asnjëra nga këto zgjidhje nuk e le atë të kënaqur për veten e saj si nënë. Nëse ajo do ta imponojë vullnetin e saj mbi fëmijën, do të ndihet si përbindësh: e dhunshme, e ulët, mohuese. Ajo mund të ndjejë se e ka frustruar aq shumë fëmijën, sa që do ta dëmtojë. Kjo e mbush atë me faj. Nga ana tjetër, bindja ndaj fëmijës nuk e bën të ndihet aspak mirë. Ajo ndihet e frustruar dhe e tiranizuar prej fëmijës së saj. Ajo përballet me një sjellje që i duket e papranueshme. E, çështje më e keqja, suksesi apo dështimi i saj si nënë gjykohet nga njerëzit e tjerë në bazë të po kësaj sjellje. S'ka rëndësi se si sillet, ajo ndihet si një nënë e keqe.

Në përpjekjen e tyre për ta zgjidhur këtë konflikt, nënat i

drejtohen teknikës së vjetër për të dalluar të drejtën nga e gabuara, të mirën nga e keqja. Një nënë mendon se do ta zgjidhë problemin e saj, vetëm nëse dikush do t'i tregojë asaj se sjellja e fëmijës është e mirë apo e keqe, apo se veprimi i saj në një situatë të dhënë është i drejtë, apo i padrejtë. Nënata shprehin fjali të tilla si: “A nuk është e drejtë për të, të më ndërpresë kur jam duke folur në telefon?” “A nuk është e drejtë për të, që të dalë nga dhoma e saj pasi e kam vënë në shtrat?” “A nuk është e drejtë që ai t'i përhapë lodrat në gjithë shtëpinë kur ka mbaruar së luajturi.” Ose ajo mund të pyesë: “A është e gabuar për mua t'i kërkoj asaj të më presë kur kalojmë kryqëzimin?” “A është e padrejtë nga ana ime t'i kërkoj që ai të luajë kur jam duke bërë darkën?” “A e kam gabim kur pres prej tij të mos e godasë vëllanë?” Kërkimi për të “vërtetën objektive” vazhdon. Asaj nuk i duket aspak se të dy, edhe ajo, edhe fëmija, mund të kenë “të drejtë” pasi të dy po shprehin nevoja njëllor të vlefshme. Fëmija mund të ketë nevojë për vëmendje; nëna e tij mund të ketë nevojë për pak pushim, apo mund të dëshirojë të flasë në telefon. **Sjellja e fëmijës që duket negative, apo shoqërisht e papranueshme, thjesht mund të jetë një mënyrë tipike e shprehjes së ndjenjave në një fazë të caktuar të zhvillimit.** Sidoqoftë, kjo sjellje mund të bjerë në kundërshtim me nevojën e nënës për t'u ndierë si një nënë e mirë me veten e saj, apo në sy të të tjerëve. **Këto konflikte formojnë prototipet e të gjithë konflikteve të tjerë të mëvonshëm që do të përjetojë fëmija në jetën e tij, konflikte që ndodhin për shkak të nevojës për të jetuar me njerëz të tjerë, dhe nga fakti i thjeshtë që, në jetë nuk ka mundësi të të shkojë vetëm e jotja gjithmonë.**

Ajo çka përfshihet këtu, nuk është as më shumë e as më pak, vetëm se nevoja për të marrë parasysh nevojat, dëshirat, dhe ndjenjat e të tjerëve. Gjithsesi, fëmija sapo ka filluar ta mësojë këtë të vërtetë të jetës, dhe, gjatë kohës kur ai është duke e mësuar këtë, mund ta shprehë në mënyra të ndryshme inatin që ne të gjithë ndjejmë kur jemi të frustruar. Nga ana tjetër, nëna mund t'i ketë përvehtësuar po

të njëjtat mësimë në mënyra aspak të përshtatshme. Zakonisht, ne nuk i trajtojmë fëmijët si njerëz të tjerë, ndjenjat e të cilëve duhet të merren në konsideratë. Kjo nuk ishte më pak e vërtetë për ne kur ishim fëmijë. Shumica prej nesh u mësua të besonte se disa sjellje të caktuara janë të gabuara. Është gabim të godasësh tjetrin; është gabim të gënjeshtë; është gabim të mashtrosh; është gabim të marrësh atë që nuk të përket; është gabim të mos ndash me të tjerët sendet e tua; është gabim të shprehësh inat apo të jesh tepër i dhunshëm. Në të vërtetë, është shumë normale dhe e natyrshme të ndihesh i inatosur; të sulmosh kur kërcënohesh; të duash gjërat që nuk të përkasin, apo të përpiqesh të shmangësh pasojat e veprimeve të tua. Këto ndjenja janë universale. Është vetëm sjellja nëpërmjet së cilës shprehen ajo që i bën të papranueshme, nëse ajo cënon në një mënyrë shkatërrimtare nevojat dhe dëshirat e të tjerëve. Gjithsesi, për shumicën prej nesh nuk është bërë kurrë ndonjëherë dallimi midis sjelljes dhe ndjenjave që fshihen prapa saj. Sjellja vetëm është gjykuar të jetë e mirë, apo e keqe, nga ata prej të cilëve ne varemi për mbijetesën tonë. Si pasojë, ne kemi vazhduar të ndjejmë se jemi të gabuar, apo të këqinj si njerëz.

Ky ngatërrim mes ndjenjave dhe sjelljes, që na ka shkaktuar vuajtje të gjithëve, është thelbi i problemit. Një nënë ka vështirësi të pranojë vlefshmërinë e ndjenjave të fëmijës së saj, sepse këto ndjenja shprehen me anë të sjelljes, së papranueshme. Kjo sjellje nxit tek nëna ndjenja, të cilat, edhe asaj i duken të papranueshme. Ajo mund ta gjejë veten duke reaguar me inat të tërbuar, apo ndjenja urrejtje ndaj fëmijës. Ajo mund ta ndjejë vetveten duke dalë nga kontrolli dhe ta gjejë veten duke thënë apo kryer gjëra që nuk pajtohen me imazhin që ajo do të donte të kishte si nënë. Gra të rritura, të forta dhe të afta flasin për dy, tre, apo katër vjeçarët e tyre, sikur ata të ishin gjigandë dhe nënat e tyre të vocërta dhe të pafuqishme, sikur në fakt nënat të ishin në vendin e fëmijëve. Sjellja primitive dhe e pasocializuar e fëmijëve takon dhe thërret fëmijën brenda ne të gjithëve. Fëmija

brenda nesh përgjigjet me të njëjtat ndjenja si fëmija prej vërteti, ndjenja që duken kaq të rrezikshme për shkak të frikës se ato do të shpërthejnë në veprime të palejueshme.

Një nënë nuk e pranon vërtetësinë e këtyre ndjenjave në vetvete. Ajo nuk e beson se këto ndjenja janë një përgjigje e ligjshme ndaj sulmit që bëhet mbi nevojat e saj nga kërkesat dërrmuese të fëmijëve që rriten. Përkundrazi, inati i saj dhe ndjenjat agresive e mbushin atë me faj dhe e paralizojnë atë në situatat konfliktuale që krijohen me fëmijën. Gjithë këshillat e botës do të ishin të pakuptimta në ato situata, sepse janë ndjenjat e saj ato që i dalin pengesë përpara në arritjen e objektivave të saj. Këto ndjenja të papranueshme e bëjnë atë të besojë se, ose ajo është nënë e keqe, ose ajo ka një fëmijë shumë të keq, meqë ai është në gjendje të provokojë ndjenja kaq të tmerrshme tek ajo. Kjo nevojë për t'ia ngjitur fajin tjetrit, e cila fillon në marrëdhënien nënë –fëmijë, është një shabllon sjellje që do të mbetet përgjatë gjithë jetës. **Kur krijohen konfliktet pyetja që shtrohet është: Kush e ka fajin? më shpesh se sa: Cila është rrënja e këtij konflikti dhe çfarë mund të bëhet për të? Këto janë ekzaktësisht pyetjet që një nënë duhet t'i bëjë vetes në konfliktet me fëmijën e saj.** Gjithsesi, ajo nuk do të jetë në gjendje t'iu përgjigjet atyre, nëse nuk beson në rradhë të parë se ajo ka të drejtë të mbështetet në ndjenjat e saj dhe se ajo ka të drejtë që këtyre ndjenjave t'iu kushtohet vëmendje. Shumë prej nesh vuajnë nga nevoja për ta provuar këtë të drejtë. Ne nuk besojmë se të tjerët do t'i marrin në konsideratë ndjenjat tona, dhe kështu ne përpiqemi t'i përlegim këto nevoja, duke identifikuar pozicionin tonë me faktin, apo të vërtetën, dhe duke sulmuar pozicionin e personit tjetër si të gënjeshtërt, të keq, apo të gabuar. Ne nuk besojmë se kemi të drejtë të respektohem i thjesht sepse ne jemi, jetojmë, ekzistojmë.

Në zhvillimin e sjelljeve sociale, detyra kryesore është rritja nga një pozicion ku fëmija kërkon vëmendje totale për të plotësuar nevojat dhe ndjenjat, drejt pikës ku ai do të jetë në gjendje që vetë

të marrë parasysh nevojat dhe ndjenjat e të tjerëve. Pra, objektivi është një ekuilibër midis vetes dhe tjetrit. Një sfidë për edukimin e fëmijës është ta ndihmojmë atë të zhvendoset nga njëri pozicion tek tjetri, në atë mënyrë që ai të mos detyrohet të besojë se nevojat dhe ndjenjat e tij janë të gabuara, dhe ai duhet të sakrifkohet për dikë tjetër, apo të tjerët duhet të shtrëngohen të sakrifikojnë nevojat dhe ndjenjat e tyre për të.

Për ta arritur këtë objektiv nëna duhet të fillojë me vetëbesimin se ajo ka të drejtë ndaj ndjenjave dhe nevojave të saj. Ajo ka të drejtë të **mos** e sakrifikojë veten e saj për fëmijën. Ajo ka të drejtë të ndjejë inat, shqetësim, urrejtje, refuzim dhe nevojën për t'u mbështetur tek dikush tjetër veç vetes. Asnjë nga këto nuk e bën atë nënë të keqe. Po ashtu, kërkesat e fëmijës, varësia, nevoja për përkujdesje, ndjenjat agresive dhe ato të inatit nuk e bëjnë atë fëmijë të keq. Sjellja e vështirë e fëmijëve mund të jetë plotësisht në përputhje me fazën e zhvillimit në të cilën ata janë. Pikërisht për shkak të kësaj sjellje "të natyrshme", e cila cënon aq shpesh nevojat e të tjerëve, ne e kemi të vështirë të jetojmë me të. **Për këtë arsye, një detyrë themelore e edukimit të fëmijës është ta mësosh atë si të shprehet në mënyra më të pranueshme.** Meqenëse nëna është mësuesja e parë, ajo është personi që ndodhet në vijën e parë të frontit, në komunikimin me dikë, i cili nuk ka mësuar ende se si të marrë parasysh kërkesat e të tjerëve. Nëse ajo duhet të korrë ndonjë sukses në këtë rol, është thelbësore që ajo të besojë në të drejtat e saj, sepse janë pikërisht nevojat e saj, ato që do t'i prezantohen të parat fëmijës ashtu si të një tjetri që duhet të respektohen. Nevoja që ka fëmija për nënën e tij është shembulli më i ngjashëm i nevojës që ai do të ketë gjatë gjithë jetës për t'u mbështetur tek dikush tjetër, deri në një farë mase, për mirëqenien e tij psikologjike dhe fizike. Është kjo nevojë, që e bind atë të fillojë të respektojë kërkesat e nënës së tij. Ajo është duke i mësuar fëmijës mënyrat me të cilat duhet të merren parasysh dëshirat e saj dhe do ta ketë të vështirë ta arrijë këtë, nëse beson se ajo

nuk meriton asnjë lloj respekti, apo fëmija nuk meriton fare respekt. Metodat që përdor ajo janë shprehje e drejtpërdrejtë e perceptimit të asaj që ndodh mes tyre. Nëse ajo beson se nevojat e fëmijës së saj janë supreme, apo se nëse do ta frustronjë atë, ai do të dëmtohet, se të jesh nënë e mirë do të thotë t'ia plotësosh të gjitha tekat, kjo do ta bëjë të besojë se ajo duhet "t'i dorëzohet" fëmijës. Duke vepruar kështu, ajo do të ndihet e abuzuar, prej së cilës fëmija ka përfituar, e shfrytëzuar dhe e inatosur. Këto ndjenja do të jenë plotësisht të vlefshme, sepse ajo ka qenë vazhdimisht duke dhunuar dhe injoruar nevojat e saj. Dhe, siç e pamë, kjo, më në fund, do ta bëjë të besojë se fëmija është i keq, sepse ai i ka ngjuar ndjenja të tilla.

Inati kundrejt fëmijës mund të rritet edhe nga një pritshmëri jorealiste të shkallës në të cilën ai është i aftë të respektojë nevojat e nënës së tij. Gjatë kohës që fëmija zhvendoset nga egocentrizmi i plotë, drejt një aftësie për të respektuar të tjerët, nëna është në të vërtetë në një pozicion ku mund të bëjë shumë kompromise. Kjo ve mbi shpatullat e saj një barrë të rëndë dhe është pjesë e asaj që e bën mëmësinë kaq të vështirë. Pritshmëria jorealiste se fëmijët sillen në mënyra të pakuptueshme është një shprehje e frustrimit, e të përballurit vazhdimisht me kërkesat e fëmijëve të vegjël. Por, është gjithashtu një shprehje e shkallës deri në të cilën nevojat e fëmijëve konsideroheshin të pranueshme, në kohën kur ajo vetë ishte fëmijë. Sjellja e varur e fëmijërisë i duket e papranueshme tek fëmija e saj, sepse ajo është mësuar ta gjejë të papranueshme në vetvete. Ajo beson se nuk do të respektohet, dhe ajo gjen në sjelljen e fëmijës së saj vërtetimin e kësaj ideje. Ajo beson se sjellja e fëmijës nuk tregon diçka për veten e tij, por është krijuar qëllimisht si një sulm mbi të.

Stresi emocional i mëmësisë krijohet nga ndjenjat që zgjohen nga sjellja e fëmijëve, ndjenja që induktohen nga një marrëdhënie në të cilën, për një kohë të gjatë, nevojat e tjetrit marrin prioritet mbi ato të tuat. Sidoqoftë, ky stres emocional përforcohet nga mendimi i nënës se ndjenjat e saj janë të dyshimta dhe nga frika

e saj se ato do të shpërthejnë në sjellje negative dhe të dhunshme kundrejt fëmijës. Ajo ka nevojë për të patur vetëbesimin e dijenisë se ajo mund t'i përjetojë këto ndjenja por, pa i shprehur ato në një mënyrë shkatërruese kundrejt fëmijës. Qëllimi i saj është që të ndihmojë gradualisht fëmijën të bëhet i vetëdijshëm se ajo është një person i veçantë, nevojat e të cilit duhet të respektohen. Ajo mund ta realizojë këtë vetëm nëse do ta besojë vetë e para.

KAPITULLI 4

*Ju nuk duhet të...**Unë jam i keq, sepse ndihem keq**Unë ndihem keq, sepse jam i keq*R.D. Laing, *Nyjet*

Përpara se të ekzistonte psikiatria, ishte feja. Përpara neurozës ishte mëkati. Përpara Frojdit ekzistonte Zoti, autoriteti final.

Të dyja, edhe feja edhe psikiatria, shprehin pikëpamjen e tyre rreth sjelljes njerëzore. Secila prej tyre bën gjykime për sjelljen që buron nga pikëpamja e saj e veçantë. Feja e gjykon sjelljen në bazë të moralit të saj. Psikiatria e gjykon atë në bazë të domethënies së saj për sëmundjen apo shëndetin mendor. Të dy sistemet përdorin koncepte të së mirës dhe së keqes në gjykimin e sjelljes. Të dyja janë autoritare në natyrë. Nënata janë kapur midis këtyre dy autoriteteve.

Dy pyetjet e bëra vazhdimisht rreth sjelljes në shoqëri dhe, gjithsesi në lidhje me edukimin e fëmijëve janë: Cila quhet sjellje e pranueshme dhe si duhet të veprojmë më të? Duke marrë parasysh këto pyetje, ne sot përpiqemi të përdorim koncepte psikologjike, por, ende nuk i kemi shpëtuar ndikimit të mendimeve të mëparshme fetare rreth origjinës së mëkatit dhe të keqes në natyrën njerëzore. Këto mendime sugjeronin se të gjitha prirjet dhe dëshirat e natyrshme njerëzore ishin të dyshimta. Sjellja që shfaqej si pasojë e nevojave të individit ishte e rrezikshme, dhe për këtë arsye nuk duhej të lejohej. Sjellja njerëzore udhëhiqej nga ligji moral dhe, nëpërmjet fesë, forcës morale të Zotit, kontrollohej sjellja e padëshirueshme tek njeriu.

Përforcimi i sukseshëm i këtij ligji të lartë moral varej nga besimi universal në ekzistencën e Zotit, si figura e plotfuqishme e autoritetit. Ai, jo vetëm që është i vetëdijshëm për sjelljen tonë, por, Ai gjithashtu sheh në mendjet dhe në zemrat tona. Asnjë ndryshim nuk bëhej midis mendimeve, ndjenjave, dhe veprimeve. Mendimet dhe ndjenjat, po ashtu si sjellja, janë ose të mira ose të këqija. Ajo që është e keqe është shprehja e forcës djallëzore tek njeriu. Ajo që është e mirë vjen nga devotshmëria ndaj Zotit. “E keqja” ndëshkohet, “e mira” shpërblehet. Motivimi për të qenë i mirë buron edhe nga dëshira për të fituar kënaqësinë e Zotit edhe nga droja e zemërimit të Tij.

Këto qëndrime kundrejt sjelljes dhe mënyrat e përdorura për ta kontrolluar atë, patën një efekt të thellë në perceptimet tona për fëmijët dhe mbi praktikën tona të edukimit të fëmijëve. Në të kaluarën sjellja “e keqe” shihej si pararendëse e një të rrituri të keq. Paraardhësit e gjithçkaje që duhej e rrezikshme për natyrën njerëzore shiheshin në fëmijëri. Në inatin dhe sjelljen agresive dhe të dhunshme të fëmijëve shihej i rrituri që mund të vriste. Seksualiteti i fëmijëve sugjeronte epshin e të rriturit. Egocentrizmi dhe dëshirat e fëmijërisë paralajmëronin egoizmin dhe makutërinë e të rriturit. Ishte detyra e prindërve që t’i mbanin nën fre dhe t’i kontrollonin këto impulse të rrezikshme tek fëmijët. Mënyra me anë të së cilës duhet të realizohej kjo ishte po aq e qartë sa edhe sjellja që duhej të kontrollohej. Edhe metoda, edhe standartet morale e kishin burimin nga feja.

Prindi u bë autoriteti i lartë, i plotfuqishëm, i cili mund të zhbironte mendimet dhe ndjenjat e fëmijës dhe mund t’i gjykonte ato dhe sjelljen si të mira, apo të këqija. Autoriteti i prindit ishte absolut dhe dëshirat e fëmijës nuk ishin aspak një faktor që mund të merreshin parasysh. Një rëndësi e veçantë i kushtohej bindjes dhe, çfarëdo lloj shprehje e inatit, apo e ndjenjave rebeluese ishte pa dyshim e keqe dhe nuk duhej të tolerohej. Fëmijët mësoheshin

t'i bindeshin pakënaqësisë prindërore nëpërmjet ndëshkimit, turpërimit dhe poshtërimit. Kur fëmijët silleshin keq, atyre u thuhej se ata ishin të këqinj. Nuk dënohej vetëm sjellja si e keqe, por edhe vetë fëmija. Midis tij dhe sjelljes së tij, nuk bëhej aspak dallim. Qëllimi ishte të zhvillonin një vetëdije strikte, kështu që, duke kryer gjëra “të këqija,” ato automatikisht do të nxisnin ndjenja të këqija brenda tij. Këto ndjenja të këqija përfundimisht do të kontrollonin sjelljen e tij. Në këtë mënyrë, fajësimi i tejskajshëm shërbente për të përforcuar kontrollin prindëror.

Në sajë të ndikimit të zhvillimeve të reja në psikiatri, veçanërisht në sajë të teorisë së Frojdit, filloi të ndryshojë pikëpamja e hershme e natyrës njerëzore. Inati, agresiviteti, seksualiteti, prirja ndaj kënaqësisë dhe plotësimi i impulseve, u arrit që të shiheshin si aspekte normale të natyrës dhe zhvillimit të njeriut. Për më tepër, sjellja e fëmijëve nuk ishte ajo që dukej në sytë e të rriturve. Fëmijëria kishte kornizën e saj të shpjegimit për sjelljen dhe sjellja feminare nuk duhej të interpretohej më nga pikëpamja e vlerave të botës së të rriturve, e as që ishte motivimi i të rriturve ai që mund t'i atribuohet. Jo vetëm që tashmë fëmijët shiheshin ndryshe nga të rriturit, por në fakt, sjellja e “sëmure” më tepër se sa ajo “djallëzore” e të rriturit, pohohej si rezultat i metodave të ashpra shtypëse, që ishin përdorur për të vënë nën kontroll prirjet e natyrshme dhe normale të natyrës njerëzore të shprehura gjatë fëmijërisë. Për këtë arsye, sjellja nuk gjykohej më duke iu referuar moralit të saj por, duke iu referuar kuptimit: kuptim, i cili në fëmijëri lidhej me zhvillimin, ndërsa në jetën e të rriturit me patologjinë.

Kjo zhvendosje e pikëpamjes mbi sjelljen nuk do të thoshte se gjykimet morale nuk do të bëheshin më. Ajo thjesht do të thoshte se nuk e gjykonim më sjelljen përsa i përket moralit të saj. Gjykimet “e keqe” apo “e mirë,” që bëheshin më parë për sjelljen e palejueshme, tashmë po bëheshin për mënyrat që po përdoreshin për ta kontrolluar këtë sjellje. Tanimë ishte “keq” të përdorje ndëshkimin

fizik. Ishte “keq” të poshtëroje dhe të turpëroje fëmijët. Ishte “keq” t'i frikësoje ata dhe t'i bëje të ndiheshin faktorë dhe ishte “keq” të mos respektoje nevojat dhe dëshirat e tyre. **Në këtë atmosferë të ndryshueshme të edukimit të fëmijëve dy gjëra mbetën të pandryshuara: përdorimi i autoritetit dhe shqiptimi i gjykimeve morale. Vetëm se tani autoriteti i psikiatrisë kishte zëvendësuar autoritetin e fesë dhe gjykimet jepeshin për sjelljen e nënës dhe jo për atë të fëmijës.**

Pasimi i autoritetit të ri të psikiatrisë i shpuri nënat në vështirësi të reja. Sapo u hap Kutia e Pandorës dolën përjashta të gjitha llojet e sjelljeve. Kur u ngrit kapaku i rëndë i shtypjes, nënat u përballën me inatin, agresivitetin, kundërshtimin, seksualitetin dhe kërkesat e mëdha për plotësimin e dëshirave të fëmijëve të tyre. Ato po ndiqnin një qasje për edukimin e fëmijëve, e cila i jepte më shumë liri fëmijës dhe kjo u pa se përfshinte lirinë për t'u sjellë në mënyra të papranueshme. Më shumë se thjesht të papranueshme, kjo ishte sjellja për të cilën nënat ishin mësuar se ishte “e keqe”, “djallëzore”. Ato u kapën papritur midis dy autoriteteve dhe dy drejtimeve të gjykimeve morale. Atyre u qe mësuar nga autoriteti tradicional i prindërve të tyre, se sjellje të tilla ishin të këqija, por, autoriteti i ri i psikiatrisë, përkundrazi, deklaronte se ishin reagimet tradicionale ndaj sjelljes, ato që ishin të këqija. Autoriteti i vjetër thoshte se ato ishin nëna të këqija, nëse do ta lejonin këtë sjellje. Ndërsa autoriteti i ri thoshte se ato ishin nëna të këqija, nëse do të ndërhyenin në këtë sjellje.

Fatkeqësisht, në pjesën më të madhe, nënat nuk kanë qenë të vetëdijshme për këto dy sisteme trysnie të ushtruar mbi to. Ato ishin vetëm të vetëdijshme për ndjenjat e tyre të inatit dhe fajit: inat për sjelljen e fëmijëve të tyre, faj për inatin e tyre. Ato duan të jenë nëna “të mira” dhe të përdorin metoda që të mos i dëmtojnë fëmijët e tyre. Por, ato do të donin që fëmijët e tyre të silleshin në mënyrat që **atyre** u ishte mësuar se si duhet të silleshin fëmijët. Metodrat

që përdoreshin më parë, për të vënë nën kontroll sjelljen “e keqe”, gjithsesi, tashmë duken po aq të gabuara sa edhe sjellja për të cilën u formuluan për ta kontrolluar. Përveç kësaj, këto metoda nuk japin më rezultat sepse forcat që i bënë ato të funksiononin janë thyer në gjithë shoqërinë.

Dhe, kështu ne jemi lënë të përballemi të vetme me çështjen e pazgjidhur dhe të pambaruar të vetë fëmijërisë tonë, e cila trazohet kur ne përballemi me të përsëri me fëmijët tanë. Ka copëra të panumërta sjelljesh të cilat ndihen se janë “të këqija.” “JO” – ja e fëmijës fillon një ndryshim emocional. Goditjet, kafshimet, rrëmbimi i lodrave të tjerëve, ndihet se janë kërcënuese. Këto janë mbetje të një epoke të harruar. Ne mendojmë se e kemi shpërndarë moralin tonë Puritan në favor të teorisë moderne, po nuk është kështu. Gjykimet morale zvarriten në përgjigjet tona ndaj fëmijëve. Ne mund të mos e shohim më një fëmijë si thelbësish të keq, por ne ende mbajmë qëndrimin se disa sjellje na bëjnë ne nënave të dyshojmë në sytë e të tjerëve dhe të vetvetes, sjellje që duken të këqija, ndonëse ne shpesh nuk e dimë përse.

Një grup nënash u takuan me mua për të diskutuar se si mund t'i bënin fëmijët të rreshtnin së godituri fëmijët e tjerë në parkun e lodrave. Cili ishte kundërshtimi i tyre ndaj goditjes? “Është e keqe, ... nuk është e drejtë.” “Nënave të tjera nuk u pëlqen.” “Fëmijët e tjerë nuk do të luajnë me ta.” Për pasojë, ato po shpreheshin: “Është e keqe sepse le shije të hidhur.” Arsyeja pse le shije të keqe ishte shumë më pak e qartë. U desh pak të menduar për t'u zhvendosur nga gjykimi moral “e keqe” drejt faktit social që goditja është e papranueshme, sepse të tjerët nuk do të donin të goditeshin dhe se sulmi fizik është cënim i të drejtës së tyre për të mos u lënduar prej dikujt tjetër.

Një nënë ishte e shqetësuar se fëmija i kishte thënë asaj se i kishte larë dhëmbët, në një kohë që ajo e dinte fare mirë se ai nuk e kishte bërë këtë. Ndonëse ajo në fillim ishte e interesuar në larjen e dhëmbëve, ajo ishte shmangur nga ndjenja e saj se ai ishte “i

keq,” sepse gënjente. Tashmë, shqetësimi i saj u shndërrua në një preokupim për ta ndëshkuar për gënjeshtërinë, se sa për t'u siguruar për larjen e dhëmbëve.

Nënat shpesh ndjejnë se diçka nuk shkon po t'u kushtojnë pak vëmendje fëmijëve për t'i ndihmuar ata të kryejnë udhëzimet, psh, të vendosin lodrat në vend, apo të pushojnë së luajturi dhe të vishen. Bindja duket më e rëndësishme se sa mbledhja e lodrave apo të veshurit. Mosbindja është “e keqe.” Në të njëjtën rrjedhë gjykimi, punët e shtëpisë janë virtyt; ato duhet të bëhen se janë për t'u bërë dhe kaq, sepse është e drejtë moralisht, më tepër sesa të arrijmë një qëllim të domosdoshëm, si për shembull: t'i vendosim lodrat në vend me qëllim që të kënaqemi me to edhe herën tjetër. Për lodrat duhet të kujdesemi sepse është “keq” të jesh shkatërrues; me to duhet të luhet së bashku me të tjerët, sepse është “keq” të jesh egoist. Nëse sjellja nuk mvishet me asnjë kuptim tjetër përveç gjykimit moral, si pasojë, fëmija që bindet është “i mirë,” ndërsa ai që nuk bindet është “i keq.” Nëna që e bën fëmijën e saj të sillet si duhet është nënë e mirë, ndërsa nëna që e lejon fëmijën të “shpëtojë pa u lagur” është nënë e keqe.

Ndjenja se diçka është “e keqe” e bën atë të duket si ogurzezë. Sjellja duket edhe më e keqe seç është dhe vishet me një kuptim të lig. “I keq” kthehet në një gjykim jo vetëm për sjelljen, por edhe për motivimin, për karakterin – shkurt një damkë për personin në tërësinë e tij. Atëhere kur sjellja merr përmasat e një mëkati, duket se thirret për ndihmë ndëshkimi i tmerrshëm. Shkeljet e rënda meritojnë pasoja të rënda.

Kur nëna përjeton ndjenja të tilla, për sjelljen e fëmijës së saj, ajo përjeton një impuls për të bërë diçka drastike. Por, ajo në të vërtetë nuk di se çfarë duhet të bëjë, sepse, ndërsa sjellja e fëmijës së saj i duket e keqe, asaj ndërsa i lind dëshira për ta ndëshkuar, ajo njëkohësisht është e frikësuar se reagimet e saj mund të jenë të këqija për fëmijën. Ajo beson se sjellja e fëmijës së saj, ndonëse “e

keqe”, mund të jetë shprehje e nevojave të tij emocionale. E, nëse është kështu, ajo nuk dëshiron që të kundërpërgjigjet në një mënyrë që do ta dëmtonte atë.

Për shembull, njëra prej grave në një grup tjetër diskutimi, donte të dinte nëse është e drejtë apo e padrejtë ta lejojë fëmijën e saj të masturbojë. “A është masturbimi i mirë apo i keq për të?” pyet ajo. Nënata e tjera prezente atje e shfaqën shqetësimin e tyre në lidhje me këtë çështje. Një nënë thotë: “Ai mund të jetë normal, por ne jemi mësuar se është i keq.” Kjo është çështja. Normalja ka marrë statusin e të mirës, por ne jemi mësuar se ajo është e keqe.

Ky konflikt ndikon në reagimet e nënës. Nëse ajo do të veprojë duke e ndëshkuar, për shkak të ndjenjës se sjellja është e keqe, më pas, ajo do të ndihet në faj. Nëse do të përpiket ta shtypë këtë impuls ajo shpesh e gjen veten duke mos bërë asgjë. Reagimet e saj duken po aq të rrezikshme sa sjellja e fëmijës dhe kështu ajo mbetet në udhëkryq. Duket sikur zgjidhja e saj është të pranojë sjelljen “e keqe” të fëmijës, ose thënë ndryshe të bëhet nënë “e keqe”; që do të kritikohet ose për lejimin e sjelljes së keqe, ose për dëmin psikologjik mbi fëmijën.

Shumë shpesh, kur nënës i duket sjellja e keqe, ajo ka për qëllim të thotë se ajo ndihet keq. Asaj nuk i pëlqen. Por fakti që ka shije të keqe, që ajo nuk e pëlqen atë – nuk e bën atë të keqe. Kjo përbën vetëm diçka që ajo nuk e pëlqen. Sidoqoftë, fakti që nuk është e keqe, nuk e zhvlerëson të drejtën e saj të mos e pëlqejë atë. Edhe kur sjellja e fëmijës nuk është “e keqe”, por “normale”, ajo nuk është nënë “e keqe,” nëse nuk e pëlqen sjelljen e fëmijës së saj. Nënata shpesh mendojnë se, nëse sjellja e fëmijës nuk është e keqe, atëherë duhet të jetë e mirë, dhe për këtë arsye ato duhet ta pranojnë atë. Nëse ato nuk mund ta pranojnë, e transferojnë të keqen nga fëmijët tek vetë ato. Ato janë nëna të këqija, sepse janë të paaferta të pranojnë sjelljen “e mirë” të fëmijëve të tyre.

Ne duket se kemi vështirësi të mëdha për ta pranuar faktin se sjellja mund të mos jetë e keqe, në kuptimin e mëkatit, apo të djallëzisë,

por, në të njëjtën kohë, ajo mund të mos jetë e dëshirueshme, apo e pranueshme e parë nga pikëpamjet e tjera. Po ashtu, fakti që sjellja është “normale,” apo në përputhje me zhvillimin e fëmijës, nuk e bën atë domosdoshmërisht të dëshirueshme, apo të pranueshme. Fakti që impulset e fëmijëve nuk janë djallëzore, nuk do të thotë se sjellja që buron nga këto impulse është e dëshirueshme nga pikëpamja e jetës në shoqëri. Impulset e padëshirueshme nuk ka pse të ndiqen si diçka e mirë, me qëllim që të pranohen si normale. Po kështu, as sjellja e fëmijës, e cila është e papranueshme nuk ka pse të dënohet si “e keqe” me qëllim që ta vemë nën kontroll.

Kundërpërgjigjja jonë ndaj sjelljes, në pjesën më të madhe, buron nga pikëpamja që mbrojmë ne për atë sjellje. Gjykimi “e mirë,” apo “e keqe” është burgosës, pak rëndësi ka nëse vjen nga autoriteti i fesë, apo autoriteti i psikiatrisë; nëse ai e ka burimin nga ligjet e prindërve tanë, apo nga shqetësimi për shëndetin mendor. Sido që ta marrim, ai nxjerr një përgjigje të programuar. Nëse është e keqe duhet të ndalohet; nëse është e mirë duhet të lejohet. Ne nuk jemi të lirë të bëjmë gjykimet tona, të vendosim standartet tona, me të vërtetë të marrim përgjegjësi për vetë sjelljen tonë, sepse kështu ne po veprojmë sipas sistemit të vlerave të dikujt tjetër – qoftë ky i prindërve tanë, apo i ekspertëve profesionistë. Gjykimet morale të së shkuarës na mbajnë ne në një shtrëngim të fortë. Si nëna, ne vazhdojmë të luajmë si pasojë e konfliktit të vjetër midis së mirës dhe së keqes të inteligjencës sonë prej të rrituri. Nevoja për të qenë konform së mirës dhe së keqes së të tjerëve e bën emocionalisht të pamundur të zbulojmë se cila është pikëpamja jonë. Nëse dikush do ta pyeste një nënë, e cila përballet me një sjellje të fëmijës që i duket e papranueshme, “Cili është kundërshtimi yt për këtë sjellje,” kjo pyetje shumë shpesh interpretohet si kritikizëm ndaj ndjenjave të saj. Ajo beson se asaj i kanë thënë se sjellja e fëmijës së saj nuk është e keqe, dhe se asaj **duhet** t’i duket e pranueshme. Asaj nuk i bie ndër mend se, nëse ajo zbulon se sjellja është e papranueshme, kjo ka

vlerën e vet më vete. Përkundrazi, asaj i duket se ndjenjat e saj duhet të jenë konform gjykimit të dikujt tjetër – gjykimit të një autoriteti më të lartë. Nëse ndjenjat e saj nuk janë konform tij, për të kjo do të thotë se reagimi i saj duhet të jetë i gabuar dhe, nëse vepron sipas tij kjo do ta bëjë nënë të keqe.

Pohimi i nënkuptuar është se ka një standard absolut – një të vërtetë abstrakte – që e përkufizon sjelljen si të mirë, apo të keqe. Nënata besojnë se dikush duhet t'ua tregojë atyre se cili është ai, me qëllim që ato të japin përgjigjen e duhur – përgjigjen që do të jetë “e mirë” për fëmijët e tyre. E mira dhe e keqja morale janë mbjellë nga e mira dhe e keqja emocionale dhe frika e ankthit që lidhet me të **qenit** i keq janë zëvendësuar nga njëra tek tjetra. Nënata janë tani të frikësuar se do t'i kalojnë caqet pa vetëdije, sepse, ndërsa standartet morale për sjelljen janë të mirënjohura, rregullat e së mirës dhe së keqes për shëndetin mendor mbeten të paqarta.

Por, puna është se, kur pyesim një nënë çfarë kundërshton ajo në sjelljen e fëmijës, nëna duhet të vështrojë thellë në vetvete për të zbuluar se çfarë **kundërshton** ajo, nëse do t'i duhet të përgjigjet në mënyrë kuptimplotë fëmijës së saj. Nëse ajo nuk e ka të qartë për vete se çfarë është me të vërtetë kundërshtimi i saj, ajo nuk është e lirë ta pranojë apo ta kundërshtojë atë për vete, dhe e vetmja mënyrë që i vjen në ndihmë asaj në marrëdhënie me fëmijën është ta quajë edhe sjelljen edhe fëmijën të keqe, apo ndjenjat dhe veten e saj të keqe.

Nëse nënat duhet të jenë të suksesshme në realizimin e qëllimeve të edukimit të fëmijëve, duhet të kenë lirinë e tyre të brendshme për të gjetur sistemin e vlerave të tyre, dhe brenda këtij sistemi të zbulojnë se çfarë është dhe çfarë nuk është e pranueshme për to. Kjo do të thotë të lenë mbrapa ankthin, por, njëkohësisht, edhe thjeshtësinë e formulave të mirë – e keqe dhe të vendosin vetë se çfarë dëshirojnë t'iu mësojnë fëmijëve të tyre.

KAPITULLI 5

Rrezik i dyfishtë

Një nënë thotë: “Kur fëmija im bën diçka që nuk duhet ta bëjë, unë i them të ndalojë. Nëse ai nuk dëgjon, unë, ose e le të bëjë sipas kokës së tij, ose do të më duhet ta ndaloj. Por, mënyra ime e vetme me të cilën mund ta ndaloj, është nëpërmjet mjeteve fizike. Asnjëra nga këto nuk jep rezultat. Nëse unë i dorëzohem atij gjithë kohën, ndjej se ai po më lodh së tepërmi. Por, kur përdor dhunë fizike, kjo më bën të ndjej se jam një monstrë.”

Një nënë tjetër thotë: “Kur fëmija im përjeton një krizë inati në mes të supermarketit, më duket sikur të gjithë më vështrojnë mua duke menduar: “Ajo nënë s'është në gjendje as të kontrollojë fëmijën e saj.” Kjo më tërbon aq shumë sa filloj ta rrah. Atëherë njerëzit bëjnë komente sikur unë të jem dhunuese fëmijësh.”

Edhe një nënë tjetër thotë: “Sa herë që përpiqem të punoj në tryezën time të punës, djali im fillon të hedhë lapsa prapa kaloriferit. Unë e kuptoj se ai po e bën këtë për të më tërhequr vëmendjen dhe, nëse unë ngrihem dhe luaj me të, ai ndalon. Megjithatë, kjo nuk më duket e drejtë. Unë e ndjej se ai duhet të ndalojë sepse unë i them ta bëjë këtë.”

Ne të gjithë përdorim një shumëllojshmëri mënyrash për t'i bërë të tjerët të bëjnë atë që themi ne. Kjo përpjekje për të kontrolluar sjelljen është edhe një burim vështirësie edhe një tregues i vështirësive në marrëdhëniet njerëzore. **Kjo nevojë për të kontrolluar shpreh ndjenjën se të tjerët nuk do t'i plotësojnë nevojat tona, dhe nuk do t'i respektojnë dëshirat tona, nëse nuk detyrohen të veprojnë kështu. Ne besojmë se duke i lënë të operojnë me mjetet e tyre, të**

tjerët nuk do të bëjnë atë që duam ne, dhe, madje, mund të na shkelin me këmbë gjatë rrugës së plotësimi të dëshirave të tyre. Ne ndjejmë se duhet ta imponojmë vullnetin tonë, ose të gjejmë një mënyrë për ta bërë personin tjetër të dëgjojë me qëllim që të na kushtojnë vëmendjen për të cilën kemi nevojë.

Shpesh, ne kemi po aq pak besim në aftësinë tonë për t'i respektuar të tjerët, sa ç'kemi në vullnetin e të tjerëve për të na respektuar ne. Ne kemi frikë se, nëse do të kujdesemi për nevojat tona, mund të mohojmë dikë tjetër. Nevoja për të kontrolluar sjelljen tonë, atëherë bëhet po aq sfiduese, sa edhe nevoja për të kontrolluar dikë tjetër. Është frika se ne do të sillemi në mënyrë të papranueshme, ajo që na nxit drejt kontrollit të rreptë. Por, kjo është më pak frikë e sjelljes sonë se sa është frikë e ndjenjave tona. Ne përjetojmë dëshirën për të hequr qafe këdo që na del përpara në rrugën e asaj që duam të marrim, dhe ndihemi të frikësuar se mos veprojmë sipas kësaj ndjenje. Rreziku që përjetojmë atëherë, qoftë nga të tjerët, qoftë nga vetja, është rreziku që duket se vjen nga ndjenjat. Ndjenjat e të tjerëve janë të rrezikshme sepse çojnë në sjellje që mund të na dëmtojnë ne, dhe vetë ndjenjat tona janë të rrezikshme, sepse ato çojnë në sjellje që mund t'i dëmtojnë të tjerët. Nevoja për të qenë në kontroll, edhe mbi të tjerët, edhe mbi vetveten, shprehet në përpjekjen për të kontrolluar edhe sjelljen edhe ndjenjat: sjelljen që është e papranueshme për shkak të pasojave mbi ne, ndjenjat që janë të papranueshme për shkak të pasojave tyre mbi sjelljen.

Ndjenja e nënës, se ajo ka nevojë të kontrollojë sjelljen e fëmijës së saj, është një burim i madh stresi tek mëmësia. **Nevoja për të kontrolluar sjelljen dhe mënyrat që përdorim ne në përpjekjen për të vepruar kështu, i kanë rrënjët në eksperiencën e fëmijërisë së hershme.** Fëmijët sillen në bazë të impulseve dhe sipas dëshirave të tyre, pa shumë dijeni për pasojat e sjelljes së tyre mbi dikë tjetër. Nëna ka profesionin e mësimit të fëmijës së saj për të menduar mënyrat me të cilat sjellja e tij **ndikon** të tjerët, apo veten e tij dhe

të ndihmës ndaj tij për të kontrolluar impluset ndërsa ai është duke mësuar. Aftësia e saj për ta bërë këtë, gjithsesi dëmtohet nga ndjenjat që krijohen tek ajo nga sjellja e pasocializuar dhe primitive e fëmijës. Këto ndjenja përforcohen nga rreziku i dyfishtë i trashëguar tek mëmësia. Së pari, për shkak të përfshirjes së saj në kujdesin e pandërprerë të fëmijës, nëna është në vijën e parë të sulmit ndaj sjelljes së tij urdhëruese, impulsive dhe të pakujdesshme. Nëse fëmija e derdh qumështin në dyshe, është mirë të dihet se ai është thjesht i tërhequr nga femomeni i derdhjes, por, është pikërisht nëna ajo që duhet ta pastrojë rrëmujën. Nëse ai thyen ndonjë send të çmuar të nënës, ajo duhet ta dijë se ai thjesht po shpreh kuriozitetin e tij dhe po eksploron botën rreth tij, por, megjithatë, ajo vuan nga humbja. Nëse ai gjuan apo kafshon në frustrim apo inat e sipër, është nëna, ajo që shpesh kafshohet apo goditet. Sjellja e fëmijës, atëherë, është në realitet e vështirë dhe nuk është aspak e habitshme që kjo sjellje nxit inat dhe impulsin për t'u kundërpërgjigjur.

Intensiteti i reagimit të nënës ndaj sjelljes së fëmijës vjen më pak nga barra e vërtetë që ve sjellja mbi të, se sa nga shkalla deri në të cilën ajo ndihet e përgjegjshme për këtë sjellje. Korda umbilikale psikologjike është më e vështirë për t'u prerë se sa ajo e vërteta. Ne i përjetojmë fëmijët si një zgjatim të vetvetes dhe ndihemi sikur sjellja e tyre është shprehje e diçkaje brenda nesh, në vend që të jetë shprehje e diçkaje brenda tyre. Ne shohim tek fëmijët tanë pasqyrimin tonë dhe, kur nuk na pëlqen ajo që shohim, ndihemi të inatosur për pasqyrimin.

Kjo lidhje psikologjike me fëmijën, kjo ndjenjë përgjegjësie në të cilën duket qartë faji, i drejton nënat drejt një beteje emocionale për kontroll. Një herë kur isha duke ngarë kalin, dëgjova instruktorin që më thirri: "Mos e ler kalin të vrapojë tatëpjetë kodrës." Çështje e vërteta, unë nuk po e lija kalin të "bënte" ndonjë gjë. Po tërhiqja frerët dhe po e nxisja për të ecur dhe nuk po përpiqesha fare të bëja asgjë që do ta ndalonte. Ankthi që erdhi nga të qenit jashtë

kontrollit u përforcua nga zëri që erdhi prapa meje, duke ma bërë të qartë që unë e kisha fajin për sjelljen e kalit, sepse po bëja diçka të gabuar. Më është dukur se edhe nënat e përjetojnë këtë. Nëse fëmija sillet në një mënyrë që duket negative apo e papranueshme, nënës i thuhet se ajo nuk duhet ta “lejojë” atë të sillet në atë mënyrë, se ajo duhet ta “bëjë” atë të sillet kështu e ashtu. Ndjenja e nënës, se ajo është përgjegjëse për sjelljen e fëmijës së saj, e përfshin atë në shqetësimin për të kontrolluar sjelljen e tij. Nëse ajo nuk mund të kontrollojë sjelljen “e keqe” të fëmijës, ajo ndihet si një nënë e keqe, e papërshtatshme dhe e paaftë. Duket sikur e keqja e saj shfaqet në sjelljen e fëmijës. Është pikërisht ky konfuzion i vetes me fëmijën e saj, ai që i krijon asaj një nevojë të fortë për ta kontrolluar atë. Sjellja e tij kërcënon imazhin që ka ajo për vete dhe, për këtë arsye, është emocionalisht e rrezikshme. Në këto rrethana, paaftësia e saj për ta detyruar atë të bëjë atë që dëshiron ajo, provokon inat të madh, dhe e bën atë të ndihet vetë jashtë kontrollit. Kur një nënë thotë se fëmija e saj po e çmend atë, ajo zakonisht ka për qëllim të thotë se paaftësia e saj për ta detyruar të ndalojë atë që po bën, po i jep asaj ndjenjën se ajo vetë është jashtë kontrollit.

Kur një nënë e ndjen se duhet të bëjë diçka për sjelljen e fëmijës, ajo përqendrohet në përpjekjen për ta ndaluar sjelljen. **Por si mund ta ndalosh sjelljen e dikujt tjetër? Si mund ta bësh dikë tjetër të sillet ashtu siç dëshiron ti?** Vetëm një fëmijë i vogël mund të ndalohet nëpërmjet forcës fizike dhe madje, edhe ai nuk mund të detyrohet të pushojë së qari, apo të detyrohet të ndalohet nga përjetimi i një krize inati. Një nënë nuk mund ta **detyrojë** fëmijën të qëndrojë në shtrat, të hajë, apo të tregojë për nevojat personale. Është ndjenja se ajo duhet të jetë e aftë ta detyrojë atë që t’i bëjë të gjitha këto, se sjellja që i duket asaj negative duhet të ndalohet, ajo çka e fut një nënë në vështirësi kaq të mëdha. Ajo duhet t’ia fillojë duke ditur se ajo nuk e ka këtë lloj kontrolli mbi dikë tjetër. Por, mesazhi që iu jepet nënave përsëri e përsëri, është se ato duhet ta kenë këtë lloj kontrolli.

Një nënë më pyeti e dëshpëruar se çfarë mund të bënte me djalin e saj të vogël, i cili vazhdimisht i pështynte njerëzit. Pa i paralajmëruar, ai i pështynte fëmijët e tjerë, të panjohurit në autobus dhe, madje, edhe pjesëtarët e familjes. Ajo ishte përpjekur t’i fliste atij, e kishte qortuar dhe e kishte ndëshkuar. Tani ajo donte të dinte se çfarë mund të bënte tjetër për ta ndaluar këtë sjellje. Unë i thashë asaj se nuk mund të bënte asgjë për ta detyruar që ai të ndalonte së pështyri. Ajo nuk u kënaq kur e dëgjoi këtë, por, ca kohë më vonë, më tha se kjo përgjigje i kishte dhënë një ndjenjë të madhe lehtësimi. Ajo e kishte ndjerë më parë se duhet të kishte një përgjigje dhe meqë ajo nuk e kishte gjetur, ajo duhet të ishte në një farë mënyre e gabuar, sepse sjellja e tij pasqyronte tek ajo kompetencën e saj si nënë. Vetëm pasi ndjeu se se nuk kishte asgjë që mund të bënte për ta ndaluar sjelljen, ajo u lehtësua. Fatkeqësisht, rëndësia që u jepet zgjidhjeve dhe teknikave në edukimin e fëmijëve, nuk bën gjë tjetër, veçse përforcon ndjenjën e nënës se ajo duhet të jetë në gjendje të bëjë diçka për çdo gjë.

Përpjekjet për t’i kontrolluar të tjerët gjithmonë bien në komandën e pulit të forcës dhe bindjes. Mundësia e përdorimit të masave shtrënguese fizike me një fëmijë, zgjat vetëm për një kohë të shkurtër. Nuk shkon shumë dhe, fëmija bëhet tepër i madh dhe i fortë për shumicën e nënave që të përdorin llojet e ndryshme të kontrollit fizik. Madje, edhe një fëmijë i vogël mund të jetë i vështirë për ta përmbajtur fizikisht. Cilado nënë që përpiket të mposhtë një fëmijë, që dridhet si purtekë në mes të një krize inati, e zbulon shpejt këtë. Shumica e fëmijëve kur përjetojnë të qenit të manipuluar fizikisht kundër vullnetit të tyre, mund të mbledhin aq shumë inat për t’u bërë të paepshëm, saqë mund të refuzojnë të luajnë nga vendi. Një qëndresë e tillë, zakonisht, provokon më tepër inat tek nëna, e cila i përforcon përpjekjet e saj për ta vënë nën kontroll dhe përballja shkon drejt pikut. Gjetja e vetes në një përballje fizike me fëmijën, duke iu rritur edhe ndjenja e inatit, është një përvojë frikësuese për

nënë. Ajo fillon të përrjetojë potencialin për dëmtimin e fëmijës së saj. Ajo çka filloi si një përpjekje për ta përmbajtur, tashmë shumë shpejt ndihet si një sulm dhe inati i saj, i shprehur në kontakt fizik, e mbush atë me faj. Shumica e nënave, ndonëse, mund ta gjejnë veten në të tilla përballje me fëmijët, në fund, me vetëdije heqin dorë nga dhuna fizike, si zgjidhje për sjelljen e papranueshme.

Paraardhësit e dhunës fizike, si kërcënimet dhe ndëshkimi, duken më të pranueshme për egon e njeriut. Ato janë gjithashtu më të pranueshme në shoqëri, po t'i jepeshin një sistemi drejtësie për krimet, i cili mbështetet mbi ndëshkimin dhe kërcënimin për dënim për sjellje antisociale. Problemi me këto metoda është se, ato shpesh nuk janë të suksesshme. Kur një nënë thotë: “ndaloje këtë ose ... “ (çdo nënë ka fundin e saj të veçantë për këtë fjali: “shko në dhomën tënde”; “nuk do të le të shohësh më TV”; “s’ka më akullorë”), fëmija mund të bindet ose jo. Nëse ai nuk bindet, çfarë bën ajo pas kësaj? A vazhdon ende të bërtasë? A i përforcon ende kërcënimet dhe pasojat? A fillon ajo dhunën fizike me egërsi? Edhe një herë ajo ndodhet në një përballje që shkon drejt pikut, sepse, në fund të fundit, nuk ka asnjë rrugëdalje për ta bërë fëmijën të bindet.

Problemi ndërlikohet nga natyra subjektive e përkufizimit të sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme. Jo vetëm që nënat ndryshojnë përsa i përket kësaj, kjo varet nga personalitetet dhe mënyra e tyre e jetesës, por, ato ndryshojnë edhe nga fakti se kur e presin të ndalojë sjelljen e papranueshme dhe të pranueshmen të mbisundojë tek fëmijët e tyre. Shumë nëna pyesin: “Kur është e mundur, kur është e arsyeshme që fëmijët të dallojnë të mirën nga e keqja?” Kjo është e njëjta pyetje që bëhet edhe në sistemin kriminal të drejtësisë në përcaktimin e përgjegjësisë për një vepër penale. Aftësia për të dalluar të mirën nga e keqja, kërkohet përpara se dikush të përgjigjet për akte kriminale. Kur nënat e bëjnë këtë pyetje, nënkuptimi është se disa sjellje negative duhet të tolerohen deri një pikë, por, kur pas asaj pike ato kthehen në sjellje “kriminale,”

duhet të ndëshkohen. Shumë nëna e ndjejnë veten të shqetësuar rreth kësaj pyetje kur ato kanë fakte të mjaftueshme dhe kur fëmijët e tyre i kuptojnë shprehjet verbale.

Nënat shpesh thonë shprehje të tilla si: “Unë e di që ajo më kupton. Unë e di që ajo e kupton që nuk duhet ta ndezë gazin, që nuk duhet ta ngasë biçikletën në dhomë, që duhet të flerë kur është koha për gjumë. Atëherë pse ajo nuk dëgjon?” **Këtu bëhet supozimi i njohur se aftësia për të kuptuar çfarë pritët prej tyre është i vetmi faktor që do të çojë në sjelljen e pranueshme.** Një nënë e kupton se deri në një farë mase se fëmija është i paaftë të kontrollojë sjelljen e tij. Nëse një foshnjë zvarritet për të vënë spinën në prizë, nëna nuk pret që ai të ndalojë vetëm prej urdhërave gojorë. Ajo e di se duhet patjetër ta largojë nga rreziku i mundshëm. Aftësia për t’u përgjigjur ndaj udhëzimeve verbale kërkon edhe aftësinë për të kontrolluar sjelljen. Aftësia për të kuptuar atë që thuhet nuk sjell automatikisht aftësinë për të kontrolluar vetveten. Nënat shpesh e ngatërrojnë *paaftësinë* e fëmijës për të kontrolluar veten, me *kundërshtimin* për të kontrolluar veten. Nëse ajo beson se ai e dallon të mirën nga e keqja, çka për një nënë do të thotë të kuptojë se çfarë pret prej tij, dhe ai nuk sillet ashtu si i thonë, ajo e percepton këtë si një kundërshtim nga ana e tij për të bërë atë që dëshiron ajo. Sjellja e fëmijës buron nga impulset e tij, por nëna e përjeton atë si një kundërshtim të dëshirave të saj. Sjellja e fëmijës fillon të ndihet sikur i kundërvihet nënës. Në vend që ajo ta perceptojë atë sikur ai është duke bërë atë që mendon, ajo e percepton atë sikur refuzon të bëjë atë që thotë ajo.

Për shembull, një fëmijë mund të jetë duke luajtur me lodra, dhe nëna i thotë se duhet të lajë duart për të ngrënë drekë. Ai nuk ka dëshirë të heqë dorë nga përjetimi që po i jep kënaqësi. Por, nëna e sheh atë si të pavullnetshëm për t’u pajtuar me dëshirat e saj. Po ashtu, një fëmijë, nuk mund të mësohet në tualet derisa të arrijë një nivel pjekurie fiziologjike, i cili e lejon atë të ushtrojë kontroll

mbi muskujt. Në po këtë mënyrë, kërkohen shkallë të ndryshme maturie për të vendosur kontroll mbi disa impulse. Nëse topi i një djali rrokulliset në rrugë, impulsi i tij është të vrapojë pas tij, por kjo kërkon kontroll të madh prej tij për të ndaluar dhe për të vëzhguar trafikun, për të kontrolluar semaforin dhe për t'u siguruar se nuk ka asnjë rrezik para se ta marrë topin. Megjithatë, për nënën, që e ka paralajmëruar disa herë për këtë, mund të duket sikur ai nuk pranon të dëgjojë. Sjellja e fëmijës që bie ndesh me dëshirat e nënës, mund të tregojë një paaftësi për të kontrolluar veten, ose mund të tregojë thjesht ndjekjen e dëshirave të tij, që janë të ndryshme nga të sajat. Problemi në të dy rastet është se, nëna, në vend që ta shohë atë si shprehje të diçkaje që flet për fëmijën, e sheh atë si një deklaratë për vetveten reagimin e fëmijës ndaj saj.

Kur janë dy njerëz bashkë, ka mundësi për secilin prej tyre të dëshirojnë diçka të ndryshme në të njëjtën kohë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në marrëdhënien nënë – fëmijë, ku fëmija shqetësohet në radhë të parë për plotësimin e dëshirave të tij, kurse nëna për përgjegjësinë që ka ndaj tij. Sa më tepër të konturohen qartas mendja dhe vullneti i fëmijës, aq më tepër rritet mundësia për konflikt midis nënës dhe fëmijës.

Për disa nëna ky problem fillon kur fëmija bëhet fizikisht i lëvizshëm, kur ai, me një fjalë, është i aftë të largohet prej saj në një drejtim tjetër. Shumica e nënave ndihen të kërcënuara deri në një farë mase nga personaliteti i fëmijës që po fillon të spikatë. Konflikti shndërrohet në një përballje, atëherë kur nëna e interpreton sjelljen e fëmijës sikur të jetë në kundërshtim me dëshirat e saj. Nëse fëmija e ndjen se dëshirat e tij nuk merren parasysh, se ai detyrohet të bindet, ndoshta do të bëjë qëndresë në atë shkallë, saqë arrin të mësojë se dëshirat e tij nuk merren parasysh nga nëna, ai fillon të gjejë mënyra për ta kundërshtuar dhe për ta sfiduar atë. Sjellja që filloi si ndjekje e dëshirave të tij, në fakt, shndërrohet në kundërshtim të dëshirave të nënës. Në të vërtetë, edhe nëna vetë ndodhet në të njëjtën situatë.

Ajo mund të fillojë me një dëshirë për të servirur drekën, në mënyrë që të vazhdojë pastaj me enët dhe të lexojë edhe një libër. Përfshirja e fëmijës me lodrat bëhet pengesë për të kryer atë që dëshiron ajo. Kur ajo i kërkon atij të ngrihet dhe të lajë duart për të ngrënë drekë, ajo thjesht po i kërkon t'i kushtojë vëmendje asaj që do ajo. Megjithatë, kur ai nuk përgjigjet, asaj i duket se ai nuk përfill të bëjë atë do ajo, kështu që ajo vetë ndihet si kundërshtare e dëshirës së tij për të luajtur. Shumica e nënave nuk e përfjetojnë ngjashmërinë midis ndjenjave të tyre dhe ndjenjave të fëmijëve. Ne jemi kaq të ngopur me qëndrime autoritare saqë besojmë se realiteti i nënës është trashëgueshëm më i vlefshëm se ai i fëmijës. Në kohën që ne mund të besojmë me vetëdije në përpjekjen për të plotësuar nevojat e fëmijës, nuk mund të vëmë në dyshim ndjenjën brenda nesh, në shumë situata në të cilat duhet të mbizotërojnë fjala jonë. Dhe fjala të cilën ne duam të mbizotërojnë është "Jo." Sillni ndër mend nënën që na tregonte se sa e shpërqendruar ishte kur fëmija hidhte lapsa prapa kaloriferit, kur ajo ulej të punonte në tryezën e saj të punës. Ajo e dinte se ai e bënte këtë ngaqë kërkonte vëmendjen e saj, dhe mund ta ndalonte këtë sjellje negative vetëm duke ndërprerë atë që po bënte për disa minuta, për ta ndihmuar atë të fillonte një veprimtari më vete. Megjithatë, asaj i dukej se me këtë qasje diçka nuk shkonte. Ajo nuk hiqte dorë nga ideja e saj se fëmija duhet të ndalonte sjelljen e tij thjesht sepse ajo ia kërkonte. Nuk ka dyshim se, jeta do të ishte shumë më e thjeshtë nëse njerëzit do të bënin atë që ne dëshironim, thjesht sepse ne ua kërkonim këtë. Në aspektin e edukimit të fëmijëve, shumë nëna ende nuk kanë hequr dorë nga synimi që gjërat të funksionojnë po ashtu. Ai tregon qasjen ndaj konfliktit që shprehet si jo më mirë me shprehjen "Bëje se them unë."

Për shumë nëna, kërcënimet dhe ndëshkimet fizike janë metoda dëshpërimi, të përdorura atëherë kur kanë dështuar të gjitha përpjekjet e tjera në kontrollin e sjelljes së fëmijëve. Këto përpjekje

të tjera janë pothuajse gjithmonë orvatje për t'ia mbushur mendjen fëmijës të pajtohet me atë që dëshiron nëna. Nëna përpiqet ta bindë fëmijën ta bëjë këtë sipas mënyrës (këndvështrimit) së saj.

Për ta realizuar këtë, nëna shpesh ndjen se duhet t'ia vërtetojë fëmijës se këndvështrimi i saj është më i mirë se i tij, apo se ajo që dëshiron ajo është më e rëndësishme se ajo që dëshiron ai. Nënës shpesh këtë e quajnë arsyetim me fëmijën. Një nënë më shpjegoi se ndonjëherë e humbiste kontrollin pasi ishte përpjekur të arsyetonte me fëmijën por, pa asnjë rezultat. Ajo më përshkroi një episod, në të cilin ai nuk pranonte të hynte në shtëpi me të, kur ajo duhet të gatonte drekën. “Unë i shpjegova atij se ishte vonë, se duhej të bëja drekë, se ai kishte qëndruar për një kohë të gjatë jashtë në dëborë dhe se ishte shumë ftohtë për të qëndruar më gjatë përjashta.” Me arsyetim, kjo nënë qartas do të thoshte dhënien e arsyeve të saj, që ai të ndryshonte sjelljen. Ajo e dinte se arsyeja e fëmijës për të mos u futur brenda ishte se ai donte të luante ende në dëborë. Por, ajo e ndjente se ai duhej ta kuptonte se arsyeja e saj që ai të futej brenda, ishte më e rëndësishme se ajo e tij për të qëndruar jashtë. Ajo u nxeh sepse fëmija nuk hiqte dorë nga kënaqësia e gërmimit me lopatë në borë ndaj nevojës së saj për të gatuar drekë. Ajo donte që logjika e fëmijës të funksiononte brenda sistemit të saj të logjikës, si një mënyrë për ta zgjidhur konfliktin mes tyre dhe, kur kjo u doli pa sukses, perceptimi i saj i situatës ishte se nuk ishte e mundur të “arsyetoje” me të. Kjo “paaftësi” për të dëgjuar arsyen filloi t’i dukej nënës si një defekt në karakterin e tij. Ajo e ndjente se fëmija i saj duhej të ishte ekstremisht i keq që nuk e dëgjonte kur ajo ishte kaq e arsyeshme.

Një variant i këtij lloj arsyetimi është dëshira e nënës që fëmija ta kuptojë se ajo çfarë kërkohet prej tij është veçse për të mirën e tij, se ajo ka në mendje më të mirën për të. Kur bëhet një kërkesë mbi bazën e mirëqenies së fëmijës nëna ndjen se arsyeshmëria e kërkesës duhet t’i mundësojë fëmijës ta pranojë atë pa kundërshtim.

Për shembull, nëna mendon se fëmija duhet ta kuptojë se, ngrënia e ëmbëlsirës përpara buke do t’ia prishë oreksin, se kërcimi nëpër pellgje pa çizme do ta ftohë, se nga përdorimi i gërsërëve të mprehta mund të pritet, apo nëse rri zgjuar deri vonë në darkë, do jetë shumë i lodhur të nesërmen për t’u ngritur herët për në shkollë. Për të duket e qartë se, çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin dhe sigurinë e fëmijës marrin përparësi mbi kënaqësinë. Për të është e vështirë të pranojë idenë se impulset dhe dëshirat e fëmijës mund të jenë më të forta se kërkesat e saj, edhe atëherë kur janë në të mirë të tij. Kur sjellja e fëmijës vazhdon me këmbëngulje përballë asaj që ajo e quan si arsyetim të madh nga ana e saj, nëna ndihet e inatosur që po shpërfillet në këtë mënyrë, dhe bën gjykime për sjelljen e fëmijës.

Problemi për nënën është se fëmija ka shumë impulse, që i shpreh me veprime derisa zhvillon aftësinë për t’i kontrolluar ato. Ai, gjithashtu, ka idetë e tij për gjërat që do t’i pëlqenin t’i provonte dhe ndjenjat e tij për ato që i pëlqen të bëjë dhe për ato që nuk i pëlqen të bëjë. Të gjitha këto mund të pengojnë programin e nënës, qoftë kur bazohet në atë që beson ajo se është e mirë për fëmijën, apo çfarë është e mirë për veten e saj. **Kur nëna përdor bindjen, apo “arsyetimin,” si një mënyrë për të kontrolluar sjelljen e tij, ajo është me të vërtetë duke i kërkuar shpesh atij të ndërrojë mendjen e tij, apo të ndërrojë mënyrën se si i ndjen gjërat.** Ajo percepton se nëse ai do të mendojë ose do të ndjejë ndryshe, do të sillet ndryshe, dhe kështu, ajo përpiqet t’i kontrollojë mendimet dhe ndjenjat e tij si një mënyrë për të kontrolluar sjelljen e tij.

Një nënë më përshkroi “betejën” që provonte me djalin kur donte ta lante. Kur i thoshte atij se ishte koha që ai të lahej, ai kundërshtonte duke thënë se nuk donte. Nëna përgjigjej duke u përpjekur t’ia mbushte mendjen, se ai në të vërtetë donte të lahej, se atij i pëlqente të lahej. Konflikti u shdërrua në një betejë, të lahej, apo të mos lahej fëmija. Nëna e ndjente se, nëse do ta pranonte se djali nuk donte të lahej, kjo automatikisht donte të thoshte se ai nuk

do të lahej. Meqenëse ajo donte që ai të lahej, e ndjente se e vetmja mënyrë për ta bërë atë të lahej, ishte t'ia mbushte mendjen se edhe ai donte të lahej. Asaj nuk i dukej se sjellja e dikujt mund të ishte e ndryshme nga ndjenjat, se fëmija i saj mund të mos donte të lahej, e, megjithatë, të lahej.

Në të vërtetë, kjo është një përpjekje për ta zgjidhur konfliktin duke u përpjekur t'i bësh të dyja anët e tij të njëjta. Nëse fëmija ndihet ashtu si edhe nëna, ai nuk ka pse të bjerë ndesh me dëshirat e saj. Nëse ai ka të njëjtat mendime me të, nuk ka pse t'i kundërshtojë idetë e saj. Nëse të dy mendojnë dhe dëshirojnë të njëjtat gjëra, atëherë nuk ka pse të ketë konflikt. Janë ndryshimet ato që duken të rrezikshme, sepse ndryshimet shpjegojnë konfliktin dhe, nëse ka konflikt ne ndihemi të frikësuar se nevojat dhe dëshirat tona mund të humbasin.

Nënat shpesh përpiqen të kontrollojnë ndjenjat e fëmijëve të tyre, jo vetëm sepse ato e kuptojnë se këto ndjenja i shpien ata në sjellje të papranueshme, por, gjithashtu, edhe sepse edhe vetë ndjenjat mund t'iu duken të papranueshme. Një nënë thotë se ajo mendon se fëmija e saj duhet të jetë i lumtur. Kur ai duket i mërzitur, ajo mendon se duhet të jetë në gjendje patjetër të bëjë diçka për këtë, se ajo është në gjendje ta bëjë atë të ndihet më mirë. Në po të njëjtën mënyrë, nënat mendojnë se ato duhet të jenë të afta të mbyllin brenda ndjenjat e inatit dhe frustrimit të fëmijëve të tyre. Këto ndjenja i bëjnë nënat të besojnë se ato kanë dështuar deri diku dhe duan t'i bëjnë fëmijët të ndihen më mirë me veten.

Metodat për të kontrolluar të tjerët zhvillohen si një përgjigje ndaj frikës se të tjerët nuk do të plotësojnë, apo nuk do t'i kushtojnë vëmendje nevojave dhe dëshirave të dikujt, vetëm nëse ata detyrohen të veprojnë kështu. Beteja për kontroll, për këtë arsye, është një betejë për mbijetesë. Në marrëdhënien nënë – fëmijë ky është një problem veçanërisht shumë i vështirë, sepse shumë shpesh është në rrezik mbijetesë fizike dhe ajo psikologjike (e fëmijës).

Një nënë ndihet e frikësuar se, nëse ajo nuk e kontrollon vajzën, ajo mund të vërsulet në rrugë dhe ta godasë makina. Ajo mund të hapë rrubinetin e gazit dhe mund të digjet. Ajo mund të hajë gjëra që mund ta helmojnë, apo mund të bjerë nga dritarja. Fëmija ende nuk e ka zhvilluar gjykimin për vetëkontroll të domosdoshëm për t'i vënë fre sjelljes që mund të jetë e rrezikshme për të, apo për të tjerët. Në situata të tilla, nëna është ajo që duhet të sigurojë kontrollin, të cilin nuk e zotëron fëmija.

Gjithsesi, shumica e përpjekjeve për të kontrolluar sjelljen e fëmijës, e kanë burimin nga kërcënimi psikologjik, që përbën një sjellje të tillë për nënën. Bota e fëmijës, me atë të nënës, duken kaq të largëta, sa që nëna e ndjen se do të kapitultojë nëse nuk vepron shpejt për të marrë fëmijën në botën e saj. Fëmija nuk sheh asnjë arsye pse të lerë një lojë që i sjell kënaqësi për të shkuar në shtrat, kur ai po kënaqet, apo të lajë duart për të ngrënë drekë. Nëna e ndjen se, nëse ajo nuk do ta detyrojë atë t'i kushtojë vëmendje, nuk do t'i mbarojë dot punët, nuk do të ketë sadopak kohë për vetë. Frika e nënës, se mos do të shkelet me këmbë nga sjellja e fëmijës, e drejton atë ta përfetojë këtë sjellje si një ndërhyrje të qëllimshme tek ajo që dëshiron ajo, më tepër se sa një shprehje të asaj që dëshiron të bëjë fëmija. Ajo është e paaftë të dëgjojë atë që ai po tregon për veten, për shkak të ndjenjës së saj për të mbrojtur vetveten.

Nëse u duhet dy njerëzve të zgjidhin ndryshimet e tyre, atyre u duhet në fillim të zbulojnë se cilat janë këto ndryshime. Secilit prej tyre i duhet të jetë i aftë të dëgjojë se çfarë dëshiron tjetri. Nëse ju besoni se personi që keni përballë po ju dëgjon, nuk është e domosdoshme të shpenzoni energji në përpjekjen për ta kontrolluar atë, apo me fjalë të tjera, ta bëni t'iu dëgjojë. Vetëm atëherë bëhet e mundur të dëgjoni se çfarë thotë ai. Nëse e ndjeni se tjetri *nuk* ju dëgjon, të gjitha përpjekjet tuaja përqendrohen për të mbrojtur atë që dëshironi ju, dhe bëhet pothuajse e pamundur të dëgjoni dikë tjetër. Në rastin e konflikteve mes nënës dhe fëmijës, nënës i duket

se fëmija i saj nuk e dëgjon atë. Secili prej tyre duket prej tjetrit si kokëfortë, si pasojë ata gërmojnë të dy në pozicionet e tyre, të përgatitur për betejë për atë që dëshirojnë ata. Fëmija që dëshiron të qëndrojë jashtë në dëborë, duket i palëvizshëm nga nëna e tij. Si rezultat, ajo e ndjen se duhet ta detyrojë për t'u futur brenda. Por, ndjenja se dikush detyrohet të heqë dorë nga ajo që dëshiron ai, e bën të pamundur të marrë parasysh se çfarë dëshiron tjetri. Zemërimi që ndjen njeriu kur detyrohet, nuk është aspak ndihmues në respektimin e dikujt tjetër. Kjo është njëlloj e vërtetë për nënën dhe fëmijën. Nëna ndjen se detyrohet të qëndrojë jashtë; fëmija ndjen se detyrohet të hyjë brenda. Fëmija i duket nënës i paarsyeshëm; nëna i duket e paarsyeshme fëmijës. Nëse ata të dy futen në llogoren e këtyre ndjenjave, humbet ndjeshmëria e nevojshme për të zgjidhur konfliktin e tyre.

Zgjidhja e paqtë e konfliktit kërkon lëshime dhe kompromis.

Secilës palë i duhet të pranojë diçka më pak se e tëra e asaj që dëshironte, apo ndoshta një ndryshim të planit fillestar. Nëse kjo duhet të bëhet për të zgjidhur një konflikt mes dy njerëzve, atëherë dikush duhet të bëhet gati për të dëgjuar tjetrin i pari. Ky model duhet të hedhë themelet në marrëdhënien nënë –fëmijë. **Nëna, që është më e pjekur, ka më tepër kontroll mbi veten dhe durim më të madh mbi frustrimin, dhe që është në pozicion më të fortë për shkak të nevojës që ka fëmija për aprovimin e saj, është ajo që duhet të dëgjojë e para nevojat dhe dëshirat e fëmijës.** Fëmija, pasi mëson se nëna e *dëgjon* atë, se dëshirat e tij *do të* merren parasysh, atëherë është në gjendje ta dëgjojë nënën.

Është pikërisht kjo pjesë e procesit, ajo që shumë shpesh është shkatërruar për shumë arsye. Ndoshta, arsyeja më e rëndësishme është se nëna nuk e ka përjetuar këtë proces vetë. Ajo nuk beson se, nëse do ta dëgjojë fëmijën, atëherë edhe ai do ta dëgjojë atë. Sjellja e fëmijës së saj shihej si e papranueshme tek ajo kur ishte ende fëmijë dhe tani asaj i duket e papranueshme tek ai. Ajo e sheh atë si sjellje

që duhet ndaluar më tepër se sa nxitur. Ajo nuk beson se duke respektuar fëmijën, edhe fëmija do të fillojë ta respektojë atë. Ajo nuk ka asnjë bazë në fëmijërinë e saj për ta besuar këtë. Përkundrazi, ajo ndjen se nëse do ta dëgjojë fëmijën, do të thotë të heqë dorë nga e drejta e saj për t'u dëgjuar. Ajo ndjen sikur përjetimi i realitetit të fëmijës, do të thotë të braktisë realitetin e saj.

Por, dëgjimi i fëmijës në fillim nuk do të thotë dëgjim pa fund, apo të lidhesh me atë që dëshiron ai. Kjo do të thotë vonimi i përkohshëm i asaj që dëshiron nëna, si një mënyrë për t'i treguar fëmijës se ai nuk ka përballë një pengesë të palëvizshme, që duhet t'i rezistojë me forcë, apo ta kapërcejë me qëllim që të sigurojë atë që dëshiron. Nëna, fëmija i së cilës dëshiron të luajë në dëborë, mund të bjerë dakord që ai të qëndrojë edhe dhjetë apo pesëmbëdhjetë minuta të tjera, pa i dhënë atij idenë se mund të rrijë jashtë pa mbarim. Nëna, fëmija e së cilës hidhte lapsa prapa kaloriferit, si mënyrë për të shprehur dëshirën e tij për vëmendje, mund të luajë me të për pak kohë, pa i lënë atij të kuptojë se mund të luajë gjithë ditën. Vonimi i asaj që dëshiron nëna nuk është njëlloj me braktisjen e asaj që do. Kjo nuk do të thotë se fëmija është më shumë apo më pak i rëndësishëm se nëna. Ajo thjesht do të thotë se edhe ajo që dëshiron ai është *gjithashtu* e rëndësishme. Për fëmijën, dëshira për të luajtur jashtë, është po kaq e rëndësishme sa edhe nevoja e nënës për të gatuar drekë; nevoja për vëmendjen e nënës është po kaq e rëndësishme, sa edhe dëshira e saj për të punuar në tryezën e saj. Ajo nuk ka pse t'ia vërtetojë fëmijës se nevojat dhe dëshirat e saj janë më të rëndësishme se ato të tij. Përkundrazi, nëse ajo e trajton atë me mendimin se nevojat dhe dëshirat e tij janë, po ashtu, të rëndësishme, edhe kur ato nuk janë të sajat, ai patjetër do të mësojë të bëjë të njëjtën gjë për të.

Respektimi i dëshirave të fëmijës nuk është ajo që e fut në vështirësi nënën, por më tepër është ndjenja se ajo po kapitullon prej tyre, për shkak të dështimit të saj për ta bindur të bëjë atë që

dëshiron ajo. Pasi ka dështuar në përpjekjet e saj për detyrim, ajo tashmë ndihet e detyruar nga fëmija. Si pasojë, ajo ose do të luftojë edhe më tepër, ose do të heqë dorë nga e saja. Fëmija tashmë mëson se, nëse ai u bën qëndresë përpjekjeve të nënës për të imponuar vullnetin e saj mbi të, ai përfundimisht do të jetë i aftë të imponojë vullnetin e tij. **Të dy, nëna dhe fëmija, mbeten duke pritur të vetën më tepër se sa të mësojnë ta respektojnë njëri – tjetrin.**

Për shkak se mjaft nëna në fëmijërinë e tyre nuk e kanë përjetuar kurrë mundësinë për bashkekzistencë të nevojave dhe ndjenjave kundërshtuese, atyre vazhdon t'iu duket se, nëse do t'i respektojnë fëmijët do të thotë të mos respektojnë veten, të respektojnë veten do të thotë të detyrojnë fëmijët e tyre. Duket sikur, ose vetëm nëna, ose vetëm fëmija mund të ekzistojë. Nëse nëna vendos që do të jetë fëmija, ajo sillet sikur ka dalë nga loja përfundimisht dhe heq dorë nga shpresa se ai më në fund do të mësojë ta respektojë atë. Nëse ajo vendos që do të jetë vetë, ajo ndjen se duhet ta detyrojë fëmijën e saj t'i bindet. Ajo beson se, ose duhet të heqë dorë nga ajo që dëshiron për hir të fëmijës, ose ai duhet të detyrohet të heqë dorë nga ajo që dëshiron për hir të saj. Një keqkuptim i madh në edukimin e fëmijëve ka qenë ideja se, plotësimi i nevojave të fëmijës është qëllim në vetvete, për të ruajtur shëndetin e tij mendor. **Nënat nuk e kanë kuptuar se ky s'është gjë tjetër veçse një hap në zhvillimin social, qëllimi i të cilit është ta ndihmojë fëmijën t'i respektojë të tjerët.** Si pasojë, ato shpesh nuk i kanë *respektuar* fëmijët, por, përkundrazi, kanë lejuar që realiteti i fëmijës të marrë përparësi prej frikës së dëmtimit të tyre emocional. Nëse fëmija e kupton se nëna e tij ka frikë të mos e lejojë të bëjë çfarë të dojë, ai arrin të besojë se është shumë i fuqishëm, dhe, asnjëherë nuk sheh asnjë arsye për të hequr dorë nga ajo që do ai.

Bashkekzistencë nuk do të thotë që secilit t'i plotësohet e tija gjithë kohës, e as që gjykimi i fëmijës të jetë njëloj me atë të nënës. Ajo nuk do të thotë se e drejta e secilit për respekt është po aq e

barabartë me atë të tjetrit. Nëna duhet të jetë ajo që duhet ta dijë dhe ta mësojë këtë, sepse fëmija nuk mundet. Synimi i saj është t'ia mësojë atij se si gjen vend kjo për të dy. Nuk ka asnjë metodë të parashkruar për të zgjidhur çdo konflikt që mund të përjetojë nëna me fëmijën, dhe sigurisht që nuk ka asnjë metodë që do t'i mundësojë asaj të arrijë pikërisht atë që dëshiron. Nuk ka asnjë mënyrë për ta detyruar një fëmijë të rreshtë së pështyri, asnjë mënyrë për ta bërë atë të hyjë brenda, apo të ndalojë së hedhuri lapsa prapa kaloriferit. **Gjithsesi, ka një qëllim më të madh, i cili është të hedhim themelet e një klime të përgjithshme të arsytimit, në të cilin ajo dhe fëmija e dëgjojnë njëri – tjetrin.** Në çfarëdo lloj momenti që ajo mund t'iu dorëzohet dëshirave të fëmijës, të jetë më këmbëngulëse në atë që dëshiron ajo, ose mund të gjejë një zgjidhje kompromisi me të cilën mund të bashkëjetojnë. Por, edhe gjatë atyre shumë herëve, kur ajo nuk është aq e sukseshme ta ndihmojë fëmijën të dalë nga një pozicion i paarsyeshëm, ajo ka nevojë të vazhdojë t'ia bëjë atij të ditur se çfarë pret prej tij dhe të mbajë shpresa që, më në fund, ai do të jetë në gjendje të respektojë atë që dëshiron ajo.

Nëna që merr pak kohë nga puna e saj për të luajtur me fëmijën mund të shprehë, jo si një kërcënim, por si një të vërtetë, se edhe fëmija i saj do të jetë në gjendje të luajë vetë. Nëna që qëndron pak më gjatë në dëborë, ende mund të mbajë shpresa se është e mundur ta plotësojë qëllimin e saj më mirë herës tjetër. Këto situata të veçanta janë vetëm disa episode, e jo e gjithë historia. Ideja është që, për shkak të disa gabimeve, të mos heqim dorë nga vetvetja e as nga fëmija. Fëmija ka nevojë për shumë përsëritje për të mësuar se si funksionojnë marrëdhëniet. **Ajo për të cilën ka nevoja nëna, nuk është një “metodë e drejtë,” por, ajo duhet të jetë aq elastike sa për të vazhduar të zgjidhë çdo konflikt të veçantë që mund të ketë me fëmijën. Asnjë nuk mund t'ia kalojë krijueshmërisë së zgjidhjeve të një nëne, kur ajo është emocionalisht e lirë për t'i gjetur vetë këto zgjidhje.**

Ndoshta, vështirësia jonë më e madhe në të dëgjuarit dhe në respektimin e nevojave të fëmijës, gjendet në faktin se nevojat dhe ndjenjat shpesh shprehen në sjellje që është kërcënuese, për shkak se ne nuk jemi të sigurt për mundësinë tonë për t'i kontrolluar ndjenjat të ngjashme brenda vetes tonë. Lëshimi pa fre i ndjenjave në sjellje primitive, është një përkujtues se këto ndjenja ekzistojnë dhe na sjellin ndër mend se kontrolli ynë delikat mund të shkatërrohet. Paaftësia për të vënë në kontroll sjelljen e fëmijëve tanë ndihet sikur është e njëjta gjë me paaftësinë për të kontrolluar veten. Dhe fakti është që, sjellja primitive tek fëmijët shkakton sjellje primitive tek nënat. Kjo është ajo që i frikëson më tepër nënat. Fëmijët e vegjël, edhe kur dalin jashtë kontrollit nuk e kanë fuqinë t'i shkatërrojnë nënat e tyre, por nënat që u ka dalë vetja nga kontrolli ndjejnë se mund t'i shkatërrojnë fëmijët.

Nënat nuk e kanë kuptuar se është e mundur të ndihesh në një mënyrë dhe të sillesh në një tjetër. Këmbëngulja e fëmijës për t'i shkuar e tija, e bën nënën të ndjejë se edhe ajo duhet të këmbëngulë që t'i shkojë e saja. Por, një nënë nuk ka pse të reagojë në bazë të ndjenjave të ngjallura nga sjellja e fëmijës. Fakti që ajo e ndjen se duhet të imponojë vullnetin e saj, ose do të fshihet nga horizonti për vete, nuk do të thotë se kjo është në të vërtetë çështja. **Ajo është më e fortë nga ç'e pandeh. Mbijetesa e saj nuk varet nga fshirja e fëmijës; mbijetesa e tij nuk varet nga fshirja e saj. Arritja e një qëllimi madhor shpesh do të thotë mosveprim sipas dëshirave apo ndjenjave të çastit.** Për t'i mësuar fëmijës objektivin më të madh për respektin ndaj të tjerëve, nëna mund të tolerojë pak frustrim të dëshirave të saj, ajo mund të vonojë atë që dëshiron, ajo mund të jetë aq e përkulshme sa të bëjë marrëveshje. E kjo është pikërisht ajo që duhet të mësojë edhe fëmija: që është e mundur t'i mbijetojë frustrimit, që është e mundur të presë për atë që dëshiron, që është e mundur të bëjë marrëveshje pa kapitulluar.

Për arsye se ndjenjat dhe sjellja janë dukur sinonime të njëra-tjetrës, sikur ndjenjat në fakt duhet të luhen në skenë, nënave u është dukur e domosdoshme të kontrollojnë ndjenjat e fëmijës si një mënyrë për të kontrolluar sjelljen e tyre. Anasjelltas, kur ato duan të shfaqin pranim për ndjenjat, mendojnë se ato gjithashtu duhet të pranojnë edhe sjelljen me anë të së cilës shprehen këto ndjenja. Por, ndryshimi i sjelljes nuk varet nga heqja dorë prej ndjenjave. Një nënë e cila jep pak nga koha e saj për të luajtur me fëmijën, ende mund të ndjejë se do të preferonte të bënte diçka tjetër. Një fëmijë që do të luajë jashtë mund të hyjë brenda me nënën e tij edhe atëherë kur ai do të donte të qëndronte jashtë. Ai nuk ka pse të ndryshojë ndjenjat e tij për të bërë atë që i kërkohet. Nëse nëna e di këtë, ajo mund të jetë mirëkuptuese ndaj dëshirave të fëmijës, edhe atëherë, kur ajo nuk do të donte apo nuk ka mundësi t'i plotësojë ato. Kjo i jep idenë fëmijës se nëna është në anën e tij, edhe atëherë kur ai nuk mundet të ketë atë që dëshiron. Nëse ajo është në anën e tij, atëherë ajo nuk është armiku dhe ai nuk ka pse ta luftojë atë.

Nëse nënat do të duhet t'u mësojnë fëmijëve të tyre se është e mundur të ndihesh në një mënyrë dhe të sillesh në një tjetër, ato duhet vetë ta mësojnë se sjellja dhe ndjenjat nuk janë e njëjta gjë. Nëse fëmijët do të duhet të mësojnë të heqin dorë nga një këmbëngulje e vazhdueshme për t'u shkuar gjithmonë e tyrja, po kështu duhet të ndodhë edhe me nënat. Është më tepër përvehtësimi i këtyre principeve më tepër se sa një kërkim i kotë për "metoda" që i lejojnë nënës të zgjidhë konfliktet e saj me fëmijën.

KAPITULLI 6

I inatosuri nuk është i keq

Përballja me ndjenjat e inatit, qofshin tonat apo të të tjerëve, duket e rrezikshme për shëndetin tonë. Metodën që përdorim ne për t'i shprehur këto ndjenja shpjegojnë stresin emocional të marrëdhënieve njerëzore. Për shumë nëna, dhimbja dhe shqetësimi të ngjallura prej inatit të fëmijëve, krijojnë një stres të madh emocional tek mëmësia. Vështirësia me ndjenjat e inatit, që përjetojmë ne të rriturit e ka burimin nga përvoja jonë e fëmijërisë. Ai tregon qëndrime të ngulitura thellë përsa i përket shprehjes së ndjenjave të tilla nga fëmijët, qëndrime që ne i kemi përjetuar vetë kur ishim të vegjël, të cilat vazhdojnë deri në pleqërinë tonë si prindër. Qëllimet e mira të të rriturit sabotohen prej përgjigjeve emocionale që vijnë prej fëmijërisë.

Një nënë përmbloodhi një zbulim që kishte bërë për vete dhe për prindërit e tjerë. “Inati është një e drejtë që të rriturit nuk ua lejojnë fëmijëve. Nëse fëmija nuk e pëlqen diçka, apo nuk do të bëjë diçka është shumë i keq. Ai duhet ta bëjë atë patjetër, sepse kështu i thonë prindërit. Ata nuk e shohin fëmijën si person me ndjenja dhe ide të tijat por, pothuajse si një send – sendin e tyre. Fëmija duhet të bëjë ashtu si i thuhet, e nëse ai nuk vepron kështu, ata e shohin atë si me probleme në disiplinë, sikur ka sjellje të vështirë dhe duhet të bëhet diçka me të. Fëmija nuk ka të drejta, por ai është si një kafshë që po pë stërvisni.”

Një nënë tjetër tha: “Unë i blej atij çfarë dëshiron, sepse, nëse nuk do t'ia blija, ai shqetësohet, inatoset, qan dhe nuk e kontrollon dot veten. Kjo më bën të ndihem fajtorë, sepse, kur ai është i mërziur unë e ndjej se është faji im.”

Këto dy qëndrime mund të duken se ndryshojnë, por të dyja vijnë nga frika e inatit. Ndjenjat e inatit duken të rrezikshme, në rastin e parë për fëmijën, në tjetrin për nënën. Në mendjet tona ne e dimë se inati është “normal”, se është e natyrshme që fëmijët të përjetojnë ndjenja inati, dhe si ide abstrakte kjo duket e pranueshme. Në teori, është e lehtë të pranosh inatin e fëmijës. Por, në prani të inatit të vërtetë, nëna përballlet me kontradiktën midis dëshirës së saj për të pranuar inatin e fëmijës, dhe paaftësisë së saj për të vepruar kështu, midis asaj çka mendon dhe çka ndjen ajo. Ideja se inati është normal e bën atë të sigurt dhe të mirë, por, në realitet, shumica e njerëzve i përgjigjen inatit sikur të jetë i rrezikshëm dhe i keq.

Inati është një përgjigje ndaj diçkaje apo dikujt, që duket se kërcënon mbijetesën tonë fizike apo psikologjike. Nevojat, dëshirat dhe të drejtat tona, duken se janë në rrezik dhe ne ndjejmë një impuls për të kundërsulmuar ndaj kujtdo apo çfarëdo lloji gjëje që ne na duket përgjegjës. Në formën e tij primitive, inati mbart dëshirën për të mohuar objektin e inatit tonë. Fjalja “Do të të vras që ma bëre këtë,” është një shprehje e njohur. Ndonëse shumë prej nesh as që i afrohen këtij veprimi sa të vrasim njëri-tjetrin kur jemi të inatosur, inati së paku, sjell një humbje të përkohshme të pranimit dhe të dashurisë. Një vdekje të vogël. Në shkallën që siguria jonë, mirëqenia varen nga dashuria dhe aprovimi i dikujt tjetër, në atë shkallë, inati ndihet i rrezikshëm.

Fëmijëria është koha kur ne jemi në realitet më të varur se kurdoherë tjetër tek të tjerët për mbijetesë. Nëse fëmija ndihet i frustruar prej nënës së tij dhe do të donte që ajo të mos ishte më, mundësia që kjo të realizohej, është me të vërtetë frikësuese. Inati i nënës kundrejt tij është edhe më i frikshëm, meqenëse ajo e ka në kuptimin e drejtpërdrejtë fuqinë për ta shkatërruar atë. Të paktën, humbja e dashurisë që fëmija përjeton në inatin e saj, i sjell ndër mend mundësinë e braktisjes prej saj, e cila është po kaq kërcënuese për mbijetesën e tij.

Fëmija e përjeton inatin e drejtuar ndaj tij, si pasojë e gabimeve të tij. Ai nuk mendon se, “Mami im është e inatosur me zhurmën që bëj unë, sepse është e lodhur dhe i dhemb koka.” Apo, “Mami u nxeh me mua se theva abazhurin, që ishte aq i dashur për të.” Fëmija beson se nëna e tij është e inatosur, ngaqë ai është i keq. Humbja e miratimit dhe e dashurisë së saj e bën atë të **ndihet** i keq dhe kjo interpretohet prej tij me kuptimin ai **është** i keq. Veç kësaj, edhe nëna ia konfirmon këtë duke i thënë se ai është djalë i keq.

Si nëna, ne vemë përsëri në skenë përvojën tonë të fëmijërisë përse i takon inatit. Marrëdhënia nënë – fëmijë, me ne tashmë si nëna, është një përjetim i dytë i po kësaj marrëdhënie me ne kur ishim fëmijë. Por, në versionin e të rriturit, ne i ndërrojmë rolet duke qenë tashmë nëna, por dhe fëmija. Në rolin e fëmijës, inati zgjon ndjenjën se jemi deri diku gabim. E kthyer në gjendjen e të rriturit bëhet: Nëse fëmija im është i inatosur, kjo do të thotë se unë jam nënë e keqe. Nëse nga ana tjetër, ne bëhemi nëna e plotfuqishme e fëmijërisë tonë, e cila nuk mund të bënte asnjë gabim, atëherë i bie që fëmija të jetë i keq, përderisa ka shprehur një inat të tillë. Shumë nëna bëjnë ecejake midis të qenit fëmija që ato ishin, ose nëna që ato kishin. Atyre iu duket e vështirë ta tejkalojnë marrëdhënien e vjetër nënë –fëmijë dhe të krijojnë një marrëdhënie të re. Kjo është një situatë emocionalisht e pamundur. Nëse inati e bën një nënë të ndihet për vete si fëmijë, atëherë ai bëhet shfarosës. Nëse ajo ndihet si nëna, ajo e ka fuqinë të asgjësojë. Ajo bie në grackën e dëshirës së fëmijës për të vrarë nënën dhe dëshirës së nënës për të vrarë fëmijën. Këto ndjenja janë pjesë e mëmësisë, por ato janë të frikshme për nënat dhe i pengojnë ato për t’iu përgjigjur inatit me mënyra të cilat i lejojnë edhe nënën edhe fëmijën të jetojnë.

Shprehja e ndjenjave të inatit shpall praninë e konfliktit. Fëmija godet me shpullë shokun e tij të klasës, që ia ka rrëmbyer lodrën. Një tjetër përjeton krizë kur nuk i jepet diçka që e dëshiron shumë. Një tjetër akoma kundërshton plotësisht kërkesat e nënës së tij. Në

këto, dhe shumë mënyra të tjera, fëmijët shprehin faktin se ata nuk e pëlqejnë atë që po u ndodh atyre, apo atë që po u kërkohet. Sjellja e fëmijës sinjalizon kundërshtimin e tij ndaj planit, apo dëshirës së nënës. Fakti që fëmija ndihet keq për diçka që i kërkon nëna, krijon dy probleme për nënën. Së pari, kundërshtimi i fëmijës e bën për të të vështirë të realizojë atë që do ajo. Qëndresa e tij ndrydh dëshirat e saj. Por, përtej kësaj, fëmija e shpreh kundërshtimin e tij me një sjellje që është e vështirë për t’u përballur, që duket e papranueshme për nënën dhe që ngjall inat dhe zemërim tek ajo.

Për shembull, nëna vendos se ka ardhur koha për t’u larguar nga këndi i lodrave dhe për t’u kthyer në shtëpi për të bërë punët. Ajo ia thotë këtë fëmijës, i cili menjëherë ulet në tokë dhe fillon të bërtasë. Ai nuk do që të kthehen në shtëpi, por dëshiron të qëndrojë ende dhe të luajë me shokët. Plani i nënës është ndërprerë nga kundërshtimi i fëmijës. Në vend që të kthehej në shtëpi shpejt e shpejt, ajo duhet të përballlet me një fëmijë që qan, dhe nuk pranon të lëvizë vendit. Megjithatë, një vështirësi më e madhe vjen nga ndjenjat që ngjallen tek ajo nga e qara e fëmijës. Ajo e përjeton të qarën e tij si një akuzë, një sulm personal mbi të. E qara e fëmijës shndërrohet më shumë se në një protestë kundër asaj që ajo dëshiron që të bëjë fëmija; më shumë se një fjalë që tregon se ai do të bëjë diçka ndryshe; më shumë se sa një shprehje dëshpërimi për situatën e tmerrshme ku ndodhet: një botë ku ai nuk mund të bëjë atë që do. Më shumë se të gjitha këto, nëna e merr këtë mesazh sikur të ishte faji i saj. Ndjenja e të qenit nën sulm se është nënë e keqe, ndikon përgjigjen e saj. Për shumë nëna, intensiteti i reagimit të fëmijës nuk përbën aspak një shprehje që tregon se sa fort e përjeton këtë fëmija, por më tepër, se sa e keqe është ajo. E qara ndihet si një shprehje për të, në vend që të ndihet si një shprehje për vetë fëmijën. Reagimi i fëmijës i le të kuptojë nënës se mund të ketë bërë gabim. Një ndjenjë e tillë mund ta detyrojë atë të heqë dorë nga ajo që dëshiron.

Nga ana tjetër, ajo mund të mos bjerë dakord me “akuzën” e fëmijës, me gjykimin e saj që deshifron në sjelljen e tij. Ajo mund ta ndjejë se nuk ka bërë asnjë gabim, por thjesht ka bërë një kërkesë të arsyeshme. Tani është fëmija, që është në gabim për mënyrën me të cilën reagon. Duke u ndjerë e sulmuar padrejtësisht nga sjellja e tij dhe e mbushur me inat, edhe nëna vetë fillon të inatoset. Impulsi i saj është të kundërpërgjigjet dhe ta “detyrojë” fëmijën të pushojë, apo ta “detyrojë” atë të pajtohet me dëshirën e saj. Ajo nuk merr fare parasysh dëshirën e tij për të qëndruar në park, por, përkundrazi, i përgjigjet sjelljes së tij të inatosur. Kur një nënë fillon të nxjerrë inatin e saj, tashmë nuk e ka më në dorë situatën. Kështu, ata përfshihen në betejë. Secili bëhet edhe kokëfortë në pozicionin e tij, secilit i duket gjithnjë e më vështirë për t’u kthyer prapa. Ndjenjat që zgjohen tek nëna prej sjelljes së inatosur të fëmijës çojnë drejt përkeqësimit, më tepër se sa zgjidhjes së konfliktit mes tyre.

Meqë konflikti është i trashëgueshëm në marrëdhënien nënë – fëmijë, është në natyrën e rolit të mëmësisë për të qenë e përgjegjshme për situatat që mund të shkaktojnë inat tek fëmija. Është e pashmangshme që fëmija të përgjigjet me inat kur ndërhyhet në atë gjë që i sjell atij kënaqësi. Gjithsesi, mjaft nëna përballë inatit të fëmijëve përfundojnë se ajo që **ato** dëshirojnë duhet të jetë e gabuar. Atyre iu duket se, nëse do të bënë inat që duhet, fëmijët nuk do të inatoseshin. Ky formulim i padrejtë na bën të fantazojmë një marrëdhënie ideale nënë – fëmijë, në të cilën nuk ekziston ndjenja e inatit. Kjo nënkupton se një marrëdhënie e tillë është, edhe e mundshme, edhe e dëshirueshme. Në fakt, nëse qëllimi i nënës do të ishte që fëmija të mos inatosej, ajo duhet të bëhet gati për telashe. Mënyra e vetme me anë të së cilës mund ta arrijë këtë është, që nëna ose të heqë dorë vazhdimisht nga ajo që dëshiron, ose, në një farë mënyre, të fshijë inatin e fëmijës. Me fjalë të tjera, nëse një nënë i duket inati i fëmijës kërcënues, heqja qafe e tij bëhet qëllimi i saj. Mënyra e vetme me të cilën mund të arrihet kjo është të lerë pas

dore atë që dëshironte, që i solli inat fëmijës, ose ta sulmojë fëmijën pse është inatosur: në të vërtetë, t’ia rrëmbejë atij të drejtën për t’u inatosur. Nevoja për të hequr qafe inatin e fëmijës, shdërrohet në një inat kundrejt fëmijës pse është i inatosur. Meqenëse inati i fëmijës është shprehje e ndjenjave të tij për urdhërat apo dëshirat e nënës së tij, inati i saj ndaj tij se pse është i inatosur do të thotë se, jo vetëm që ai duhet të bëjë diçka që nuk e pëlqen, por ai nuk lejohet ta shprehë faktin që nuk e pëlqen atë. Atij nuk i lejohet të ankohet!

Që fëmija është i inatosur, kjo nuk do të thotë se nëna e ka gabim atë që dëshiron. Ndërkohë, kjo nuk do të thotë se fëmija e ka gabim që ndihet i inatosur. Nëna mendon se, meqenëse ajo nuk e ka gabim, atëherë ajo ka të drejtë, e nëse ka të drejtë, fëmija nuk ka asnjë të drejtë të inatoset. Por, edhe atëherë kur ajo që dëshiron ajo është e drejtë për fëmijën, ai ka të drejtë mos ta pëlqejë atë. Problemi për shumë nëna është se ato duan t’iu shkojë e tyrja, por, ato duan, gjithashtu, edhe që fëmijët të bëjnë sikur iu pëlqen. Një nënë shpesh nuk mund ta durojë dot idenë se ajo po imponon mbi fëmijën diçka që e inatos, apo e bën atë të dëshpëruar. Ajo do që ai ta ndjejë (dhe ta ndjejë edhe vetë) se ajo është nënë “e mirë,” edhe atëherë kur i kërkon diçka që atij i duket e papranueshme.

Inati i fëmijës do të thotë se ai e përjeton atë që dëshiron nëna, si një sulm mbi atë që dëshiron ai. Edhe një kërkesë më se e arsyeshme që mund t’i bëjë nëna, përjetohet nga fëmija si një sulm, nëse bie ndesh me atë që dëshiron ai për momentin. Edhe atëherë kur qëllimi i saj nuk është ta frustrojë fëmijën, ai mund të ndihet i frustruar. Të pranosh inatin e fëmijës do të thotë të njohësh faktin që ai ndihet i sulmuar, pa bërë asnjë gjykim për veten apo për fëmijën. Inati i fëmijës nuk do të thotë që nëna është e keqe, apo fëmija është i keq. Ai thjesht do të thotë që, diçka që kërkon nëna mund të jetë e vështirë për fëmijën. **Për ta kuptuar këtë, nëna duhet të jetë e aftë të shohë dy realitete përnjëherësh, të sajën dhe atë të fëmijës.** Kjo kërkon, që ajo ta ndjejë se, ajo që dëshiron për fëmijën është

e pranueshme, por, njëkohësisht është i pranueshëm edhe fakti që ai mund të mos ta pëlqejë atë. Nëse ajo do të jetë e aftë të përjetojë dy realitete, as ka pse të heqë dorë nga ajo që dëshiron, e as ka pse të kërkojë që fëmija të shuajë inatin i tij. Përkundrazi, ajo mund ta pranojë inatin e tij si një shprehje të pikëpamjes së tij, dhe më pas të shohë nëse ka metoda të tjera për të arritur qëllimin e saj, të cilin fëmija do ta përjetojë si më pak sulmues. Nëna në park mund ta interpretojë inatin e fëmijës thjesht me domethënien se ai nuk do të shkojë në shtëpi, më shumë se sa ajo e ka gabim që i kërkon atij të largohen prej aty. Ajo mund t'i duket atij si një nënë e keqe në atë çast, por, kjo nuk do të thotë se ajo **është** nënë e keqe. E as fëmija nuk është i keq, vetëm sepse kërkon të qëndrojë edhe pak. **Nuk ka nevojë ta ndalojë atë të ndihet i inatosur, me qëllim që të plotësojë dëshirën e saj për t'u kthyer. Nëna, në fakt, mund t'i përkrahë dhe t'i kuptojë ndjenjat e tij.** Ose, nga ana tjetër, ajo mund të vendosë, se, meqenëse ai ka kaq shumë dëshirë, ata mund të qëndrojnë edhe pak më gjatë. Largimi apo qëndrimi varet nga ndryshimi i mënyrës se si ndihen secili.

Në fëmijëri, ndjenjat e inatit shprehen së pari me sjellje sulmuese ose fyese. Fëmija mund të godasë, të bërtasë, apo të hedhë sende përtokë, si mënyrë për të shprehur inatin e tij. Kjo sjellje përjetohet nga nëna si një sulm i trefishtë: Ajo është shprehje e armiqësisë së fëmijës, që nënkupton humbjen e dashurisë së tij. Por, përtej kësaj, vetë sjellja, jo vetëm që shkakton stres të madh fizik apo emocional tek nëna, por, gjithashtu, ngjall të gjitha ndjenjat e njohura të sjelljes së keqe. Për shkak se fëmijët nuk i kanë zhvilluar kontrollet e tyre të brendshme, por vetëm sa manifestojnë ndjenjat e tyre, ndjenjat dhe sjellja duket se janë e njëjta gjë. Ndjenjat marrin formë në sjellje, dhe, meqenëse sjellja është kërcënuese për të tjerët, ajo nxjerr një përgjigje të ashpër, ndonjëherë edhe kundërsulm. Fëmija, që është i paaftë të bëjë dallimin mes ndjenjave të tij dhe sjelljes, fillon të besojë se janë ndjenjat ato që janë të rrezikshme. Edhe nëna e beson këtë, po ashtu.

Fakti që ndjenjat e inatit shoqërohen emocionalisht me sjellje sulmuese gjatë fëmijërisë, ngjyros përgjigjen tonë ndaj ndjenjës së inatit përgjatë gjithë jetës sonë. Ne mbetemi të frikësuar nga mundësia për ushtrimin e dhunës, edhe prej inatit të fëmijëve, edhe prej tonit. Rreziku se ndjenjat do të shpërthejnë kufirin e kontrollit tonë është gjithmonë i pranishëm. Duket sikur prania e ndjenjave të inatit pashmangshmërisht do të thotë shkarkimi i tyre në sjellje të dhunshme. Ne nuk kemi besim në vetvete, në aftësinë tonë për të shprehur inatin në një mënyrë që nuk do ta zhdukë personin ndaj të cilit drejtohet. Përkundrazi, ne besojmë se intensiteti i ndjenjave tona do të bashkangjitet patjetër me poshtërsinë e veprimeve tona. Prandaj, shpesh duket e pasigurt jo vetëm të shprehësh inatin, por edhe t'ia lejosh vetes ta ndjesh atë.

Për shkak se të ndjerit e inatosur duket e rrezikshme, nënat shpesh ia mohojnë vetes ndjenjat e inatit kundrejt fëmijëve dhe inatin e fëmijëve kundrejt tyre. Një mënyrë për të shmangur inatin e fëmijëve është të përqendrohesh vetëm në sjelljen me të cilën shprehet. Meqenëse sjellja është “e keqe”, është e thjeshtë ta shohim atë si një sjellje të padisiplinuar më tepër se sa një shprehje inati. Atëherë, ajo bëhet një pasqyrim vetëm i diçkaje që duhet korrigjuar tek fëmija, dhe shprehja që fëmija po shfaq për ndjenjat e tij kundrejt nënës, në atë moment, mund të anashkalohet. Nëse fëmija i vërvit një lodër nënës, sepse ajo i ka thënë t'i vendosë ato, sjellja e tij duket se është e tërbuar, krahasuar me kërkesën e saj. Ajo ndihet e justifikuar ta ndëshkojë atë se i guajti me diçka, dhe nuk e vëren fare se sa i inatosur është ai, kur urdhërohet të braktisë diçka me të cilën po kënaqet. **Nëna e sheh fëmijën sikur ai ka nevojë të mësojë se si të sillet si duhet, më shumë se sikur ka nevojë se si të shprehë inatin në mënyrë të përshtatshme.**

Nga ana tjetër, nëse nëna dëshiron ta pranojë inatin e fëmijës, ajo shpesh beson se duhet të pranojë edhe sjelljen me të cilën ai shprehet. Një fëmijë godiste nënën e tij me grushta kur ndihej i

inatosur. Ndonëse nënës nuk i pëlqente fare kjo, ajo gabimisht besonte se ai duhej të lejohej ta godiste atë, nëse ajo duhej t'i tregonte se, të qëniti i inatosur ishte diçka normale. Por, një nga gjërat që e bën inatin kaq tmerrues, si për nënën, edhe për fëmijën është fakti se ai mund të shprehet në sjellje sulmuese. Është e frikshme për të dy të ndjerit se, nuk ka asgjë që mund ta pengojë inatin e fëmijës prej shkatërrimit të mundshëm të dikujt, për të cilin ai ka aq shumë nevojë, siç është nëna e tij. Njëkohësisht, nëna që pranonte goditjet e fëmijës si mënyrë për të shprehur inatin, po mohonte ndjenjat e saj të inatit teksa goditej ashtu. Ajo kishte frikë se, nëse do ta nxirrte inatin e saj, do ta shprehte atë në mënyrë shkatërrimtare; se do ta sulmonte fëmijën me sjelljen e saj, ose, të paktën, do ta dëmtonte atë duke ia mohuar nevojën për të shprehur inatin. Sjellja e fëmijës dhe reagimi i nënës e vërtetonte për të dy se sa e rrezikshme është një përvojë inati.

Nënat, ndonjëherë, mendojnë se e vetmja mënyrë për t'i treguar fëmijës se inati është diçka e lejuar, është të ngjiten pas dëshirave të tij. Nëse një fëmijë është i inatosur, sepse nëna e tij ngul këmbë që ai të shkojë në shtrat, ajo mendon se e vetmja mënyrë për të pranuar inatin e tij është ta lejojë të rrijë pa fjetur. Ajo beson se pranimi i inatit është e njëjta gjë me largimin e burimit të tij, apo sikur të mos ndjesh më inat. Në fakt, e kundërta është e vërtetë. **Vetëm duke përjetuar ndjenjën e inatit, por, pa e shprehur atë në sjellje sulmuese, ai mund të bëhet më pak i rrezikshëm.**

Fëmija ka nevojë të mësojë se ndjenjat e tij janë të pranueshme, por goditjet, të bërtiturat, dhe guajtjet me sende, jo. Nëna mund t'ia mësojë atij këtë, vetëm nëse ajo vetë e ndjen se inati i fëmijës nuk është i rrezikshëm për të, se nuk do ta shkatërrojë atë, se ai nuk ka pse të shuhet fare, me qëllim që ajo të arrijë synimet e saj. Nëse ajo ndihet e sigurt për këtë, nuk do t'i duket aspak e domosdoshme të hidhet në kundërsulm. **Ajo nuk ka pse t'i përgjigjet me inat, inatit të fëmijës. Ajo mund ta ndihmojë atë të përmbajë sjelljen e tij, por, pa e sulmuar për inatin e tij.**

Inati përjetohet si i rrezikshëm kur duket se do të shkatërrojë dikë tjetër, apo kur pasohet nga një përgjigje që është shkatërruese për vetveten. Nëse një nënë dërrmohet përballë inatit të fëmijës, ai nuk do t'i duket fëmijës si një gjë normale. E as duket ashtu, kur zgjon tërbimin e nënës. Për të zhvilluar vetëbesimin se inati mund të përjetohet pa shkatërruar dikë tjetër, fëmija duhet ta përjetojë edhe inatin, edhe mundësinë që ai mund të shprehet në mënyra të përshtatshme. T'i japësh leje fëmijës të ndihet i inatosur, nuk është njëlloj si t'i japësh leje ta shprehë inatin në sjellje të dhunshme. E as që është njëlloj si ta bësh inatin e tij arsyen më të rëndësishme. Sidoqoftë, kjo do të thotë se duhet t'iu kushtohet më pak rëndësi ndjenjave të tij. Nëse nëna duhet ta pranojë inatin e fëmijës, dhe dëshiron t'ia mësojë atij si ta shprehë atë ndryshe, ajo duhet të bëhet gati të dëgjojë mospajtim. Ajo duhet të jetë e aftë të tolerojë faktin që ai nuk po e pëlqen diçka që po bën ajo, që në vërtetë, ai nuk po e pëlqen nënën në atë moment. Shkurtimisht, ajo duhet të rrezikojë të ndihet si nënë "e keqe". Nëse kjo ide është e pranueshme, ajo nuk ka pse të hidhet në kundërsulm me inatin e saj, apo të kapitultojë në një mënyrë që e bën inatin e fëmijës të duket shumë i fuqishëm dhe, për këtë arsye, edhe i frikshëm.

Të respektosh ndjenjat e fëmijës do të thotë t'i japësh edhe atij pak zë në çështjen në fjalë, por, jo ta bësh zërin e tij të vetmin që dëgjohet. Ajo mund të vendosë se, meqë djali i saj ka kaq shumë dëshirë për të mos shkuar në shtrat tani, t'i lerë edhe pak kohë më tepër. Ajo, natën tjetër, mund t'ia bëjë të ditur që më parë se po afrohet koha për të rënë në gjumë, apo ta bëjë kërkesën e saj në një mënyrë më pak sfiduese. Edhe atëherë kur nuk është e mundur ta ndryshojë planin e saj, ajo mund ta pranojë me fjalët dhe mënyrën e saj të sjelljes se nuk e sheh fëmijën si "të keq," ngaqë nuk dëshiron të bëjë atë që duhet. Ajo mund t'ia shprehë këtë të kuptuar, pa hequr dorë aspak nga ajo çfarë pret prej tij.

Sigurisht, të respektosh ndjenjat e fëmijës varet nga besimi se fëmija ka të drejtë të respektohet. Por, kjo varet gjithashtu edhe tek besimi i nënës se edhe ajo ka të drejtë të respektohet.

Nëse ajo nuk e ndjen këtë për veten, ose ndjenjat e fëmijës, ose të sajat mund të duken tejet të rëndësishme dhe mund të sundojnë skenën. E pasigurt për vlefshmërinë e ndjenjave të saj, ajo, ose do t'i lerë mënjane ndjenjat e saj në favor të fëmijës, ose do të përfshihet kaq shumë për të provuar vlefshmërinë e ndjenjave të saj, sa që do të jetë e paaftë të respektojë fëmijën.

Nëse një nënë është e aftë t'i japë vetes të drejtën të përjetojë ndjenjat e saj, nëse ajo mund t'i lejojë vetes të ndjejë të gjitha ndjenjat që mendon se nuk e ka të lejuar t'i ketë, vetëm atëherë ajo mund t'ia japë këtë të drejtë edhe fëmijës. Nëse ajo vetë është e bindur se të ndjesh diçka, nuk është si ta shfaqësh atë, atëherë, do t'ua mësojë edhe fëmijëve të saj. Ndjenjat e tij do të duken më pak tmerruese, nëse ajo është e sigurt se mund t'i kontrollojë të vetat. Asaj do t'i bëhet e qartë se, respektimi i ndjenjave të tij nuk është e njëjta gjë me dorëzimin përpara dëshirave të tij, apo pranimin e sjelljes së tij; të përmbajturit e sjelljes së fëmijës nuk ka pse të jetë njëllor me shtypjen e ndjenjave. Meqë, për shumë prej nesh këto dallime nuk janë bërë të qarta kurrë gjatë fëmijërisë sonë, ne kemi nevojë për po aq ndihmë sa edhe fëmijët tanë, për të mësuar të bëjmë dallimin mes sjelljes dhe ndjenjave, kur përmbajmë ndjenjat tona, teksa ushtrojmë kontroll mbi veprimet. Si nënat, ashtu edhe fëmijët, kanë nevojë për praktikë në përjetimin e inatit, por, pa e shprehur atë në sjellje të dhunshme.

Për shkak se inati dhe dhuna janë kaq shpesh të lidhura me sjelljen e fëmijëve, ato janë të bashkëshoqëruara në mendjet e nënave. Inati shpesh shfryhet në sjellje të dhunshme, ndonëse jo të gjithë aktet e dhunës janë shprehje të inatit. Gjithsesi, të dyja duken të këqija, sepse ato mbartin rrezikun për sulm ndaj të drejtave të dikujt tjetër. Në fakt, të jesh i dhunshëm do të thotë, gjithashtu,

të jesh shumë i sigurt në vetvete, të përpiqesh të mbrosh vetëm të drejtat e tua, të kesh fuqinë për të plotësuar vetëm nevojat e tua dhe të arrish qëllimet e tua. Ashtu si inati i tij, aftësia e fëmijës për t'u sjellë vetëm në favor të vet, së pari, shprehet pa bërë dallimin midis sjelljeve të pranueshme ose jo. **Këtu, gjithashtu, sfida për nënën është të bëjë dallimin midis sjelljes dhe ndjenjave, për të mbështetur kapacitetin për siguri në vetvete, teksa i mëson atij mënyra më të pranueshme për ta shprehur atë.**

Si inati, ashtu edhe dhuna, luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e pavarësisë, në aftësinë e fëmijës për t'u rritur dhe për t'u bërë i pavarur nga nëna. Fakti që jo gjithçka që bën nëna, përshtatet me pëlqimin e tij, siguron një pjesë të impulsit dhe dëshirës për t'i bërë gjërat në mënyrë të pavarur. **Inati dhe dhuna e tij, ndihmojnë për ta përkufizuar atë si një person me identitet e vet të qartë, të ndryshëm nga nëna e tij.** Pikërisht nga ky ndryshim, gjithashtu, lindin konfliktet të cilat ia shtojnë stresin mëmësisë. Atëherë, impulsi që zgjohet është të eliminojmë konfliktin, më mirë se sa të përballemi me të. Por, eliminimi i konfliktit, pashmangshmërisht do të thotë të bëhesh shkatërruese për fëmijën, ose për veten. Konflikti, inati, dhuna, janë pjesë e jetës, si të nënës ashtu edhe të fëmijës. Zhdukja e tyre nuk kërkohet, për ta bërë jetën të sigurt për të dy.

KAPITULLI 7

Dialogu nënë - fëmijë

Nëna i bën vetes pyetje të tilla si: “Kur mund t’i vë për të ngrënë ushqim shtesë, veç qumështit?” “A duhet ta stërvis për të treguar nevojat e tij personale?” Ajo i kërkon përgjigjet në librat që flasin për kujdesin ndaj fëmijëve dhe, në të vërtetë, ajo është duke pyetur ekspertët: “Nëse do të më thoni se çfarë të bëj, unë do t’iu bindem. Nëse ju më tregoni çfarë të mos bëj, unë nuk do ta bëj.” Ajo që nënkuptohet këtu është se, gjendet një përgjigje e drejtë dhe abstrakte, vetëm duhet që dikush ta japë. Në të vërtetë, nuk ka përgjigje të drejta në atë kuptim. Ka vetëm pyetje. Ato që kanë të bëjnë me varësinë dhe pavarësinë: Ku ndodhet fëmija në atë vazhdimësi që idealisht zhvendoset drejt pavarësisë në rritje? Ku ndodhet nëna në pavendosmërinë e saj në lidhje me braktisjen e nevojave të varësisë së fëmijës? Përgjigjet për pyetjet e veçanta të një nëne qëndrojnë në eksplorimin e këtyre dy pyetjeve më thelbësore.

Historia e përvehtësimit të funksionimit të pavarur është historia e braktisjes së plotësimi të çdo nevojë primitive për shpërblimin e pavarësisë. Më kujtohet, kur po sillnim në shtëpi djalin tonë më të madh nga spitali, kur ai ishte vetëm një javësh. Duke u ngjitur në ashensor, ai ndodhej në krahët e të atit. Një i ri, që u ndodh atje, tha: “Duhet të jetë mirë të të mbajnë ashtu kudo që të shkosh”, komentit të së cilit bashkëshorti im iu përgjigj: “Nuk e di. A ke menduar ndonjëherë se mund të çohesh atje ku nuk dëshiron?” Kënaqësia e foshnjërisë është që foshnja të mbahet kudo. **Shpërblimi i të qenit i pavarur është aftësia për të vendosur vetë se ku do të shkosh.** Edukimi i fëmijëve është një proces përcaktimi se ku

TË JESH NËNË

ndodhet fëmija në gadishmërinë e tij për të ndërmarrë hapin tjetër, në po atë drejtim. Personi më i mirë, që ndodhet në pozicionin më të favorshëm për ta ditur këtë, është nëna. Megjithatë, ka një mori gjërash që e pengojnë aftësinë e saj për të bërë këtë gjykim. Dy prej tyre, që janë më të rëndësishmet, janë anë të kundërta të të njëjtit fenomen. Njëra është dëshira e saj për t’i sjellë kënaqësi fëmijës; tjetra, vetë ankthi i saj, faji dhe dhimbja kur ajo ndjen sikur po i shkakton atij vuajtje. Fëmija ndihet kaq mirë kur pi qumësht. Pse të mos e lë edhe pak? Apo anasjelltas, ai qan në mënyrë kaq prekëse, sa që i thyhet zemra kur e dëgjon. Nëna dëshiron që gjithë jeta të jetë pa asnjë dhimbje për fëmijën e saj. Megjithatë, ky nuk është një qëllim realist. Mohimi dhe frustrimi janë po kaq pjesë e jetës sa edhe plotësimi i dëshirave dhe impulseve. Është pikërisht, një ekuilibër midis këtyre dy faktorëve, ajo që po kërkon nëna. Që të ndërmarrë hapin tjetër, është gjithmonë pjesërisht e dhimbshme. Kjo do të thotë të lërë në një farë mase plotësimin. Nëse njeriut i përmbushen të gjitha atje ku është, pse të bëjë përpara? Nëse dikush është plotësisht i frustruar, pse të përpiqet për të provuar?

Drejtimi i fëmijës nëpër të gjithë hapat në rrugën drejt pavarësisë është një proces ku përfshihen së bashku nëna dhe fëmija. Në të vërtetë, mes tyre zhvillohet një dialog sjellor, i cili, në fazat e mëvonshme, do të bëhet verbal. Nënës i duhet të mbledhë fakte për të përcaktuar, nëse fëmija është gati për të bërë hapin tjetër, dhe ajo mund t’i gjejë këto fakte në sjelljen e tij. Për shembull, ai mund të bëhet më i interesuar në vërejtjen me vëmendje të shishes se sa të pijë prej saj. Heqja e biberonit nga shishja mund të jetë më interesante se sa pirja prej tij. Nëna e tij mund të vendosë se, ky është një tregues që thotë se ai nuk ka dhe aq nevojë për shishen, dhe ndoshta ajo do ta provojë duke mos ia dhënë më. Mënyra me të cilën ajo verifikon informacionin që beson se e merr nga të dhënat e sjelljes së fëmijës, dhe mënyra me të cilën ai i përgjigjet sjelljes së nënës, është në realitet një bisedë që ndodh midis tyre, që tregon

nëse fëmija është i aftë, ose jo, të ndërmarrë hapin tjetër që po i kërkon nëna. Fëmija thotë: “Ky burim plotësimi është për mua më pak i rëndësishëm se ç’ishte më përpara.” Nëna e tij i përgjigjet duke i thënë: “Të shohim nëse mund ta lemë atëherë.” Fëmija mund të reagojë në shumë mënyra. Ai mund të thotë: “Unë nuk e kisha me gjithë mend, është ende herët.” Ose ai mund të thotë: “Mirë, t’u desh shumë kohë që ta kuptoj!”

Por, ajo që ka më shumë të ngjarë është se, ai, sikurse edhe nëna, do të ketë pak pavendosmëri për të hedhur hapin tjetër. Ai mund të protestojë pak, pastaj të provojë atë që i kërkohet, më pas të kundërshtojë prapë pak më shumë. Gradualisht, pa shumë stres dhe parehati, ai do të bëjë përpara. Janë një seri grackash pavendosmërie që shpesh përfshihen në këtë proces. Nëse vetë nëna është më pak eksperimentuese, apo e pasigurt që është vërtet në rregull me hapin tjetër gjatë zhvillimit të fëmijës, ato momente kur fëmija shpreh pakënaqësinë e tij për gjendjen ku ndodhet, mund ta shqetësojnë nënën në planin e saj të veprimit. Ajo beson se gjen në sjelljen e fëmijës konfirmimin për t’u tërhequr prapa, se sa për të bërë përpara. **Inati momental, apo pakënaqësia e fëmijës i duket asaj si e gjithë piktura, se sa një pjesë shumë e vogël e saj. Ajo ka nevojë të sigurohet se, në rritje duhet patjetër pak frustrim. Jo dhe aq frustrim dhe dhimbje sa për të paralizuar, por, gjithashtu, edhe shumë plotësim, gjithashtu, paralizon.**

Ajo që përshkruhet këtu, sigurisht, është një proces në të cilin ai lëviz pak para, është gati të bëjë edhe prapa po të jetë nevoja, ku ka marrje dhe dhënie midis nënës dhe fëmijës. Idealisht në këtë proces nëna, jo vetëm që ndjek treguesit e fëmijës, por, ajo gjithashtu e udhëheq atë. Fëmija, jo vetëm që përkulet ndaj vullnetit të nënës, por, gjithashtu e udhëheq atë. Nëse nëna arrin t’ia kapë thelbin këtij procesi, ajo mund ta ndjejë dialogun që zhvillohet mes saj dhe fëmijës. Atëherë sjellja e fëmijës dhe përgjigja e tij ndaj saj do të jenë më pak të rrezikshme. Ai nuk ka dalë për ta mposhtur

atë, teksa i përgjigjet negativisht, por, vetëm sa shpreh qëndrimin e tij në lidhje me atë situatë. Nëna, nga ana tjetër, nëse bën pak prapa nga pozicioni i saj nuk ka pse të ndjejë se ka humbur, por thjesht po merr parasysh ndjenjat e fëmijës mbi një çështje të rëndësishme të zhvillimit të tij.

Një nënë pyet: “Sa frustrim është i domosdoshëm?” Deri në çfarë shkalle parehatie mund të durojë fëmija? Kur është thjesht një shprehje kalimtare kundërshtimi, që nuk është shumë serioze? Këto janë pyetje që vetë nëna mund t’iu përgjigjet në mënyrën më të mirë, në sajë të njohjes që ka ajo për fëmijën, rreth sjelljes së tij përgjatë udhës së zhvillimit. Përgjithësisht, nëna mund të ketë besim në të kuptuarit e saj. Nëse asaj i duket se ata po përfshihen në një mosmarrëveshje rreth diçkaje, ky është sinjal i mirë për ta lënë atë dhe për të vazhduar me diçka tjetër. Nëse ajo e sheh fëmijën duke u përpjekur të arrijë diçka, megjithë kundërshtimin që bën, ajo është ndoshta në udhë të mbarë.

Ky proces vihet në lëvizje bashkarisht, më mirë se sa nëna, apo fëmija si imponues të vullnetit të tyre ndaj njëri – tjetrit. **Nëna ka nevojë të jetë aleat i fëmijës në rritje.** Nëse nëna ndihet si një aleat, pyetja që i bën ajo vetes është: Si mund ta **ndihmoj** atë të hedhë hapin tjetër, më mirë se sa, si mund ta **detyroj** të hedhë hapin tjetër? Mbështetja më e madhe që ajo mund t’i ofrojë fëmijës është vetë njohja e saj se sa i vështirë është gjithë procesi. **Mbështetja emocionale e nënës bëhet zëvendësuese e kënaqësisë konkrete dhe të prekshme, nga e cila po heq dorë fëmija.** Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që nëna të jetë e aftë të tolerojë ndjenjat negative të inatit dhe kundërshtimit. Nëse nëna gjen në shprehje të tilla një qortim për veten e saj, që është i pafalshëm, ajo, ose mund të ngarkohet me faj, ose t’ia marrë hakun me inat. Nëse ajo do ta kuptojë inatin e fëmijës, jo si një shprehje kundrejt saj, por, si një shprehje të ndjenjave të fëmijës në lidhje me situatën, atëherë, për të bëhet më e lehtë të përcaktojë nëse komunikimi i tyre i tregon se

me të vërtetë është një situatë e padurueshme, apo diçka që ai nuk e pëlqen edhe aq. Ajo mund të thotë në përgjigjen e saj: “Unë e kuptoj se është me të vërtetë shumë e vështirë për ty në këto çaste,” ose “Po, unë e di se ty nuk të pëlqen edhe aq kjo, por, unë do të të ndihmoj t’ia dalësh.”

Nënat shpesh frikësohen mjaft lehtë prej reagimeve negative të fëmijëve të tyre. Arsyeja që japin shumë nëna, për paaftësinë e tyre për të arritur një qëllim që mund të kenë në mendje, është se ai e shqetëson shumë fëmijën. Shpesh, përkthimi i kësaj fjalie është se reagimi i fëmijës e shqetëson mjaft nënën. Kur fëmija qan apo është i mërztur, nëna e lexon këtë veshur me kuptimin sikur ajo është një dështim. **Ja pse është shumë e rëndësishme për nënën, të dijë dhe të ndihet e sigurt për faktin se procesi i rritjes përfshin a priori gjëra, të cilat ajo dhe fëmija e saj mund të mos u pëlqejnë. Detyra e saj nuk është të krijojë një shtrat me trëndafila, por ta ndihmojë atë të gjejë rrugën përmes gjembave.** Nëse, sa herë që ai shpohet, nëna beson se është faji i saj, do të jetë e pamundur për të ta lejojë të hedhë hapin tjetër.

Pikërisht këtu hyn në lojë plotfuqishmëria e pabesueshme e mëmësisë. Ne nuk duhet t’iu besojmë të gjitha deklaratave që thonë se, për gjithçka që shkon keq, fajin e ka nëna. Ata që nuk e kanë pranuar idenë se, privimet që kemi përjetuar ne janë në vetë natyrën e jetës, janë ende të përfshirë në idenë se, nëse nëna do të kishte vepruar ndryshe, gjërat nuk do të ishin siç janë sot. Ne, si nëna e kemi fatin ta bëjmë më mirë këtë detyrë, por, biem drejt e në kufizimet tona si njerëz dhe kufizimet e vetë jetës. **Një nënë duhet të ketë besim tek forcat e saj dhe tek kapaciteti i fëmijës për të mbijetuar ndaj disa frustrimeve të përkohshme. Vetëm atëherë, ajo mund t’i japë fëmijës sigurinë se ai mundet t’ia dalë, sigurinë se ajo po e mbështet, sigurinë që bëhet zëvendësuese për plotësimin konkret dhe të prekshëm të dëshirave, nga i cili ai po heq dorë. Si për nënën, ashtu edhe për fëmijën, ka shpërblime**

kur hidhet hapi tjetër. Shpërblimi për të dy është liria gjithnjë e në rritje. Për nënën është me të vërtetë çliruese të mos përgatitë më shishe, apo të ndërrojë pelena. Është çliruese të mos e vëzhgosh orë e çast fëmijën për shkak të paaftësisë së tij për të dalluar çka është e rrezikshme. Është çliruese kur fëmija shkon në shkollë. Për fëmijën është çliruese të mos ketë nevojë për nënën në gjithçka që bën. Është thelbësore që ai ta fitojë lirinë në këtë mënyrë, që ai të bëhet i pavarur, sepse, në të vërtetë, nëna nuk do t’i gjendet pranë gjithë jetën. Dhe, ndoshta, është ky fakt që përbën edhe një pengesë tjetër për nënën në moslejimin e fëmijës në përparimin drejt pavarësisë. Bashkë me çdo hap që hedh fëmija drejt sjelljes autonome, ai është më pak i varur nga nëna dhe ajo është më pak e domosdoshme. Pavarësia gjithnjë e në rritje e fëmijës na sjell ndër mend vetë vdekshmërinë e saj. Pavarësia e tij e fshin funksionin mëmësor dhe në këtë ndjesi përfshihet shumë ankth.

Çështjet që ngrihen në zhvillimin e fëmijës, që kanë të bëjnë me varësinë dhe pavarësinë, nuk kanë zgjidhje arbitrare brenda ndarjeve kohore të fiksuara. Nuk ka asgjë të drejtë apo të gabuar. Janë vetëm pikëpamja e nënës dhe ajo e fëmijës, të cilët duhet të bashkëpunojnë. Po ashtu, si në kuptimin abstrakt, nuk ka mënyrë, apo kohë të duhur për nënën, në arritjen e objektivave të saj për fëmijën, e as nuk ka për fëmijën ndonjë mënyrë, apo kohë të përcaktuar kur ai ia shpreh nevojat e tij nënës. Pa dyshim, që është e dobishme që nëna të lexojë udhëzues të përgjithshëm, që tregojnë se kur fëmijët i arrijnë normalisht disa gurë kilometrikë të zhvillimit. Megjithatë, shumë shpesh këta udhëzues priren të veprojnë për nënën si një tërësi absolute, kundrejt së cilës, ajo mat veten dhe fëmijën. Toni autoritar i shumë këshillave mbi edukimin e fëmijëve përpiqet t’i nxitë nënat të venë veten në po të njëjtin pozicion autoritar në lidhje me fëmijët e tyre. Eksperti i tregon nënës çfarë të bëjë, kështu, nëna fillon t’i tregojë fëmijës se si të sillet. Shpesh, kur lind konflikti mes nënës dhe fëmijës, ai krijohet prej vendosmërisë së nënës në sajë

të një vendimi të marrë arbitrarisht. Metoda autoritare e përdorur nga eksperti me nënën, dhe prej nënës tek fëmija, është e tillë që, pikëpamjet apo vendimet imponohen nga lart. Ajo nuk lejon ndërveprim midis dy qenieve njerëzore të pajisura me ndjenja. Ajo nënkupton se pikëpamja e nënës, perceptimi i saj, është më pak i vlefshëm, më pak i rëndësishëm, se sa ai i ekspertit. Një nënkuptim tjetër është se, nëna, duke u bërë një zgjatim i ekspertit gjatë ndjekjes së udhëzimeve të tij, mund të marrë vendime që s'kanë të bëjnë fare me fëmijën e saj, ndërkohë që, ajo çfarë nevojitet më shumë është njohja e procesit që përfshin, si nënën, ashtu edhe fëmijën. Nëna, së pari, duhet të përcaktojë çfarë po përpiqet të arrijë, dhe më pas të vendosë një strategji për ta përmbushur qëllimin e saj. Nëse fëmija reagon me kundërshtim ndaj sjelljes së saj, ajo duhet të përcaktojë natyrën e këtij kundërshtimi. A po i tregon fëmija se ajo çka po i kërkohet është tepër e vështirë në këtë fazë të zhvillimit, apo thjesht ai po ankohet rreth asaj që pritet prej tij dhe, me pak inkurajim, do të ecë përpara dhe do t'ia dalë mbanë? Nëse nëna e gjen veten të shpartalluar nga reagimi i fëmijës, nëse ajo ndihet në ankth, apo fajtorë, ka nevojë të kërkojë arsien e këtyre ndjenjave në vetvete. A është shumë shqetësuese për të, ekspozimi i fëmijës ndaj ndjenjave të parehatisë? A po e merr ajo shprehjen e tij kundërshtuese tejet personalisht, apo, nga ana tjetër, a inatoset ajo prej mosdashjes së tij për të ecur në një hap me të? Ashtu siç janë ndonjëherë shenjat e pavarësisë kërcënuese, edhe nevojat e varësisë së fëmijës, edhe mënyrat me të cilat ato shprehen, mund të jenë njëloj kërcënuese.

Varësi e plotë ekziston në foshnjëri. Pavarësi e plotë nuk ekziston kurrë. Dëshira për të qenë i varur te dikush tjetër dhe për t'u rrethuar nga përkujdesja e të tjerëve vazhdon gjatë gjithë jetës. Nevoja për t'u mbështetur tek të tjerët është një e vërtetë e jetës. Aftësia emocionale për t'u mbështetur tek të tjerët është një pasuri e jetës. Ajo na mundëson të marrim shpërblimin e një marrëdhënie të ngushtë. Ajo na le të kuptojmë se ne mund të mbajmë pak dobësi,

një derë të hapur me të cilën mund të komunikojmë me të tjerët, një shkallë vetëbesimi se, nëse ne i shfaqim nevojat tona, ato nuk do të shkelen me këmbë. Sigurisht, nëse jeta na ka mësuar se shfaqja e këtyre nevojave duhet të pritët me këmbët e para, çfarëdo lloj shprehje e dëshirës për të qenë i pavarur, duket e veshur me rrezik.

Varësia e plotë e foshnjërisë është e pranueshme vetëm gjatë foshnjërisë. Marrëdhënia nënë - fëmijë nuk është marrëdhënia e ndërvarur e një të rrituri. Ajo është marrëdhënia, në të cilën varësia e fëmijës ka kërkesa të mëdha mbi nënën, dhe e ngarkon atë, si fizikisht, ashtu edhe emocionalisht. Megjithë ndjenjat që iu ngjallen nga kërkesat e mëdha të fëmijës gjatë fëmijërisë së hershme, shumica e nënave e pranojnë realitetin se foshnjat e kërkojnë këtë lloj përkujdesje. Çdo hap në zhvillimin e fëmijës është si një gur kilometrik, i cili do të thotë një kërkesë më pak për nënën. Shumica e nënave mezi i presin ata gurë kilometrikë në udhën drejt pavarësisë, që t'ua lehtësojnë barrën e lodhjes. Gjumi gjatë gjithë natës, pirja nga gota, ngrënia në tavolinë, të ushqyerit vetë, të veshurit vetë, shkuarja vetë në tualet, shfaqja e të gjitha këtyre aftësive të pavarësië, më në fund do të thotë më pak punë për nënën.

Pyetja që davaritet në mendjen e nënës është: Kur? Kjo pyetje është në vetvete e përbërë prej dy pyetjesh. Njëra prej tyre është: Si mund ta di unë nëse fëmija im është gati për të hedhur hapin tjetër? Dhe tjetra është: Kur e kam të drejtën të pres nga fëmija im të hedhë hapin tjetër? Problemet që përjeton nëna në udhëheqjen e fëmijës drejt sjelljes së pavarur, vijnë ngaqë ajo është shumë e përfshirë vetëm me njërën nga këto pyetje. Përsëritet situata e njohur sërish: Nëse do të respektoheshin vetëm ndjenjat e fëmijës, pasojnë një mori grackash. Nëse do të respektoheshin vetëm ndjenjat e nënës, vijnë edhe një mori grackash të tjera.

Kur nëna vendos se fëmija është i aftë të hedhë hapin tjetër, qëndrimi i saj kundrejt varësisë së fëmijës pëson një ndryshim të pakapshëm. Nëse më parë, ajo e shihte paaftësinë e fëmijës për të

funksionuar në aspekte të caktuara si një kusht të natyrshëm të nivelit të tij të zhvillimit, vetë fakti që ajo ka vendosur të përparojë, ose sepse ajo mendon se fëmija është gati, ose sepse ajo e di se **ajo** është gati, e kthen situatën përmbys në një konfrontim. Nëse më përpara nëna e perceptonte fëmijën si **të nevojshëm** për t'u kujdesur, ajo tashmë e percepton atë si **urdhërues** për t'u kujdesur për të. Në ato fusha ku ajo jepte pa kursim nga vetja për fëmijën, tashmë fillon të ndihet e shfrytëzuar. Sjellja foshnjare, që dikur ishte e pranueshme, tashmë konsiderohet si sjellje e keqe. "Mjaft u solle si bebe," u thonë nënat fëmijëve të tyre të vegjël, të cilët kanë ende shumë prej sjelljes foshnjare të mbetur tek ta. Ajo çka deri dje ishte një përshkrim i fazës së jetës së fëmijës, tani është kthyer në akuzë, në gjykim.

Një nënë vendos ta mësojë fëmijë si të tregojë nevojat personale dhe fillon ta çojë atë në banjo në intervale të rregullta. Shpejt shfaqet një shabllon, në të cilin fëmija vrapon tek nëna dhe e çon atë në banjë, vetëm që t'i tregojë asaj se, ai sapo i ka lagur pelenat. Apo, ndoshta, ndodh edhe e kundërta. Ai nuk bën asgjë kur është në tualet, por, sapo del që andej, laget. Ajo thotë me zemërim se, e ka të qartë se ai e kupton atë që pritët prej tij. Prandaj, nëna arrin në përfundimin se ai qëllimisht nuk dëshiron të bindet. Ky është një ngatërrim i njohur, midis të kuptuarit të asaj që pritët, dhe të qenit i aftë për të bërë atë që i kërkohet. Në cilindo prej rasteve, nëna beson se fëmija, qëllimisht, po ia prish planin. Nëse dikush do ta pyeste nënën: "Pse do të ta prishte planin fëmija?" ajo mund të thotë diçka të tillë si: "Atij nuk i pëlqen ta ndërpresë lojën për të shkuar në tualet," apo "Atij i pëlqen të jetë bebe." Apo: "Ai ka frikë nga tualeti." Në dhënien e këtyre shpjegimeve nëna po shpreh ndjenjat e fëmijës, pikëpamjen e tij. Megjithatë, ai nuk e percepton si të tillë, por, si një pengesë të padëshirueshme që duhet të kapërcehet. Duket sikur fëmija është disi i keq që ka frikë nga tualeti, apo se do të qëndrojë ende bebe, apo se nuk i pëlqen t'ia ndërpresin lojën. Nëse dikush

do ta shqyrtonte më tej se çfarë nuk shkon me fëmijën që i ka këto ndjenja, ato që dalin në pah janë vetëm ndjenjat femino-re të nënës ato që janë të papranueshme dhe të këqija. Kjo do të thotë të mos bësh atë që thotë nëna.

T'i kthehem studimit të faktit se, pse nëna ndjen sikur fëmija po e sfidon atë. Shumë nëna do të na rrëfejnë ca sekrete për të cilat ndihen fajto-re. Për shembull, një nënë tha: "Kur ai ishte 9 muajsh unë e mbaja në tualet për dy orë rresht, me shpresën se do ta mësoja. Tani e kuptoj se e kisha gabim, dhe mendoj se ai nuk më ka falur që ia bëra këtë." Ajo e interpretonte sjelljen e fëmijës si një shprehje inati kundrejt së ëmës për gabimin e saj të mëparshëm. Edhe një nënë rrëfeu se vendimi i saj për ta mësuar fëmijën në tualet, koiçidoi me planin e saj për të bërë një udhëtim të afërt dhe, për këtë arsye, ajo e shihte sjelljen e fëmijës si hakmarrje kundër saj për presionin që i kishte ushtruar. Këto interpretime mund të kenë qenë të drejta, por, për faktin se nënat i përjetonin ato si akuza, e jo si deklarata të qarta të fëmijëve, faji që ngjallej sillte metoda të paefektshme të përballjes me situatën.

Çdo hap i zhvillimit shpalos një problem të mësuarit për fëmijën: Ushqyerja, veshja, larja e dhëmbëve, të gjitha këto janë aftësi që duhet të zotërohen. **Si në çdo lloj të mësuarit, do të ketë, si suksese, ashtu edhe dështime. Megjithatë, shumë nëna i shohin sukseset si një masë të aftësisë së fëmijës, ndërsa dështimet i perceptojnë si mosbindje.** Ndërmarrja e hapave të zhvillimit kërkon zotërimin e ndjenjave, po ashtu, edhe të aftësive. Kundërpesha për shtytjen drejt pavarësisë është tërheqje prapa drejt varësisë. Fëmija e shpreh këtë shtytje dhe tërheqje, duke lëvizur përpara dhe prapa në gadishmërinë e tij për të përmbushur pritshmëritë e nënës. Një ditë, ai mund të duket plotësisht gati për t'u veshur vetë, për të ngrënë vetë dhe për të luajtur vetë, gjatë kohës kur nëna bën punët e saj. Ditën tjetër, nënës mund t'i duket sikur mban sërish një foshnjë në duar. Rreth këtyre luhatjeve të sjelljes zhvillohet konflikti, kur pikëpamja

e personalizuar e nënës e bën atë ta shohë sjelljen e fëmijës si të drejtuar kundër saj, më shumë se sa një shprehje që flet për vetë fëmijën. Sjelljet regresive të fëmijës i duken si sjellje të këqija dhe nëna tërhiqet në një situatë përballjeje me të. Problemi më i thellë është se, nevojat e varësisë së fëmijëve që ishin të pranueshme, të mos themi krejtësisht të tolerueshme, tashmë fillojnë të ndihen si të rrezikshme dhe shqetësuese për nënën, e cila sapo ka vendosur që fëmija nuk duhet t'i ketë më. Sapo fëmija të ketë shfaqur kapacitetin për sjellje të pavarur në ndonjë fushë, rrëshkitjet e tij në sjellje të varur, ndonëse edhe të përkohshme, e bëjnë nënën të ndjejë se po shfrytëzohet. Në këtë pikë, nga ana e saj bëhet një gjykim, se varësia është e keqe. Nëse më parë, nëna ia jepte të drejtën atij që të kishte nevojë për të, në të vërtetë ajo ia merr këtë të drejtë fëmijës, dhe ia jep vetes të drejtën që të mos ia kushtojë fëmijës më atë kujdes. Varësia e fëmijës është e keqe, sepse prish lirinë e sapo fituar të nënës. Ajo ka frikë se, nëse e pranon sjelljen e varur në këtë pikë, do të pushtohet edhe një herë nga nevojat e fëmijës.

Nevojat e varësisë janë të kundërshtueshme kur shprehen si urdhëra. Nëna, e cila për një kohë të gjatë nuk kishte zgjidhje tjetër, pos të pajtohej me kërkesat e fëmijës, qartas kthehet në zemërake kur i duket se nuk është më e nevojshme për ta përmbushur këtë rol. Fëmija fillon të duket si i parespektueshëm, sepse vazhdon të kërkojë diçka për të cilën nuk ka më nevojë. Por, ai sigurisht që **ka nevojë** për të, por, ndonjëherë. Për nënën është e mundur ta pranojë këtë nevojë por, pa u kapur në grackë përgjithmonë. Është e mundur për fëmijën të lerë sjelljen e varësisë por, pa lënë dëshirën për të qenë i varur. E as arritja e pavarësisë nuk varet nga dënimi i plotë i ndjenjave të varësisë.

Qëllimi i nxitjes së zhvillimit të fëmijës drejt pavarësisë, përfshin më tepër se sa të mësuarit e fëmijës të pijë me gotë, apo të vishet vetë. Qëllimi është të ushqejmë zhvillimin e autonomisë, kapacitetin për një të menduar të pavarur, për zgjidhjen e

problemeve, për zhvillimin e cilësive unike të një personaliteti individual. Në punën drejt arritjes së këtij qëllimi, problemi për nënën është se, sa më shumë që fëmija zhvillon mendjen dhe vullnetin e tij, aq më e madhe është mundësia për konflikt. Dëshira e flaktë e fëmijës për t'i bërë gjërat vetë dhe idetë e tij për gjërat që kërkon të provojë zakonisht i paraprijnë aftësive të tij. Periudha gjatë së cilës, aftësia e fëmijës për të bërë diçka vetë, i qepet pas dëshirës së tij për ta kryer atë, mund të jetë një periudhë shumë e lodhshme për nënën. Ai përpiqet t'i veshë këpucët në këmbë të kundërta. Po ashtu, vesh me zell këmishën e tij mbrapsht. Në hutim e sipër, përmbyt dyshtemenë e tualetit duke larë duart dhe fytyrën. Të gjitha këto marrin trefishin e kohës që merrnin më parë dhe shoqërohen me një qëndresë të madhe nga ana e tij për të mos u ndihmuar nga nëna. Ajo fillon të ndjejë sikur përkujdesja fizike e kërkuar më parë nga varësia e tij e plotë ishte në të vërtetë më e lehtë se sa këto përpjekje drejt pavarësisë. Është sigurisht më e shpejtë dhe shpesh më e lehtë për nënën, t'i bëjë këto gjëra vetë, se sa të presë gjatë kohës që i duhet fëmijës dhe të ndreqë rrëmujën që bën ai, ndërsa është duke mësuar t'i bëjë vetë.

Çdo hap në zhvillimin e fëmijës përfshin një periudhë pune shtesë dhe stresi për nënën. Fëmija mund ta heqë shishen me qumësht të darkës duke e zëvendësuar atë me fjalët: "Mami, më jep një shishe ujë," apo me njëqind variacione të kësaj të fundit. Fëmija mund të jetë gati për t'i hequr pelenat, por nëna nuk është gati për pellgjet, që sigurisht do shfaqen në autobus, në rrugën për te gjyshja, apo për lajmërimin: "Unë kam bërë çizin" në mes të një autostrade, ku nuk duket asnjë stacion karburanti. Në këto faza dhe të tjera si këto, është joshje e madhe për nënën të bëjë atë që i duket më e lehtë për momentin. Është më e lehtë t'i japësh fëmijës shishen, se sa të bësh njëzet xhiro në dhomën e gjumit për t'i dhënë mbështetjen emocionale që

do ta ndihmojë fëmijën të braktisë burimin e mëhershëm të plotësimit. Është më e lehtë të ndërrosh pelena se sa një deng me rroba. Është më e lehtë ta veshësh fëmijën, se sa t'i japësh kohë sa të vishet vetë. **Por, gjërat nuk janë ashtu siç duken. Në fund nëna do të inatoset nga fakti se fëmija nuk i ka përvetësuar aftësitë e nevojshme që priten prej tij.** Ajo do ta gjejë veten drejt masave dhunuese që çojnë drejt përballjes dhe mundjes. Varësia e fëmijës i lejon nënës një mundësi më të madhe për kontroll të situatës – ndërsa ajo çka dëshiron me të vërtetë, është sjellja e pavarur.

Përcaktimi i pritshmërive të duhura në fazat e ndryshme të zhvillimit është një nga fushat më të vështira të edukimit të fëmijës. **Ta udhëheqësh me sukses një fëmijë drejt sjelljes së pavarur kërkon që nevojat e nënës dhe ato të fëmijës të mbahen në ekuilibër.** Ngjan pak me kolovitjen në lisharse. Nëse do të marrë peshë të madhe, qoftë plotësimi i fëmijës, qoftë rehati i nënës, ajo anë e mban lisharësen në tokë dhe ndërpritet lëkundja. **Çdo nënë duhet të gjejë pikën e ekuilibrit me fëmijën e saj. Kjo përfshin, jo vetëm përpjekje të madhe, por edhe aftësinë për të toleruar pasigurinë.** Nëse ajo përpiqet të marrë vendime të bazuara, si në nevojat e fëmijës, ashtu edhe në të vetat, nuk do të ketë këshilla fikse apo manuale, sepse ajo dhe fëmija i saj janë të ndryshëm nga çdo nënë dhe fëmijë tjetër. Një qasje e tillë do të thotë që vetë nëna të jetë e aftë të funksionojë në mënyrë të pavarur. Është ndonjëherë e sikletshme të marrësh këtë lloj përgjegjësie për vendimmarrje, por, nënat kërkojnë rehatin e varësisë tek figurat e autoritetshme, të cilët do t'u tregojnë me siguri atyre se kur duhet të mësohet fëmija për në tualet, kur duhet të vishet dhe si duhet të sillet në faza të ndryshme të zhvillimit. **Problemi është se metodat autoritare nuk krijojnë liri; përkundrazi, ato e përforcojnë varësinë.**

Pavarësi nuk do të thotë thjesht aftësi për të bërë diçka, por edhe aftësi për të vendosur për atë që do të bësh. Nuk është vetëm aftësia për t'u kujdesur për veten, por, është gjithashtu edhe aftësia për të marrë përgjegjësi për veten. Autonomia dhe pavarësia nuk burojnë nga të thënit se çfarë të bësh dhe kur ta bësh. Vetëm duke iu respektuar nevojat dhe duke u bërë pjesëmarrës në procesin e vendimmarrjes, fëmija zhvillon kapacitetin për autonomi. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për nënën.

KAPITULLI 8

Mediumi dhe mesazhi: Sjellja dhe kuptimi i saj

Komunikimi i suksesshëm është çelësi për marrëdhënie të suksesshme njerëzore. Nëse duam që të na plotësohen nevojat dhe të na respektohen dëshirat nga të tjerët, dhe nëse përpiqemi t'ua kthejmë atyre me të njëjtën monedhë, atëherë, së pari, këto nevoja dhe dëshira duhet të bëhen të ditura. Kjo do të thotë se ne duhet të jemi të aftë t'i shprehim nevojat dhe dëshirat tona. Por, ne duhet të jemi të aftë gjithashtu edhe të dëgjojmë dhe të kuptojmë nevojat dhe dëshirat e shprehura nga të tjerët.

Të mësuarit për të shprehur nevojat dhe ndjenjat si duhet me fjalë, është një nga detyrat kryesore të pjekurisë, të cilën shumë prej nesh nuk e kanë përvetësuar ende. Përkundrazi, ne shpesh mbështetemi te komunikimi sjellor joverbal, në më të shumtën e mesazheve emocionale, së bashku me përdorimin e fjalëve, të cilat e shfytyrojnë, apo i japin kuptim të kundërt nga ai që duam të shprehim. Fjalët tona mund të shqiptojnë: “O, shkëlqyeshëm fare,” ndërsa shprehja e fytyrës dhe toni i zërit e bëjnë të qartë se nuk është asgjë në rregull. Ose ne mund të bërtasim: “Ti po më çmend,” ndërsa ajo që duam të përçojmë është: “Do të doja të ndaloje.” Ndonjëherë, ne mund të mos shqiptojmë asgjë, ndërsa në heshtje lënduese besojmë se dikush po na e lexon mendjen.

Në përgjigjen ndaj të tjerëve ne sillemi sipas mesazheve që marrim, shpesh, edhe pa e ditur se a ishin me të vërtetë ato që u dërguan. Ajo që dëgjojmë, nuk është shpesh ajo që u tha. Realiteti ynë emocional mund ta transformojë mesazhin në diçka të synuar, apo mesazhi mund të dërgohet në një formë të shtrembëruar. Sido

TË JESH NËNË

që të jetë, ne marrim informacion, e interpretojmë atë, dhe më pas përgjigjemi në bazë të interpretimit tonë. Nëse për çfarëdo lloj arsyeje, interpretimet tona janë të gabuara, përgjigjet që dalin prej tyre, do të jenë gjithashtu të pasakta. Në fakt, ato nuk do të jenë fare përgjigje, por benzinë për zjarrin e keqkuptimit. Në këtë mënyrë, njerëzit në marrëdhëniet e tyre, jo vetëm që nuk i plotësojnë dot nevojat, por shpesh ndihen të keqkuptuar.

Në fëmijëri, sjellja mbetet për një kohë të gjatë mjeti i parë i komunikimit. Gjatë foshnjërisë, nënat mbështeten tek tingujt që nxjerr bebja, gjestet, lëvizjet trupore dhe shprehjet e fytyrës për çelësat që tregojnë rehatin apo paretin e tij. Ndonëse, ky varg shprehjesh është i kufizuar, është i kufizuar edhe vargu i nevojave dhe dëshirave. Qysh në fillim, nëna fillon të interpretojë të qarat e fëmijës dhe gjestet e tij, për të arritur në përfundimin se çdo të thonë ato. Edhe sjellja e saj ndikohet nga këto interpretime. Nëse foshnja qan, nëna kontrollon mundësitë: A është i uritur? A është i lagur? Nëse duket i shqetësuar, a mos ka vapë, mos ka të ftohtë, mos ka dhimbje barku? Nëna i ofron ushqim dhe rehat, varet se çfarë mendon ajo se ç'mund të jetë problemi. Ndonjëherë ajo mund t'ia qëllojë në shenjë, ndërsa herë të tjera është një proces provash dhe gabimesh. Pastaj, ka herë të tjera ku asnjë nga përgjigjet e nënës nuk e zgjidh problemin. Kur ndodh kjo, nënat thonë se fëmija po qan “pa asnjë arsye, kot.” Ajo që duan të thonë ato është se, nuk mund ta përcaktojnë dot arsyen. Vargu i kufizuar i shprehjeve të foshnjës ia pengon nënës komunikimin e qartë. Nënashpesh ndihen në ankth dhe të shqetësuar, sepse nuk mundin të ndihen të suksesshme në përgjigjen ndaj nevojave të foshnjës. Kështu, një marrëdhënie e suksesshme gjatë periudhës së foshnjërisë, varet nga aftësia e nënës për të interpretuar drejt një varg të kufizuar komunikimi joverbal të fëmijës.

Gjatë rritjes së fëmijës, idetë, nevojat, ndjenjat, dhe dëshirat e tij bëhen më të ndërlikuara, dhe, me zhvillimin e të folurit, rritet

gjithashtu edhe aftësia për t'u shprehur. Sidoqoftë, nëna kërkohet të interpretojë më shumë sjelljen e fëmijës dhe përpjekjet fillestare për të folur. Është mençuri e natyrshme që një nënë të kuptojë se çfarë dëshiron fëmija, edhe atëherë kur askush tjetër nuk mundet. Kjo, sepse bashkëbisedimi i tyre i vazhdueshëm i ka mësuar nënës të kuptojë gjuhën e sjelljes së fëmijës. Ai e tërheq nënën nga mënga duke e çuar atje ku do ai. Ai bën me shenja dhe tregon me gisht derisa ajo ta përcaktojë sendin që kërkon ai. Nëna, zakonisht, nuk sjell vetëm sendin që kërkon fëmija, por, edhe gjuhën apo emrin që e përcakton atë dhe e ndihmon atë që të jetë më i suksesshëm për ta marrë atë tjetër herë. Fëmija mëson jo vetëm fjalët, por edhe faktin që fjalët e ndihmojnë të plotësojë nevojat.

Gadishmëria e nënës dhe aftësia e saj për të interpretuar sjelljen e fëmijës luajnë një rol të rëndësishëm në aftësimin e tij për të zhvilluar mjete më të ndërlikuara shprehjeje. Në këtë mënyrë nuk zhvillohet vetëm gjuha, por gjithashtu edhe konceptet të cilat i japin një kornizë reference përvojës që do të vijë. Fëmijët reagojnë ndaj ngjarjeve dhe shprehen me anë të sjelljes. Por, ata vetë zakonisht nuk e kanë të qartë se çfarë tregon sjellja e tyre. Ata reagojnë në bazë të impulseve të çastit, duke iu përgjigjur ndjenjave të kënaqësisë dhe pakënaqësisë, frustrimit apo plotësimit. Për shembull, një fëmijë i vogël nuk e ka të qartë se po përjeton një ndjenjë të quajtur inat, se ai ndihet i inatosur ngaqë iu ndërpre, apo iu mohua diçka e këndshme. Ai nuk është i vetëdijshëm se në goditjen ndaj dikujt, në nguljen e këmbëve në dysheme, apo në qarit, ai po shpreh ndjenja inati. Ai ende nuk e di se një send interesant, që po e tërheq shumë është lodra e një fëmije tjetër, se rrëmbimi i këtij sendi është më shumë sesa të zgjatesh për të marrë diçka që do, dhe ka të ngjarë të përfundojë me pasoja të pakëndshme. Një fëmijë i vogël ende nuk e di çfarë po ndjen, pse po ndjehet ashtu, apo çfarë të bëjë në lidhje me atë që ndjen. **Nëna, në sajë të aftësisë së saj për ta interpretuar sjelljen e fëmijës, dhe më pas për të komunikuar**

këtë të kuptuar ndaj tij, i qartëson se ç'do të thotë të jetosh në këtë botë. Fëmija mëson jo vetëm fjalët, me të cilat mund të shprehet, por, edhe atë që po përpiket të shprehë.

Sjellja e fëmijës është një deklaratë për atë që dëshiron, apo për atë që ndjen ai. Nëse nëna e kupton këtë deklaratë, ajo mund të ketë sukses në plotësimin e nevojave të tij, apo në komunikimin se ajo i kupton ndjenjat e tij. **Ajo është e aftë t'i përçojë fëmijës se po i përkrah dëshirat e tij, edhe atëherë kur nuk është e mundur t'i plotësojë ato. Ndjenja e të qenit i kuptuar përbën një mbështetje emocionale dhe i mundëson fëmijës të tolerojë mohimin e plotësimit konkret të një dëshire që ai po kërkon.** Aftësia e nënës për të kuptuar sjelljen e fëmijës është ajo që i bën të mundur asaj për t'u përgjigjur në mënyra, të cilat kanë një ndikim pozitiv tek ai dhe kjo, patjetër, do ta bëjë atë të ndihet e suksesshme si nënë.

Sigurisht, nëse të qarat e fëmijës kanë një numër të kufizuar kuptimesh, bëhet gjithnjë e më e vështirë interpretimi i sjelljeve gjithnjë e më të ndërlikuara. Ajo që e ndërlikon problemin janë mënyrat karakteristike me të cilat shprehen fëmijët, të cilat, në fëmijëri, kanë kuptim krejt ndryshe, krahasuar me jetën e të rriturit. Për fëmijët është e zakonshme të shprehen me anë të sjelljeve të papranueshme, gjatë kohës kur mësojnë mënyra më të pranueshme dhe më frytdhënëse komunikimi. Ata bëjnë pyetje, shqiptojnë fjali dhe i shkarkojnë ndjenjat nëpërmjet veprimeve, më shumë se nëpërmjet fjalëve. Fëmija mund ta hapë diçka për ta parë se si është nga brenda. Ai mund të shtyjë një fëmijë tjetër si një mënyrë për të qenë i shoqërueshëm. Ai mund ta flakë lodrën e tij, sepse nuk e ve dot në punë. Nëna, ka të ngjarë, të ketë pasur të njëjtat përvoja si këto në fëmijërinë e saj, në të cilat një sjellje e tillë gjykohej e mirë, ose e keqe, pa iu referuar fare kuptimit të saj. Thyerjet, të shtyrat, flakjet janë thjesht gjëra "të këqija." **Sjellja që sinjalizon nevojën e fëmijës për ndihmë, apo vëmendje duket si një provokim i qëllimshëm ndaj nënës.** Për nënën, është më e lehtë t'i japë kuptim sjelljes së

fëmijës që vjen nga përvoja e saj, se sa nga përvoja e vetë fëmijës. Ashtu si fëmija që është i paafte të shprehë atë që ka për qëllim, ajo që dëgjon nëna mund të mos jetë ajo që thotë fëmija.

S'ka rëndësi nëse jemi të vetëdijshëm apo jo, ne jemi gjithmonë duke interpretuar sjelljen, edhe atëherë kur kuptimi që nxjerrim mund të mos jetë i drejtë. Nëse një mikesha jonë mund të sillet vrazhdë papritur, ne mund të mendojmë: "Vras mendjen, mos është e mërzhitur me mua për ndonjë arsye?" ose "Dua të di, mos vallë nuk ndihet mirë" ose, "Mos është zënë me dikë," ose të tjera si këto. Puna është se nuk e marrim me mend se sjellja mbart kuptim dhe përgjigjet tona individuale ndikohen prej interpretimeve që bëjmë. Nëse mendoj se, shoqja ime është zemëruar me mua për diçka që mund t'i kem bërë, përpikem ta gjej çfarë i kam bërë që e kam shqetësuar. Nga ana tjetër, unë mund të dal në përfundimin se, nuk i kam bërë asgjë që do ta mërziste, dhe pastaj mërzitem vetë me atë që ndihet si sjellje e papërshtatshme prej saj. Po ashtu, nëse mendoj se problemin e ka me veten apo jetën e saj, unë mund të interesohem për këtë dhe të shpreh shqetësim, ose, nga ana tjetër, unë mund të inatosem për faktin që, ndjenjat që duhej t'i drejtoheshin dikujt tjetër, tashmë po më drejtohen mua.

Ne kemi prirjen ta interpretojmë sjelljen, ose si një përgjigje ndaj diçkaje që *ne* mund të kemi bërë, ose ta shohim atë sikur vjen nga personaliteti apo situata e jetësore e dikujt tjetër. Varet se cilin interpretim bëjmë, mund të përgjigjemi me përkrahje ose jo, me shqetësim apo me inat, me kujdes apo me moskokëçarje. Është e qartë se, nëse interpretimet tona janë të gabuara, ne nuk po i përgjigjemi fare personit tjetër, por perceptimeve tona për të. Ne po reagojmë në sajë të sensit tonë të realitetit, më shumë sesa po i përgjigjemi realitetit të personit tjetër. Në të vërtetë ne po flasim me vete, ndërsa mendojmë se po i drejtohem dikujt tjetër. Prej këtyre dështimeve të komunikimit, vijnë keqkuptimet që shkaktojnë prishjen e marrëdhënieve. Është e qartë se, që të funksionojë një

marrëdhënie në mënyrë të frytshme, duhet që ne t'i kontrollojmë perceptimet tona ndaj realitetit të tjetrit. Para se të përgjigjemi, ne duhet të verifikojmë mënyrën si po i përgjigjemi. Apo, nëse po i përgjigjemi dhe përgjigja jonë po i prish marrëdhëniet, duhet të shohim mundësinë se supozimet që kemi formuluar mund të mos kenë qenë të drejta.

I njëjti proces ndodh edhe në marrëdhënien nënë – fëmijë. Nënata i interpretojnë sjelljet e fëmijëve, edhe atëherë kur ato nuk janë të vetëdijshme se po veprojnë kështu, dhe përgjigjet e tyre ndikohen nga interpretimet që bëjnë. Nëse fëmija përjeton një krizë inati, nëna mund të vendosë ta përcaktojë këtë me kuptimin se ai është i lodhur dhe ka nevojë për gjumë, apo mund ta shohë si kundërshtimin e tij për diçka që dëshironte e nuk iu dha. Varet se çfarë mendon ajo se cila mund të jetë arsyeja, mund të përgjigjet me përkrahje ose me inat, duke u përpjekur ta përmirësojë situatën, apo duke mos çarë kokën për të. Ata që shpesh e bëjnë këtë proces të vështirë për nënën janë një shumëllojshmëri faktorësh që pengojnë aftësinë e saj për të bërë interpretime të sakta dhe aftësinë e saj për t'u sjellë sipas tyre, edhe atëherë kur ajo i ka bërë ato.

Sjellja që keqinterpretohet, apo keqkuptohet më shpesh është sjellja shqetësuese, apo bezdisëse për nënën. Është sjellja që ose ia bën jetën të vështirë, ose ngjall ankth tek ajo për mirëqenien e fëmijës. Në pjesën më të madhe kjo sjellje e bën atë të besojë se, ose fëmija i saj është "i keq," ose me të diçka nuk shkon. Konkluzione të tilla kanë prirjen të ndërpresin komunikimin e suksesshëm mes nënës dhe fëmijës, sepse ato janë gjykime emocionale dhe e pengojnë nënën nga të kuptuarit e sjelljes si një deklaratë joverbale bërë nga fëmija. Me fjalë të tjera, ndjenjat e zgjuara tek ajo nga sjellja e bëjnë që ajo të imponojë një kuptim të përgjithësuar se sa të gjejë kuptimin që ka patur synim fëmija.

Gjykimet konvencionale të bëra për sjelljen e fëmijëve luajnë një rol të madh në ngatërrimin e nënave në përgjigjet ndaj tyre.

Fëmijët shpesh shprehin vetveten nëpërmjet sjelljeve që duken të pakëndshme, apo të padëshirueshme nga pikëpamja e një të rrituri, megjithatë, kjo nuk na pengon ne gjithmonë që të dëgjojmë mesazhin që fshihet përtej tyre. Nëse një fëmijë bërtet kur një tjetër ia rrëmben lodrën, apo shtyn një fëmijë tjetër që po ia prish lojën, zakonisht, është e qartë se sjellja e tij është kundërshtim, një shprehje pakënaqësie, apo mërzie për atë që i ka ndodhur. Nëse i njëjti fëmijë ia merr lodrën dikujt tjetër, apo ia ndërpret lojën, ne nuk e dëgjojmë këtë mesazh, ne shohim vetëm sjelljen e keqe. Ne nuk e dëgjojmë fëmijën tek thotë: “Unë do të doja ta kisha atë lodër,” apo “Unë do të doja të luaja me ty.” Forma me të cilën bëhet kjo deklaratë, na pengon ne nga dëgjimi i vetë deklaratës. Pjesërisht, ajo që shpie në gjykimin se sjellja është e keqe është një gjykim i mëparshëm për justifikimin. Të bërtiturit apo të shtyrit për të mbrojtur veten janë të justifikueshme. Sidoqoftë, si një mënyrë për të thënë se çfarë kërkon dikush, të bërtiturit, apo të shtyrit nuk janë të justifikueshme prandaj, dhe janë sjellje të këqija. Për shkak të këtyre gjyimeve mbi sjelljen, ne bëhemi të paaftë t’i referohemi kuptimit më të thellë që ajo shpreh.

Të njëjtat interpretime të ngulitura bëhen edhe për llojet e tjera të sjelljeve. Nëse fëmija, lodra e të cilit u rrëmbye, nuk bërtet, por, përkundrazi tërhiqet në një qoshe, apo nuk do të shkojë më në këndin e lodrave, nëna e tij fillon të ndjejë se diçka nuk shkon me të. **Ka** diçka që nuk shkon, por jo në kuptimin e përgjithshëm për të cilin frikësohet nëna. Sjellja e fëmijës thjesht mund të jetë mënyra për t’i treguar asaj se ai ka nevojë për pak ndihmë, gjatë të mësuarit si ta mbrojë veten në këndin e lodrave. Nëse nëna do të jetë e aftë ta dëgjojë këtë mesazh, ai i jep asaj informacionin për të cilin ka nevojë, me qëllim që të japë një përgjigje të dobishme. Tani ka diçka konkrete që ajo mund të bëjë për situatën. Por, nëse ankthi i saj për sjelljen e pengon të lexojë kuptimin e saj, ajo mund të duket si shenjë e një shqetësimi të panjohur, dhe kjo e bën nënën të ndihet e pafuqishme për të bërë diçka për të.

Është e vështirë të dëgjosh mesazhet që jepen në mënyrë negative. Dikush që bërtet, apo ulërin, jo vetëm që është i vështirë për t’u dëgjuar, por, edhe frenon dëshirën për ta dëgjuar. Meqenëse fëmijët shpesh komunikojnë në mënyra që duken si sjellje e keqe, apo shenja çrregullimi, mesazhet e tyre shpesh tingëllojnë negative dhe, si pasojë, zgjojnë ndjenja negative. Forma negative që merr mesazhi e bën vetë mesazhin të papranueshëm. Një sjellje e njohur për nënat është nevoja urgjente e fëmijës për vëmendje, kur ajo është duke folur në telefon, apo zhurma që vjen nga dhoma ngjitur tek dëgjohet diçka që thyhet, teksa ai po përpiquej ta merrte nga rafti i lartë. Kur fëmija i ndërpret nënës bisedën në telefon ai mund të jetë duke thënë dy gjëra njëherësh: “Mua nuk më pëlqen kur ti flet në telefon,” dhe “Do të doja të më kushtojë pak vëmendje.” Ky mesazh ka një anë pozitive dhe një tjetër negative. Ana negative është inati i fëmijës, sepse iu mohua vëmendja e nënës; ana pozitive është kërkesa e tij që ajo t’i kushtojë vëmendjen për të cilën ka nevojë. Ai, njëkohësisht, po bën një kërkesë dhe po shpreh një ndjenjë, por cilësia negative e ndjenjës i jep formë kërkesës me të cilën ajo bëhet. Nëna mund të jetë gati t’i kushtojë pak vëmendje fëmijës, por, megjithatë, asaj nuk i pëlqen kur e ndërpresin në telefon. Vëmendja e saj i kushtohet sjelljes, më tepër se sa mesazhit, sepse sjellja e ka bërë mesazhin të papranueshëm. Sjellja e pakëndshme e fëmijës nxjerr një përgjigje të pakëndshme nga nëna.

Nëse fëmija do ta shprehte të njëjtin mesazh – si ndjenjën ashtu edhe kërkesën – me fjalë, do të ishte shumë më e lehtë për nënën që t’i përgjigjej në mënyrë më të frytshme. Por, kjo është pikërisht ajo që ai është i paaftë ta bëjë dhe ka nevojë për ndihmë që ta mësojë. Ai nuk ka mundësi ta ndajë atë që do dhe ndien, nga ajo që po bën për ta arritur. Nëna vetë ka nevojë të mësojë si të dallojë mes mediumit (mjetit të transmetimit) dhe mesazhit. Mesazhi është përmbajtja, të cilën po përpiquej ta shprehë fëmija. Mediumi është sjellja, mënyra e vetme që ka në dorë ai për të shprehur atë që dëshiron. Kur nëna

është e aftë ta bëjë këtë dallim, ajo mund të kryejë shumë gjëra njëherësh. Ajo aftësohet në përgjigjen ndaj këtij mesazhi për t'ia bërë atij të ditur se sjellja nuk është e pranueshme dhe i mëson atij një mënyrë më të efektshme për të transmetuar mesazhin herës tjetër. Nëse ajo i përgjigjet vetëm mesazhit, fëmija merr idenë se dëshirat e tij janë kaq mbizotëruese, sa mënyra e të kërkuarit të tyre është e parëndësishme. Por, nëse nëna përqendrohet vetëm te papranueshmëria e sjelljes, fëmija ndoshta do arrijë të besojë se ajo që do dhe ndjen ai është e papranueshme. Vetëm duke bërë dallimin midis mediumit dhe mesazhit, dhe duke iu drejtuar të dyve, nëna mund ta ndihmojë fëmijën të mësojë se dëshirat dhe ndjenjat e tij janë të pranueshme, por jo sjellja. Besimi se, mesazhi i tij do të pranohet, e ndihmon atë të mësojë një mënyrë më të mirë të transmetimit të tij. Ai mëson ta shprehë vetveten me anë të fjalëve, në vend të veprimeve.

Sigurisht, edhe atëherë kur nëna e kupton mesazhin, ajo mund të mos e pëlqejë. E vështirë për ta thënë, por, fëmijët kurrë nuk duken se mund të heqin dorë nga kërkimi i vëmendjes, kur nënat e tyre flasin në telefon, dhe, ndonëse nënave iu duhet ta shkurtojnë bisedën kur fëmijët janë ende të vegjël, ato nuk do të heqin dorë asnjëherë nga ky burim kënaqësie. Ky mbetet një konflikt për t'u marrë vesh deri sa të rriten fëmijët dhe nënat t'iu kërkojnë atyre të largohen nga telefoni!

Shpesh, vetë mesazhi është i papranueshëm. Nënave, mesazhet e fëmijëve, iu duken të vështira për t'i dëgjuar, kur ato duken po aq të pakëndshme sa edhe sjellja. Fëmija mund të thotë diçka që nëna veçanërisht nuk do ta dëgjojë. Një nënë më tregoi se, pasi kishte bërë gati të gjitha valixhet për një fundjavë për ski me familjen, ajo zbuloi se djali i vogël i kishte vendosur gjithë rrobat sërish nëpër sirtarë. Në fillim, sjellja e tij iu duk fare e palogjikshme dhe nëna u zemërua shumë. Megjithatë, pasi reflektoi, ajo e kuptoi mesazhin, vetëm se nuk e pëlqeu. Ajo e dinte se fundjava si këto kishin qenë të

vështira për fëmijën për shumë arsye, dhe ai po shprehte dëshirën e tij që të qëndronin në shtëpi. Forca e ndjenjave të tij e bëri nënën të mendojë se ajo duhej të mendonte një aktivitet tjetër që ishte shumë i rëndësishëm për të. Kështu që, në një farë mënyre, ajo do të kishte preferuar të mos e dëgjonte fare mesazhin.

Me qëllim që të studiojmë sjelljen e fëmijës, si mënyrën e tij të komunikimit dhe të gjejmë kuptimin që do ta ndihmojë nënën të dijë si të përgjigjet, është e domosdoshme që ajo të hyjë në botën e fëmijës dhe ta shohë situatën nga këndvështrimi i tij. Kjo përfshin njohjen se realiteti i fëmijës dhe realiteti i nënës janë dy realitete të ndryshme. Për fëmijën, mënyra më e qartë për të treguar se ai kërkon diçka, është ta marrë atë. Nëna, nga ana tjetër, e sheh këtë si rrëmbimin e diçkaje që nuk i përket atij. Derdhja e qumështit në lavaman mund t'i duket fëmijës mënyra më e mirë për të mos e pirë. Nënës kjo i duket sjellje e keqe. Qëllimi i tij mund të mos ketë qenë të sillte keq, por të gjejë një zgjidhje për problemin në fjalë. Nëse nëna do ta shihte realitetin ashtu siç e sheh fëmija, ajo do ta ketë më të lehtë të bëjë dallimin midis asaj që po bën dhe asaj që ka në mendje ai, pra, midis mediumit dhe mesazhit.

Por, përveç pranimi të dy realiteteve, të sajit dhe të fëmijës, nëna duhet të jetë e aftë të pranojë faktin se, ato që dëshiron dhe për të cilat ka nevojë fëmija mund të jenë të ndryshme nga ato që dëshiron ajo. Sjellja e fëmijës i jep nënës informacion për dëshirat dhe nevojat e tij, të cilin ajo duhet ta dijë, nëse dëshiron t'i respektojë ato. Megjithatë, përdorimi i këtij informacioni, për momentin, mund të sjellë kufizimin e shprehjes së dëshirave dhe nevojave të saj. Kështu, me qëllim që të dëgjojë mesazhin e fëmijës, nëna duhet të tolerojë marrjen e këtij informacioni që është duke i dhënë ai.

Nënat, shpesh, janë shumë të sakta dhe të qarta për kuptimin e sjelljes së fëmijëve, por u mungon vetëbesimi në vërtetësinë e perceptimeve të tyre. Ato nuk arrijnë të dallojnë se, ato vetë e kanë në dorë informacionin për të cilin kanë nevojë në zgjidhjen

e problemit. Atyre i duket se sjellja duhet të ketë ndonjë kuptim të veçantë, të cilin s'mund ta kapin. Ato besojnë se dikush tjetër, i cili e di këtë kuptim, e di edhe përgjigjen e duhur. Por, nuk ka asnjë kuptim të veçantë dhe nuk ka asnjë përgjigje "të duhur." Nëna dhe fëmija kanë bëshkëbisedimin e tyre, i cili buron nga personalitetet e tyre dhe stili i tyre i jetesës. Megjithatë, nëna ka nevojë për ndihmë në lënien mënjane të frikës se fëmija i saj është "i keq," apo se diçka nuk shkon me të. Këto janë ndjenja që ia bëjnë asaj të vështirë për ta gjetur vetë kuptimin. Nëse ajo do t'i tejkalojë këto ndjenja dhe do të mësojë t'iu besojë perceptimeve të saj më të thella, do të marrë informacionin për të cilin ka nevojë për të zhvilluar përgjigjet e saj, përgjigje, të cilat janë kuptimplota, sepse ato i referohen fëmijës së saj dhe jo fëmijës së dikujt tjetër, apo fëmijëve në përgjithësi.

Edhe njerëzit e tjerë, shpesh e keqinterpretojnë sjelljen e nënës, ashtu si nënat keqinterpretojnë sjelljen e fëmijëve të tyre. Ata që janë më të paepshëm në dëshirën që nëna ta kuptojë sjelljen e fëmijës së saj, shpesh nuk bëjnë asnjë përpjekje për ta kuptuar vetë nënën. Të njëjtat gjykime fikse që bëhen për sjelljen e fëmijëve, bëhen edhe për përgjigjet e nënave ndaj kësaj sjelljeje. Kur keqinterpretohet sjellja e një fëmije, ai quhet "i keq" apo "fëmijë me probleme." Përgjigjet e nënës ndaj fëmijës, të cilat ndonjëherë e kanë burimin nga konfuzioni i saj për kuptimin e sjelljes së tij, keqinterpretohen po ashtu, edhe ajo quhet "e keqe," apo "e çoroditur." **Nëse besojmë se fëmijët kanë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u vështuar, na duhet të fillojmë duke dëgjuar nënat. Vetëm kur ato vetë të kuptohen më mirë, do të jenë në gjendje t'i kuptojnë edhe fëmijët.**

KAPITULLI 9

Nëna është mësuese

Sjellja është njësia monetare e marrëdhënieve njerëzore. Me qëllim, apo rastësisht, shpesh veprimet tona ndikojnë tek të tjerët, si edhe veprimet e tyre ndikojnë tek ne. Atëherë, sjellja është një çështje shqetësimi shoqëror.

Dobitë e ndërsjellta të jetës së bashku në shoqëri, kërkojnë që sjellja të rregullohet në një farë mënyre. Forcat e ndryshme që kanë shërbyer për të kontrolluar sjelljen kanë përfshirë të gjithë gjykimin, se cila sjellje duhet të trajtohet e papranueshme, çfarë qëndrim duhet të mbahet ndaj kësaj sjellje dhe cilat janë pasojat që vijnë prej saj. Feja është përpjekur ta rregullojë sjelljen sipas standarteve të moralit. Sjellja gjykohet si e mirë ose e keqe, sipas një force më të lartë morale. Rrjedhojat e sjelljes së keqe janë faj dhe mundësia e ndëshkimit hyjnor.

Ligji, si një forcë për të rregulluar sjelljen, është pjesërisht një sistem rregullash të shkruara, që e gjykon sjelljen si të drejtë, apo të gabuar dhe përcakton një shkallë të qartë dënimesh si mjet për të përforcuar kodet e tij.

Psikiatria përdor normalitetin si standard për sjelljen. Sjellja e papranueshme quhet e sëmurë, ose anormale dhe pasojat e rekomandueshme janë një formë e trajtimit.

Të gjitha këto forca ushtrojnë ndikimin e tyre mbi praktikatat tona të edukimit të fëmijëve dhe mbi qëndrimet tona kundrejt sjelljes së tyre. Ne i përgjigjemi sjelljes së papranueshme të fëmijëve tanë në një mënyrë tjetër, sikur ajo të ishte e keqe; sikur të kishte një defekt në karakter; sikur të ishte kriminale dhe prandaj meriton

ndëshkim; ose sikur ajo tregon keqformim që kërkon ndërhyrjen e një eksperti profesionist. Të gjitha këto qasje kanë efekte anësore të pakëndshme. Faji i tepërt, krijuar nga ndjenja se njeriu është i keq, është provuar se është paralizues. Përpjekjet për të vendosur një sistem ndëshkimesh kanë përhapur vrazhdësi dhunuese, rebelim të provokuar, apo thjesht janë provuar se janë të pafrytshme. Fokusi i psikiatrisë mbi formimin personal ka udhëhequr udhën drejt shqetësimit për kuptimin e sjelljes vetëm në lidhje me individin, duke mos menduar fare përgjegjësinë për pasojat e saj mbi të tjerët dhe, për këtë arsye, në praktikë nuk ka qenë forcë për zhvillimin e sjelljes sociale të përshtatshme.

Në përpjekjen për të zhvilluar llojet e përgjigjeve që do të kenë ndikim pozitiv mbi sjelljen e fëmijëve, ne përballemi me të njëjtat mori pyetjesh: Cila mund të quhet sjellje e papranueshme? Si duhet ta kuptojmë atë? Çfarë mund të bëjmë për të? Në përgjithësi, sjellje e papranueshme është sjellja që cënon të drejtat, nevojat, dhe dëshirat e të tjerëve. Ne kemi arritur të kuptojmë se një sjellje e tillë ka kuptim të ndryshëm gjatë fëmijërisë, krahasuar me jetën e të rriturit. Sjellja e të rriturit në të gjitha fushat: intelektuale, fizike, emocionale dhe sociale, pasqyron produktin përfundimtar të një procesi të gjatë zhvillimi dhe pjekurie. Fëmijët ndodhen vetëm në fillim të këtij procesi të ndërlikuar. Ata ende nuk i kanë përvetësuar aftësitë për ndërveprim të suksesshëm me të tjerët. Ata ende nuk e kanë zhvilluar aftësinë për të kontrolluar impulsset, për të toleruar frustrimin, për të pritur për atë që dëshirojnë. Mjaft prej sjelljes së tyre, që na duket e papranueshme, është thjesht një tregues i papjekurisë së tyre dhe, meqenëse shpresat tona janë se ajo do të ndryshojë, ajo nuk duhet të duket aq e shqetësuese sa tek i rrituri. Megjithatë, pyetja e vërtetë që ne duhet të bëjmë është: Çfarë e bën këtë sjellje të ndryshojë? Çfarë i bën fëmijët t'i braktisin sjelljet e papjekura, dhe të papranueshme dhe, në vend të tyre, të plotësojnë standardet e të rriturve për sjelljen e pranueshme?

Zhvillimi i fëmijës, që kaq shpesh duket se thjesht ndodh spontanisht, është rezultat i një procesi të mësuarit. Rritja e fëmijëve është në thelb edukim. Fëmija duhet të mësojë aftësitë e nevojshme për të jetuar i pavarur dhe sjelljen që do ta ndihmojë atë të bëhet qenie shoqërore. Zakonisht, nëna është mësuesja e parë e fëmijës. Ajo i mëson atij si të pijë lëngje me gotë, si të hajë me lugë e pirun, si të vishet vetë, si të përdorë tualetin. Ajo i mëson atij si të mbledhë lodrat, si t'i ndajë ato me të tjerët, si të mos godasë apo kafshojë dhe si të respektojë të drejtat e të tjerëve. Ajo e ndihmon atë të zhvillojë aftësitë e nevojshme dhe ia mëson atij sjelljen e pranueshme. Por, si ndodh si ky proces shpjegimi dhe të mësuarit?

Nëna, zakonisht, e mëson fëmijën në një shumëllojshmëri mënyrash se çfarë kërkon prej tij. Ajo përdor fjalët, demonstroi, ajo ofron ndihmë fizike. Megjithatë, nëse ajo kërkon të jetë e suksesshme në shpjegimin e saj, duhet të analizojë pritshmëritë e saj me atë çfarë është në gjendje të mësojë fëmija në fushat fizike, emocionale dhe intelektuale. Do të ishte e palogjikshme të përpiqeshim t'i mësonim atij të lidhte këpucët, kur është ende shumë i vogël për të patur koordinimin motorik fin të domosdoshëm, për ta kryer këtë detyrë. Ajo nuk do të dëshironte të përdorte udhëzime gjuhësore të ndërlikuara me një fëmijë, që sapo ka filluar të kuptojë gjuhën. Ajo nuk do të priste nga një parashkollor të qëndronte i vetëm, pa asnjë mbikqyrje. **Pritshmëri të sakta kërkojnë që nëna të dijë në një mënyrë të përgjithshme se çfarë janë të aftë të bëjnë fëmijët në faza të ndryshme të zhvillimit.** Por, ajo që është më e veçantë dhe më e rëndësishme është se, nëna duhet ta njohë mirë fëmijën e saj. Ajo ka nevojë të dijë se ku ndodhet ai në zhvillimin e tij, cila është gadishmëria e tij individuale për të mësuar atë që po përpiqet ajo t'i mësojë. Informacioni që ka nevojë të dijë nëna për modelin e tij të zhvillimit dhe mënyrat e tij të të mësuarit, vjen nga vëzhgimet që bën ajo dhe të kuptuarit e sjelljes së tij ashtu siç shpaloset në bashkëveprimet e panumërta midis tyre që nga çasti i

lindjes. Ajo i mëson gjëra të tilla si, për shembull, për sa kohë mund të përqendrohet fëmija mbi një detyrë të dhënë, për sa ndihmë ka nevojë ai për ta kryer diçka që ka në mendje, sa vetëkontroll ka arritur të mësojë ai, cilat situata janë veçanërisht frustruese për të, etj. Informacioni që ofron fëmija nëpërmjet sjelljes së tij, i mundëson nënës të qartësojë perceptimin e saj dhe të korrigjojë përgjigjet e saj. Kjo është një formë e të mësuarit të ndërsjelltë midis nënës dhe fëmijës. Nëna mëson nga fëmija ato që ka nevojë të dijë, me qëllim që ta ndihmojë më me sukses të mësojë nga ajo.

Ka dy mënyra, me të cilat ndërpritet, ndonjëherë ky proces të mësuarit. Njëra ndodh kur nëna duket e paaftë ta kuptojë sjelljen e fëmijës. Tjetra ndodh nëse fëmija duket i paaftë, apo i pavullnetshëm për t'iu përgjigjur pritshmërive të nënës. Që të dyja këto, shpesh, ndodhin kur fëmija sillet në mënyra të tilla që nuk i pëlqejnë nënës. Fëmija, gjatë rrugës së të mësuarit se si funksionon bota rreth tij dhe si mund të jetojë sa më mirë brenda saj, provon shumë lloje sjelljesh. Kur sjellja e tij zgjon ndjenja të forta te nëna, këto ndjenja mund të shfityrojnë perceptimet e saj për fazën e zhvillimit në të cilën gjendet fëmija. Dëshira e saj që ai të ndryshojë sjelljen, mund të jetë më e fortë se aftësia e tij për të vepruar kështu. **Kur fëmija iu përgjigjet menjëherë korrigjimeve të nënës dhe shfaq lloje sjelljesh që ajo i sheh si të suksesshme, ajo shpesh nuk është e vetëdijshme për shkallën e mësimdhënies së përfshirë. Si rezultat, kur fëmija nuk tregohet aq i përgjegjshëm sa ç'do të donte, apo do t'i pëlqente nënës, ajo nuk e sheh këtë si problem të mësuarit, por si një problem në sjellje. Ajo fillon të ndjejë se diçka nuk shkon me fëmijën. Sjellja e tij duket se tregon, ose një problem në karakter, ose keqformim emocional.** Në cilindo prej rasteve, nëna përqendrohet në "të bërit diçka" për sjelljen. Ajo beson se duhet të ketë teknika të veçanta, të cilat do ta përmirësojnë apo korrigjojnë sjelljen. Nëse ajo mendon se sjellja është shenjë e një problemi emocional, ajo e hedh vështrimin drejt

ekspertit psikolog, për të mësuar këto teknika. Nëse e sheh sjelljen si një shenjë e karakterit të keq të fëmijës, ajo e hedh vështrimin drejt asaj tërësie teknikash, të cilat njihen si disiplinë.

Kërkimi për disiplinë është në realitet një kërkim për metoda që mund të kontrollojnë sjelljen. Disiplina shpesh diskutohet përse i përket të shpjeguarit dhe të mësuarit, por ky është mashtrim. Nënata shprehin ide të tilla, si: "Më duhet t'ia mësoj atij të dallojë të drejtën nga e gabuara." Gjithsesi, nënkuptimi këtu qëndron se, sjellja është e tillë që kërkon një përgjigje ndëshkuese. Duket se, diku brenda nesh, vazhdon të jetojë ende bestytia se, vetëm ndëshkimi mund të na bëjë që të nxjerrim mësim. Çuditërisht, vetëm disa lloje sjelljesh na drejtojnë mendimet drejt disiplinës. Asnjëherë nuk do t'i binte ndër mend një nëne që ta godiste fëmijën, që po mëson të ecë, sa herë që ai të bjerë përtokë, si një mënyrë për t'i mësuar që të mos bjerë më. E as që do ta pengonte ajo të ecte, si një mënyrë për t'i mësuar se rënia është e ndaluar. Po ashtu, asnjëherë nuk do t'i binte ndër mend se janë të domosdoshme masa disiplinore për t'i mësuar fëmijës të veshë këpucën e djathtë në këmbën e djathtë, apo të dallojë të kuqen nga bluja. Ne duket se e kemi ndarë sjelljen e papranueshme në dy kategori: sjellje që do të jetë kalimtare, apo që do të përmirësohet me mësim dhe të mësuar shtesë, dhe sjellje që tregojnë diçka të keqe në personalitetin e fëmijës dhe, si rrjedhim, do të përmirësohet nëpërmjet disiplinës. Sigurisht, disiplina **ka për qëllim** të funksionojë si një formë të mësuarit. Njerëzit thonë gjithmonë, kur shohin sjellje që nuk u pëlqejnë: "Ajo ka nevojë për një mësim të mirë." Ajo që nënkuptojnë ata sigurisht që është se, për atë sjellje, duhet të ketë pasoja të tmerrshme. Ideja është se, fëmijët do të mësojnë se sjellje të caktuara mbartin pasoja shumë të pakëndshme dhe, për këtë arsye, ata do të heqin dorë nga ato lloj sjellje. Konkluzioni duket të jetë se, për disa sjellje mund të përdoren metoda të buta, por, për të tjerat duhet të përdoren metoda të ashpra.

Nëse besojmë se, ajo çfarë ndodh është një proces të mësuarit, pse të besojmë se disa gjëra mund të mësohen në mënyrë ndëshkimore? Pse nuk janë metodat e zakonshme të mësimit të zbatueshme për të gjithë llojet e të mësuarit? Duken se këtu shfaqen dy supozime të nënkuptuara që e çoroditin të kuptuarin tonë: Njëra është ndjenja se disa sjellje janë kaq të rënda dhe kaq potencialisht të rrezikshme sa duhet të konrollohen menjëherë. Nënashpesh ndihen kështu në lidhje me dhunën e fëmijëve. Nëse, për shembull, fëmija kalon një periudhë goditjesh dhe sulmesh ndaj fëmijëve të tjerë, nënat mendojnë se kjo duhet të ndalohet menjëherë. Në mendjet e tyre ato e përfytyrojnë këtë sjellje si ajo e të një të rrituri ngac, apo më keq akoma. Po ashtu, nëse fëmijët marrin gjërat që nuk u përkasin atyre, nënat shohin hajdutërinë, apo kriminalitetin e të rriturit menjëherë pas shpine. Sigurisht që, një sjellje e tillë te fëmijët nuk ka të njëjtin kuptim që do të kishte te një i rritur, por, shumë nënave nuk u është mësuar se si ta shquajnë këtë sjellje si tipike për fazat e zhvillimit.

Fakti që sjellja në dukje antisociale është karakteristike e fazave të zhvillimit të fëmijës, nuk do të thotë në vetvete se sjellja është e pranueshme. Ajo do të thotë se fëmijës duhet t'i përkushtohet më shumë kohë dhe më shumë përpjekje se si t'u afrohet fëmijëve të tjerë, apo si t'i kërkojë gjërat me të cilat do të donte të luante. Kjo sjellje zakonisht nuk është kaq e rëndë, apo e rrezikshme, saqë duhet t'i nënshtrohet kontrollit të menjëhershëm. Por, ajo që i fut në vështirësi nënat është ndjenja e tyre se kjo sjellje mund, dhe duhet të vihet nën kontroll menjëherë.

Ndjenja tjetër që nxit kërkimin e disiplinës përmban në vetvete kontradikta të lindura. Ajo është ndjenja se disa sjellje janë reflektim i një defekti në karakter, një ndjenjë në mbetjet e mëkatit origjinal. Duket sikur një e keqe e trashëguar te fëmija po shfaqet nëpërmjet sjelljes së tij. Një nënë ishte shumë e shqetësuar për djalin e saj 5 vjeçar, i cili gënjente gjatë një loje, vetëm për faktin se donte të

fitonte. Ajo kishte frikë se, nëse nuk gjente një mënyrë për ta ndaluar mashtrimin e tij, kur të rritej ai do të bëhej gënjeshtar, i cili do t'u rrëmbente të tjerëve atë që donte. Për të, sjellja e tij ishte pasqyrim i llojit të njeriut që ishte ai, se sa e fazës së zhvillimit në të cilën gjendej. Një nënë tjetër ishte shumë e shqetësuar për fëmijën e saj, i cili sillte gjëra nga shkolla në shtëpi dhe pretendonte se ia kishin dhënë. Ajo e keqinterpretonte sjelljen e tij dhe, me të kuptonte se ai ishte ai lloj njeriu që rrëmbente gjërat që donte dhe ishte shumë e shqetësuar për pasojat që mund të kishte kjo për të ardhmen. Kontradikta këtu është se, ndonëse, nënat shpesh thonë se ato po kërkojnë një mënyrë për t'i mësuar fëmijët të mos gënjejnë, apo të mos marrin sendet që nuk u përkasin, ato vërtet e ndjejnë se këto janë të meta të karakterit që nuk duan t'ia dinë për të mësuarit dhe të nxënës. Nënashpesh janë në të vërtetë duke pyetur për metodat që do të heqin qafe defektet, dhe, meqenëse gjykimi i bërë për sjelljen është kaq i ashpër, supozohet se edhe ilaçi duhet të jetë po kështu.

Atë që kanë të përbashkët këto qëndrime dhe ndjenja është besimi se disa sjellje duhet të vihen nën kontroll të menjëhershëm, dhe kjo mund të arrihet, vetëm nëse gjenden metodat e duhura disiplinore. Asnjëra nga këto ide nuk është e drejtë. **Lënia e sjelljes së papranueshme nuk varet as nga nëna, as nga fëmija, pasi e kanë vënë atë nën kontroll menjëherë. Përkundrazi, e kundërta është e vërtetë. Çfarëdo lloj forme përvetësimi të diçkaje merr kohën e saj dhe kërkon përsëritje të shumta dhe, kjo nuk është më pak e vërtetë, kur është fjala për përvetësimin e mënyrave të përshtatshme të sjelljes. Përpjekja për të kontrolluar sjelljen nëpërmjet metodave të dhunshme e ndërpret procesin e të mësuarit dhe krijon mosmarrëveshje midis nënës dhe fëmijës.** Fëmija preokupohet gjithnjë e më shumë të përsëritë sjelljen që përpiket t'ia ndalojë nëna dhe, si rezultat, është më pak i aftë të përmbushë atë që pritet prej tij.

Ideja që të mësuarit mund të përshpejtohet, apo të kryhet sakaq, apo se sjellja e papranueshme mund të rregullohet në mënyrë të menjëhershme, nëpërmjet metodave ndëshkuese, apo disiplinore, gjithashtu, nuk duket se funksionon në praktikë. Sjellja e fëmijës është shprehja e zgjidhjes së tij ndaj një problemi. Nëse fëmija dëshiron diçka, zgjidhja e tij është ta marrë atë. Nëse një fëmijë tjetër ia rrëmben lodrën, zgjidhja e tij është ta shtyjë atë përtokë. Nëse ai nuk mund të marrë diçka që dëshiron, zgjidhja e tij mund të jetë të bërtasë për ta marrë. **Përgjigjja ndëshkuese ndaj sjelljes së tij i drejtohet zgjidhjes së fëmijës dhe jo problemit të tij. Ai pengohet të përdorë zgjidhjen e tij, apo i thuhet se zgjidhja e tij është e keqe, dhe nuk i prezantohen aspak zgjidhje alternative. Situata që e shkaktoi sjelljen mbetet e pazgjidhur. Jo vetëm kaq, por, fëmijës i jepet një mesazh i paqartë, rreth të cilit ai mbetet i hutuar. Ai e di se diçka është e keqe, po, është ajo që dëshiron ai, apo ajo që bëri?** A është keq të shtysh dikë përtokë, apo është keq të ndjerit i inatosur kur dikush të merr lodrën? A është keq të rrëmbesh lodrën e tjetrit, apo është keq *ta dëshirosh* lodrën e tij? Përgjigjet ndëshkuese, jo vetëm theksojnë atë që u fillua si sjellje e papranueshme, por, gjithashtu shpesh krijojnë çoroditje për atë që ishte me të vërtetë e papranueshme. Përpyekja për t'i dhënë fund të menjëhershëm ndaj sjelljes, pothuajse gjithmonë ka efekt të kundërt dhe, në vend që fëmija të mësojë mënyra më të dobishme për të përmbushur qëllimet e tij, ai mbetet në nivelin e zgjidhjeve më primitive.

Presioni për të ndaluar, apo për të kontrolluar sjelljen e padëshirueshme, e ka burimin në pjesën më të madhe nga këto gjykime të ashpra që kemi bërë ne. Këto gjykime pengojnë aftësinë e nënës për të mbledhur informacionin për të cilin ajo ka nevojë, me qëllim që të zhvillojë atë lloj përgjigje, që do të ndikojë pozitivisht në sjelljen e fëmijës. Ajo është e paaftë për të zhvilluar një metodë mësimi frytdhënëse, sepse ankthi i ngjallur tek ajo nga sjellja e tij

“e keqe” e errëson faktin se, ai me të cilin po përballlet ajo, është një problem të mësuar. Ajo, jo vetëm që nuk mund të shohë se çfarë është gati të mësojë fëmija, por, për më tepër ajo nuk e ka të qartë se çështje ajo që duhet të përpiket t'i mësojë atij. Nëna nuk e ka parasysh se, ajo që po përpiket të bëjë, është t'i mësojë fëmijës sjelljen sociale. Ajo nuk është në gjendje ta bëjë këtë, sepse nuk është e sigurt se, pse sjellja e tij nuk është e pranueshme. Ajo di vetëm se disa sjellje nuk mund të lejohen, sepse janë “të gabuara, të këqija.”

Pyetja që shtrohet këtu është: A besojmë ne se një sjellje e caktuar është e mëkatshme, apo thjesht e papranueshme, nëse objektivi që duam t'i mësojmë është aftësia për të jetuar në shoqëri? A është fëmija “i keq,” apo është sjellja ajo që është e padëshirueshme, për shkak të pasojave të saj mbi fëmijën, apo mbi të tjerët? **Që të jetë mësuese e suksesshme, nëna duhet të dijë në radhë të parë se çfarë dëshiron t'i mësojë fëmijës, dhe, më pas, duhet të dijë mënyrat më frytdhënëse për t'ia mësuar atë.** Intensiteti emocional, me të cilin vishen gjykimet morale të sjelljes, pashmangshmërisht pengon të mësuarin e vërtetë. Të tilla gjykime çojnë drejt ndalimeve të verbra, ndaj të cilave fëmija mund të pajtohet, ose mund të rebelohet. **Nëna, ose ia del mbanë, ose dështon në imponimin e vullnetit të saj. Fëmija mund të mësojë, ose mund të mos mësojë të nënshtrohet ndaj një autoriteti më të fortë, por, kjo nuk është e njëjta gjë me të mësuarit se si të marrë përgjegjësi për sjelljen e tij.** Nëse objektivi ynë është t'iu mësojmë fëmijëve si të jetojnë sa më mirë në shoqëri, ne mund ta arrijmë atë qëllim më shpejt, jo duke u përpjekur t'i “detyrojmë” fëmijët të braktisin sjelljen fëmimore, **por, duke i pajisur ata me metoda më të kënaqshme për të arritur qëllimet e tyre, si dhe për të zgjidhur problemet e jetës së përditshme.**

Kjo qasje bazohet sigurisht mbi pohimin se sjellja e fëmijës mund të shihet qartë si e kuptimshme brenda kornizës së realitetit të tij. Sjellja e fëmijës është shprehje e diçkaje që dëshiron ai, apo e diçkaje që po përpiket të bëjë, qoftë kjo zgjidhja e një problemi, apo

shprehja e një ideje. Një nënë më tregoi se, kishte mbërritur në kohë në kuzhinë për të shpëtuar peshkun e akuariumit nga tigani. Djali i saj 4 vjeçar i tregoi me krenari se po gatuante peshk për darkë, ashtu siç e kishte parë të ëmën mbrëmjen e shkuar. Një fëmijë tjetër që kishte parë pikturën e qelqtë të burrit prej dëbore të mbushur nga brenda me një pluhur të bardhë, po përpiquej ta ndërtonte vetë atë. E zbrazti gjithë përmbajtjen me pluhurin e bardhë dhe, pasi e pa që nuk bëhej siç kishte shpresuar, u përpoq ta pastronte rrëmujën që kishte bërë me një sfungjer të lagur.

Sjellje të tilla kuptohen lehtësisht si shembuj të punës së mendjes së një fëmije. Jo çdo sjellje është e lehtë për ta deshifruar. Po i njëjti fëmijë, që përpiquej të skuqte peshkun, ua shkulte flokët fëmijëve të tjerë, sa herë që ata qanin. Më në fund u bë e qartë se, ai shqetësohej mjaft kur dëgjonte dikë duke qarë dhe, kështu ua shkulte flokët për t'i bërë të ndalonin së qari. Sigurisht që zgjidhja e tij bënte krejt të kundërtën e asaj që kishte për qëllim dhe ishte me të vërtetë frustruese për nënën e tij. Ajo filloi të ndjente se ai ishte njeri shumë mizor, kur, në të vërtetë, ishte krejt e kundërta. Çështja është se ne kemi ca reagime automatike ndaj sjelljeve të caktuara dhe këto reagime e zbehin fuqinë tonë për të vëzhguar. Është shumë e vështirë për të lënë mënjanë këtë përgjigje emocionale, me qëllim që të kuptojmë funksionin e vërtetë që kryen sjellja për fëmijën.

Ideja për të kuptuarin e sjelljes ka qenë me të vërtetë e ngatërruar. Ne kemi qenë tërësisht të kushtëzuar të ndjejmë se disa sjellje nuk duhet të lejohen dhe përgjigjja jonë ndaj tyre është t'i ndalojmë ato. Nëse dikush do të përpiquej ta zhvendoste fokusin, nga ndalimi i saj drejt të kuptuarit e saj, duket sikur nuk bëhet asgjë në lidhje me sjelljen – ajo është ende atje! Kjo fillon të duket si e njëjta gjë me lejin e saj. Meqenëse, përpjekja për ta ndaluar sjelljen e ka burimin nga dënimi i saj, mospërpjekja për ta ndaluar duket sikur është ekuivalentja e faljes së saj.

Në bisedat me nënat haset një pohim i përgjithshëm që do të thotë se, të kuptosh sjelljen do të thotë ta pranosh atë. Në të vërtetë, është krejtësisht e kundërta. Vetëm duke kuptuar sjelljen, do të jemi në gjendje të kemi rezultat në lidhje me të. Me qëllim që të dini se çfarë të bëni, ju, së pari, duhet të dini se çështë ajo për të cilën po përpiqeni të bëni diçka. Sjellja e fëmijës na sinjalizon se ku ndodhet ai në zhvillimin e tij social. Me këtë informacion që do të fitojë, nëna mund të fillojë ta udhëheqë atë drejt hapit tjetër. Fëmija që pickon shokun se ia rrëmbeu lopatën, sigurisht që ka të drejtë ta marrë atë përsëri. Megjithatë, ka mënyra më të pranueshme për ta arritur këtë qëllim. Nëna nuk ka pse ta gjykojë situatën për ta shpallur njërin fëmijë sikur ka të drejtë dhe tjetrin sikur e ka gabim, me qëllim që të zgjidhë mosmarrëveshjen. Synimi i saj mund të jetë të ndihmojë fëmijën të marrë lopatën sërish, dhe, njëkohësisht, të demonstrojë mënyra alternative të përballjes me situatën, si: “Do të doja lopatën time përsëri,” në vend të goditjes. Ky është një proces i ndërlikuar, që, si çdo të mësuar tjetër, kërkon shumë përsëritje. **Fakti që, fëmija nuk i ka përvetësuar disa hapa në zhvillim, nuk do të thotë se ai nuk po mëson. Fazat e vështira të zhvillimit mund të duken të përjetshme. Disa ndërveprime që duhet të përsëriten e përsëriten, qoftë kjo ndërrimi i pelenave, apo zgjidhja e një konflikti në këndin e lojrave, nënës fillon t'i duket sikur këto do të zgjasin gjithë jetën. Fazat e zhvillimit mund të duken si probleme të rënda që kërkojnë ndërhyrje drastike. E, megjithatë, duke iu shtuar ankthi, shqetësimi, dhe inati i përfshirë në to është gjithmonë e habitshme të bëjmë një retrospektivë në kohë për të parë se sa pak kanë zgjatur në të vërtetë!**

Kur mendojmë në mënyrë abstrakte për procesin e të mësuarit, ne presim dhe iu lëmë fëmijëve, jo vetëm kohën që duhet për të mësuar, por edhe gabimet që bëhen gjatë të mësuarit. **Ne e pranojmë menjëherë këtë, kur bëhet fjalë për të mësuarit në shkollë. Por, është shpesh e vështirë për nënat ta shohin sjelljen e fëmijëve të**

tyre si shprehje të gabimeve të bëra gjatë udhës së të mësuarit, se si të ndërveprojnë me botën përreth. Një herë pashë një djalë të vogël duke u kolovitur në degën e pemës së fqinjit. Papritmas, dega u thye dhe fëmija i tmerruar për atë që kishte bërë vrapoi teposhtë rrugës duke thirrur: “Mami, mami, bëra një gabim.” Ai qartas medonte se gabimet ishin të këqija. Ne shpesh sillemi sikur gabimet që ndodhin nga mungesa e përvojës së fëmijës dhe eksplorimet që ai i bën botës, të jenë në të vërtetë shenja të një shpirtligësie të paramenduar. Dhe ende, sa herë që njerëzit provojnë diçka të re vetë ata, pashmangshmërisht do të bëjnë gabime. **Nëse gabimet duken kaq të rrezikshme, si nëna, ashtu edhe fëmija, fillojnë të ndjejnë se është e pasigurt të provosh diçka të re.**

Kështu pyetja kthehet sërish tek ajo e qëllimit. A është bindja dhe përshtatja ndaj një sistemi të imponuar nga jashtë i së mirës dhe së keqes qëllimi ynë, apo është pavarësia dhe kapaciteti për funksionim të pavarur brenda një kornize respekti për të drejtat dhe nevojat e të tjerëve? Të mësuarit është një proces i ngadalshëm dhe nënat shpesh bëhen të paduruara për ngadalësinë e të mësuarit të fëmijës nëpërmjet përvojës. Në edukimin e fëmijëve, pa dyshim, do të ishte më e lehtë sikur fëmija të kryente diçka vetëm se i themi ne. **Metoda autoritare i përshpejton gjërat, por nuk krijon sjellje të pavarur. Nëse fëmija nuk ka përvetësuar ende principet e marrëdhënieve njerëzore dhe vetëm sa nënshtrohet në sajë të dhunës apo kushtëzimit, ai nuk ka asnjë mjet për të përdorur, asnjë burim për të shfrytëzuar në situatën tjetër që do të gjendet përballë tij.**

Funksionim i pavarur nuk do të thotë të bësh vetëm atë që të sjell kënaqësi. Por, do të thotë të marrësh përgjegjësi për sjelljen tënde edhe atëherë kur nuk ka asnjë kontroll të jashtëm mbi të. Akoma më tej, kjo do të thotë vetëdije për sjelljen e njeriut mbi të tjerët dhe mbi vetveten. Është zhvillimi i kësaj vetëdije, ajo që përbën pjesën më të madhe të përvojës së të mësuarit gjatë

fëmijërisë. Rrjedhojat e sjelljes do të duhen t'i shpjegohen fëmijës, por kjo nuk ka pse të bëhet nëpërmjet metodave të ashpra, apo gjykuese. Ashtu si të gjithë ne, edhe fëmijët marrin kënaqësi nga marrëdhëniet me të tjerët. Nëse ne i lëndojmë të tjerët, ne e shkatërrojmë kontekstin social, për të cilin kemi nevojë për mbijetesën tonë. Pasi ta kemi mësuar ne këtë, po ashtu, do të veprojnë edhe fëmijët tanë.

KAPITULLI 10

Qëndro në krye të detyrës

Në një botë specialistësh, të cilët gjithnjë e më shumë japin receta për jetën e fëmijëve, nënës, që e vlerëson si duhet rolin e saj për të qëndruar në krye të detyrës për zhvillimin e fëmijës së saj, i duhet një punë shumë e madhe dhe e vështirë. Të qëndrosh në krye të detyrës si nënë, do të thotë të ushtrosh gjykimin tënd për atë që është më e mirë për fëmijën tënd. Kjo do të thotë që, ndonjëherë, edhe të mos marrësh parasysh këshillat e ekspertëve. Kjo do të thotë të çajë rrugën nga vendimmarrja institucionale drejt një përkjekje për t'u bërë e përgjegjshme për nevojat e fëmijës së saj. Kjo do të thotë që ajo t'i besojë pikëpamjes së saj. Mbi të gjitha, kjo do të thotë të zhvillojë aftësi për të toleruar, si ankthin e brendshëm, ashtu edhe armiqësinë e jashtme që krijohen, kur dikush përpiket të qëndrojë në krye të detyrës.

Një nënë më tha njëherë: “Do të ishte shumë më e lehtë, nëse ju do të më tregoni atë që po mendoj unë, sepse, edhe ndonëse ndihem në një mënyrë të caktuar, nuk kam besimin e duhur në mënyrën time të të menduarit për t’iu qëndruar besnike bindjeve të mia. Por nëse do të ma thonit ju, do të ndihesha mirë, sepse ju jeni e përgatitur në këtë fushë dhe do të kisha më shumë besim në opinionin tuaj se në timin.”

Kur unë vetë isha nënë e re, djali im 3 muajsh filloi të kishte të vjella që pasoheshin nga humbja e vetëdijes. Së bashku me bashkëshortin shkuam nga një specialist tek tjetri, duke u përpjekur të gjenim si ishte puna. Asnjëri prej tyre nuk po kuptonte ç’po ndodhte me djalin. Më në fund, unë vendosa të konsultohesha me një doktor

që kishim punuar bashkë, mendimin e të cilit e respektoja. Ai më pyeti se çfarë mendoja **unë** se nuk shkonte me fëmijën. Unë i thashë se besoja se diçka kishte të bënte me ushqimin. Ai më pyeti se çfarë më bëri të mendoj kështu dhe, e gjeta veten duke paraqitur të dhëna që nuk mendoja se i kisha. Pak kohë më vonë, kur u provua se djali ynë kishte një formë të rrallë alergjie ndaj ushqimit, i thashë doktorit se sa e habitur isha kur zbulova se unë e kisha informacionin që më duhej për të ndihmuar fëmijën tim dhe nuk e kisha ditur, derisa ai më bëri pyetjen që duhej. Ai tha se kjo meritë i takonte një profesori në një shkollë mjekësie, i cili iu thoshte studentëve të tij: “Nëse nuk kuptoni se çfarë nuk shkon me fëmijën, pyesni nënën.”

Kur nëna përpiket të marrë përgjegjësi për zhvillimin e fëmijës së saj, ajo përballlet me dy lloj presionesh: Ajo ka vështirësi të pranojë perceptimet e saj kur ato kundërshtohen nga ata që konsiderohen specialistë. Gjithashtu, ata që besojnë se duhet të jenë **ata** në krye të detyrës, shpesh, i kushtojnë shumë pak rëndësi pikëpamjes së nënës. Perceptimi i ndryshëm i nënës bëhet pengesë për t’u tejkaluar, dhe nëse ajo këmbëngul etiketohet si nënë “e vështirë.”

Ne jetojmë në një shoqëri të kompjuterizuar, në të cilën ne jemi paralajmëruar të mos futemi me turmën, mos hollohemi dhe mos gjymtohemi. Por, si nënat, ashtu edhe fëmijët, vazhdimisht bashkohen me turmën, hollohen dhe sakatohen në përpjekje për t’i bërë ata t’iu shkojnë për shtat institucioneve dhe ideve të dizenuara për t’i shërbyer një numri të madh njerëzish, më shumë se sa individit. Kur kemi të bëjmë me numra, është e pashmangshme që një normë hipotetike të bëhet standardi kundrejt të cilit të matet çdo njeri. Shmangiet nga kjo normë përbëjnë problem, sepse ato kërkojnë të menduar dhe vëmendje të veçantë. Si rezultat, është vetvetiu keq të mos pajtohesh me normën. Ndryshimet janë të padëshirueshme. Të jesh i ndryshëm nuk është “normale.” Ky është mesazhi që u jepet nënave për veten dhe për fëmijët e tyre. Shumëllojshmëritë dhe ndryshueshmëritë në zhvillim nuk tolerohen menjëherë nga ata,

funksioni i të cilëve është t'iu shërbejnë nevojave të fëmijëve, por barra i shkarkohet fëmijës dhe nënkuptohet, nënave. Ideja është se, nëse fëmija nuk përshtatet, me të diçka nuk shkon. E nëse diçka nuk shkon me fëmijën, diçka nuk shkon edhe me nënën.

Kur mendime të tilla shqiptohen nga specialistët, nënat, kuptohet e pranojnë këtë si të vërtetë. Por, “të vërtetat” që varen nga vëzhgimet nuk janë absolute. Përkundrazi, ato janë perceptime dhe gjykime që janë shpesh çështje opinioni dhe interpretimi. Nëse fëmija ndryshon nga grupi në zhvillimin e tij social, emocional, intelektual apo fizik, kjo nuk do të thotë se domosdoshmërisht me të diçka nuk shkon. Kjo do të thotë se, thjesht këtu ka një pyetje që pret përgjigje për disa aspekte të sjelljes së tij. Diçka në sjelljen e tij i tërheq vëmendjen apo është burim shqetësimi: Pse një fëmijë duket se është i pandjeshëm ndaj të tjerëve? A nuk kupton ai, a ka ndonjë problem me dëgjimin, apo është i tërhequr, apo “kundërshtues”? Çfarë do të thotë nëse një fëmijë nuk bashkohet me grupin në shkollë, apo është agresiv ndaj fëmijëve të tjerë? A është kjo një fazë e zhvillimit, apo ka një problem në personalitet, a reagon ai ndaj një situatë pa interes dhe jotërheqëse në klasë, apo ndaj një mësuesi ndëshkues? A është serioze që një fëmijë t'i qepet nënës, menjëherë nëse qan, nëse zgjohet natën apo vuan nga disa frikëra? Si duhet t'iu japim përgjigje këtyre pyetjeve dhe të tjerave si këto?

Nuk mund të merret një shabllon sjellje, ta përdorim atë për ta kultivuar në laborator dhe pastaj ta vemë në mikroskop për të përcaktuar se është virale apo bakteriale. Zhvillimi i fëmijëve është fluid, sjellja e tyre ndryshon përditë, si përgjigje ndaj ambientit të tyre të veçantë. Sjelljes i vishet kuptim nga vëzhguesi dhe interpretimet që pasojnë, pasqyrojnë jo vetëm ekspertizën objektive, por, edhe paragjykimet subjektive. Nëna është gjithashtu një vëzhguese, e cila ndjek të njëjtin proces në vlerësimin e sjelljes së fëmijës së saj. Por, atje ku ajo mund të tregohet shumë e shpejtë të japë përfundimin se sjellja e fëmijës së saj mund të jetë si përgjigje ndaj diçkaje që mund

të ketë bërë ajo, vëzhguesit e jashtëm, rrallë mund të arrijnë në të tilla konkluzione të ngjashme. Një mësues rrallë beson se sjellja e fëmijës është një reagim ndaj sjelljes së tij. Psikologu apo pediatri nuk e imagjinojnë se fëmija mund të reagojë ndaj personalitetit, apo stilit të tij të ekzaminimit. Edhe atëherë kur vëzhgimet e sjelljes janë të besueshme, gjithsesi, domethënia e sjelljes, kuptimi i saj, mbetet ende për t'u vlerësuar. **Pikërisht, këtu njohuria e nënës për fëmijën e saj dhe mundësia për vëzhgim të vazhdueshëm mbeten kritike.**

Një nënë përshkroi takimin e djalit të saj me një psikolog në shkollë. Atë javë, fëmija për herë të parë, kishte parë babain e tij të gjunjëzuar në lutje. Nëna e tij e mori vesh nga pyetjet që ai i bëri asaj, se sa përshtypje i kishte bërë kjo gjë. Gjatë testit psikologjik fëmijës iu kërkua që të gjunjëzohej. Ai e pranoi kërkesën, u gjunjëzua dhe tha një lutje! Nëna më vonë e mori vesh se, raporti psikologjik përfshinte një opinion se fëmija ishte i preokupuar me besimin në Zot. Një fëmijë tjetër, i cili ishte i ndrydhur dhe i padëgjueshëm gjatë një vlerësimi për pranim në shkollë, u zbulua më vonë se kishte pasur ethe. Megjithatë, ai nuk u pranua si me zhvillim të vonuar. Përsëri e përsëri përcaktimet bëhen mbi bazën e vëzhgimeve të kufizuara, të cilat kanë një efekt të madh në të ardhmen e fëmijës. Thjesht, merret si i mirëqenë fakti se, të tilla vëzhgime dhe vendime janë të vlefshme, sepse ato janë bërë nga specialistë.

Çështja është se, të kuptuarit e nënës për sjelljen e fëmijës së saj, vetëdija e saj për mënyrën se si reagon ai në një shumëllojshmëri situatash, e bën të domosdoshme që pikëpamja e saj të merret në konsideratë në nxjerrjen e konkluzioneve për fëmijën. Ndonëse nënat mund t'i keqinterpretojnë vëzhgimet e tyre, në pjesën më të madhe, ato janë të etura për të kërkuar mendimin e një specialisti të jashtëm, ndërsa, zakonisht e kundërta nuk ndodh. Në fakt vetëm duke kërkuar ndihmë, nëna mund ta gjejë veten në një pozicion ku nuk i besohet si një vëzhguese e vlefshme. Pikëpamja e saj është automatikisht e dyshimtë. Shumë shpesh mesazhi që u jepet nënave

është se fëmija që ka probleme, ka pa dyshim një nënë me probleme. Nëna nuk trajtohet si partner në trajtimin e fëmijës së saj, por, ajo vetë trajtohet si pacient.

Ironia është se, të tjerët që merren me fëmijët, shpesh, përjetojnë reagime emocionale ndaj sjelljes së fëmijëve, reagime që janë shkatërruese për vetë fëmijët. Por, vetëm nënat ngarkohen me përgjegjësinë e këtyre reagimeve. Një fëmijë që kishte vështirësi të shkonte mirë me të tjerët në shkollë dhe sulmonte të tjerët kur ndihej i sulmuar, vazhdimisht ndëshkohej dhe izolohej nga mësuesit. Megjithatë, ishte nëna ajo që u muar në pyetje për trajtimin e tij, të cilës iu dha mesazhi se diçka nuk shkonte në ambientin e tij të shtëpisë, sigurisht, dhe jo në atë të shkollës. Atyre që nuk janë të suksesshëm me fëmijët, shpesh iu duket më e lehtë të fajësojnë fëmijën, ose nënën për dështimet e tyre.

Një nënë telefonoi për të diskutuar një problem. Ajo e kishte regjistruar fëmijën në një program argëtues të së shtunës, me këshillën e shkollës së fëmijës. Mësuesit e tij besonin se ai kishte nevojë për më tepër mundësi për t'u shoqëruar me fëmijët e tjerë. Megjithatë, pas disa javësh ai dukej ende i mërzhitur se shkonte atje. Ai qante kur ikte nëna dhe fliste gjithë javën se nuk donte të shkonte më atje të shtunave. Mendimi i nënës ishte se ai po përjetonte shumë presion dhe i mungonin shëtitjet e mbasdites së të shtunës me babain. Meqë ai nuk ndihej mirë që shkonte atje, mbetej i veçuar nga fëmijët e tjerë dhe qëllimi për të cilin shkonte atje, nuk realizohej. Ende nëna ndihej e pasigurt për të ndjekur mendimin e saj, pra, ta largonte fëmijën nga ai program, sepse njerëzit në shkollë i thanë se ajo prekej shpejt nga reagimet e fëmijës së saj dhe ajo duhet të ngulte këmbë që ai të vazhdonte. Me fjalë të tjera, ajo duhet ta detyronte fëmijën të bënte atë që mendonin ata se ishte më e mirë për fëmijën.

Është e rëndësishme për edukatorët, doktorët dhe specialistët e tjerë, të shohin se si shkon fëmija me grupin. Kjo është një mënyrë

për të përcaktuar se ku ndodhet fëmija në zhvillimin e tij. Mbi bazën e asaj që dihet për fëmijët e tjerë në përgjithësi në një moshë të caktuar, nxirren konkluzione për një fëmijë të veçantë, jo vetëm për momentin, por, gjithashtu, edhe për të ardhmen. Megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e historisë. S'ka rëndësi se sa i ngjashëm, apo i ndryshëm është një fëmijë nga të tjerët në një grup të dhënë, ngjashmëritë dhe ndryshimet e tij janë në mënyrë unike vetëm të tijat. Domethënien që ato mbartin gjatë udhës së zhvillimit kanë të bëjnë më shumë me njohurinë për personalitetin dhe individualitetin e tij, se sa me njohurinë e përgjithshme të grupit më të gjerë pjesë e të cilit është ai. **Është pikërisht nëna, ajo që e ka këtë të kuptuar më personal dhe, për këtë arsye, ajo duhet të qëndrojë në krye të detyrës për të vendosur se çfarë e ndikon fëmijën në rrjedhën e zhvillimit të tij.**

Edhe në ngjashmërinë me anëtarët e tjerë të grupit, fëmija mund të jetë i ndryshëm. Një test me rezultat të dobët për një fëmijë mund të jetë masë e saktë e aftësisë së tij; për një fëmijë tjetër mund të jetë një masë e tensionit që ai ndjen në një situatë testi. Një fëmijë mund të ketë nevojë për ndihmë përmirësimi në këtë drejtim; tjetri mund të ketë nevojë për vetëbesim më të madh. Një rezultat i kënaqshëm për një fëmijë mund të tregojë se ai po ecën mirë, por, për një fëmijë tjetër, i njëjti rezultat mund të tregojë se ai nuk po ecën aq mirë, pra, është nën nivelin e tij. Për fëmijën e parë rezultati është një tregues i besueshëm; për të dytin mund të jetë një sinjal paralajmërimi se atij i duhet ndihmë. A duhet të trajtohen të dy fëmijët njëjloj, thjesht sepse kanë të njëjtin rezultat? Ndonëse ata mund të bien në të njëjtën përqindje në grup, ndryshimet e tyre janë më domethënëse se sa ngjashmëritë e tyre. Vetëm nëpërmjet njohjes së fëmijës, që shkon përtej njohjes së rezultateve të tyre, mund të bëhen këto dallime, dallime që janë thelbësore për një vendimmarrje të saktë.

Një mësues vuri në dukje njëherë se, fëmijët që shkëlqejnë, shpesh, tërheqin vëmendje të veçantë. Po kështu, edhe ata që

sjellin shqetësime. Është grupi i madh në mes i cili shket pa shumë vëmendje nga askush. Ekzaktësisht për arsyen se shkollat dhe institucionet shpesh nuk kanë shumë zgjidhje në dorë, pos t'ua shpërndajnë kohën dhe përpjekjet e tyre në këtë mënyrë, i mbetet nënës të qëndrojë në krye të detyrës për fëmijën e saj, të përdorë të kuptuarin e saj për fëmijën për të përcaktuar kuptimin që fshihet në sipërfaqen e sjelljes dhe, të bëjë të mundur që atij t'i jepet ndihmë dhe shanset për të cilat ai ka nevojë dhe i meriton.

Të qëndrojnë në krye të detyrës do të thotë që nëna të ndjekë gjykimin e saj në dy fronte: t'i interpretojë këshillat dhe rekomandimet që i jepen në mënyrat që asaj i duken më të përshtatshme për fëmijën, dhe duhet të këmbëngulë që ata, të cilët marrin vendime që ndikojnë fëmijën e saj t'ia marrin parasysh të kuptuarin dhe pikëpamjen e saj. Nënata dhe specialistët e tjerë shpesh kanë qëllime të ndryshme dhe shqetësime të ndryshme. Një doktor dëshiron që fëmija të pijë ilaçin që i jep ai; nëna shqetësohet për turbullimin që shkaktohet kur fëmija duhet ta pijë atë. Dentisti do që të mbushet dhëmbi; nëna nuk dëshiron që vajtje ardhjet te dentisti të bëhen provë e rëndë. Okulisti kërkon ushtrime për korrigjimin e syve, nëna shqetësohet për betejën me fëmijën që ato të kryhen. Për shkollën, mund të jetë më mirë të ketë fëmijën në një klasë të caktuar, por nënës mund t'i duket se ai mësues nuk është i përshtatshëm për fëmijën e saj. Çdo specialist shqetësohet për fushën e tij të veçantë për trupin apo mendjen e fëmijës. Ndërsa nëna mbetet e shqetësuar në mënyrë unike për fëmijën në tërësi. Çdo specialist punon nën presione të tjera, që shpesh duhet të kenë prioritet më të madh se sa nevojat e fëmijës si individ. Prioriteti i nënës është të bëhet më e mira për fëmijën.

Nëse nëna është e vendosur për të qëndruar në krye të detyrës për zhvillimin e fëmijës dhe për vendimet që ndikojnë tek ai, ajo duhet të përgatitet të ndihet, ose si nënë e keqe, ose si nënë e çmendur. Nëse ajo i zbaton rekomandimet e të tjerëve në mënyra që i duken

më të përshtatshme për fëmijën e saj, kjo nuk do të interpretohet domosdoshmërisht me kuptimin se ajo po vepron në interesin më të mirë të fëmijës. Përkundrazi, ajo ka të ngjarë të konsiderohet e papërgjegjshme, apo neglizhente. Nëse ajo është këmbëngulëse në zbatimin e pikëpamjes së saj, dhe vazhdimisht pyet shkollat, doktorët, apo ekspertët e tjerë, të cilët kanë të bëjnë me fëmijën e saj, ajo ka të ngjarë të marrë një përgjigje që është padronizuese, armiqësore, apo indiferente. Shpejt do ta marrë mesazhin se ajo është prej atyre nënave “të çmendura,” apo “të vështira.”

Pa dyshim, që të tjerëve do t'u pëlqente sikur nënat të vepronin ashtu siç u thonë. Pajtimi dhe përshtatja e bëjnë jetën më lehtë për ata që kanë një punë për të bërë. Por, edhe një nënë ka gjithashtu një detyrë për të kryer dhe, që ta bëjë atë mirë mund t'i sjellë punë shtesë të tjerëve. Megjithatë, njerëzit nuk i shqetëson vetëm ndërprerja e procedurave të vendosura. Është shpesh sfida ndaj funksionimit autoritativ, ajo që është më shumë shqetësuese. Në një jehonë të njohur të ndjenjave të nënave kundrejt fëmijëve të tyre, ata që janë me autoritet shpesh ndjejnë se do ta humbasin kontrollin, po që se nuk i bëjnë gjërat sipas mënyrës së tyre. Duket sikur po ta marrin parasysh edhe pikëpamjen e nënës, do t'u zbehet ekspertiza e tyre; sikur po të dëgjojnë rekomandimet e nënës, kjo do të përbente një sfidë për autoritetin e tyre. Është më e lehtë të imponosh pikëpamjen tënde se sa të respektosh atë të nënës, është më e lehtë të fajësosh nënën se sa të vesh në pikëpyetje vetë këshillën. Ashtu si nëna, nuk duhet të verë përballë këmbënguljen e fëmijës, për t'i shkuar gjithmonë e tija me këmbënguljen e saj, për t'i shkuar gjithmonë e saja, këmbëngulja e të tjerëve për t'i bërë gjërat siç u thonë ata nuk do të thotë se ajo duhet t'i detyrojë ata të veprojnë sipas mendimit të saj. Gjithsesi, kjo do të thotë se ajo duhet të këmbëngulë që zëri i saj të dëgjohet dhe mendimi i saj të respektohet. Si nënat, ashtu edhe njerëzit e tjerë të cilët punojnë me fëmijët, gjithkush ka ekspertizën e tij të veçantë; secili ka diçka për të kontribuar për mirëqenien e

Elaine Heffner

fëmijës. Ndaj, duhet të respektohet mendimi i gjithsecilit. Së bashku, ata mund të punojnë në mënyrë më të frytshme në të mirë të fëmijës. Nuk është se njëri e ka mirë, apo tjetri gabim, njëri është i mirë, tjetri i keq. Nuk ka përgjigje të sigurta dhe të gjithë informacionin për të cilin kemi nevojë. Ka erdhur koha për t'u ndalur së kërkuari një të personazh negativ – dhe është sigurisht koha të ndalojmë së vendosuri nënat në atë rol.

Mëmësia është një profesion për një nënë, e cila zgjedh për ta bërë të tillë. Nëna është profesioniste, nëse ajo zgjedh të jetë e tillë. Të sjellësh ndryshime në jetën e njerëzve është një vepër mjaft domethënëse, që kërkon vetëvlerësim dhe, po ashtu, edhe vlerësimin e të tjerëve.

Por, përtej kësaj, ndërsa qëndron në krye të detyrës për zhvillimin e fëmijës së saj, një nënë mëson të qëndrojë edhe në krye të detyrës për veten e vet. Ajo mëson ta shohë veten si person i rritur dhe të pranojë përgjegjësitë e një të rrituri. Ajo kështu zhvillon pavarësi mendimi dhe kapacitetin për të funksionuar si një forcë frytdhënëse në botën përtej përkujdesjes. Ajo forcon të kuptuarit e saj për sjelljen njerëzore dhe natyrën e marrëdhënieve njerëzore. E forcuar në këtë mënyrë ajo është e mirëpajisur për të plotësuar çfarëdo lloj sfide që e pret në jetë. Ajo nuk është më një nënë fëmije e pashpresë. Ajo është person më vete – dhe, njëkohësisht, nënë.

KAPITULLI 11

Qëllimi i munguar

...ne u goditëm me një lloj mendjemadhësie kozmike, që na bëri të imagjinonim se po rrisnim fëmijët në një mënyrë të tillë, sikur asnjë nga paraardhësit tanë në tokë para nesh nuk kishin patur as mençurinë dhe as pastërtinë e zemrës për të vepruar në të njëjtën mënyrë.

Midge Decter, *Prindër Liberalë, Fëmijë Radikalë*

Kufijtë që përcaktojnë sjelljen e pranueshme nga ajo e papranueshme vazhdimisht luhaten gjatë kërkimit tonë për vendime të reja për konfliktet e vjetra të jetës në shoqëri. Në çfarë pike liria e individit çon në sjellje që nëpërkëmbin të drejtat e të tjerëve, apo mirëqenien e gjithë shoqërisë?

Në çfarë pike veprimi i ndërmarrë në emër të mirëqenies shoqërore bëhet tejet shtypës për lirinë e individit? Standartet tona të sjelljes shfaqin, midis të tjerash, një përpjekje për të mbajtur pak ekuilibër midis nevojave kundërshtuese të individit dhe grupit. Nëse grupi bëhet tiran në autoritetin e tij, ai nxit rebelimin. Për të gjetur pak qetësi, zbuten kufizimet e grupit mbi individin. Nëse individ bëhet shkatërrimtar në lirinë e tij personale, ai nxit kufizimet. Sa më shumë kufij të rreptë ndaj sjelljes së tij, aq më të ashpra kërkohen metodat e dallimit të këtyre kufijve nga grupi.

Ky konflikt, i shprehur qartë në nevojën njerëzore për të jetuar në grup, reflektohet në filozofinë dhe metodat tona të rritjes së fëmijëve. Synimi në rritjen e fëmijëve është që t'i përgatisim ata t'ia dalin mbanë me sukses si të rritur në shoqëri. Mënyra, me të cilën

kryhet ky qëllim, shpreh një pikëpamje edhe për natyrën njerëzore, edhe për rëndësinë që duhet t'i jepet afirmimit të individit apo konformizmit ndaj grupit. **Duke transmetuar këtë pikëpamje, çdo brez i jep formë sjelljes së tjetrit, i cili për rrjedhojë, i jep formë vetë shoqërisë.**

Atë që shumë e kanë quajtur si dalje jashtë kufijve të sjelljes në shoqërinë bashkëkohore, shpesh ia kanë ngarkuar mbi kurriz asaj që quhet rritje tolerante e fëmijëve. Brezi i fëmijëve që u lind në vitet e fundit, midis viteve 1940 dhe 1950, iu përgjigj në një mënyrë të re ngjarjeve unike dhe presioneve në botën rreth tyre. Si pasojë, rebelimi i të rinjve në vitet 1960, përfshirja e tyre me drogë, revolucioni seksual, dhe dëshira e flaktë për “t'u ndjerë mirë”, i cili çoi në gjithçka, që nga klithjet primitive e deri në meditimin transcendetal, të gjitha këto ishin shtruar në prapun e qëndrimeve prindërore tolerante. Toleranca si koncept ngjan pak me paturpësinë – ndonëse nuk mund ta përcaktojme, ne menjëherë e njohim kur e shohim. Po, çdo të thotë në të vërtetë ajo? Sigurisht, prindërit në pjesën më të madhe, nuk u dhanë leje fëmijëve të tyre të përfshiheshin lirisht në seks paramartesor, apo të trulloseshin me drogë. E vërteta është se ata ishin të pafuqishëm për ta ndalur këtë. **Atëherë, toleranca shoqërohet me një autoritet të mangët prindëror.** Po pse duhet të quhet tolerant ndikimi i dobësuar prindëror? A u dhanë prindërit leje të mos i merrnin parasysh dëshirat e tyre? Nëse është kështu, atëherë kjo ishte ajo që kishin për qëllim ata, apo ndodhi si rezultat i diçkaje tjetër që ata kishin në mendje?

Përkufizimi “tolerant” është përdorur gjerësisht për një stil prindërimi, që “lulëzoi” në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo përjashe e re që shquhej për mënyra të reja të këndvështrimit të sjelljes së fëmijëve, ishte në realitet kulmi i flirtimit të gjatë me psikoanalizën dhe teorinë e Frojdit për zhvillimin e personalitetit. Gjatë viteve 1920 dhe 1930, kur këto teori filluan të filtrojnë te prindërit, klima mbizotëruese e opinionit të rritjes së fëmijëve ishte ajo e disiplinës dhe kontrollit prindëror.

Ato ishin ditë kur qëllimi i rritjes së fëmijëve ishte t'i stërvisinin ata sa më shpejt që të ishte e mundur që të silleshin sipas rregullave të sjelljes së pranueshme. Viruset, prishja, dhe zakonet e këqija duhej të shmangeshin po njëllë. Besohej se fëmijët kishin nevojë për ndikimin e fortë të prindërve në mënyrë që të qëndronin në udhë të mbarë. Impulset e fëmijëve konsideroheshin potencialisht të rrezikshme, meqë ato shpesh shpreheshin në sjellje të papranueshme agresive, ndaj duhet të viheshin nën kontroll me edukim strikt dhe bindje ndaj autoritetit prindëror. Në këto qëndrime shtypëse ndaj sjelljes së individit qëndronte një ideal shoqëror. Sjellja që nxiste qëllimin e jetesës në grup admirohej. Ndërsa, ajo sjellje që shfaqte vëmendje të madhe ndaj individit haste mosaprovim. Vlerat ekzistuese shoqërore përfshinin: respekt për autoritetin dhe të drejtat e të tjerëve, ndihmë reciproke, sakrifikim, punë të palodhur, përgjegjësi dhe mbështetje në forcat e veta. Ato ishin vlera që buronin nga besimi në një qëllim më të lartë në jetë dhe nga konceptet morale të fesë. Si të tilla, ato transmetoheshin në formën e “ju nuk duhet të” të predikimit religjioz.

Rëndësia që iu kushtua faktorëve socialë në rritjen e fëmijëve mund të gjendet në artikuj të botuar në Revistën e Prindërve gjatë viteve 1930. Një forum për ide të reja dhe barometër për shqetësimet prindërore, kjo revistë e njohur tregonte përpjekje për të pajtuar teorinë e reja mbi personalitetin e fëmijës me idetë tradicionale mbi sjelljen.

Një artikull i titulluar “Karakterit në Formim”, shkruar nga një psikolog, trajton teorinë e konfliktit dhe rolin e tij në zhvillim, duke shpjeguar se:

...shumë psikoanalistë janë të mendimit se, pjesa më e madhe e çrregullimeve mendore tek të rriturit vijnë për shkak të konflikteve të pazgjidhura, që janë krijuar gjatë fëmijërisë... Konfliktet, të cilat janë shumë të vështira për t'u trajtuar, rezultojnë nga një lloj edukimi

që ka dështuar t'i japë fëmijës një sens realiteti për botën. Gabimi më flagrant që bëjnë disa prindër është se, nuk i kushtojnë fëmijës vëmendjen që duhet dhe i mburrin ata në publik. Fëmija i trajtuar në këtë mënyrë rritet me idenë se ai është natyrisht qendra e vëmendjes.

Një artikull i titulluar “Fëmija juaj dhe fëmijët e tjerë” shtjellon rëndësinë e suksesit social në fëmijëri në përcaktimin e qëndrimeve të ardhshme kundrejt njerëzve:

Ka një problem, të cilin e kanë të përbashkët si fëmijët, ashtu edhe të rriturit, e ai është pikërisht beteja jetëgjatë e përshtatjes së sjelljes drejt asaj pike delikate ku, edhe individ i ndihet i lumtur, edhe grupi social e miraton... Në eksperiencat e para të lojës me fëmijët e tjerë, a mëson fëmija juaj të jetë një bos i bezdisshëm, apo një drejtues i mirë dhe i aftë? Kur fëmijës tuaj nuk i shkon e tija, a reagon me shpërthime inati, apo largohet nga grupi me turp varur për të qëndruar në vetmi? A pajtohet ai ndjeshëm me dëshirat e grupit dhe a mban marrëdhënie të mira dhe miqësore me shokët e tij, edhe atëherë kur kundërshtohet prej tyre?

Artikulli vazhdon të përshkruajë se si foshnjat fillojnë përvojat e tyre sociale si qendra e një bote vëmendjeje. Bebjë e mëson nga përvoja, se të qarit dhe të bërtiturit do t'ia sigurojë vëmendjen që po kërkon. Gjithsesi, një bebe tjetër mëson se mënyra për t'u ngritur dhe për t'u kujdesur për të është të gugasë dhe të buzëqeshë. Këto dy eksperiencat të hershme të jetës lidhen me përpjekjet e jetës së mëvonshme për t'i detyruar të tjerët për vëmendje nëpërmjet sjelljes së papranueshme, apo për ta fituar dashurinë e të tjerëve nëpërmjet sjelljes miqësore dhe të pranueshme.

Në artikullin me titull: “Morale të reja në vend të të vjetrave,” shkruar nga një profesor në një seminar teologjik shkruhet:

Çdo fëmijë përballet me nevojën për të gjetur mënyra të

pranueshme shoqërisht për t'i plotësuar dëshirat e tij. Kur të rriturit i thonë atij qartë dhe haptas se çfarë pret shoqëria prej tij, ai shpëton nga shumë gabime që i kushtojnë shtrenjtë. Pak rëndësi ka nëse bindet apo jo, por, atij i ofrohet një kod ndaj të cilit mund të reagojë në mënyrë inteligjente ... Jemi apo s'jemi mirënjohës ndaj paraardhësve tanë që na detyruan të bindeshim ndaj rregullave për të cilat ne kundërshtohim?

Sidoqoftë, këta janë tregues të idesë në rritje se, potencialet individuale të fëmijës duhet të zhvillohen në të njëjtën kohë kur ai është duke mësuar sjelljen sociale. Një artikull i titulluar “Mos Prek” shpreh një mesazh që është tërësisht antonim me titullin e tij. Duke filluar me imazhin e një vazoje të çmueshme të hequr mënjanë nga dora e një vogëlushi dhe nënkuptimin e qartë se fëmija do ta thyejë atë, lexuesit i thuhet të mendojë se sa e rëndësishme është ndjenja e të prekurit të fëmija. Duart e fëmijës janë të mbushura me potenciale, i etur për të njohur një botë të re duke e prekur.” Nëna këshillohet:

... të jetë inteligjente dhe e duruar për të mbajtur parasysh se, në këtë marrëdhënie, si në shumë të tjera, gjëja më e shëndetshme për mendjen dhe trupin e një fëmije është ta lejojë atë t'i bindet impulseve të tij normale, për sa kohë që kjo pajtohet me logjikën e shëndoshë. Ai jo vetëm që duhet të njihet me ambientin e tij, por duhet t'i përshtatet atij.

Ka edhe impulse të tjera të fëmijëve që tashmë duhet të kuptohen ndryshe nga ç'janë kuptuar në të kaluarën. Në shkrimin me titull “Fëmijët nuk vjedhin kurrë,” një psikiatër shpjegon se fëmija që rrëmben gjërat pa leje po përpjeket të ngopë një lloj urie. Ai ndihet i privuar në një farë mënyre nga dashuria e prindërve të tij.

Fëmijët nuk janë aq të prirur si të rriturit në kapjen e supozimeve të mprehta që nënkuptohen qartë në ligje. Kur babai është i shqetësuar për bursën dhe ka prirjen t'ia presë për shkurt djalit të tij, i riu e quan indiferencën e tij si mungesë dashurie. Kur nëna i rrëmben nga dora vajzës së saj një vazo të çmuar, pa u shqetësuar aspak t'ia shpjegojë se pse, fëmija ndjen disi turbull se ajo nuk ka pjesë në atë shtëpi.

Një deklaram i qartë i besimeve imponuese i kësaj periudhe dhe një sfidë direkte për këto besime bëhet në artikullin “A duhet të shqetësohen prindërit për thithjen e gishtit?”

Nëna e kujdesshme e kësaj epoke i afrohet lindjes së bebes së parë me dy ide të ngulitura mirë në mendje. Njëra prej tyre është rritja e bebes me orar. Tjetra është se ajo nuk do ta lejojë atë ta thithë gishtin.

Diskutimi që vijon i siguron nënat se keqformimi i dhëmbëve nuk shkaktohet nga thithja e gishtit. Lajmi më i rëndësishëm është se të gjitha bebet kanë një nevojë për të thithur. Nëse thithja e ushqimit është shumë e lehtë, atëherë bebjë do të thithë diçka tjetër. Për këtë arsye, thithja e gishtit vjen si pasojë e një nevojë normale dhe zakonisht shfaqet spontanisht.

Këto teori të reja për sjelljen e fëmijëve po fillonin të ndikonin gradualisht të gjitha aspektet e rritjes së fëmijëve, por, asnjëra kaq thellë sa shqetësimi tradicional për disiplinën. Nëse fëmijëve do t'u jepej më tepër liri dhe do t'u kushtohej më shumë vëmendje nevojave të tyre, si do t'u mësohej bindja dhe respekti për të drejtat e të tjerëve? Këto pyetje diskutoheshin në “Sa bindje?” dhe jo shumë kohë pas këtij në artikullin me titull: “Sa liri për fëmijët?” Artikulli i parë nënvizon:

Prindërit nuk pyesin se, si mund të arrij bindje të padiskutuar, por, si ta stërvit fëmijën në mënyrë që të bëhet një i rritur i përgjegjshëm, i lumtur, të ketë besim te vetja, i aftë për të mbajtur integritetin e tij përballë joshjeve dhe vështirësive dhe si mund të plotësojë me sukses detyrimet e tij ndaj fqinjëve dhe shoqërisë?

Përgjigjja e kësaj pyetje sugjeron se ka një ndryshim të madh midis:

... lejimit të fëmijës për të plotësuar çdo tekë dhe dëshirë pa kufi, dhe zhvillimit të të kuptuarit se ai nuk duhet të cënojë të drejtat e të tjerëve dhe, duhet, ndonëse në një shkallë gradualisht në zvogëlim, t'ua lerë veten në dorë të gjykimeve më të pjekura dhe eksperiencave më të mëdha të atyre që e kanë nën kontroll.

Për më tepër, përgjigjja ndaj pyetjes “sa shumë liri” sugjeron se prindërit po shqetësohen ku ta ndajnë vijën midis lirisë dhe disiplinës.

A duhet që Alisa 3 vjeçare të lejohet të zhgaravisë muret e dhomës së saj me bojëra, meqë asaj i pëlqejnë ashtu? A po e prish e ëma Xhonin në moshën 5 vjeç, duke e lënë atë të bëjë thujëse çdo gjë që bën vëllai i tij 7 vjeç, apo kjo është e nevojshme për të mos e bërë atë të ndihet inferior?

Artikulli këshillon kundër kalimit nga një ekstrem tek tjetri dhe paralajmëron se, në përpjekjen për t'u dhënë fëmijëve liri të tepërt, ekziston rreziku i mbingarkimit të sistemit të tyre nervor me shumë përgjegjësi dhe shumë vendime.

Por, këto ishin vetëm kashtër në erë. Nga viti 1940 çdokush do të mendonte se teoritë psikologjike mbi rritjen e fëmijëve nuk ishin gjë tjetër veçse furtunë në ibrik. Artikujt nga teologët shfaqeshin

po aq shpesh sa edhe nga psikologët. Shëndeti fizik ishte ende në qendër të vëmendjes më tepër se sa ai mendor, ashtu siç pohonin tituj si: “Të mundim pneumoninë”, Çfarë të bëjmë për dhimbjen e veshit”, “Ruhuni nga këto viruset”. Një doktor, ndërsa shkruante për kujdesin mjekësor të fëmijëve, thotë:

Sigurisht, asnjëri me përvojë nuk do t'i këshillonte prindërit të hiqnin dorë nga ushqyerja me orar dhe të ktheheshin te metodat e rastësishme të shekullit të XIX.

Edhe një nënë e vlerëson negativisht traditën e rritjes “moderne” të fëmijëve në vitet 30:

Duke e ditur që rrahja është tabu për prindërit modernë, shumë nëna të reja dështojnë në krijimin e sigurisë që jep autoriteti në shtëpi. Brezi i nënave si unë kishin shumë frikë të merrnin autoritet, sepse ai mund të gjymtonte vetëvlerësimin dhe iniciativën. Disa prej tyre i qëllonin me shpulla, ose i rrihnin të mbushura me mosbesim, ndërsa disa të tjera arsyetonin me fëmijën... fëmijët e vegjël duhet të mësojnë të pranojnë autoritetin, nëse duam që ata të shkojnë një jetë për së mbari. E nëse fëmijëve nuk u mësohet ai, prindërit e tij do të zgjohen një mëngjes dhe do ta gjejnë veten skllëvër të lidhur të kalamanit të tyre, sepse ai është thujasë i padisiplinueshëm.

Rritja e re e fëmijëve përqeshet në anekdotën në vijim, që është më domethënëse nga të gjitha:

Nëna është bindur nga një psikoanalist se djaloshi i saj ka një kompleks inferioriteti, por jo babai, i cilit iu desh t'i dorëzohej djalit herë pas here, për shkak të bindjes së nënës se, djali i tyre duhej të lejohej të afirmonte egon e tij. Një ditë, kur babai ishte në dhomën e ndenijes, u dëgjua një krismë e madhe. “Thuaj moj mami,” e thirri ai

gruan e tij, “Xhuniuri sapo thyeu vazon tonë më të mirë. Çfarë të bëj tani, mos duhet ta puth?!”

Vazoja për të cilën kishim kohë që dëgjonim tashmë ishte thyer. Dhe, me të, dukej se shkoi edhe liria e re. Por, në fakt, ajo sapo kishte filluar. Njollat në horizont ishin bërë vetë horizonti.

Ç'ishin ato ide që do të përmbysnin nga themelet, jo vetëm qëndrimin kundrejt sjelljes, por edhe vetë sjelljen? Pjesa më e madhe e tyre ishin shkëputur nga teoritë psikoanalitike të zhvillimit normal dhe anormal të personalitetit. Por, është gabim të besojmë se tërësia e mendimit Frojidian po aplikohet në rritjen e fëmijëve. Vetë prindërit nuk e lexonin dhe interpretonin Frojdin. Por, në vend të këtyre teorive, u shkëputën disa koncepte nga shkrimet e Frojdit, të cilat u përpunuan nga psikiatrit, edukatorët dhe specialistët e edukimit të fëmijëve. Është mjaft domethënëse fakti se, shumica e materialit burimor origjinal vinte nga studimi i sjelljes anormale. Kjo do të thoshte se, shpesh përfundimet për zhvillimin normal, jo vetëm që nxirreshin nga anormalja, por çështje më e rëndësishme, spektri i dëmit që do të vinte nga dështimi për zhvillim normal, qëndronte i varur pezull në horizont. Tani personaliteti anormal u bë kërcënimi i ri. Ashtu si njëherë e një kohë, nënat kishin ndjekur metoda për të luftuar viruset, që mund të shkaktonin pneumoninë dhe infeksionin e veshit, tashmë ato do të përpiqeshin të shmangnin viruset psikike të keqformimit emocional. Sidoqoftë, ndryshimi qëndronte se, nëse prindërit mund ta dallonin menjëherë kur fëmijët ishin fizikisht të shëndetshëm, shëndeti mendor ishte një çështje e gjerë interpretimi dhe keqinterpretimi.

Ideja thelbësore e edukimit të ri të fëmijëve ishte se, sjellja e fëmijës është shprehje e disa shtysave njerëzore bazë – nevojave dhe dëshirave, të cilat janë të natyrshme dhe, për këtë arsye, normale. Për më tepër, këto shtysa janë pozitive, në kuptimin që janë burimi i vërtetë i energjisë psikike që farkëton zhvillimin e personalitetit. Për

këtë arsye, shtysave instiktive u duhet lejuar shprehja, në mënyrë që të plotësohen nevojat bazë. Nëse u përgjigjemi shumë ashpër dhe me ndëshkim shfaqjeve sjellore të këtyre nevojave, apo i frustrojmë, nuk mund të zerë vend zhvillimi normal. Çështje më keq akoma, shkaktohen ndjenja faji, të cilat bëjnë që shtysat e papranueshme të shtypen. Dhe këto shtypje janë përgjegjëse për personalitet anormal.

Më vonë u kuptua se, rritja emocionale, apo psikologjike, ashtu si rritja fizike, bëhet me faza. Në secilën nga këto faza nevojat bazë shoqërohen me pjesë të ndryshme të trupit dhe plotësohen me aspekte të ndryshme të funksionimit trupor. Shtysat më kryesore, që janë seksi dhe agresiviteti, për këtë arsye, shprehen në sjellje karakteristike të secilës fazë të zhvillimit. Nga kjo pikëpamje, u mendua se sjellje të tilla nuk janë të dëmshme, por thjesht pjesë e zhvillimit normal, i cili do të nxitet nëse plotësohen si duhet këto nevoja të fshehura.

Këto ide pasqyronin një ndryshim dramatik në dallim me pikëpamjet e mëparshme për sjelljen e fëmijëve dhe, ndërlikimet që përmbanin ato për ndryshimet në edukimin e fëmijëve ishin tronditëse. Mënyra se si iu interpretuan këto ide prindërve dhe nga prindërit, shihet qartë në këtë pjesë të shkëputur nga një artikull i vitit 1945 shkruar nga një specialist i njohur në fushën e këshillimit për fëmijët:

Le të shpresojmë se shumë prindër e kanë mësuar se frustrimet janë të këqija për fëmijët, se ato sjellin çrregullime neurotike apo prishje të karakterit të llojeve të ndryshme. Si rrjedhim, ata janë përpjekur të shmangin ato mënyra sjelljeje me fëmijët që shkaktojnë "ndjenja faji", në të njëjtën kohë e kanë kuptuar se shumica e eksperimentimit seksual dhe akteve agresive tek fëmijët e vegjël nuk janë "të këqija", ashtu siç mendoheshin më parë, por vetëm primitive apo fëmimore, pjesë e materialit të parë, nëse do shpreheshim kështu, të personalitetit

të ardhshëm, i cili mund të bëhet i fortë apo i deformuar, sipas shkallës me të cilën edukohen impulset e forta.

Një nga këto mënyra (për të prodhuar ndjenja faji tek fëmijët) është dështimi për të njohur si një fazë të vlefshme dhe të domosdoshme të zhvillimit prirjet egoiste dhe agresive të fëmijës, apo kuriozitetin dhe dëshirat e tij seksuale dhe trajtimi i tyre si diçka e turpshme dhe mëkatore.

Sidoqoftë, pikëpamja e re e tejkaloi pranimin e një sjelljeje të veçantë drejt formulimit të një qëndrimi të ri kundrejt vetë natyrës njerëzore. Meqë shtysat njerëzore janë natyrale dhe të "mira", atëherë kjo tregon qartë pastërtinë e natyrës njerëzore. Fëmijët lindin natyrshëm "të mirë" (jo të "këqinj"), të mbushur me potencial pozitiv, të cilin ata duhet të ndihmohen ta realizojnë. Në rreshtat më poshtë ishte një mesazh i qartë për edukimin e fëmijëve:

Metoda tradicionale e disiplinës nënkupton se, nëse qeniet njerëzore dhe, veçanërisht fëmijët do të bënin një zgjedhje në një situatë të caktuar, ata do të bënin pa dyshim zgjedhjen më të keqe, se ndëshkimi apo kërcënimi është e vetmja masë mbrojtëse për sjelljen e mirë. E vërteta... është pikërisht e kundërta. Fëmijët, nëse do të kishin një rast për aprovim, do të preferonin t'i kënaqnin të rriturit se sa t'i mërzisnin. Ata do ta ndryshojnë sjelljen e tyre të padëshirueshme shumë më shpejt nëse do të lavdëroheshin dhe do ta ndjenin se të rriturit kanë besim në qëllimet e tyre të mira, se sa çdo të vepronin si pasojë e ndëshkimit, apo kërcënimit për të.

Urgjenca për të modifikuar metodat tradicionale kishte një anë pozitive, po ashtu edhe atë negative. Qëndrimet e vjetra ndëshkuese, jo vetëm që krijonin represione dhe, si pasojë, edhe një zhvillim patologjik, por, ato ndërhyenin gjithashtu edhe tek zhvillimi pozitiv që do të ndodhte, nëse nuk pengohej nga përgjigjet

prindërore. Në atmosferën e një mendimi të tillë një peshë e madhe i vishej ndikimit të ambientit të hershëm. Fati i ardhshëm i fëmijës qëndronte në duart e nënës, jo vetëm mirëqenia e tij emocionale, por edhe vetërealizimi i tij gjithashtu. Dashuria, e jo ndëshkimi, ishte arma më e rëndësishme e saj. Fuqia e nënës për të dëmtuar, sidoqoftë, e tejkalonte fuqinë për të bërë mirë. Besohej se neurozat shkaktoheshin si pasojë e traumave që shfaqeshin para moshës 6 vjeç dhe, për këtë arsye, shqetësimet emocionale mund të diktoheshin në sjelljen e nënës.

Po si në botë mund ta plotësonte një nënë përgjegjësinë monumentale, me të cilën përballej ajo brenda qëllimit të ri të edukimit të fëmijëve: shëndet mendor të fëmijës nëpërmjet vetërealizmit? Ndihej ishte rrugës në formën e një libri të vogël xhepi botuar në vitin 1946, që kushtonte vetëm 25 cent, të cilit i ishte vënë titulli aspak tërheqës “Libri i xhepit për bebin dhe kujdesin ndaj fëmijës.” Ai u shkrua nga Dr. Benjamin Spock, një pediatër që kishte marrë trajnim në psikiatri, i cili u përpoq të zbatonte perspektivën e tij psikoanalitike për pyetjet specifike të edukimit të fëmijëve, të cilat i shqetësonin nënat. Ndikimi i Dr. Spokut mbi një brez prindërisht dhe fëmijësh është vënë në dukje ashtu si duhet, shpesh në mënyra thellësisht prekëse. Megjithatë, përgjigjja e pabesueshme ndaj librit të tij sugjeron se, jo vetëm që kishte ardhur koha, (kishte filluar buja e bebes në periudhën e pasluftës) po, gjithashtu, ekzistonte një uri e madhe për këso lloj këshillash.

Cilatdo qofshin arsyet për joshjen e madhe të librit, qëllimi i tij ishte të përhapte si mulli me erë teoritë e reja mbi edukimin e fëmijëve. Për të parën herë një numër i madh prindërisht u ekspozuan ndaj një prishje psikologjike dhe ajo që ishte provuar nga disa guximtarë, tashmë do të praktikohesh gjerësisht.

“Bebi dhe kujdesi ndaj fëmijës,” jo vetëm që shpjegonte me terma të thjeshtë një teori të re për zhvillimin e fëmijës, por ajo e përktente këtë teori në metoda konkrete që duhej të zbatoheshin

për çdo fazë të zhvillimit të fëmijës. Nën petkun e këtyre metodave fshihej një qëndrim, që thoshte se nevojat e fëmijës janë të ligjshme dhe duhet të respektohen, se sjellja e tij është shprehje e këtyre nevojave, dhe se qasja më e mirë është ajo që ndjek shprehjen e këtyre nevojave nga vetë fëmija. Tema kryesore është vendosur në një kapitull fillestar të librit nën titullin “Kënaquni me beben tuaj”:

Ai nuk është ngatërrestar, ai ka nevojë për dashuri. Ju do të kuptoni nga gjithçka që do të dëgjoni për bebet që kërkojnë vëmendje se ata vijnë në këtë botë të vendosur për t'i bërë zap prindërit e tyre, me hir a me pahir. Këtu nuk ka asgjë të vërtetë. Bebi juaj ka lindur për të qenë një qenie njerëzore e arsyeshme dhe miqësore... Ai nuk ka pse të edukohet me ashpërsi... ai do t'i përshtatet mënyrës së jetesës së familjes herët a vonë, pa shumë mundim nga ana juaj... Dëshira për të shkuar gëzueshëm me njerëzit e tjerë zhvillohet tek ai si pjesë e shpalosjes së natyrës së tij...

Është pikërisht kjo tema e “shpalosjes së natyrës së tij” që shfaqet herë pas here gjatë gjithë librit:

“Pse qan bebi kur i afrohet koha për të ngrënë? Jo për ta mundur nënën e tij, po ai do ca qumësht.”

“... ju mund t'ia lini tërësisht në dorë atij kur të bjerë dhe kur të ngrihet.” (nga gjumi)

“Thithja e gishtit në muajt e parë nuk është zakon, ajo tregon një nevojë.”

“Ai buzëqesh herët sepse është qenie sociale... sepse është natyra e tij.”

Elaine Heffner

“Hiqeni gradualisht nga gjiri... merreni lehtë dhe ndiqeni atë, ai do t’ju udhëheqë.”

“Metoda më e mirë nga të gjitha, është t’ia lini trajnimin e tualetit pothuajse në dorë tërësisht bebit tuaj.”

“Sillni ndër mend se natyra e tij e nxit atë t’i provojë gjërat dhe prishet nga direktivat.”

“Një nënë mund t’i besojë oreksit të paprishur të fëmijës për të zgjedhur një dietë të plotë.”

“Fëmijët mësojnë t’i kontrollojnë vetë ndjenjat e tyre të agresivitetit... Një fëmijë normal i mëson këto kontrolle dalëngadalë gjatë rrjedhës së zhvillimit të shpalosjes së natyrës së tij...”

Mesazhi që del këtu është shumë i qartë: Fëmija është si puna e bimës, gjethet e së cilës do të shpalosen dhe do të lulëzojnë të gjitha vetë, mjafton që ta ujisim sa duhet dhe të ketë edhe diell. Po ashtu, mirësia e natyrshme e fëmijës do të shpaloset pa ndonjë edukim të veçantë, mjafton që të mos ketë ndonjë ndërhyrje të panevojshme. Metodën e rekomanduar për ta bërë të mundur këtë lloj rritje – pra uji dhe drita e diellit – zhvillohen natyrshëm, nisur nga kjo pikëpamje. Gjithsesi, ato ishin një largim rrënjësor dhe i skajshëm nga shumë metoda të atëhershme mbi edukimin e fëmijës. Për shembull, mbi temën e ushqimit të bebes, nënave u ishte shpjeguar se oraret e rrepta që i kishin tiranizuar ato, ishin në të vërtetë një imponim i shkencës së mjekësisë. Është shumë më e natyrshme t’i ushqesh bebet kur ata janë të uritur dhe është me të vërtetë qesharake të thuash se, do t’i prishësh po të veprosh kështu.

Dr. Spock i këshillon nënat të mos i mbajnë fëmijët në djep apo në kosh, por t’u japin atyre lirinë për t’u sorollatur përreth shtëpisë

TË JESH NËNË

dhe për të eksploruar. Për ta realizuar këtë, ai rekomandon ta sistemojmë shtëpinë në atë mënyrë që objektet e çmuara, të thyeshme apo të rrezikshme të vendosen larg fëmijëve. Ai i paralajmëron prindërit kundër mbështetjes në fjalën “Jo” dhe përshkruan si ta manipulosh fëmijën e vogël me tërheqjen e vëmendjes dhe me respekt. Prindërve, gjithashtu, iu mësohen ca ide të reja për bindjen dhe ndëshkimin. Në rradhë të parë, fëmijët nuk kanë nevojë për një sasi të caktuar ndëshkimi për t’u mirërritur. Nuk është frika nga ndëshkimi ajo që ua mëson fëmijëve sjelljet e mira dhe respektin për të tjerët, por është më tepër ndjenja e dashurisë dhe respektit që kanë për prindërit e tyre. Është dëshira për aprovim, ajo që i pengon fëmijët nga kryerja e gjërave “të këqija”. Një fëmijë mund të mos bindet gjithmonë në mënyrë të përsosur, por kjo nuk është e nevojshme.

Ndonëse Dr. Spock kërkonte t’iu përcillte prindërve besimin pozitiv që ata mund të kishin tek fëmijët nëse i trajtonin si duhet, ai, në të njëjtën kohë, i sqaronte ata mbi pasojat e rënda të trajtimit të keq:

“Bebi që nuk merr dashuri do të rritet i ftohtë dhe i papërgjegjshëm.”

“Me kalimin e kohës, ju do të prireni ta bëni atë ngatërrestar dhe të padëgjueshëm, kur përpiqeni shumë për edukimin e tij.”

“Nxitja e fëmijës për të ngrënë më tepër se ç’duhet mund ta bëjë atë që “të humbë disa nga ndjenjat e tij pozitive për jetën.”

“Lënia e fëmijës për një kohë të gjatë duke qarë “do ta dëmtojë shpirtërisht.”

“Mos përdorni masa penguese për ta larguar atë nga zakoni i thithjes së gishtit – ato do ta frustrojnë atë dhe kjo “nuk i bën mirë.”

“Nëse heqja nga gjiri iu bëhet betejë e vërtetë, ai ndoshta do të qepet pas shishes shumë më gjatë se po të vepronit ndryshe, dhe ndoshta nuk do ta dojë qumështin në gotë për muaj, madje edhe vite.”

“Ndonjëherë, lufta për ta hequr nga gjiri nis një problem të vërtetë të të ushqyerit dhe ky, po ashtu, mund të sjellë probleme të tjera në sjellje.”

“Nëse nëna fillon ta mësojë me zor në tualet, nuk vuan vetëm ky aspekt, por, gjithashtu, edhe personaliteti i tij... Ai bëhet shumë i padëgjueshëm, thotë jo për gjithçka... bëhet shumë armiqësor dhe kundërshtues.”

“Mosaprovimi i nënës e bën fëmijën të ndihet në siklet dhe në faj. Nëse ajo përpiket ta bëjë atë të ndihet i keq që është bërë pis...kjo ka prirjen ta shndërrojë atë në një mistrec që fut hundët kudo, i llojit të tillë që ka frikë të kënaqet, apo të provojë diçka të re...”

“Nëse fëmija godet një fëmijë tjetër, “largojeni me takt...nuk është mirë të derdhni turp mbi të – kjo vetëm sa do ta bëjë të ndjehet edhe më i braktisur dhe më agresiv.”

“Nëse fëmija rreth moshës 2 vjeç nuk i jep gjërat e tij, ai po sillet normal për moshën që ka...nëse ju do ta detyroni ta japë karrocën e tij të shtrenjtë kurdo që të dëshirojë një fëmijë tjetër, ju vetëm sa do t'i krijoni ndjenjën se e gjithë bota ka dalë t'ia rrëmbejë gjërat... Kjo do ta bëjë atë më dorështrënguar, në vend që ta bëjë më pak.

I parë nga pikëpamja e ditëve të sotme, Dr. Spock nuk duket si përkrahës i metodave “tolerante” të rritjes së fëmijëve. Ndonëse ai mbron qendrimet e reja kundrejt fëmijëve dhe një liri më të madhe për ta, ai ishte shumë i qartë për standartet e sjelljes që priteshin dhe ishte sigurisht synimi i tij që prindërit të qëndronin në krye të detyrës.

Sidoqoftë, më domethënës se sa metodat e Dr. Spock-ut mbi mirërritjen e fëmijëve, ishte mesazhi që dilte prej tyre. Zbatimi prej tij i mendimit Frojdian theksonte idetë binjake që po shfaqeshin gjithnjë e më tepër në interpretimet e teorisë psikologjike: Fëmijët janë të mirë nga natyra, ndaj edhe zhvillimi i tyre “natyral” do të jetë i mirë. Trajtimi i papërshtatshëm pengon zhvillimin e tij “normal”, dëmton fëmijën dhe çon në problem personaliteti. Në botimin e parë të librit të tij, Dr. Spock shpreh idenë se vetë natyra e fëmijës do ta udhëzojë atë në drejtimin e duhur dhe, po ashtu, i bën të qarta pasojat e qasjeve të gabuara. Me gjithë dëshirën e tij të shprehur për t'u dhënë besim në vetvete prindërve, nënkuptimi mjaft i qartë është se bebi e di më së miri.

Nuk u desh shumë kohë për të kuptuar se, shumë prindër nuk po merrnin nga Dr. Spock-u atë që ai kishte dashur të shprehte. Rreth vitit 1950 ai e ndjeu të domosdoshme të tërhiqte vëmendjen drejt një problemi të ri të sjelljes në foshnjëri, përkatësisht rezistencës për të fjetur. “Shpeshtësia e saj duket se është e lidhur me prirjen për të sistemuar vetveten dhe një dashamirësi më të madhe për bebet dhe konfuzionin se si ta zbatojmë këtë filozofi.”

Në vitin 1957, në një variant të rishikuar të librit “Bebi dhe kujdesi i fëmijës,” prindërve u shtohet më tepër çoroditja. Për shembull, ndonëse fëmija ende lind për të qenë një njeri i arsyeshëm dhe miqësor, nënës i thuhet që t'ia plotësojë dëshirat e tij “po qe se ato ju duken me vend dhe po qe se ju nuk bëheni skllavër të tij.” Prishja e fëmijës ndodh kur nëna është “shumë e frikësuar për të përdorur logjikën e saj, apo kur ajo me të vërtetë do që të jetë skllave

e tij dhe e nxit bebin e saj për t'u bërë padron." Problemit të prishjes i kushtohet vëmendje edhe më e madhe nga ajo e botimit të vitit 1946. Dr. Spock vë në dukje se fëmijët që prishen kanë prindër të cilët janë:

... aspak të gatshëm për të sakrifikuar rehatin dhe të drejtat e tyre, përherë në ankth për t'ia siguruar fëmijës gjithçka që ai kërkon. Kjo mund të jetë shumë më keq, nëse bebi do ta dinte çfarë do të ishte më e arsyeshme për të kërkuar. Por, ai nuk e di se çfarë është e mirë për të.

Dhe tashmë ja tek është një shtojcë e re për natyrën e bebit: "Është në natyrën e tij që të presë drejtim nga prindërit."

Diskutohen keqkuptimet për ushqyerjen sipas regjimit të udhëhequr nga vetë fëmija dhe vihet në dukje se, disa prindër që dëshironin të hiqnin qafe oraret e caktuara të së shkuarës, menduan të bëjnë pikërisht të kundërtën dhe "ta ushqejnë fëmijën në çfarëdo orari që të zgjohet dhe të mos e zgjojnë asnjëherë për ta ushqyer..."

Mbi çështjen e stërvitjes së tualetit, vihet në dukje se metoda e pritjes së vetë fëmijës për të marrë iniciativën, për disa prindër nuk funksionoi fare dhe se disa prindër "bëheshin kaq të shqetësuar rreth stërmundimit të tij, saqë nguronin t'i jepnin fëmijës qoftë edhe një inkurajim pozitiv."

Në mënyrë mjaft domethënëse, tashmë ka një ndarje të re mbi rreptësinë apo tolerancën. Dr. Spock vë në dukje se, në filozofinë e rritjes së fëmijëve ka ndodhur një revolucion dhe se, "nuk është e mundur të ndryshojmë kaq shumë ide rreth natyrës dhe nevojave të fëmijëve pa u përfshirë shumë prindër." Prindërit, që kanë patur telashe me idetë e reja, kanë deshifruar kuptimin në to, i cili shkonte përtej asaj që kishin për qëllim shkencëtarët. Për shembull,

... gjithçka, për të cilën kanë nevojë fëmijët është dashuria, të cilën ata nuk duhet të detyrohen t'i përshtaten, se ata duhet të lejohen t'i shprehin lirshëm ndjenjat e tyre agresive ndaj prindërve dhe njerëzve të tjerë, se për çfarëdo që të shkojë keq fajin e kanë prindërit, se kur sillen keq fëmijët, prindërit nuk duhet të inatosen dhe t'i ndëshkojnë, por, duhet të shfaqin më tepër dashuri. Të gjitha këto keqkuptime nuk funksionojnë nëse shpien tepër larg. Ato i nxitin fëmijët të bëhen më urdhërues dhe më të pabindur... Ato i bëjnë prindërit të stërmundohen për të qenë mbinjerëz.

Çfarë ndodhi? Po si një teori e tillë e re dhe e mirë për natyrën njerëzore i bëri fëmijët të shndërrohen në urdhërues dhe të pabindur, ndërsa prindërit i bëri të goditen me stërmundim mbinjerëzor? Mos diçka nuk shkonte me teorinë, apo me mënyrën, me të cilën u interpretua dhe u zbatua? Duket se rrjedhojat e paparashikueshme të mënyrës së re të rritjes së fëmijëve erdhën, po aq si pasojë e mënyrës se si u dërgua mesazhi i saj, aq sa edhe nga mënyra se si u perceptua.

Gjithçka filloi me idenë se aspekti egoist, impulsiv, urdhërues, agresiv, kënaqësi kërkuar i sjelljes feminare nuk ishte "i keq" ashtu siç ishte menduar, por vetëm një shprehje e nevojave natyrale njerëzore. Këto nevoja ishin normale, por frustrimi dhe shtypja e tyre prej metodave të vjetra të rritjes së fëmijëve, kishte çuar në një zhvillim anormal. Meqenëse anormalja ishte e padëshirueshme, apo e keqe, përfundimi që doli ishte se, normalja do të thoshte e dëshirueshme, apo e mirë. Përtej kësaj, sidoqoftë, ishte konkluzioni se, nëse frustrimi dhe represioni kishin shkaktuar neurozë dhe dëshpërim, vetërealizimi dhe plotësimi i dëshirave do të sillte shëndetin mendor dhe lumturinë e shumëkërkuar.

Përpjekja për t'i vënë në zbatim këto teori krijoi një pështjellim të ri. Fëmijët i shprehin nevojat e tyre me anë të sjelljes. Që t'uua plotësojmë nevojat atyre, u duk se ishte e nevojshme t'i lejonim ata të

shprehnin vetveten me të gjitha llojet e sjelljeve dhe t'ua plotësonim të gjitha dëshirat. Të ndërhyje në sjelljen e tyre, apo t'ua mohojë dëshirat, ata bëheshin të dëshpëruar – po synimi ishte lumturia. Është e lehtë të kuptosh se ku të çonte kjo. Nëse shëndeti mendor varej nga ngopja e dëshirave, mungesa e frustrimit dhe lumturia, atëherë nevojat dhe dëshirat e fëmijës duhet të vireshin në qendër të vëmendjes. Imponimi nga dikush tjetër i nevojave dhe dëshirave do të shpjegonte edhe frustrimin që duhej shmangur. Dëshpërimi i fëmijës do të ishte një shenjë që tregonte rrezik. Shëndeti i tij mendor ishte në rrezik!

Në një atmosferë të tillë nevojat “normale” të fëmijës, të shprehura në sjellje “normale” filluan të kishin një ngjashmëri me sjelljen, për të cilën na këshillonin gjithmonë moralistët e vjetër. Kënaqja e këtyre nevojave “të mira”, për të cilat mendohej se do të sillnin shëndetin mendor dhe lumturinë në mënyrë misterioze, po udhëhiqnin rrugën drejt sjelljes “së keqe” dhe “zhvillimit anormal.” Për më tepër, gjithë fajin e kishte nëna. Meqenëse natyra e fëmijës ishte e mirë, fajin e kishte nëna që kishte dështuar në plotësimin e nevojave të tij ashtu si duhet. Natyra normale e fëmijës na ka çuar në natyrën anormale të nënës. Besimi te fëmija “i mirë” ka sjellë me vete besimin në nënën “e keqe”. Nëse natyra njerëzore është e keqe, fëmijët duhet të bëhen të mirë. Nëse natyra njerëzore është e mirë, atëherë, dikush i ka bërë fëmijët të këqinj.

Ishte pikërisht ky zbatim i të mirës dhe të keqes, ai që na futi i pari në telash. Ndjenja se sjellja ishte moralisht “e keqe” - e mëkatshme – solli masat shtypëse, që u zbuluan se luanin rol në shtrembërimin e personalitetit. Pasi mësuam se sjellja ishte normale, na udhëhoqi ideja se ajo duhet të ishte “e mirë.” Çoroditja kryesore, nga e cila e patën burimin të gjitha, ishte barazimi i normales me të mirën, veçanërisht e mirë në kuptimin moral absolut me të cilin ishim mësuar. Normale nuk do të thotë e mirë apo e keqe. Ajo do të thotë se është vetë natyra e gjërave – mënyra si funksionojnë ato. Jo çdo gjë natyrale është e mirë. Vullkanet

dhe tërmetet sjellin shkatërrim kur zgjohen, dhe sigurisht, që nuk janë të mirë për njerëzit që vrasin. Por, ata kanë një qëllim në natyrë dhe vetëm nga kjo pikëpamje mund të jenë të dëshirueshëm.

Po ashtu, disa nevoja dhe dëshira të caktuara janë pjesë e natyrës njerëzore dhe, si rrjedhim, janë normale. Por, kjo nuk i bën ato të mira. Ato, gjithashtu ekzistojnë për t'i shërbyer një qëllimi dhe, sjellja që krijohet nga këto shtysa natyrale duket e mirë, apo e keqe, varet se si e besojmë ne qëllimin e tyre. Gjykimet mbi sjelljen ekzistojnë dhe marrin kuptim vetëm në një kontekst shoqëror. Kur ne e quajmë sjelljen të mirë apo të keqe, nuk e nënkuptojmë këtë për jetën në xhungël. Këto koncepte, nga mënyra se si i vëmë në zbatim, dalin nga një realitet shoqëror: me të mirë ne kemi për qëllim të themi i dëshirueshëm për vetë jetën në shoqëri. Për këtë arsye, kur flasim me terma shoqërorë, një sjellje “normale” e fëmijërisë është “e keqe” (e padëshirueshme), dhe jo “e mirë” (e dëshirueshme). Teoria e Frojdit këtë e bën të qartë. Por, megjithatë, normalja u barazua me të mirën dhe mori të njëjtat ngjyime morale si e keqja, sikur “e mira” të ishte një abstraksion që ekzistonte më vete apo në lidhje me qiellin, në vend që të kishte lidhje me vlerat shoqërore dhe jetën në këtë botë. Shkurtimisht, ne shpikëm një ideal të romantizuar të natyrës njerëzore, i cili sugjeronte se nëse fëmijës do t'i jepej rasti të shpalosej, ai nga natyra e tij, do të sillej në mënyrë të admirueshme.

Ideja ishte se, meqenëse nevojat sociale janë pjesë e jetës njerëzore, vetëm duke lejuar personalitetin të zhvillohet, automatikisht do të sillte sjellje sociale, si për shembull respekti dhe kujdesi për të tjerët. Por, në fakt “shpalosja e natyrës” vjen si rezultat i pjekurisë dhe të mësuarit, të cilat ndodhin në një ambient social. Është ky realitet i jashtëm që cënon nevojat e lindura, të cilat stimulojnë zgjidhjen e problemit dhe të mësuarit që kërkohen, nëse fëmija duhet të plotësojë këto nevoja në këtë botë. Dëshirat e fëmijës janë normale, por vetëm dëshira nuk do të thotë arritje. Atij

i duhet të mësojë si të arrijë qëllimet dhe si të plotësojë dëshirat e tij. Meqenëse dëshirat e tij mund të jenë normale, mënyra natyrale e plotësimit të tyre mund të mos jetë e dëshirueshme në shoqëri. Nëse nevojat e fëmijës shprehen gjithmonë me anë të një sjellje të padëshirueshme sociale, nevojat e tij nuk do të plotësohen mirë asnjëherë.

Zhvillimi i personalitetit nuk ndodh nga shpalosja misterioze e natyrës së tij, por, në sajë të ndërveprimeve me ambientin e tij. Një ambient ideal, që do t'i shkonte për shtat nevojave përgjatë zhvillimit të tij, nuk ekziston. Ai nuk është pjesë e jetës së vërtetë. Për këtë arsye, frustrimi është i pashmangshëm. Dhe është pikërisht frustrimi, ai që pjesërisht jep shtytjen për të mësuar për t'i plotësuar nevojat e njeriut.

Ishte dëshira për këtë ambient ideal dhe të përsosur që do të kryente ngopje të plotë të dëshirave dhe nuk do të impononte asnjë frustrim të habitshëm në përpjekjen për të zbatuar teorinë psikoanalitike në rritjen e fëmijëve. Sipas kësaj teorie, edhe frustrimi, edhe plotësimi i dëshirave janë të domosdoshëm për rritjen emocionale. Nëse nuk kemi plotësim të dëshirave, individit ngelet në një shkallë të prapambetur të zhvillimit në përpjekjen për të arrirë këtë ngopje. Prandaj, pak frustrim është i domosdoshëm për të nxitur kërkimin për metoda më të pavarura për të plotësuar dëshirat e njeriut. Edhe plotësimi tej mase mund të jetë në vetvete frustrim sepse ai dështon në mbështetjen e nevojave që lindin për të rritur sigurinë në vetvete. Gjithsesi, kur këto ide u hodhën në praktikë, plotësimit të dëshirave iu vesh pektu i shëndetit mendor, ndërsa frustrimi mbartte kërcënimin për patologji.

Rritja tradicionale e fëmijëve bazohej pikërisht mbi idenë e kundërt. Plotësimi i të gjitha dëshirave shihej si rruga e sigurt që të çonte drejt prishjes dhe karakterit të keq. Frustrimi i imponuar me metoda edukimi të rrepta do t'i përgatiste fëmijët të përballeshin me realitetet e jetës. Por, zhvillimi anormal i personalitetit kishte

të bënte pikërisht me këto metoda të rrepta të edukimit të fëmijës. Si rezultat, frika nga neuroza u lidh me frustrimin e tejskajshëm. Përveç kësaj, dëmtimi potencial që vinte nga frustrimi ishte diçka, me të cilën mund të identifikoheshin prindërit e viteve 1950, meqë ata e kishin përjetuar në jetën e tyre. Këtyre prindërve iu duk se iu dha leja për t'u dhënë fëmijëve të tyre atë që atyre u ishte mohuar. Ideja origjinale ishte se duhej të ishte mirë t'ua plotësonin nevojat e fëmijëve, sepse kjo do t'i krijojte mundësinë atyre të rriteshin dhe më në fund të zhvillonin aftësinë për t'i plotësuar vetë nevojat e tyre. Në fakt, plotësimi i nevojave u bë një qëllim në vetvete. Nevojat dhe dëshirat u shndërruan në të mirë absolute që duhej të plotësoheshin si qëllim në vetvete, më shumë se sa për të realizuar qëllime më të larta të zhvillimit. Ky fokus mbi vetëplotësimin, i arritur nëpërmjet plotësimit të nevojave dhe dëshirave, ka qenë shfrytërimi kryesor në edukimin bashkëkohor të fëmijëve. Plotësimi u bë sinonim me lumturinë personale, apo shëndetin mendor. Nëse plotësimi i dëshirave është parë si rruga drejt lumturisë, atëherë kënaqësia bëhet objektivi kryesor, ndaj dhe dhimbja, apo frustrimi janë krejtësisht të patolerueshëm.

Besimi se frustrimi është “i keq” ishte gjysma tjetër e idesë se plotësimi i çdo dëshire është “i mirë.” Këto dy ide, që ndërvepronin së bashku krijuan, një paralizë të gjykimit prindëror. Nëse qëllimi i nënës është t'i plotësojë dëshirat fëmijës së saj; nëse qëllimi i saj është të shmangë me çdo kusht frustrimin; dhe, nëse masa e vetme që ka ajo për suksesin e saj është “lumturia” e fëmijës, atëherë metoda për arritjen e qëllimit të saj do të jetë në mënyrë të pashmangshme ajo e dhënies së gjithçkaje që ai kërkon dhe e lejimit që ai të bëjë gjithçka që do. Meqenëse fëmijët i shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre me anë të sjelljes, dukej sikur mënyra e vetme për të plotësuar nevojat e tyre dhe për të shmangur frustrimin ishte të mos ndërhynin me sjelljen. Nëse nëna ka frikë nga frustrimi i fëmijës së saj, nuk ka rrugë tjetër që ajo mund ta arrijë këtë. Një fëmijë, që nuk i jepet gjithçka

që kërkon, do të shfaqë pakënaqësi dhe, nëse nëna frikësohet nga shenjat e pakënaqësisë, ajo ndodhet në telash.

Për më tepër, nënat nuk dinin si ta zbatonin konceptin e plotësimit të nevojave, përveç se duke siguruar plotësim konkret apo duke lejuar që këto nevoja të shpreheshin në sjellje. Nëse fëmija do të vizatojë nëpër mure, ai po shpreh një nevojë, kështu që mos ndërhyri në vizatimin e tij. Nëse një fëmijë ia rrëmben lodrën tjetrit në parkun e lojrave, ai po shpreh një nevojë, kështu që mos ndërhyri në rrëmbimin. Nuk ishte se nënat u dhanë leje fëmijëve të tyre të sillleshin në këtë mënyrë, apo se atyre iu dukej sjellja e pranueshme. Ato nuk e bënë këtë. Por ato besonin se ndalimi i fëmijës ishte i dëmshëm. Ato nuk dinin si t'ia bënin të ditur fëmijëve të tyre se nevojat dhe dëshirat e tyre ishin normale dhe të natyrshme, përveç se duke i lejuar t'i shfaqnin ato në sjellje. Nëse qëllimi i dikujt është të mos ndrydhë nevojat, gjëja tjetër që ka të ngjarë të ndodhë është të lejojë sjelljen.

Këshilla më e ndërlikuar e ofruar ndonjëherë në edukimin e fëmijëve është gjykimi ndaj prindërve për t'ua bërë të ditur fëmijëve se nevojat dhe dëshirat e tyre janë normale dhe ndjenjat e tyre janë të pranueshme, madje, edhe atëherë kur sjellja e tyre nuk është e tillë. Fëmijët i shprehin ndjenjat, nevojat, dhe dëshirat me anë të sjelljes dhe, madje, shpesh me anë të sjelljes së papranueshme. Kjo sjellje duket e papranueshme tek nëna dhe krijon një reagim të fortë emocional tek ajo. Nëse ajo do të vepronte e shtyrë nga të tilla ndjenja, ka më shumë të ngjarë që të përgjigjet me anë të ndëshkimit. Këtë ajo po përpiqet të mos e bëjë sepse asaj i është mësuar se sjellja e fëmijës së saj është normale dhe përgjigjet e ashpra mund ta dëmtojnë atë. Intensiteti i ndjenjave të saj bën që çfarëdo lloj veprimi nga ana e saj të duket i rrezikshëm. Duket se është mënyrë më e sigurt të mos bëjë asnjë gjë, pra, “ta lejojë” sjelljen. Nëse, nëna dëshiron t'i kuptojë dëshirat e fëmijës së saj, por, nga ana tjetër, ajo i vë kufij sjelljes së tij, ajo duhet të jetë e

qartë se sjellja është e papranueshme, por jo aq e rrezikshme, sa të kërkojë ndërhyrje të ashpër dhe ndëshkim.

Formulimet psikologjike pretendonin se sjellja e fëmijëve nuk është shprehje e diçkaje të keqe apo djallëzore brenda tyre, por, më tepër një reflektim i nevojave të tyre në fazat e ndryshme të zhvillimit. Plotësimi i nevojave të tyre, më mirë se sa reagimi me anë të përgjigjeve të ashpra dhe ndëshkuese ndaj sjelljes së tyre, do t'u bënte të mundur atyre të hiqnin dorë nga sjellja pa trauma dhe kështu të vazhdonin rritjen e tyre emocionale. **Sidoqoftë, ajo që ndodhi në praktikë ishte se, metoda dhe qëllimi u ngatërruan dhe një metodë e keqkuptuar u shndërrua në qëllim në vetvete.** Qëllimi i edukimit të fëmijëve ka qënë ai i mësimi se si të jetonin me sukses në këtë botë. Ky mësim, më herët, ishte dhënë nëpërmjet metodave ndëshkuese dhe të rrepta. Ideja e re ishte se, ky mësim mund të mësohej nëpërmjet metodave më të zbutura, metoda që shfaqnin mëshirë për nevojat që shprehnin sjelljen fëmimore dhe që do t'u jepnin kohë fëmijëve të zhvillonin këtë lloj sjelljeje. Përkundrazi, këto metoda u interpretuan me kuptimin që shprehja dhe plotësimi i nevojave të fëmijëve ishte qëllimi i rritjes së tyre. Nuk ishte vetëm koncepti i plotësimit të nevojave ai që u shfrytëzua, por gjithashtu, arritja e tij u bë qëllim në vetvete, më shumë se sa diçka për t'u shfrytëzuar në shërbim të një qëllimi më të lartë, siç ishte mundësia e fëmijës për të pasur marrëdhënie të suksesshme me botën përreth tij. Nënat nuk e dinin se, frustrimi për fëmijët ishte po aq i nevojshëm për zhvillimin, sa edhe plotësimi i dëshirave. Ato nuk e dinin se nevojat dhe dëshirat nuk kanë pse të aktrohen me qëllim që të plotësohen. Ato nuk dinin si t'i vinin kufi sjelljes së padëshirueshme me mënyra jondëshkimore. Si rezultat, vetëplotësimi i fëmijës dhe ngopja e nevojave të tij për ruajtjen e shëndetit mendor, u bë qëllimi i edukimit të fëmijëve. Ndonëse rrjedhojat e edukimit të ri të fëmijës i atribuoheshin përdorimit të metodave tolerante, më shumë se sa ato të rrepta, problemi i vërtetë nuk erdhi nga ndryshimi i metodës, por nga humbja e qëllimit.

Meqenëse, një nga nevojat e fëmijës është të jetë qenie sociale, mendohej se, pjesë e “shpalosjes së natyrës tij,” nëse nuk do të pengohej, do të ishte zhvillimi i sjelljes së pranueshme sociale. Sjellja e hershme “e natyrshme” me anë të së cilës fëmijët i shprehin nevojat e tyre, gjithsesi, shpesh nuk është e pranueshme. Nëse prindërit besojnë se fëmijët duhet të përfshihen në këtë lloj sjellje, me qëllim që t’iu plotësohen nevojat, nëse ata ngurojnë të vendosin kufij për sjelljen e pranueshme, atëherë, qartazi brenda fëmijës nuk zhvillohet asnjë nevojë kundërvepruese për ta modifikuar këtë sjellje. Fëmijët nuk mund të kenë çfarëdo lloj gjëje që të dëshirojnë, apo të bëjnë çfarë të duan, sepse kjo bie ndesh me atë që dëshiron, apo ka nevojë tjetri. Fëmijët e marrin këtë mësim nga marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Gjithsesi, nëse nëna beson se plotësimi i dëshirave të fëmijës është qëllimi i saj, më shumë se sa pjesë e ndihmës në përparimin e tij, në mënyrë që të komunikojë si duhet me njerëzit e tjerë, fokusi i saj kryesor bëhet ai i plotësimit të nevojave. Fëmija, në këtë rast, nuk përballet me realitetin e nevojave të njerëzve të tjerë, por, përkundrazi, udhëhiqet të besojë se nevojat e tij janë ato që kanë rëndësi.

Metodat e formuluar për të siguruar plotësim të menjëhershëm dhe për të shmangur frustrimin u japin fëmijëve mesazhin se kjo është mënyra se si duhet të jenë gjërat, se nënkuptohet se ata duhet “të ndihen mirë” dhe të jenë “të lumtur” përgjithmonë. Ata nuk po mësonin të duronin frustrimin, të kontrollonin impulset e tyre dhe të vononin plotësimin e dëshirave, e të gjitha këto janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e mirë të shoqërisë. Përkundrazi, të tilla metoda nxisin një dëshirë për kënaqësi të pandërprerë, çka nuk mund realizohet në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, meqenëse marrëdhëniet e suksesshme varen nga marrja parasysh e dëshirave të tjetrit, ashtu si edhe të tuat.

Supozimi se shëndeti mendor personal do të krijojë automatikisht sjellje sociale dhe do t’i mundësojë njeriut të bëhet

anëtar i përgjegjshëm i shoqërisë nuk doli aspak kështu në realitet, sepse shëndeti mendor, ashtu siç interpretohej, nuk e kishte këtë qëllim të saj. Fokusi mbi vetveten dhe shpalosjen e saj, mbi plotësimin e dëshirave dhe vetëplotësim nuk çoi aspak në respektin për të tjerët, por, në të kundërtën e tij. Dëshirat e të tjerëve janë ato, që në të shumtën e rasteve pengojnë dëshirat e vetvetes. Nëse plotësimi i dëshirave të vetvetes bëhet tejet i rëndësishëm, atëherë dëshirat e të tjerëve nuk duhet të merren parasysh.

Ne, njëherë e një kohë kemi besuar se, nevojat e individit dalin në plan të dytë në të mirë të grupit. Kur qëllimi i edukimit të fëmijës u bë plotësimi i vetvetes, duke mos marrë parasysh aftësinë e vetvetes për të shkuar mirë me të tjerët, marrëdhëniet midis individit dhe grupit u çekuilibruan në kahun tjetër. Pasi filluam me paaftësitë që vijnë nga frustrimi i tejskajshëm, ne kemi arritur të përballemi me paaftësitë që vijnë si rrjedhojë e plotësimit të tejskajshëm dhe fokusin mbi veten. Ajo që filloi me prishjen e personalitetit të fëmijës, që ndikonte marrëdhëniet e tij me botën, ka përfunduar me prishje të marrëdhënieve me botën, që ndikojnë personalitetin e tij.

Si prindër në vitet 1940 dhe 50 ishim mësuar për pasojat e mohimit të plotë të dëshirave mbi zhvillimin e personalitetit, tani po mësojmë për rrjedhojat sociale të fokusit mbi veten.

Kur brezi i “mua” arriti pjekurinë dhe kulti “Unë” mblodhi idhtarë dhe kur vetëdërgjegjësimi, ekspansioni i vetëdijes dhe vetë - aktualizimi arriti statusin e religjionit, vitet 1970 janë shpallur si dekada e Narcisizmit të ri.

Një psikiatër vë në dukje “egocentrizmin e shfrenuar tek të rinjtë sot, nevojën urgjente për të marrë ç’të mundën me përpjekje minimale dhe aspak respekt për të tjerët,” po ashtu, ai thotë se: “shkalla e vlerave, me të cilën të dyja gjinitë matin gjithçka, është vetëm ngopja e dëshirave.”

Artikujt për edukimin e fëmijëve nuk shtjellojnë më rreziqet e frustrimit, por rrjedhojat e dëshpëruara të përfshirjes me veten, kërkimin e plotësimit të dëshirave dhe autoritetin prindëror gjithnjë në humbje:

Meqenëse ne të rriturit kemi hequr dorë nga udhëheqja jonë, njëherë e një kohë e padiskutueshme, në zëvendësimin e qetësisë për autoritet, fëmijët tanë nuk janë bërë më të lirë, po përkundrazi, më të çoroditur.

Në një shoqëri ku principi kryesor duket se është: merre tënden dhe mos çaj kokë për tjetrin, si mund t'i mësojmë fëmijët tanë të kujdesen për të tjerët si për veten e tyre?

Ne kemi arritur të kuptojmë se një qëndrim sipas qejfit ndaj disiplinimit të fëmijëve... nuk është i mjaftueshëm. Shumë shpesh të vegjëlvë që u jepet gjithçka nuk mësojnë si të japin, por vetëm si të marrin.

Tashmë është vetë Dr. Spock që na tregon se, “konceptet psikologjike nuk bëjnë dobi vetëm nëse vishen me kuptimin e asaj që është e mirë dhe e drejtë” dhe e shoh si shpresën e vetme që ne t'i rrisim fëmijët tanë me ndjenjën se, ata janë në këtë botë, jo vetëm për të plotësuar kënaqësinë e tyre, por, në radhë të parë për t'u shërbyer të tjerëve.”

Nëse do të ndiqnim këtë këshillë, do t'i ktheheshim edhe një herë idesë se, dalja në pah vetëm e nevojave të individit është e rrezikshme dhe duhet të mbahet nën kontroll, për të mirën e gjithë shoqërisë. Por konflikti midis “vetes” dhe të tjerëve nuk zgjidhet nga sulmi mbi nevojat e individit, apo ato të të tjerëve. Dhe as që gjendet zgjidhje, për aq kohë sa ne i shohim këto koncepte si përjashtuese të njëra-tjetrës. Individi nuk ekziston jashtë kontekstit shoqëror. Ashtu

siç e dimë, ai varet nga të tjerët për jetën. Po ashtu, shoqëria nuk ka kuptim përveç se t'u shërbejë nevojave të anëtarëve të saj. Ndonëse individit dhe grupit mund të jenë në konflikt në një moment, ata janë një tërësi organike dhe qëllimi ynë duhet të jetë shpëtimi i të dyve. Asnjëri nuk mbijeton pa tjetrin.

Edukimi i fëmijëve nuk zë vend në boshllëk; ne po rrisim fëmijë që do të jetojnë si të rritur në një botë me të tjerët, e jo në një xhungël të izoluar. Për këtë arsye, ne duhet të kemi një pikëpamje, jo vetëm për botën se si do të dëshironim të ishte, por edhe për mënyrat me të cilat njerëzit mund të jetojnë së bashku në të. Vetëm me këtë pikëpamje, metodat e edukimit të fëmijëve marrin kuptim. Një metodë nuk është qëllim në vetvete, ajo është mjet për arritjen e tij.

Për shumë vjet me radhë iu është kushtuar rëndësi e madhe nevojave të shoqërisë së të rriturve dhe fëmijët janë rritur nëpërmjet metodave, të cilat nuk i lejonin ata të rriteshin në atë botë. Ne ishim të qartë për kërkesat e jetës në shoqëri, por i arritëm qëllimet tona në kurriz të nevojave të qenieve të tjera njerëzore. Në kërkim të metodave, të cilat do të përfshinin këto nevoja, ne humbëm qëllimin. I flakëm vlerat tona, si pjesë e rebelimit kundër mënyrës me të cilën na ishin transmetuar ato. Nevojat tona nuk ishin plotësuar, ndaj ne provuam t'ua plotësojmë ato fëmijëve tanë dhe, duke vepruar kështu, pa vetëdije u mësuam atyre se vetëm nevojat e tyre janë ato që duhet të merren parasysh. Brezit që u rrit me këtë frymë vetëplotësimi tani i duket tepër e vështirë për t'iu dhënë të tjerëve dhe, kështu, është i privuar nga një lloj vetëplotësimi edhe më i thellë. Ata janë lënë të vazhdojnë kërkimin e tyre për këtë vetëplotësim.

Ishte pikërisht kjo klimë për vetëplotësim që pjesërisht bëri të mundur një lëvizje që iu drejtua plotësimit të nevojave të grave. Antipatia kundrejt mëmësisë u zhvillua në një kontekst të fokusit mbi veten, në kontrast me shqetësimin tradicional për përgjegjësi ndaj shoqërisë. Nënave u është dhënë leje ta braktisin përgjegjësinë

që kanë ndaj fëmijëve në favor të vetëplotësimit personal. Prishja e ekuilibrit në marrëdhënien unë – tjetri, që filloi me edukimin që kishte në qendër të vëmendjes fëmijën, tashmë ka arritur përfundimin se, vetëm nevojat e nënës janë ato që duhet të merren parasysh.

Është me të vërtetë një paradoks që ky shqetësim për vetëplotësim, shprehet tani, në një formë që më në fund do ta shkatërrojë individualitetin. Nëse gjithnjë e më shumë gra do t'ia dorëzojnë fëmijët e tyre, në mosha gjithnjë e më të njoma, në ca grupe të kujdesit ditor të sponsorizuara nga qeveria, kjo eksperiencë e re e fëmijërisë në mënyrë të pashmangshme do ta riformatojë personalitetin, ashtu siç ka vepruar më parë edukimi i fëmijëve me qendër fëmijën. Është e qartë se, kujdesi ditor në grup mund të realizohet nëpërmjet një varësie më të madhe në përshtatjen dhe nënshtrimin ndaj grupit, çka nuk lejon vend për plotësimin e nevojave të individit. Kjo, gjithashtu, do të thotë se përvoja e fëmijërisë së hershme do të formohet nga një pikëpamje e vetme, e varur gjithnjë e më shumë nga kontrolli burokratik i jashtëm. Kjo do të fillojë edhe më herët presionet e shoqërisë së industrializuar, e cila në tërësi milton kundrejt barazisë dhe humbjes së identitetit personal. Në një shoqëri të tillë, familja është fortesa e fundit e individualitetit, ndërsa nëna, avokatja e fundit për personalitetin e fëmijës së saj.

Elementi i sakrificës që kërkohet në edukimin e fëmijëve është i tillë që shumë pak njerëz janë përgatitur për t'u përballur, apo janë gati ta realizojnë një gjë të tillë. Por, gjithashtu, ky lloj i edukimit të fëmijëve që është zhvilluar gjatë 30 viteve të shkuara, ka ofruar një pamje të shfytëruar të asaj sakrifice. Tabloja e përfshirjes totale me nevojat e fëmijës, duke mos patur të drejtë të marrësh në konsideratë të tuat, nuk është aspak tërheqëse për prindërim. Dhe as që janë akuzat dhe faji, nxitëse si shpërblime për mëmësinë.

Lloji tjetër i edukimit të fëmijëve, ai që merr parasysh edhe nevojat e fëmijës, edhe të nënës, është i vështirë, sepse lë pas një proces të gjatë të mësuari. Vëmendja dhe përfshirja e nënës kërkohen patjetër, si një sistem mbështetës bazë që do t'i shërbejë fëmijës, kur ai mëson të plotësojë nevojat e atyre që ka përreth. Pa këtë bazë mbështetëse, njeriu mund t'i drejtohet dhunës dhe kapitullimit: dhunës nga nëna, si pasojë, kapitullim të fëmijës, apo e anasjellta. Alternativa tjetër është në thelb një metodë joautoritare, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje për konfliktet që marrin parasysh reciprocitetin e nevojave, në vend të zgjidhjeve të imponuara nga lart. Vështirësitë në vënien në funksionim me sukses të kësaj metode dëshmojnë për llojet e çrregullimeve që janë shfaqur. Në përvojën jetësore brenda shoqërisë sonë nuk ka asgjë që do të na përgatiste për një përqsje të tillë.

Nënat kanë pasur vështirësi në zbatimin e një metode joautoritare, sepse ato vetë i janë ekspozuar një qasje të tillë. Me qëllim që një nënë të ndërveprojë suksesshëm me fëmijën, mbi bazën e plotësimit të nevojave të tij dhe të saj, kërkohet patjetër kapaciteti për vëzhgim dhe gjykim të pavarur. Me fjalë të tjera, ajo vetë duhet të funksionojë e pavarur.

Edukimi i fëmijëve i ndikuar nga psikoanaliza, ashtu siç edhe u provua, nuk u bë joautoritar. Ai vetëm sa ndërroi autoritetet. Nënat kaluan nga idetë autoritare për të gjitha aspektet e kujdesit ndaj fëmijës – sa gjumë, sa ushqim, sa vëmendje, drejt recetës që ato duhej të udhëhiqeshin nga nevojat e fëmijëve të tyre. Të papërgatitura për ta ndjekur një recetë të tillë, ato i shndërruan fëmijët e tyre në autoritet. Nënat asnjëherë nuk janë bërë profesionisti që duhet të bëhen.

Nënat kanë pasur vështirësi të besonin në të drejtat dhe në gjykimin e tyre, sepse ato janë shndërruar në fëmijë, në rolin e përmbysur të edukimit modern të fëmijës. Nga ky pozicion, ato atëherë i nënshtrohen kritikizmit, kur janë të paafta të përvehtësojnë pikëpamjen e specialistëve

psikologë se si duhet të trajtohen nevojat e fëmijëve. Por, ne ende nuk i kemi pajisur nënat me mjetet që iu nevojiten për të realizuar përgjegjësinë me të cilën ngarkohen në edukimin bashkëkohor. Ne nuk i kemi dhënë atyre njohuritë mbi zhvillimin e fëmijës, të cilat do t'u bënin të mundur ta kuptojnë sjelljen e fëmijës të lidhur me fazat e zhvillimit. Ne nuk i kemi mësuar atyre ato që dimë për mënyrën se si mësojnë fëmijët. Dhe as që u kemi ofruar atë lloj të edukimit emocional, që do t'i lehtësonte ato të përballen me sjelljen e fëmijës në ato mënyra që nuk janë shkatërrimtare, si për fëmijët, ashtu edhe për ato vetë. Nënat ende nuk e kanë marrë atë qartësi dhe mbështetje, për të cilën kanë nevojë për t'u përballur me stresin normal të mëmësisë. Përkundrazi, ato janë sulmuar sepse kanë vepruar sipas përvojës së jetës së tyre dhe, nevoja për edukim emocional ka mbartur me vete stigmën se ato kanë dështuar në kryerjen e detyrës së mëmësisë. Ashtu si në vetë edukimin e fëmijës, metodat që përdorim ne për të mësuar nënat, lidhen me qëllimet tona. Qëllimi i vetëm i mëmësisë është të zhvillojë aftësinë për sjellje të pavarur, dhe kjo nuk mund të arrihet me metoda autoritare.

Nëse ato do të duhet t'u mësonin këtë fëmijëve të tyre, vetë nënat duhet të kenë respekt për nevojat e tyre. Nëse do të duhet t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të rriten, ato vetë duhet të ndihmohen "të rriten." Pavarësia dhe gjykimi i pavarur duhen, po aq për mëmësinë, sa edhe për botën profesionale. Por, ndërsa ne e kemi njohur dhe i jemi drejtuar nevojës për këtë të fundit, nuk e kemi bërë këtë me atë të parën.

Ne patëm një brez nënash pa fare përvojë në fëmijërinë e tyre, që do t'u mësonte atyre të merrnin në konsideratë nevojat dhe të drejtat e tyre. Ato, si pasojë, kanë rritur një brez pa bazë fëmijërie, ku mbështeten për të marrë parasysh të drejtat dhe nevojat e të tjerëve. Nuk jemi më të lirë tani, se atëherë. Sepse liri e vërtetë është liria për të trajtuar të tjerët njëllor si veten, duke e ditur se nuk është asgjë më pak se egoizmi i nxjerrë nga padija, i cili na shtyn për të vepruar në këtë mënyrë.

Bibliografia

Bettelheim, Bruno, M.D. Fëmijët e Ëndrrës, New York: The Macmillan Company, 1969.

Bird, Caroline, së bashku me Briller, Sara Welles. Të lindësh femër, New York:

David McKay Co. Inc. 1970.

Cardozo, Arlene. Gratë në shtëpi. Garden City, N.Y.

Doubleday & Company, Inc. 1976.

Curtis, Jean. Nënat që punojnë jashtë shtëpisë. Garden City, N.Y. Doubleday & Company, Inc. 1976.

Davis, Glen. Fëmijëria dhe Historia në Amerikë. New York: The Psychohistoric Press, 1977.

Decter, Midge. Prindër liberalë, Fëmijë radikalë. New York: Coward, McCann & Geoghegan, Inc. 1975.

Deutsch, Helene, M.D. Psikologjia e grave. Vol. 2

Mëmësia. New York: Grove & Straton, 1945.

Diamond Stanley. "Dinamika e personalitetit në komunitetin izraelit: Një analizë psikohistorike e dy brezave." Periodiku Historia e fëmijërisë, Vol. 3 Nr. 1 (verë 1975).

Dinnerstein Dorothy. Zonja dhe minotauri. New York: Harper & Row, 1976.

Freud Sigmund. "Seksualiteti femëror" (1931), në Letrat e tubuara, Vol. 5 Londër: The Hogart Press.

Freud Sigmund. Një ravijëzim i psikoanalizës. New York: W.W. Norton & Company, Inc. 1949.

Freud Sigmund. Qytetërimi dhe të pakënaqurit e tij. New York: W.W. Norton & Company, Inc. 1961.

Friedan Betty. Mistika e feminizmit. New York: W.W. Norton & Company, Inc. 1963.

Friedan Betty. Ajo ndryshoi jetën time. New York: Random House, Inc. 1976.

Gaylin, Willard. M.D. Përkujdesja. New York: Alfred A. Knopf, 1976.

Greer, Germaine. Femra eunuk. New York: McGraw – Hill Book Company, 1971.

Grossman, Edward. “Në ndjekje të femrës amerikane.” Harper’s Magazine, Shkurt 1970.

Hendin, Herbert. M.D. Shekulli i ndjenjave. New York: W.W. Norton & Company, Inc. 1975.

Keniston, Kenneth dhe Këshilli Carnegie mbi fëmijët. Të gjithë fëmijët tanë. New York: Harcourt BraceJovanovich, 1977.

Lazarre, Jane. Nyja e nënës. McGraw – Hill Book Company, 1976.

Lundberg, Ferdinand dhe Fernham, Marynia. F. M.D. Gruaja moderne: Gjinia e humbur. New York: Harper & Brothers, 1947.

Mead, Margaret. Mashkull dhe femër. New York: William Morrow & Company, 1949.

Millett, Kate. Politikat seksuale. Garden City. N.Y. Doubleday & Company, Inc. 1970.

Radl, Shirley. Dita e nënës ka marrë fund. New York: Chatterhouse, 1973.

Spock, Benjamin, M.D. Libri i xhepit për beben dhe kujdesin ndaj fëmijëve. New York: Pocket Books, Inc. 1946, 1957, 1976.

Tanner, Leslie B. Zëra nga liberalizimi i grave. New York: New American Library, 1971.

